

Islam Karanfli - Dr. Zihni Osmani

# GJUHA SHQIPE DHE LEXIMI

N\_P I J ? Q\_L G/

*Shkup, 2020*

**Recensentë:**

Dr. Ismet Osmani  
Merita Kolçi - Koxhaxhiku  
Ibe Mustafa

**Lektor:**

Mr. Dritan Osmani

**Redaktor teknik dhe disenji:**

Naser Fera

**Botues:**

Ministria e arsimit dhe shkencës  
e Republikës së Maqedonisë së Veriut

**U shtyp në shtypshkronjën:**

ArbëriaDesign - Tetovë

**Tirazhi:**

1.429

Me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të R. së Maqedonisë nr. 22-2322/1 të datës 21.04.2010, ky liber lejohet në përdorim.

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св.Климент Охридски" , Скопје  
373.3.016:811.18 (075.2)

KARANFILI, Islam

Gjuha shqipe dhe leximi për klasën IX / Islam Karanfile, Zihni Osmani.  
- Shkup: Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut,  
2020. - 210 стр. : илустр. во боја ; 26 см

**ISBN: 978-608-226-433-2**

1. Osmani, Zihni [автор]  
COBISS.MK-ID 111885322

# PËRMBAJTJA:

O, sa bukuri ka tufa! - <i>Naim FRASHËRI</i> .....	7
Te bregu i detit - <i>Zef SEREMBE</i> .....	9
Vaji i bylbylit - <i>Ndre MJEDA</i> .....	10
Ku janë ata djem të ri - <i>Pjetër BUDI</i> .....	12
Vallja e luleve - <i>Lasgush PORADECI</i> .....	14
Mbeçë, more, shokë, mbeçë - <i>Populli</i> .....	16
Besa e Konstandinit - <i>Legendë</i> .....	17
Erveheja - <i>Mubamet KYÇYKU</i> .....	22
Lisi i Milosaos - <i>Moikom ZEÇO</i> .....	24
Dallëndyshë eja! - <i>Filip SHIROKA</i> .....	27
Në kërkime - <i>Enver GJERQEKU</i> .....	30
Mallkimi i nënës - <i>Sterjo SPASSE</i> .....	32
Plaku prej bore - <i>Azis NESIN</i> .....	36
Zana e fundit e bjeshkëve - <i>D. SHAPLLO</i> .....	42
Gjëegjëzat.....	46
Dr. Gjilpëra “shëron” Arifenë e Zylfikar agait - <i>Faik KONICA</i> .....	47
Kultura - <i>Tajar ZAVALANI</i> .....	52
Poema e mjerimit - <i>Millob Gjergj Nikolla – MIGJENI</i> .....	54
Një mbrëmje në Lurë - <i>Ismail KADARE</i> .....	58
Shpell’ e Dragobisë - <i>Fan S. NOLI</i> .....	62
Besa - <i>Sami FRASHËRI</i> .....	65
Në Manastir te Migjeni - <i>Nasbo JORGAQI</i> .....	70
Kush e solli Doruntinën - <i>Ismail KADARE</i> .....	73
Te hani i bishtanakes - <i>Jakov XOXA</i> .....	75
Anës lumenjve - <i>Fan S. NOLI</i> .....	79
Oda e burrave - <i>Kim MEHMETI</i> .....	82
Konica dhe qëllimi i jetës së tij - <i>Fan NOLI</i> .....	84
Korbi - <i>Edgar ALLAN POE</i> .....	87
Të falem o mësues - <i>Ramiz KELMENDI</i> .....	89
Udha e shkronjave - <i>Rahmi TUDA</i> .....	92
Fyelli i gdhendur në gur - <i>Moikom ZEÇO</i> .....	94
Kur mungon atdheu - <i>Ali PODRIMJA</i> .....	97
Qortimet e vjeshtës - <i>Qemal STAFEA</i> .....	100
Kthimi i Gjergj Kastriotit në Krujë - <i>Fan S. NOLI</i> .....	103

<b>Mali për jug - Konstandin MILLADINOV</b> .....	<b>105</b>
<b>Priami i lutet Akilit - Omeri</b> .....	<b>107</b>
<b>Po unë dua të mësoj - Aleks ÇAÇI</b> .....	<b>110</b>
<b>Në qytetin e liliputëve - Xbonatan SUIFT</b> .....	<b>115</b>
<b>Letrat dhe llojet e letrave</b> .....	<b>118</b>
<b>Filmimi dhe kinematografia</b> .....	<b>120</b>
<b>Gazetat dhe revistat</b> .....	<b>121</b>
<b>Probleme të drejtshkrimit të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve</b> .....	<b>123</b>
<b>Drejtshkrimi në rastet e takimit të bashkëtingëlloreve</b> .....	<b>129</b>
<b>Përdorimi i drejtë i nyjave</b> .....	<b>133</b>
<b>Përdorimi i shkronjave të mëdha</b> .....	<b>134</b>
<b>Përemri vetor</b> .....	<b>137</b>
<b>Gjuha shqipe gjuhë indoevropiane</b> .....	<b>140</b>
<b>Gjuha letrare dhe dialektet e gjuhës shqipe</b> .....	<b>144</b>
<b>Përcaktuesit e emrit</b> .....	<b>145</b>
<b>Përemri lidhor dhe i pacaktuar</b> .....	<b>148</b>
<b>Folja dhe veçorit e saj</b> .....	<b>152</b>
<b>Mënyra kushtore dhe kohët e saj</b> .....	<b>156</b>
<b>Mënyra habitore dhe kohët e saj</b> .....	<b>160</b>
<b>Struktura e grupit emëror dhe funksionet brenda tij</b> .....	<b>163</b>
<b>Struktura themelore e fjalisë</b> .....	<b>166</b>
<b>Grupi foljor</b> .....	<b>169</b>
<b>Rrethanorët dhe llojet e tyre</b> .....	<b>171</b>
<b>Tipat e fjalive dhe struktura e tyre</b> .....	<b>173</b>
<b>Rendi i fjalëve në fjali</b> .....	<b>178</b>
<b>Fjalia e thjeshtë dhe fjalia e përbërë</b> .....	<b>180</b>
<b>Rrethanori i kohës</b> .....	<b>182</b>
<b>Rrethanori i vendit</b> .....	<b>184</b>
<b>Rrethanori i qëllimit dhe i shkakut</b> .....	<b>186</b>
<b>Rrethanori i kushtit</b> .....	<b>190</b>
<b>Rrethanori i lejimit</b> .....	<b>191</b>
<b>Fjalia e përbërë me më shumë se dy pjesë</b> .....	<b>193</b>

# O, SA BUKURI KA TUF!

Dua të dal maj malit, të shoh gjithë Arbërinë,  
vëllezërit shqiptarë, që venë në pun'e vinë,  
burrat trima me besë dhe shpirtmir'e punëtorë,  
dhe fushatë gjithë lule e maletë me dëborë.  
O! Sa bukuri ka tufa! Sa gaz bije bagëtia!  
Vinë posi blet'e plotë! I bekoftë perëndia!  
Nëpër shesh'e nër bregore janë përhapurë shqerrat,  
e kecërit nëpër rripat dhe në gjethet e në ferrat,  
sa me vrap e me gaz bredhin edhe lozin shoku me shok;  
aty përhapen me nxit, aty mblidhenë prapë tok,  
edhe prapë tufë-tufë përhapen duke bredhur,  
duke ikur me vrap shumë, duke lojtur, duke hedhur.  
Nxitojn'e s'lodhenë kurrë edhe, kur i merr uria,  
secili futet në tufë, suletë në mëm'e tia.  
Posa gjen mëmën e dashur edhe me vrap i hyn në gji,  
rri në gjunjë dhe zë sisën e qumshtin e ëmbël pi,  
pa e ëma me mall' shumë, ndo dhi qoftë a ndo dele,  
Birr'e vetëm merr në gji me gaz e me përkëdhele.

*Naim Frashëri*



## ***Fjalë dhe shprehje***

*tufë-a* - kope, grigjë

*bregore-ja* - kodër e vogël

*shqerrat* - qengjat

*rripë-a* - tokë e përpjetë, vend i varur, shpat

*me nxit* - me nxitim, shpejt



### ***Komentojmë tekstin***

Cila është tema dhe ideja që trajton poeti në vepër?

Nga ç'pamje është frymëzuar N. Frashëri për të shkruar këto vargje kaq të bukura?

Si i përfytyron Naimi bashkatdhetarët e tij?

Në cilat vargje del kjo?

Ç'ju bën më tepër përshtypje në këtë skenë baritore që përshkruan Naimi?



### ***Detyrë***

Mësoni përmendsh vjershën.



### **NAIM FRASHËRI (1846 – 1900)**

Naim Frashëri është poeti më i madh i Rilindjes sonë Kombëtare. Ai është atdhetar, mendimtar dhe veprimtar i shquar i arsimit dhe i kulturës shqiptare. Gjithë jetën dhe veprën e tij Naimi ia kushtoi çështjes së çlirimit të Shqipërisë nga zgjedha osmane. Lindi në Frashër të Përmetit, ku kaloi edhe fëmijërinë dhe rininë. Atje shijoi bukuritë e natyrës së mëmëdheut dhe më vonë në atë temë bëri hapat e parë në vjershërimin shqip. Mësoi në gjimnazin “Zozimeja” të Janinës ku studioi historinë dhe letërsinë. Mësoi disa gjuhë. Në atdhe punoi në Berat e në Sarandë. Ngjarjet e vitit 1878 ndikuan në formimin e Naimit si atdhetar dhe si poet i madh. Botoi këto vepra: “Bagëti e bujqësi”, “Lulet e verës”, “Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve” (greqisht), “Qerbelaja”, “Historia e Skënderbeut” etj. Vdiq në vitin 1900 në Stamboll.

# TE BREGU I DETIT

Atje nga bregu i detit shoh një valë  
që me oshëtimë stuhia e degdis,  
si një mal ujët ngrihet pa u ndalë  
si për të rrahur qiellin e zi pis.

Dielli mbulohet, qielli është i zënë  
nga mjegulla që dhenë e tërë fsheh:  
dhe koha e keqe krejt pas krahëve le  
helmet dhe frikën që s'kanë të thënë.

Era ra dhe tufani mbaroi,  
duke qeshur në qiell dielli dolli  
dhe natyra stoliset hare.

Mëkata paqën e vjetër dërrmoi  
edhe neve një valë helmesh na solli:  
Po gjaku i arbërit dha paqën e re.

*Zef Serembe*



## ***Të komentojmë poezinë***

Cili është motivi që paraqet poeti në këtë poezi?

Pse poeti në të dy vargjet e para thotë:

“Atje nga bregu i detit shoh një valë  
që me oshëtimë stuhia e degdis”?

Nga cila anë poeti i vërejti valët?

Për ç'valë helmesh e ka fjalën poeti dhe cili gjak solli paqën e re?

## **SONETI (tingëllima)**

Soneti ose tingëllima është një vjershë e tërë e përbërë prej katër strofash, ku kombinohen katërmbëdhjetë vargje. Dy strofat e para janë katër vargueshe dhe dy të fundit janë treshe. Rimojnë midis tyre strofa e parë me të dytën kurse e treta me të katërtën. Skema më të zakonshme janë ABBA, CDC, EDE. Sonete të bukura në gjuhën shqipe përveç Zef Serembes ka shkruar edhe Ndre Mjeda (Liria, Lisus, Scodra) si dhe Petrarka e Dante Aligieri tek italianët.



### **ZEF SEREMBE (1843 – 1901)**

Zef Serembe është poet i shquar i letërsisë arbëreshe. Figura e tij është më origjinale, më komplekse dhe më e dhembshme në letërsinë tonë. Të njohura janë vjershat e tij me motive erotike dhe atdhetare. I botoi Kozmo Serembe pas vdekjes së autorit, me titullin “Vjersha” më 1926.

### **Lirika**

Lirika është lloji letrar ku përshkruhen gjendja shpirtërore, mendimet, ndjenjat që i lindin poetit nën ndikimin e jetës shoqërore. Llojet e poezisë së lashtë lirike janë: himni, oda, ditirambi, elegjia etj. Ndërsa llojet e poezisë së sotme lirike janë: poezia sociale, patriotike, erotike, peizazhiste, refleksive etj.

## **VAJI I BYLBYLIT**

Po shkrihet bora  
dimri po shkon  
bylbyl i vorfën,  
pse po gjimon?  
Pushoi murlani  
me duhi të vet  
bylbyl i vorfën,  
çohu, mos rri shkret.  
Gjithë fushat e malet  
blerimi i mbuloi





livadhi e përroi  
gjithkah lulzoi.  
Ndër pyje e ograja  
në ma të mirin vend  
me rreze dielli  
po e gëzon gjithkënd.  
A çil kafazi  
bylbyl, flutro,  
ndër pyje e ograja  
bylbyl, shpejto.  
Po shkrihet bora,  
dimni po shkon;  
bylbyl i vorfën  
pse po gjimon?



*Ndre Mjeda*

### **Shënim**

Në këtë vjershë, poeti përmes alegorie të qëlluar u drejtohet shqiptarëve, që të ngrihen kundër robërisë shekullore dhe të fitojnë lirinë për vendin e vet.



### **Fjalë dhe shprehje**

*gjimon* - rënkon mbyturazi nga dhimbja ose nga fatkeqësia

*dubi-a* - vrrull i fuqishëm

*ograjë-e* - livadh pranë pyllit a në mes të korijeve, kullosë bagëtish

*a çil* - është çelur



### **Komentojmë poezinë**

Ç'ka dashur të tregojë poeti nëpërmjet bilbilit, kafazit dhe dimrit?

Ç'ndjenja shpreh poeti në këtë vjershë?

Cila strofë ju pëlqen më shumë dhe pse?

Shpjegoni me fjalët tuaja vargjet:

...a çil kafazi bilbil flutro

ndër pyje e ograja bylbyl shpejto...



### **Detyrë**

Mësoni vjershën përmendsh dhe bëni një recitim të bukur artistik.

# KU JANË ATA DJEM TË RI

Ku janë ata pleq bujarë,  
që qenë përpara ne,  
e ata trima sqimatarë,  
të shpejtë si rrufe?

Ku janë ata djelm të ri,  
të bukur e të lulzuom,  
që pate pamë me sy,  
me ta folë e ligjruom?

Ku janë ata zotërinj,  
që dojin me zotënuam  
ndë sqime e ndë madhështi,  
këtë jetë tue shkuom?

Ku janë ata perandorë  
gjithë shekull nalcuom,  
në krye me një kunorë,  
gurëshi të paçmuom?

Ku janë ata letërorë  
t'urtë e dijës të ndëgjuom,  
të bardhatë posi borë  
letëra tue kënduom?

Ku janë ata gra e vasha  
ndë sqimë e ndë madhështi,  
me petëkat të mëndafshta  
nolcuom mbë zotëni?

Gjithë mortja i rrëzoi  
sikur i pret me shpatë,  
për të ri si shukoi,  
as të vobegë, as të begatë.

*PJETËR BUDI*

## **Shënim**

Kjo poezi është shkëputur nga vepra “Doktrina e krishterë” e shkrimtarit të letërsisë së vjetër shqiptare, Pjetër Budit. Autori në këtë vjershë i thekson disa nga cilësitë e shqiptarëve, krenohet me rrinë e vendit të vet dhe me të kaluarën e ndritur të kombit. Në këtë vjershë Budi njëherit vë në pah të vërtetën e perjetshme se, ashtu siç ka jetë, ka edhe vdekje, përpara së cilës të gjithë janë të barabartë.



### **Fjalë dhe shprehje**

*Sqimatar-e* – që i pëlqen të vishet bukur e pastër  
*gurishtë* – vend me shumë gur



### **Komentojmë poezinë**

Ç’ndjenjë e përshkon këtë poezi?  
Cilat janë cilësitë e shqiptarëve të trashëguara brez pas brezi?  
Ç’përshkruan poeti në strofën e pestë të vjershës?  
Në cilin dialekt është shkruar kjo poezi?

## **PYETJA RETORIKE**

Siç shihet, në vargjet e kësaj poezie poeti pyet, por nuk pret përgjigje dhe kështu poezia ka fituar më tepër fuqi shprehëse e emocionale, përkatësisht poeti këtu ka përdorur figurën stilistike që quhet pyetje retorike.

Figura stilistike që tërheq vëmendjen e lexuesit ose të dëgjuesit duke pohuar diçka në trajtë të një pyetjeje, por pa pritur përgjigje, quhet pyetje retorike.

Pyetja retorike si figurë stilistike në letërsinë shqipe haset edhe te poezia “O moj Shqypni!” e P.Vasës; “Kështjella e Krujës” e Azem Shkrelit etj.



### **Detyrë**

Përpiquni të mësoni për recitim këtë poezi.  
Krahasoje këtë poezi me atë të Pashko Vasës dhe gjeni figurën stilistike që përputhe me këtë?

## **PJETËR BUDI (1566 - 1622)**

Pjetër Budi lindi rreth vitit 1566 në fshatin Guri i Bardhë, rrethi i Matit. Mësimet e para i bëri pranë klerit të vendit. Në moshën 21-vjeçare u emërua prift. Disa vjet punoi në vise të ndryshme të Kosovës, kurse në vitin 1599 u emërua vikar i përgjithshëm i Serbisë. Në vitin 1618 Budi arriti të nxjerrë nga shtypi librin e tij të parë “Doktrina e Krishtenë”. Në vitin 1621 ai botoi librin e dytë “Pasqyra e të rrëfyemit” dhe të tretin “Rituali roman”. Këta libra autori i firmos si peshkop i Zadrimës.

# VALLJA E LULEVE

Vijnë vashat valle valle  
Gjyshë-e-gji-stolisur  
Një pëllumb, një sy-zorkalle  
Se vjen m'e mbollisura.

Ç'm'i ka hije shtat'i hedhur,  
Hije kraharuari,  
Pa fillon me zë të dredhur  
Motra së kënduari:

Ju që niseni për lule,  
Shoqe moj të mijëza,  
Merr-më-ni as edhe mua  
Nër pyje-e korijëza;

Pritni moj të vi dhe unë  
Maleve, lëndinave,  
Ndaj çkëlqen pa të përdhunë  
Fill-i trendelinave;

Në mos diça të bëj tufë,  
Shoqe ju dëgjomëni:  
Bëni moj një tog me lule  
Dhe me to mbulo-më-ni;

Në ju pyeçin për mua:  
Ç'u bë flog-banusheja?  
Thoni, se më një përrua  
E zu gjarpërusheja:

Thoni, se ndaj një mburimi  
Më t'e patë fluturën:  
Thoni, seç e zuri trimi  
Atë bel-këputurën.

*Lasgush Poradeci*



## ***Komentojmë vjershën***

Në cilat strofa rrëfimi e ndërton “heroi lirik” dhe në cilat poeti?  
 Pse poeti e ka ndërtuar rrëfimin në këtë mënyrë?  
 Ku shkojnë vashat e stolisura?



## ***Detyrë***

Shpjegoni kuptimin e vargjeve:

Thoni, se më një përrua  
 E zu gjarpërusheja:  
 Thoni seç e zuri trimi  
 Atë bel-këputurën.

## ***Motivi, tema dhe ideja e poezisë lirike***

Strukturën e krijimeve letrare e përbëjnë disa elemente, të cilat së bashku paraqesin ndërtimin apo përbërjen e veprës letrare.

Si elemente të krijimtarisë letrare janë:

### **1. Motivi i veprës letrare**

Motivi është njësia më e vogël tematike e krijimit letrar. Ky është një element shumë i rëndësishëm i krijimtarisë letrare, sidomos i poezisë lirike e cila shpeshherë sipas motivit që shtjellon ndahet në lloje të ndryshme. Motivi pra, është shkaku, nxitja, arsyeja, ngacmimi, që e ka inicuar poetin të krijojë një krijim letrar.

### **2. Tema e veprës letrare**

Tema e veprës letrare është një rreth i caktuar dukurish që zgjedh poeti nga realiteti dhe i përgjithëson në vepër.

Çdo vepër letrare ka temë të caktuar. Ato mund të jenë të nduarnduarshme si p.sh.: ngjarjet, personat, dukuritë e ndryshme shoqërore, marrëdhëniet klasore, jeta e përditshme, veset e një individi, veset shoqërore etj. P.sh.: tema e veprës së N. Frashërit “Bagëti e buqësi” është himnizimi i natyrës shqiptare dhe i punëve të blegtorisë e buqësisë. Tema e vjershës së Migjenit ‘Poema e mjerimit’ është mjerimi i shtresave të varfëra të qytetit etj.

### **3. Ideja e veprës letrare**

Ide e veprës letrare është mendimi kryesor që buron prej ngjarjeve, të cilat shkrimtari i shkruan në vepër.

Çdo vepër letrare përmban një ide, të cilën lexuesi mund ta zbërthejë vetë, por vetëm duke u zhytur në analizën e saj. Kështu, duke lexuar romanin “Afërdita” të S. Spasses kuptojmë se ideja e atij romani është transformimi i njerëzve, çrrënjosja e prapambeturisë, e cila arrihet nëpërmjet të arsimimit dhe edukimit të njerëzve.

## ***Epika***

Epika është lloj letrar ku jeta pasqyrohet nëpërmjet rrëfimit për ngjarje dhe për njerëz që kanë marrë pjesë në to, për sjellje dhe emocione të tyre në rrethana të ndryshme. Lloje të veprave epike janë: përralla, tregimi, novela, romani etj.

# **MBEÇË, MORE, SHOKË, MBEÇË**

Mbeçë, more shokë mbeçë,  
përtej Urës së Qabesë;  
Falëm me shëndet nënesë,  
të dy qetë të m'i shesë,  
t'i jap nigjah të resë.  
Të më shesë kal' e mushkë.  
Të më rrisë djal e çupë.  
Në pyet nëna ime për mua,  
i thoni që u martua.  
Në thëntë se ç'nuse mori,  
shtatë plumba te kraharori,  
në thëntë ç'kalë hipi,  
në dy drurë pe meiti.  
Në thëntë n'ç'oda e mbyllë,  
në një odë ndë qereç bina,  
pa penxhere, pa baxha.

*Populli*

## ***Shënim***

Kjo këngë popullore (baladë) trajton fatin e nizamit shqiptar (ushtar i shërbimit të detyruar ushtarak në kohën e Turqisë) jetën dhe shqetësimet e tij. Marrja e djemve nizamë i sillte popullit fatkeqësi të rënda. Poezinë e përshkon ndjenja e dhembjes, e ankimit, e protestës. “Kënga e Urës së Qabesë” është më e bukura e këngëve të nizamëve dhe një nga margaritarët e rrallë jo vetëm të poezisë sonë, por edhe të poezisë popullore botërore në përgjithësi. (I. Kadare “Autobiografia e popullit tim në vargje”).

# BESA E KONSTANDINIT

*Gjashtë e gjashtë dymbëdhjetë,  
Doruntina trembëdhjetë!...*

Ish një herë e një mot një mëmë shumë e mirë e kish dymbëdhjetë bij të hijshëm. Të trembëdhjetën kish një bijë të bukur mbi të gjitha shoqet, që i thoshin Doruntinë.

Vasha u rrit e u bë për t'u martuar.

Mirëpo nga bujarët e atij vendi asnjë nuk e gëzoi.

Të gjithë e dëshironin, askush s'guxonte ta zërë nuse, sepse nuk e ndiente veten të zotin ta merrte për shoqe.

Atëhere na vjen një trim i largët: i mirë, i hijshëm, i fisëm dhe nis dërgon shkesë dallëndyshen që ta kërkojë Doruntinën nuse. E ëma dhe të njëmbëdhjetë vëllezërit e mëdhenj nuk donin t'ja jepnin, sepse trimi, ndonëse i mirë, ishte nga një vend shumë i largët. Vetëm i vogli, Konstandini, donte.

- T'ja japim, zonja mëmë, - thosh ai, - se trimi është i mirë. Më ka hyrë në zemër.

- Konstandin, biri im, ç'po më thua ti kështu? – ia kthente e ëma. – Aqë larg do ti që të ma shpiësh Doruntinën time? Se, në e daça për gëzim, për gëzim nuk do ta kem; se, në e daça për helm, për helm nuk do ta kem.

- Të jap besën, zonja mëmë, se kur ta duash ti Doruntinën, qoftë për gaz, qoftë për helm, vete unë e ta sjell.

Mëma edhe të njëmbëdhjetët u bindën: e fejuan dhe e martuan Doruntinën me trimin e largët. Bënë dasmë nëntë ditë. Të dhjetën trimi mori nusen e shkoi te dheu i tij i largët. Mëma e vasha qanë me lot kur u ndanë..

... Shumë luftëra u luftuan atë mot te dheu ynë, se kish ardhur i huaji ta shkelte e ta pushtonte. Të dymbëdhjetë vëllezërit dolën të luftojnë për vendin e tyre dhe u vranë një, pas një, të gjithë.

Kur iu vra djali i parë, mëma shërëmtiu e tha:

- Biri im, unë nuk kam helm e nuk do të të qaj, sepse ti re për dheun tënd e më mbeten njëmbëdhjetë bij të tjerë për luftë.

Kur ju vranë gjashtë, që të gjashtë trima e të dashur... ajo derdhi vetëm nga një lot për secilin e bëri vetëm nga një vajtim. Po kur nisën t'i vriten edhe të tjerët, mëmës iu këput zemra dhe lëshoi një shërëmtimë të

madhe sa uturoi tërë vendi:

- Mjerë unë, ç'helm i madh të mos e kem Doruntinën pranë në këtë zi, që më mbuloi shtëpinë!

Kur u vra djali i fundit, Konstandini, mëma shkuli leshrat e bardha e thirri:

- Bobo, vdekje, e nëmosura vdekje! Ti më more dymbëdhjetë bij e tani kush mund ta dijë a s'ma ke marrë edhe bijën time të vetme, bijën time të dëshëruar!

Kur u gdhi e shtuna e të vdekurve, mëma vajti te varret e të bijve. Dymbëdhjetë djem kish pasur, dymbëdhjetë varre kish tani... Mbi çdo varr bëri nga një vajtim, po mbi varr të Konstandinit bëri dy vajtime, qau me ngashërim e thirri tri herë:

- O biri im! O biri im! O biri im! ...

Edhe tri herë të tjera:

- O Konstandin! O Konstandin! O Konstandin!

Pastaj u shemb përdhe, pushtoi gurin e varrit e u trua:

- Konstandin, o biri im, ku është besa që më dhe, se do të ma sillje Doruntinën, tët motër? Besa jote vdiq bashkë me ty e kalbet në varr të zi!

Kështu tha dhe e lau gurin me lotët e syve.

Në mesnatë Konstandini u ngrit nga varri. Guri i varrit u bë kalë i zi si nata. Edhe dheu i zi u bë shalë e zezë si nata. Rrotulla që mbante gurin, u bë fre i argjendtë. Trimi i hipi kalit, u përkul përpara, uli kryet dhe i ra me shporet. Kuptoi si frymë male e fusha, hodhi lumenj e përrenj, la prapa katunde, kodra, pyje...

Konstandini arriti te shtëpia e së motrës, kur kish dalë dielli. Ajo ditë ndodhi ditë e kremte. Në shesh, përpara shtëpisë, gjeti të bijtë e së motrës, nipërit e tij, që loznin e vraponin pas dallëndysheve. I pyeti:

- Bij të zemrës, ku është zonja mëma e juaj?

- Konstandin, o zoti lalë, - i thanë ata, - mëma jonë po hedh valle në fshat, atje tek bëhet dasmë.

Konstandini shkoi shpejt te vallja e parë, pa një luzmë vashash të bukura tek këndonin e vallonin dhe tha me vete: "Të bukura jini, moj vasha, po për mua nuk jini, sepse unë s'jam nga kjo botë..." Dhe u afrua t'i pyesë:

- Gëzuash, o vasha të bardha! A është me ju Doruntina, motra ime?

- Shko përpara, trim, se do ta gjesh tek kërcen e hareshme veshur me petk të ndritur kadifeje.

Konstandini vajti tek vallja e dytë dhe u mat të pyesë përsëri, po Doruntina e pa vetë e i thirri:

- Konstandin, o im vëlla!



Dhe Doruntina iu afrua, e përqafoi.

Konstandini i tha:

- Doruntinë, motra ime! Eja të shkojmë. Të do zonja mëmë në shtëpi!

Më thuaj, vëlla, si të vij unë atje? Po të më dojë për gaz, do të vete të marr stolitë më të mira, po të më dojë (mos qoftë thënë!) për helm, do të vete të vishem me të zeza.

- Eja, motër, ashtu si je!

E mori në vithet e kalit. Kali ik si shakullimë. Ata kapërcejnë si në ëndërr male e fusha, pyje e kodra, lumenj e përrenj. Hëna e yjet kanë shtangur lart e shikojnë me të drojtur.

Gjatë udhës motra e pyet vëllanë:

- Konstandin, vëllathi im, përse shpatullat e gjera të janë mbuluar me myk.

- Doruntinë, motra ime, shpatullat m'i ka mbuluar tymi i shkluhave në luftë, se në vendin tonë u bënë luftëra të mëdha, erdhën armiq të na shkelin dhe ne të gjithë dolëm të luftojmë.

- Konstandin, vëllathi im, përse flokët e dredhura i ke tërë pluhur?

- Doruntinë, motra ime, gjatë udhës kishte shumë pluhur dhe m'i pluhurosi flokët.

- Konstandin, vëllathi im, përse vëllezërit e mi të bukur si drita s'kanë dalë përpara të na presin?

- Doruntinë, motra ime, ndofta janë në lodër e s'presin që të vemi sonte.

- Konstandin, vëllathi im, përse dritaret e shtëpisë janë sot mbyllur krejt?

- Doruntinë, motra ime, i kemi mbyllur se fryn nga deti era e fortë e dimrit.

Kur arrinë pranë kishës, Konstandini i tha së motrës:

- Ti shko përpara, se unë dua të hy të përgjunjem.

Konstandini shkoi e hyri prapë në varr të zi. Kali u bë prapë gur, shala u bë dhe, freri i argjendtë u bë rrotullë. Dhe përsëri rreth e qark zotëroi heshtja e vdekjes. Ndërkaq Doruntina ngjiti shkallët dhe trokiti gazmend në derë.

- Mëmë, hapma derën!

- Kush je ti që trokëllin aty te dera?

- Hapma, zonja mëmë! Jam unë, bija jote Doruntina!...

- Ik tutje nga ke ardhur, o vdekje e shkretë! Ti m'i more të dymbëdhjetë djemtë e tani ke ardhur të më marrësh edhe mua që të mos e shoh më Doruntinën time!

- Ç'po thua ashtu, zonja mëmë? Nuk ma njeh zërin? Besa, zonja mëmë, jam unë vetë, Doruntina jote.

- Ngul gishtin e vogël te vrima e kyçit: që ta shoh e të ta njoh.

Doruntina nguli gishtin e vogël te vrima e kyçit-atë gisht të hollëz e të

bardhë. Mëma ja njohu sakaq e i hapi derën.

- Kush të solli këtu, o zemra ime?

- Më solli Konstandini, im vëlla.

- Cili Konstandin, moj bijë? Konstandini im ka vdekur bashkë me të njëmbëdhjetë vëllezërit e tjerë. U vranë në luftë...

Dhe si rrinin të dyja, njëra te pragu e tjetra te dera, plasën si qelqi me verë...

*Legjendë*

### ***Shënim***

Ky tregim është punuar sipas dy baladave arbëreshe: asaj të Doruntinës, që këndohet në Sicili, dhe asaj të Garentinës, që këndohet në Kalabri, të tretura bashkë në një të vetme. Nga këto, më e hidhur duket ajo e Doruntinës, sepse lidhet me disa ngjarje historike që kanë ndodhur në të moçmen në vendin tonë, kur vetëm nga një derë u vranë dymbëdhjetë vëllezër për mbrojtjen e atdheut. Pas kalimit të shqiptarëve në islam, kjo baladë ka kaluar edhe në variantin islam, ashtu që edhe emrat e personazheve janë ndërruar në Halili e Hajria.





*Monaliza - Leonardo Da Vinci*

# ERVEHEJA

Pa dëgjoni një përrallë  
t'atyre moteve të parë  
të vërtetë po të rrallë,  
për punëra që kanë ngjarë.

Në shkronjë Kopsht' është shkruar  
si ngjau pun' e Ervehesë,  
i urti duke kënduar  
prej përrallës merr pjesë.

Erveheja që një grua,  
që s'kish shoqe atë ditë,  
vashëz' e si u martua,  
posi hëna kur ep dritë.

Me bukuri me mënt shumë,  
me çdo fjal' e me çdo punë  
burrën' e kishte nderuarë.

Burr' i saj e donte shumë,  
sa s'e duaj vetëhenë  
gjithënjë thosh lumi unë,  
që kam grua Ervehenë.

I ra puna të largohej,  
dërgoi e thirri vëllanë,  
tha: "Vlla, ty të besohem,  
të lë shtëpin' e gruanë.

Të m'a kesh kujdes shtëpinë  
të shikojsh gruanë time,  
t'a dëftejsh vëllazërinë,  
të mos m'i lipsetë qime;

Se mua kshu më ra puna,  
që të marr udhë të gjatë,  
ty, vëlla, besë të zura,  
të m'i gjindesh dit' e natë“.

Vëllaj përsipër ja mori  
punërat' e Ervehesë,  
tha: “Po të them un' i gjori,  
s'të jam vëlla i pabesë.

Po shko, mos ja ke mendinë,  
se u çdo që t'i lipsetë  
ashtu shprej mbë Perëndinë,  
më mirë se të jesh vetë“.

Dh' ati çurk' i vanë lotë,  
nga zemëra mpsherëtit,  
përsëri kthehet' i thotë,  
përsëri e porosit.

Dorën' i merr duke qarë,  
“ në dorë t'a le shtëpinë“,  
tha, dh' arth koha për të ndarë,  
s'mund të mbante ngasherinë.

Përsëri vëllaj i thot,  
“ s'le të metë për Ervehenë”,  
dhe u qas i fshiu lotë,  
tha, “vëlla, mba vetëhenë”.

MUHAMET KYÇYKU



### ***Fjalë dhe shprehje***

*moti* – dikur, një herë e një kohë, në kohë të vjetër, qëmoti

*psberëtimë-a* – marrja frymë thellë dhe nxjerrja e saj me forcë, zakonisht kur jemi të brengosur a të mërzitur

*ngashëri-a* – gjendja e atij që është i ngarkuar, mallëngjimi i thellë. Flet (qan) me ngashëri



### ***Komentojmë poezinë***


Cila është tema në këtë poemë?

Gjeje strofën ku përshkruhet bukuria e Ervehesë.

Në cilën strofë flitet për besnikërinë e Ervehesë dhe ç'kupton me atë?

Pse burri i Ervehesë ishte i detyruar të marrë rrugë të gjatë?

Pasi të kuptosh përfundimin e vërtetë të poemës, ndaji personazhet në pozitive dhe negative!



### ***Detyrë***

Përpiqu ta gjesh veprën “Erveheja” të Muhamed Çamit – Kyçyikut dhe lexojeni atë në tërësi.

## **LISI I MILOSAOS**

Në oborrin e shtëpisë së vjetër, pranë dritares gjelbëronin e fëshfërinin degët e gjethet me erë të një lisi të madh shekullor.

De Rada edhe në gjumë e ndjente fëshfërimën e lisit. Tani ai ishte 80 vjeç. Qe thinjur i tëri. Ngjante si një pellazg i dalë nga legjenda. Dikush e kishte quajtur “Pellazg i poezisë”. De Rada kishte buzëqeshur kur e kishte dëgjuar këtë gjë. Ai vetë kishte qenë i pari që kishte shkruar një studim për pellazgët, popull i stërlashtë më i vjetri i Evropës, aq sa dhe Homeri i kishte quajtur “Proselinoi” që do të thotë “Të lindur para Hënës”.

De Rada rrinte tani në shtratin e fortë. Kishte mbetur krejt vetë (gruaja dhe tërë fëmijët i kishin vdekur). Ai jetonte në shtëpinë e thjeshtë të një bariu arbëresh.

U dëgjua një trokitje në dritare.

- Ja, po çohem tani! - tha De Rada dhe u ngrit nga shtrati.

Në xham trokiste djali 15-vjeçar i bariut. Ai qe çuar nga gjumi dhe kishte nxjerrë nga ahuri mushkën. Me këtë mushkë De Rada bënte disa kilometra rrugë për të shkuar në një fshat pranë, ku ishte shkolla, ku ai, ndonëse shumë plak e i drobitur, u jepte mësim fëmijëve arbëreshë, gjuhën e bukur, gjuhën e mrekullueshme shqipe.

De Rada u vesh, mori në dorën e djathtë shkopin prej kallami, edhe pak

bukë e djathë të lidhur me një shami që qe mbi tryezë, dhe pa nga dritarja. Dukej ende hëna. Ajo i kujtonte pellazgët e stërlashtë. “Bëhu gati të udhëtosh me hënë, o pellazg!” i tha De Rada vetes. Doli jashtë. Ajri i freskët e rrëngqethi. Kështu ai çohej shumë herët me hënë, dhe dita e re e gjente në rrugë.

Në oborr qe mushka dhe pranë saj Radavani i biri i bariut.

- Mirëmëngjes! - i tha ai.

- Mirëmëngjes! - ia ktheu me butësi De Rada. E donte shumë djalin e bariut.

Radavani afroi mushkën pranë lisit në oborr. Aty ai kishte vënë prej kohësh një gur, mbi të cilin ngjitej De Rada i moshuar, për ta pasur më lehtë që t'i hipte mushkës.

Këtë lis De Rada e kishte quajtur “Lisi i Milosaos”. Në këngën e tij të fundit, të poemës “Milosao”, De Rada përmendte një lis, pranë të cilit mbylli sytë hero i poemës, vetë Milosaoja.

- A shkoi babai me dhentë në mal? - e pyeti De Rada Radavanin.

Po!

Po pse nuk shkove edhe ti me të?

- Po unë do të të shoqëroj ty deri në shkollë. Rruga është e keqe, tërë pje-rrësira e të papritura. Ju tani jeni plak dhe ju duhet ndihma ime. De Rada vuri buzën në gaz. Kjo ishte e vërtetë. Ata udhëtonin bashkë, De Rada niste e tregonte për atdheun përtej detit, për Skënderbeun. Radavani dëgjonte me vëmendje. Kjo ishte shkolla e tij pa klasë, pa bankë e dërrasë të zezë. Po sa shumë gjëra kishte mësuar Radavani nga plakun i ditur De Radë. Dielli tani qe ngritur mbi horizont. Bota lisa kish ndërruar. Zilka tingëllonte, zogitë cicërrinin, pranvera qe kudo. Lisi i Milosaos do të blerojë çdo pranverë. Rrënjët e këtij lisi janë tepër të thella. De Rada rimbushi mushkëritë me ajër të freskët. Pranë tij ecte Radovani. Ai kishte opinga dhe një kësulë të bardhë...

“Radavani do të rritet, mendoj De Rada. Unë atëherë do të kem vdekur, po Radovani do të më kujtojë”. Dëgjoi një melodi të njohur arbëreshe.

“Në përralla flitet për fyej magjikë,” - mendoj De Rada. - Ja, fyelli i Radovanit është për mua si një fyell magjik. Ai më bën të ri, më bën sërish fëmijë. Edhe unë në moshën e Radovanit i bija fyellit. Para syve më dalin njerëzit e dashur që s'i kam më.

- Faleminderit Radavan! - belbëzoi ngadalë i rënë në mendime. Radovani vazhdoi t'i binte fyellit. Ata kishin edhe pak udhë e do të vinin te shkolla, ku plakun De Radë e pritnin nxënësit e vegjël. Melodia e ëmbël e fyellit përhapej përqark. Pas pesë ditësh De Rada s'pati më fuqi të ngrihej nga shtrati. Ditën e gjashtë ndjeu si i humbi shikimi. Ditën e shtatë De Radës iu prenë fuqitë.

- Radovan, bir, - mezi belbëzoi ai.

- Urdhëro, mësues, - iu përgjigj Radovani me sy të përbotur.

Bjери fyellit, bir! Radovani nisi t'i fryente fyellit. Zemra e De Radës u gjallërua. Iu duk sikur po shikonte. Ndjeu këngën e pranverës. Iu shumëfishua në çast dëshira për jetë.

“Është me të vëretë një fyell magjik”, - mendoi De Rada. Dikush trokiti në dritare. Qenë degët e lisit. “Po më thërret të nisem për udhë”, - tha me vete ai. De Rada dëgjoi dhe zilkën e mushkës lënë në oborr.

“Mushkë e dashur, - vazhdoi të mendonte De Rada. - S'do të udhëtojmë më dot bashkë zilkë e dashur. Unë tani po dëgjoj dallgët e detit. Është deti që na ndau nga atdheu ynë i vjetër. Është deti i mallit. Me çfarë do ta kapërcej unë, këtë det të gjerë? Po dëgjoj një trokth. Kush po vjen për të më marrë? Vdekja. Jo, kurrë jo! Është trokthi i kalit të trimit Milosao. Ai do të më marrë me vete mbi kalin e tij që fluturon mbi det, për të shkuar në bregun e tokës mëmë.”

Lajmi i vdekjes së De Radës u përhap menjëherë në fshatrat rreth e qark.

Plakun e nderuar e vendosën në një arkivol të hapur në oborr të shtëpisë pranë lisit të madh. Vinin fshatarët, pleqtë dhe fëmijët dhe ia shikonin fytyrën për herë të fundit.

De Rada dukej sikur po flinte. Askujt nuk i besohej se ai kishte vdekur. Radovani mori shkopin prej kallami të plakut, mori fyellin e tij dhe ia vuri pranë vetes. Le t'i kishte me vete në banesën e tij të fundit.

De Rada pranë lisit ashtu si Milosaoja që mbylli sytë pranë lisit. Tani dukej se De Rada dhe Milosaoja formonin diçka të vetme. Përjetësisht.

*Moikom Zeqo*

## **Shënim**

Autori i këtij teksti e zgjodhi lirin e Milosaos si frymëzim nga personazhi kryesor i veprës më të njohur e më të fuqishme (jo vetëm të letërsisë arbëreshe) “Këngët e Milosaos“ me të cilën autori i saj Jeronim de Rada (në këtë rast personazhi kryesor i tregimit) u bë i njohur si një ndër përfaqësuesit më të denjë të Rilindjes.



## **Komentojmë tregimin**

Mundohuni në orën e mësimi ta nxirrni fabulën e këtij tregimi!

Cila është tema e këtij tregimi?

Cili çast ju duket më i preکشëm?



## **Detyrë**

Bëni një portretizim fizik të De Radës.



## DALLIMI I TREGIMIT NGA NOVELA

Një nga llojet e letërsisë epike narrative, formë e saj e vogël, vepër letrare që i kushtohet zakonisht një ngjarjeje të veçantë në jetën e njeriut, pa treguar në mënyrë të detajuar se ç'ka ndodhur me të para dhe pas kësaj ngjarjeje.

Tregimi dallohet nga novela, në të cilën zakonisht përshkruajmë jo një, por disa ngjarje, që tregojnë një periudhë të tërë në jetën e njeriut dhe në këtë ngjarje marrin pjesë jo një, por disa personazhe të përshkruar pak a shumë në mënyrë të detajuar. Arti i shkrimtarit në tregim konsiston në faktin se ai, në një episod të shkurtër nga jeta e njeriut, zbulon tiparet esenciale, tipike të jetës. Tregime kanë shkruar: F. Konica, Migjeni, V. Kokona, Gi de Mopasan, A. Çehovi etj.

## DALLËNDYSHË EJA!...

*“Ky dheu asht i joni qi t’parët na e lanë trashëgim e  
gjuhën tonë don me qit n’lulzim”.*

*At Gjeçovi*

Mirë se vjen, me krahë te letë,  
Dallndryshë, tui fluturue!  
Mirë se vjen! M’ket ânë te xetë  
T’dheut t’Misirit me dimnue:  
Eja, prá, ktu fluturim,  
M’gzò me at zâ gjith âmbëlcim!

Kur jé nisë t’kam porositun  
Atje larg t’shkojsh kah Shqypnija;  
M’difto pra, kur ké shetitun  
A t’kan ra n’mend fjalt e mija,  
Me m’shkue n’Shkoder fluturim,  
Me m’j’u falë gjytetit t’im?!...  
Atje malet n’i paç pá,  
Jânë prej boret nalt zbardhue:



N'ato fushat ne paç rá,  
Janë me lule lulëzue  
Atje n'paç vojte fluturim  
Aty është gjyteti i im!

Barit t'njomë gjith atje veshen  
Cuka e kodra, e atje ndinë  
Tue këndue blegtoreshe  
Qi kullotë rreth bagtinë;  
Atje n'paç vojte fluturim,  
Aty është gjyteti i im!

N' Shkodren t' ime te Shqypnisë  
Burrat lejnë qi s'dijnë ç' është friga,  
Çupat e bukra t'urtisë  
Atje lejnë qi s'dinë ç'është flliga;  
Atje n'paç vojte fluturim  
Aty është gjyteti i im!

Dishroj shum, por...nuk po dij  
A kam prap fát t'mirë me shkue  
Nji herë tjetër ne Shqypni,  
N'Shkodren t'ime me kalue...  
Atje dù t'shkoj fluturim,  
T'vdes aty n'gjytetin t'im!...

T' kam pas thënë... se *n'Fushë t'Rmajit*  
Kam dy vorre t'dashtunisë,  
Nënë e babë kam n'at vënd vajit,  
Qi m'kanë lánun t'vorfenisë;  
Me zënë t'ánd t'përmállshëm shqim,  
A m'ke bâ mbi' tà vajtim?!...

A u kè thënë se un t'kam çue  
Prindët e dashtun me m'i qà?!...  
A u kè thënë sà kam lotue  
Kur t'kam nisë vorrin m'e pà?!...  
A e kè thënë, t'përmállshme shqim,  
Kângen t'ânde gjithë vajtim?!...

A u k  th n  se z mra e ime  
 N' dhen  t'hueja keq u shktri,  
 Se s'ka gzim, as s'ka ngushllime  
 Se po digjet p r Shqypni?!...  
 Me z n  t' nd t'p rvajsh m shqim,  
 A e k  qamun fatin t'im?!...

Pr  dallndrysh , kah k  shetitun  
 Gjytetin t'im a e k  p ?!...  
 N'ato v nde k  k  rritun,  
 N'm nd p r mue a te k  r ,  
 Me m'shkue n'Shkod r fluturim,  
 Me m'j'u fal  gjytetit t'im?!...

*Filip Shiroka*

## **Sh nim**

Poezia “Dall ndyshe eja”  sht  me tematik  atdhetare dhe paraqet nd rlidhjen e poetit me atdheun, sepse Shiroka jetonte larg tij. Vet  kthimi i dall ndyshe, na kujton se ky zog shtegtar, i porositur t  shkoj  e ta shoh  m m dheun e poetit, porosin  e mbajti dhe ia solli poetit t  falat nga Shkodra e tij.



### **Fjal  dhe shprehje**

*vajt* – shkuar

*lejn * – linden

*n'Fush t' Rmajit* – varrezat e Shkodr s (vend)



### **Komentojm  poezin **

1. Mundohu t  p rkujtohesh n  poezin  “Shko dall ndyshe” nga kl. VII.
2.  ka paraqet dall ndyshja atje dhe k tu?
3. Nga erdhi dall ndyshja?
4. Cila ishte d shira e madhe e poetit q  v rehet n  strof n e gjasht ?
5. N  poezi  sht  p rdorur geg rishtja e koh s s  F. Shirok s – p rshtate n  gjuh n letrare.



### **FILIP SHIROKA (1859 - 1935)**

Filip Shiroka lindi n  Shkod r n  vitin 1859. Qe i detyruar t  largohet nga atdheu dhe t  jetoj  n  Misir e Liban. Vjershat e tij u botuan me pseudonimin Geg  Postripa. N  vitin 1933 u botua p rmbledhja e vetme e vjershave “Zani i zemr s”.

# NË KËRKIME

Shumë ke për të dashur  
Shumë për të dashuruar  
Para teje në këtë jetë  
Çdo gjë është krijuar.

Shumë ke për të krijuar  
Diell e hënë në botë  
E kanë për ta quajtur  
Ndoshta punë të kotë.

Shumë ke për të kërkuar  
Po pak për të gjetur  
Në jetë, poet i dashuruar  
Vetëm ke për të mbetur.

Pak dritë ke për të parë  
Shumë ke për të ngritur  
Flakë e fjalës së ngjarë  
Nuk ka për t'u venitur.

Xixë e strallit të këngës  
Do ndriçojë në çdo kënd  
Me gjak të blertë flakëruar  
Ngjeshë për ashtin tënd.

Shumë ke për të dashur  
Pak ke për të krijuar  
Jeta shumë të ka hije  
Poet, në të i dashuruar.

*Enver Gjerqeku*

## Shënim

Kjo vjershë është nxjerrë nga përmbledhja “Xixa stralli”, në të cilën poeti përshkruan fushën e pakufishme të poetit dhe mundësitë e mëdha që ka ai për pasqyrimin e problemeve jetësore me të cilat njeriu ndeshet në jetë.



### Komentojmë vjershën

Si është ndërtuar strofa e kësaj vjershe?

Cilin lloj të vargut dhe të rimës ka përdorur?

Në këtë poezi poeti bisedon me dikë. Gjeni vargjet në të cilat ai bisedon me personin e dytë dhe përpiquni ta identifikoni këtë!

Mos bisedon, vallë me vetveten?

Veçoni vargjet në të cilat përshkruhet: dëshpërimi dhe pikëllimi dhe ato në të cilat përshkruhet dashuria dhe shpresa.



### ENVER GJËRÇEKU (1928)

Lindi në Gjakovë, ka punuar si mësues i fillores, profesor i gjuhës shqipe në shkollën Normale, në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe së fundi mësime dhënë në letërsinë shqiptare në Fakultetin filologjik të Prishtinës. Ka botuar disa përmbledhje vjershash, temash e motivesh të ndryshme. Ndër to janë për t’u përmendur: tema e së kaluarës së largët e të afërt historike e popullit shqiptar, tema e luftës së Dytë Botërore, tema e përditshmërisë dhe jetës për liri.

Përmbledhjet si: Gjurmët e kohës, Bebëzat e mallit, Tinguj të zgjuem, Blerimi i vonuem, Xixa Stralli, Ashti ynë, Pengu, Lumi i palodhur, përmbledhjen e tingëllimave Sogjetarë Amshimi, Flatrimi i fjalës.



## MALLKIMI I NËNËS

Ju s'ë keni parë Zaverin tonë se ç'vend i mrekullishëm është! Unë shkoja kurdoherë, kur isha i vogël. Harroja shqerrat dhe më rrëmbente bukuria e natyrës: liqeni, brigjet me atë gjelbërim të përhershëm të dëllinjave; siujdhesat dhe tumbat e gjiret dhe vargjet e maleve rreth e rrotull me atë ujdhesë të madhe në mes si një anije përrallore më mahnitnin e më kënaqnin shpirtin. Një ditë papritur e pa kujtuar babagjyshi im më gjeti mu në majë të thepave të Zaverit: ishte trembur shumë se mos rrëzohesha, prandaj më hoqi veshët keq e më këshilloi për të njëmijtën herë, që të mos rrija tjetër herë nëpër vende të tilla të rrezikshme. Unë i kërkova të falur dhe i putha dorën. Atij iu bë qejfi shumë dhe më tregoi atëherë këtë legjendë të liqenit të Prespës:

-...Kushedi sa kohë të shkuara, ndofta njëmijë vjet më parë, gojë pas goje tregojnë se ky liqen ka qenë i tëri fushë, një fushë pjellore, që e kishin zili të gjithë. Në të bëhej dardha naa, sa një shtëmbë uji, e molla naa, sa një plloskë verë. Kishte kullota dhe hiesira për bagëti, ku hazdiseshin plot hergjelera e kopera. Përmes fushës kalonte një lumë, me të cilin njerëzit vaditnin kopshtet, grunjtë, misrat dhe pinin ujë e freskoheshin. Fshatrat, si tufa borziloku, ishin shpërndarë përmes fushës dhe rrëzë maleve. Çdo fshat kishte nga një krua me dhjetë solinarë me ujë të pastër qelibar e të ftohtë akull. Në këto kroje mbrëmjeve e ditëve të festave mbledheshin çupat e fshatit, mbushnin ujë, kuvendonin sa kuvendonin e ia merrnin këngës, hidhnin valle! Këto këngë e ky gaz dëgjo-heshin gjer në mesnatë an'ëmbanë fushës.

E sheh atë vend atje, midis Belit dhe Tumbës? Atje prifti i fshatit tonë kishte kullotat e tija. Dimër e verë një kope e madhe me dele kullosnin në ato livadhe. Prifti, - papa Llambua, - kishte marrë, si bari, një djalë, ja, në moshën tënde, dymbëdhjetë- trembëdhjetë vjeç. Quhej Gjokë dhe ishte nga fshati i Shën-Naumit. Emri i fshatit s'më kujtohet. Bariu ishte aq i varfër sa të këpuste shpirtin! E ëma kishte mbetur e ve me pesë fëmijë. Djaloshit, si më i madh i fëmijëve, i binte barra të ushqente të vëllezërit e të motrat. U pajtua bari te papa Llambua. E, që thua ti, Gjoka ishte bari me nishan: nga kujdesi i tij i përditshëm t'u bënë ato dele naa! t'i çaje më dysh! Po prifti, që i kishte gjithë të mirat e që i mbushte çdo të diel e çdo të premte hejbetë me meshë, nuk dinte se ç'ishte uria! Ai Gjokës i paguante shumë pak, madje akoma më pak i

jepte bukë për të ngrënë gjatë ditës. Bariu i shkreti ja hante, ja s’hante disa thërrime buke nga ajo që i jepte urata, se pjesën më të madhe e ruante në calikun prej lëkure. Kur shkonte në fshat, në fund të dy javëve, për të ndërruar rrobat e trupit, ato copa buke ua shpinte vëllezërve e motrave. Dhe kursente pothuajse tërë bukën, se ai gjatë ditës hante më shumë pemë e bari-shte të ndryshme. U dobësua djali, sa erdhi e u bë cirua! Një ditë, duke luajtur ja këtu buzë Zaverit, ra në lumë caliku e shkoi e vate nën mal. I shkruaj Gjok e qau, i ra kokës me grushte e u bë pikë e vrer, por meazallah se e gjeti calikun! Pas dy ditësh erdhi koha të shkonte në fshat për t’u ndërruar. Ishte pikëlluar fort, se po shkonte me duar bosh! Të vëllezërit e tij çfarë të hanin? Kur vajti në shtëpi, e ëma e priti buzëgaz. Ky u habit. “Ç’ë bëre, bir calikun me bukë?” e pyeti dhe e pushtoi Gjokën në gjirin e vet. Gjoka u step dhe e mbyttën lotët. “Mos qaj, biri i nënës, mos qaj, se ja ku ta kam calikun!” - i tha ajo.

Vërtet ishte caliku i tij. Atë calik që e kishte trashëguar nga i ati, i cili e mbante kur shkonte si bari në dyert e afendikonjve, ose kur shkonte kurbetli në Anadoll. Caliku ishte prej lëkure dashi të regjur dhe gryka e tij ishte qendrisur me retna, si ato qendismat e grykoreve të vajzave tona sot. E ëma i tregoi Gjokës se si i kishte rënë caliku në dorë. Dy ditë më parë, aty pasdrecke, mund të kishte pasur nja dy hostenë ditë, ajo lante levere te burimet e Shën-Naunit. Killo-killo - bënin ujërat e burimeve duke u pëplatur mbi shkëmbinjtë e përpara nënës dilnin shkuma-shkuma të bardha e vërtike-vërtike, që shkonin pastaj tatëpjetë. Kur, papritur e pakujtuar, nëpër shkumën e bardhë i zuri syri një gjë si ngjyrë hiri. Ç’të shihte? Ishte caliku i Gjokës së saj, plot me bukë. “Shpirti i nënës, ma paske dërguar bukën me valët e ujit!” - kish menduar nëna e uritur.

Gjokës i qeshi buza. Por natën në gjumi kishte vajtur ai Qoftëlargu dhe i kishte pëshpëritur në vesh: “Gjokë, Gjokë i zi, çdo të shtunë ther nga një dash të uratës, fute mishin brenda në lëkurë e dërgoja nënës nëpër grykën e Zaverit me valët e lumit, që shkon nën male. Oho, oho, sa do t’i gëzosh vëllezërit e vegjël, sa do ta gëzosh nënën! Dhe ata do të shëndoshen shpejt e shpejt, do të rriten shpejt e shpejt! Pastaj ti do të bëhesh zot shtëpie, i madh e i pasur si afendikoi i fshatit! Lum ti! Bëjë këtë çdo të shtunë! Mos harro! Mos mëno!”

Gjoka në fillim e humbi: ç’ishte ky zë, tamam si zë njeriu të gjallë? U habit, por edhe u gëzua, që i shtiri në vesh një gjë të tillë. Pa menduar gjatë, kur iku nga fshati i tij, i tha s’ëmës:

“Nënë, shko çdo të shtunë pasdrecke të burimet e Shën-Naunit, se atje do të gësh një dhuratë!”

Atë natë Qoftëlargu i kishte vajtur edhe uratës dhe i kishte pëshpëritur

në vesh:

“Uratë, uratë, jam Shëngjergji e më dërgoi Zoti të të lajmëroj se Gjoka, bariu yt, të shtunën pasdreke do të therë dashin përçor e do t`ja dërgojë s`ëmës dhe të vëllezërve me valët e lumit Zaver. Hap sytë, hap sytë që të mos të ta hedhë ai copë bari!”

E shtuna erdhi: Nëna përsëri vajti te burimet e Shën-Naumit për të larë lëveret e fëmijëve. Nuk priti shumë, kur ç`të shihte: nëpër shkumë po përpëlitej një si dele. E kapi: vërtet ishte dele! Jo, ishte dash, një dash i majmë i rrjepur e mishi futur në grykë. Ajo u kujtua se këtë dhuratë ia dërgon Gjoka i saj. Sikur e theri diçka në krahëror: mos e kishte vjedhur vallë nga kopeja e priftit? E kush ishte aq shpirtmirë sa t`ia falte djalit të saj një dash të tillë? Bubu, sa punë të keqe që kishte bërë i biri! Të vjedhë?! Të rrëmbejë?! Të gënjejë?! Jo, jo! Me mish të tillë nuk donte të ushqente fëmijët e saj! Do ta ngor-dhte në dru Gjokën, sa t`i vinte në shtëpi! Të vinte mend e të mos bënte marrëzira të tilla! Zemra e nënës u drodh, mornica i shkuan nëpër trup dhe u hakarrit kundra të birit, që kishte filluar një rrugë aq të turpshme, aq të ndyrë!

Duke palosur rrobat e fëmijëve të lara e të thara në diell, dëgjoi përsëri gurgullimën dhe buçimën e ujërave, përsëri pa ato rryma ujërash të pëplasen mbi shkëmbinj, përsëri pa ato shkuma-shkuma si qumësht deleje dhe, për habi të saj, përsëri në mes vërtikut pa të pëpëlitej edhe një dele tjetër. “Dy mishra me një ditë!?” dyshoi nëna e vrerosur. Me gjysmë shpirti e me hakarri të madhe e nxori delen e therur nga vërtiku i ujërave dhe e shpuri atje në lëdinën nën degët kryevarur të shelgjishteve, të cilat i dukeshin nënës, kushedi pse, si qirinj të verdhë përmbys e me flakë të shuar! Me të drejtuar e me kërshtëri e zgjidhi grykën e lëkurës dhe... O Zot!

Mos i bën sytë vallë?!... - brenda në lëkurë gjeti Gjokën e saj të therur!

“U bubu, e zeza unë, qyqja unë!” - ia dha kujës me sa fuqi që kishte e sakaq plasi mbi kufomën e të birit. Klithma e saj mori dhenë, si ciklon u ngrit lart e lart nër qiej, e andej si rrufe, - një rrufe që s`e kishin dëgjuar kurrë këto anë - ra mbi Malin e Thatë e nga barku i malit u dëgjua një ulurimë e një ngulçimë si e ndonjë kuçedre të therur, por ende me shpirt ndër dhëmbë:

“Prifti papa Llambrua, theri birin e nënës! Mallkimi i nënës bie kudo!...”

Ç`të shikoje atëherë: njerëz e kafshë, të tronditur e të shashtisur, rendin drejt maleve për t`u fshehur diku, ndërsa papa Llambrua rendte drejt fushës me raso të grisur, me kamillafin shtrembër, me flokët të shprishura tamam si Qoftëlargu. E sa vajti ai mu në mes të fushës, e sa u përmblodhën rrëzë maleve njerëzia, - t`u dhanë piskama e gurgullima ujërash e buçima të llahtarshme nga gryka e këtij Zaverit tonë dhe hë-hë, hë-hë brenda çastit fusha



e tërë t'u bë, ja, ashtu si e sheh edhe sot: liqen! Përmbi liqen s'u pa gjë tjetër, veç kamillafit të zi të papa Llambros, që e shtynin valët tutje e tëhu!

Mallkimi i nënës, bir! Mallkimi i nënës! E s'ka gjë më të rëndë se mallkimi i nënës! Ja këtë ma ka treguar mua gjyshja ime, asaj ia pat treguar gjyshja e saj, e, brez pas brezit e gojë pas goje, kështu do ta rrëfejnë këtë mallëkim! - shtoi babagyshi duke marrë frymë thellë.

*Sterjo Spasse*

## **Shënim**

Ky tekst trajton një temë nga legjendat e pasura për ujërat e Gjon Zaverit - një temë shumë e trajtuar prej autorit. Ngjarja paraqet lumin e nëntokës së Shën-Naumit, burimet e të cilit derdhen në Liqenin e Ohrit që pastaj vazhdojnë rrjedhjen e tyre në shtratin e Drinit të Zi.



### **Komentojmë tekstin**

Cila është tema e këtij tregimi?

Nga e mori autori idenë e hartimit të këtij teksti?

Ç'porosi na jep autori?

Ç'mendoni për veprimet e djaloshit?

Cili çast ju duket më prekës?

Ç'dini ju për legjendat si frymëzim?



### **Detyrë**

Lexoni tekstin me vëmendje dhe zbërtheni etapat e zhvillimit të veprimit.

## **Kompozicioni i veprës epike**

Etapat e zhvillimit të veprimit në veprën epike janë:

**Paraqitja e veprimit** - është etapë e zhvillimit të veprimit, që ndodh në fillim të veprës.

**Thurja e veprimit**, është shtytja themelore e zhvillimit të veprimit të ardhshëm (nis me motiv të ri dhe mbaron me shfaqjen e kulminacionit)

**Kulminacioni** shfaqet atëherë kur konflikti i thurur në veprim merr përmasa më të gjera, pra arrin shkallën më të lartë (tani zhvillohet beteja vendimtare mes personazheve në konflikt).

**Peripecia** - është ajo etapë e zhvillimit të veprimit, që shënon një kthesë

të papritur.

**Shthurja e veprimit** - është etapa përfundimtare. Tani vërejmë fatin e heroit dhe ngadhënjimin e tij.

## STERJO SPASSE (1914-1989)



Sterjo Spasse lindi në fshatin Gollomboç të Prespës. Është autori i një numri të madh veprash në prozë. Romani i tij i parë është “Pse”. U bë i njohur me “Afërditën” - roman i njohur, vite me radhë edhe si lexim shkollor. Botoi edhe shumë përmbledhje tregimesh si: “Sokolesha” dhe tregime të tjera: “Kurore e rinisë”, “Të fala nga fshati”, “Afërdita përsëri në fshat”, “Ata nuk ishin vetëm”, “Buzë liqenit”, “Zgjimi” etj.

## PLAKU PREJ BORE

Ishte dita e fundit e vitit. Bënte shumë ftohtë. Pas një jave shkollat do të mbylleshin. Atë ditë Mehmeti nuk kishte shkuar në shkollë. Babai i Mehmetit ishte i sëmurë në spital. Nëna dhe motra e madhe punonin në një fabrikë. Përveç të dielës, ditëve tjera në shtëpi nuk kishte njeri. Atë ditë Mehmeti ishte vetëm. I heshtur, ai sodiste nga dritarja borën e butë që binte. Mehmeti, nuk e kishte ndezur sobën, ndaj ndiente të ftohtë. Kishte edhe uri, po përtonte të shkonte për të ngrënë diçka në kuzhinën pa zjarr.

Mehmeti ishte një fëmijë që thurte shumë ëndrra. Ç’do të bëhej sikur nga qielli, në vend të borës të binte miell!? Bora binte ashtu si pluhur sheqeri. Çfarë do të bëhej sikur në vend të borës të binte sheqer? Sikur në vend të borës të binte miell, të varfërit do ta mblidhnin miellin dhe kishin për ta bërë bukë. Sikur në vend të borës të binte sheqer? Sikur në vend të borës të binte sheqer, të varfërit do ta mblidhnin sheqerin dhe do ta bënin ëmbëlsira, pasta. Por ç’kishin për të bërë atëherë shitësit e miellit, mullisët, furrtarët, sheqer-xhinjtë, pastičierët?

Tek po mendonte kështu, dëgjoji zërin e shokëve që po e thërrisnin nga jashtë:

- Mehmet! Mehmet! ...

Ai njohu zërin e Jallçenit, shokut të tij. Me Jallçenin mësonin në një klasë.

- Po vuj! - iu përgjigj Mehmeti, dhe doli menjëherë në rrugë.

Në fushë ishin mbledhur plot vajza e djem, gati pesëdhjet fëmij. Jallçeni kishte në dorë një lopatë.

- Ç'do të bësh me këtë lopatë? - pyeti Mehmeti.

- Do të bëjmë një njeri prej bore, - iu përgjigj ai dhe pastaj u foli fëmijëve:

- Ej çuna, ejani të fillojmë nga puna, ta mbledhim borën, ta hedhim këtu.

Fëmijët iu futën punës. Shumica ishin veshur trashë e nuk kishin ftohtë. Ndonjëri ishte pa pallto, si Mehmeti. Ai kishte këpucët e grisura dhe i lageshin këmbët. Në fillim pati të ftohtë, por, duke punuar, u ngroh, u djersit...

Mblodhën shumë borë dhe filluan të bëjnë njeriun prej bore. Nën një kokë të madhe, një trup i shëndoshë, dy krahë të trasha në të dyja anët... Tani i erdhi radha që t'i jepnin formën e plakut prej bore. Për këtë çdo fëmijë solli diçka nga shtëpia. Dhe, më në fund u ngrit plaku, trupin drejt, i gjallë, sikur të ishte njeri i vërtetë.

Dalëngadalë ra errësira e mbrëmjes. Fëmijët u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre. Në fushë mbeti vetëm Mehmeti. E ëma dhe e motra ende nuk ishin kthyer nga puna. I vetëm, Mehmeti filloi përsëri të thurte ëndrra. Atij i vinte keq ta linte vetëm plakun prej bore. Ia nguli sytë dhe fillonte ta shihte sikur të ishte vërtet njeri i gjallë. E pyeti:

- Plak bore, a do të mërzitesh, kur të mbetesh vetëm?

- Natyrisht do të mërzitem, - iu përgjigj një zë.

Kush i tha këto fjalë? A është e mundur të lëviznin buzët e plakut prej bore? Mehmetit i dukej sikur ato lëviznin vërtet.

Ai ndjeu përsëri po atë zë:

- Po të qëndroj pa punë, mërzitem shumë.

Ai që fliste, ishte Mehmeti. Siç thamë, atij i pëlqente shumë të thurte ëndrra, ndaj fliste edhe për veten, edhe për plakun prej bore.

Vetë pyeste, vetë përgjigjej.

- Meqë nuk rri dot pa punë, ç'do të bësh, o plak prej bore? - Mehmeti hyri në mes të këmbëve të plakut dhe iu përgjigj pyetjes së tij.

- Dua të bëj diçka që më pëlqen, një punë të tillë që të më falë gëzime...

- Ç'është kjo punë, o plak bore?

- Mendoj të marr sëpatën e të shkoj në mal. Të pres pemët e thata të pyllit, t'ua çoj të varfërve, që t'i ndezin nëpër vatrat e tyre. Kështu do ta kalojnë ngrohtë natën e Vitit të Ri.

- Shumë mirë e paske menduar, o plak bore!

- Fëmijët natën e Vitit të Ri marrin dhurata. Por fëmijëve të të varfërve nuk u jep kush dhurata të tilla, që asnjë fëmijë tjetër të mos i ketë.

- Shumë mirë, shumë mirë, o plak bore!

- Mua më vjen ndorësh për këpucari dhe rrobaqepësi. Mendoj të qep pallto, të bëj këpucë të forta për fëmijët e të varfërve.

- Shumë bukur, shumë bukur, o plak bore!

- Pastaj mendoj të ngre një furrë, të pjek bukë për të uriturit.

Kush thoshte “bukë të ngrohta, të buta, taze”, - Mehmeti i shkante lëng goja. Në këtë kohë, e ëma dhe e motra u kthyen nga puna. Ai e dëgjoji zërin e tyre që e thërrisnin dhe vrapoi drejt shtëpisë. Nëna kishte ndezur sobën. Motra kishte shtruar tryezën. U ulën. Mehmeti, edhe pse i uritur, nuk mundi të hante. I dhimbte koka, i qenë nxirë sytë, i përzihej në stomak. Nëna i vuri dorën në ballë. Kishte temperaturë. Kishte qëndruar në borë pa pallto, me këpucë të grisura. Ishte ftohur...

## II

Nëna e shtriu Mehmetin në shtrat dhe i dha ilaçe për të pirë. Mehmeti digjej nga ethet. Në gjumë filloi të fliste përçart. Në ëndërr i doli përsëri plaku prej bore. Plaku mblodhi gjithë borën e fushës dhe ngriti me të një ndërtesë.

Mehmeti e pyeti:

- Çfarë bën aty, o plak bore?

- Po bëj një furrë, Mehmet, - i tha ai.

- Çfarë do të bësh në atë furrë?

- Do të pjek bukë për të varfërit, për të sëmurët, sakatët, për ata që s'kanë njeri. Hajde më ndihmo edhe ti, Mehmet!

Mehmeti ishte i gatshëm për ta ndihmuar, por nuk dinte çfarë të bënte.

- Më thuaj çfarë të bëj, o plak, - e pyeti.

- Mblidhe borën e sille këtu, - u përgjigj ai. Mehmeti mblidhte borën, plaku mbushte me driza oxhakun, që kishte bërë me borë. Pastaj ai ndezi dritat. Oxhaku filloi të kërcëllinte. Bora që mblodhi Mehmeti, u bë miell, në dorën e plakut. Këtë miell ai e përzjeu me ujë bore, bëri brumë, e ngjeshi dhe e vuri pjesë-pjesë mbi lopatën e furrës. E futi në furrë. Bukët filluan të futeshin në furrën e skuqur. Përreth u përhap aroma e bukur së pjekur. Plaku prej bore i tha Mehmetit:

- Shko dhe thirr të varfërit, të sëmurët, të papunët, të uriturit, sakatët. Të vinë të gjithë. Të marrin bukë sa të duan. Merr edhe për ata që nuk mund të vijnë këtu dhe jepu!

Mehmeti vrapoi duke u hedhur nga gëzimi, si të ishte me krahë. Me zë të lartë filloi të thërriste:

- Ata që kanë dëgjuar, t'u thonë atyre që nuk kanë dëgjuar! Ata që dëgjojnë, t'u thonë atyre që nuk dëgjojnë! Të sëmure, sakatë, të papunë, të uritur, të varfër, vraponi, vraponi. Plaku prej bore do t'ju shpërndajë të gjithëve buke. Vraponi! Ejani!

Zëri i Mehmetit oshëtinte duke mbuluar gjithë qytetin. Nga të katër anët e lagjeve filluan të vinin si lumenj të varfërit, të uriturit, të papunët, sakatët, të sëmuret. U mblodhën rreth furrës. Oxhaku i saj digej flakë-flakë. Bukët u frynë, u skuqën, u poqën. Plaku prej bore i mori ato të pjekurat dhe ua shpërndau të varfërve. Kush merrte dy-tri bukë, shkonte. Dikush i fuste bukët e pjekura në torbë, në thasë ose në ç'të kishte marrë me vete. Të varfërit, doracët, topallët edhe ata merrnin bukë dhe falenderonin plakun prej bore.

- T'u ngjatë jeta, o plak bore!

- Shëndet e gjithë të mirat, o plak bore!

Plaku punonte pa u lodhur. Fuste në furrë me lopatë brumin e bukës, pastaj u shpërndante njerëzve çyrekët e pjekur. U thoshte atyre:

- Merrni, merrni, merrni.

- Asnjëri të mos mbetet i uritur! Plaku prej bore u dhuronte bukë fëmijëve të zbathur, pleqve që dridheshin. Numri i atyre që vinin rritej vazhdimisht. Plaku prej bore punonte pranë zjarrit, pranë flakëve të oxhakut. Ai djersitej dhe, duke u djersitur shkrihej vazhdimisht. Duart e tij prej bore, sa herë futeshin në furrë për të nxjerrë bukë, shkriheshin e zvogëloheshin. Gishtat e tij u shkrinë nga nxehtësia. Kraharori i tij vazhdimisht djersitej dhe tretej. Edhe krahët iu holluan, ndërsa të varfërit grumbulloheshin përherë e më shumë, por, duke u djersitur vazhdimisht, shkrihej.

Befas Mehmeti vuri re se plaku prej bore qe zhdukur. U drodh nga frika dhe thirri:

- Plak bore! O plak bore!

Po plaku nuk shihej më, kishte shkriurë, Mehmeti, i frikësuar thirri edhe më shumë:

- Plak bore! O plak bore!

Nga të thirrurat e Mehmetit, e ëma dhe e motra vrapuan pranë shtratit të tij.

- Çfarë ke, bir? Pse thërret kështu?

Mehmeti u zgjua. Buzëqeshi. Ishte dita e parë e Vitit të Ri.

Mbasdite Mehmeti kishte fjetur shumë. Tani ishte mirë, ilaçi që i kishte dhënë e ëma, i kishte bërë mirë. Ai u rrotullua në shtrat dhe hodhi sytë nga dritarja.



- Ç'u bë bora? - pyeti nënën.
- Gjithë natën ka rënë shi, e shkriu.
- Ditën koha u hap dhe doli dielli, - tha e motra.

Mehmeti vështroi fushën, atje ku ishte plaku prej bore. Ai vërtet ishte tretur si në ëndërr, por jo nga ngrohtësia e furrës. Ai qe zhdukur nga shiu që kishte rënë natën dhe nga dielli i ditës. Nga plaku prej bore kishin mbetur vetëm mjekra prej thekësh të perdes, mustaqet prej rrënjëve të preshit dhe hunda prej karrote. Fshesa, kapelja prej vezoje, veshët nga lëkura e portokallit ishin përtokë. Edhe sytë, dy copat e thëngjillit, ishin në tokë.

- Pashë një ëndërr shumë të bukur, - i tha Mehmeti s'ëmës.
- Tregoja nënës, bir, iu lut ajo.

Ai me sytë gati të përlotur, vështroi ato që kishin mbetur në fushë.

Ishte një ëndërr shumë, shumë e bukur, por nuk e mbaj mend! "Ah, sikur të bëhej vërtet ëndërra që pashë", - tha ai me vete një çast.

Po gjithçka kishte qenë ëndërr.

*Azis Nesin*

**Azis Nesin**, është shkrimtar i dëgjuar turk. Ai ka shkruar shumë vëllime me tregime të bukura, sidomos tregime humoristike. Është mik i vendit tonë dhe ka qenë disa herë në Shqipëri.



## ***Fjalë dhe shprehje***

*përçart* - në gjendje kllapie

*drizë-a* - shkurre me degë të shtrëmbra me gjëmbe, ferrëkuqe

*kërcëllinte* - kërciste, brambullinte

*aromë-a* - erë e këndshme

*oshtëtin* - ushton

*dorac-i* - njeri që ka mbetur me një dorë

*gyrek-u* - bukë gruri në trajtë të rrumbullakët

*thekë-a* - tufë fijesh të bashkuara, xhufkë



## ***Komentojmë tekstin***

Cila është ideja e këtij tregimi? Në cilat pjesë del më qartë ajo?

Cili është personazhi kryesor i tregimit dhe kë përfaqëson ai?

Ç'tregon ëndrra bamirëse e Mehmetit të varfër për zemrën dhe ndjenjat e tij?

Ku duken në tregim ndryshimet ndërmjet fëmijëve të varfër dhe atyre të pasur?



## ***Detyrë***

Bëni me shkrim shkurtimisht përmbledhjen e tregimit “Plaku prej bore”, duke u ndalur vetëm në çastet kryesore.

## ***Tregimi novela dhe romani***

**Tregimi** është lloji më i shkurtër i prozës. Zanafilla e tij janë legjendat, përrallat, gojëdhënat. Në tregim ngjarja zhvillohet brenda një kohe të shkurtër ose jepet çasti i saj kulmor. Zakonisht tregimi ka një personazh qendror, ndërsa personazhet e tjera jepen në funksion të tij. Subjekti është i thjeshtë, por konflikti është i ngjeshur.

**Novela** është lloji i prozës, më i shkurtër se romani, por më i gjatë se tregimi apo rrëfenja. Ajo ka një numër të kufizuar personazhesh; ngjarjet zhvillohen rrotull një motivi qendror dhe arrihet në një përfundim të befasishëm. Novela ka ngjashmëri me përrallën, veçanërisht kur tek ajo gërshetohen elementet reale me ato fantastike. Në novelë rrëfimi i autorit mbizotëron në raport me dialogun.

**Romani** për nga gjatësia ndryshon nga tregimi dhe novela. Romani është lloji i gjatë i prozës, në të cilën rrëfimtari rrëfen një ose më shumë ngjarje, ka më shumë personazhe dhe zgjidhen më shumë konflikte. Koha dhe vendi zënë shumë më tepër vend në roman se në një tregim. Në romanin historik

# ZANA E FUNDIT E BJESHKËVE

Kjo pjesë është marrë nga libri “Trëndafilat e dhimbjes” e autorit D. Shaplo.

Në të përmbliidhen përshtatje të baladave popullore të ciklit të Mujit dhe të Halilit. Këtë pjesë e përshkon ndjenja e thellë e dashurisë, e dhimbsurisë, pendimit dhe e faljes.

Dhe një ditë në pranverë, herët, sapo zbardhi dhe nisën të duken malet, kurora e bjeshkës, livadhet, varreza pranë, shtëpitë e shpërndara e të ralla të katundit, Halili mori kalin e pushkën dhe zuri udhën përpjetë. Te shtegu i dhive hyje në pyll, ngjiteshe një copë rrugë, pastaj dilje në një shesh, ku pylli vinte i shtruar plot pemë, lëndina, lirishta, ujëra, lule trëndelinë e lule të tjera gjithfarësh. Ishte një mbretëri e tërë pyjore, me zhurma e fërfërima, zëra kafshësh e shpendësh, me këngë bilbilash e cicërima zogjsh. Njeriu merrte frymë lirisht dhe jeta dukej ndryshe. Me gjithë këtë bukuri dhe zbutje të shpirtit, Halili përsëri ishte i përqendruar në vendimin e tij dhe e mbante kalin me hap të ngadalshëm, duke soditur të fshehtat e pyllit dhe duke menduar se nga duhej t’i binte. Tha me vete të kërkonte guvën e zanës (plaku ia pat shpjeguar përafërsisht vendin ku ndodhej), të gjurmonte atje së largu mos dilte dhia briartë dhe pastaj ta qëllonte ose ta ndiqte për të gjetur një vend të sigurt, sepse krismat e shumta do të shqetësonin kafshët e zogjtë dhe, në rrëmujë, dhia mund të fshihej më lehtë.

Priti e pritë pranë asaj guve. Ndërkaq dielli kishte dalë dhe ishin krijuar dritë-hije të bukura mëngjesore. Kur befas pa dhinë të dilte nga guva, e përcjellë edhe nga zana, veshur tani në të bardha, si nuse malësie, me flokët e verdhë të shpupuritur, me shkrepjet e çuditshme të syve. Ishte hera e parë që Halili e shihte dhe mbeti si i vrarë nga bukuria e saj. Kjo i paska goditur në zemër vëllezërit e gjorë!? Zana buzëqeshte, ngrinte me dorë flokët që i binin mbi ballë dhe ndiqte me sy dhinë që largohej ngadalë duke qëmtuar gjethe të njoma. Halili i tha vetes të mos harronte qëllimin e ardhjes dhe u përmblodh. Po që aty nuk qëllonte dot: ishte prapa një peme dhe duhej të dilte me ngadalë



që të mos e trembte dhinë. E pa më në fund me përbuzje zanën, shkaktare të vdekjeve në shtëpinë e tij, dhe i dha kalit anash për të mos u ndjerë e për t'i prerë rrugën dhisë më tej. Dhe kështu bëri. Po dhia, që zuri të ecte me të shpejtë, e ndjeu lëvizjen dhe po rendte në mes të pyllit, udhë e pa udhë, gjer-sa ajo doli në një vend më të ngritur, si kodër, pranë një lisi. Ai mori shenjë dhe goditi, ndërsa kali ish ndalur. Dhe plumbi e qëlloi dhinë e artë mespërmas. Ajo rënkoj dhimbshëm, aq sa u tund pylli, dhe ra e vdekur. Halili, i gëzuar që e kapi me goditjen e parë dhe ndofta ia arriti qëllimit, u afrua, po para bukurisë së dhisë briartë, duke i parë zogjtë që fluturonin përreth, një shqiponjë që u ngjit lart në qiell, duke i dëgjuar zërat e kafshëve që e panë së largu dhe rënkoin si të kishin humbur nusen e pyllit, - atëherë ndjeu një pikëllim në zemër. Bashkë me këtë ndjenjë ai po kuptonte se, me vrasjen e kësaj dhie kaq të hijshme, si një perëndeshë pylli, ai kishte vrarë një kohë të tërë. Në të vërtetë ajo kohë po humbiste vetë, po largohej dalngadalë, po me pushkën, me plumbin që i ra mespërmas, me zemërimin e tij për njerëzit e humbur, ai i dha, ndofta, një goditje të fundit. Dhe vërtet, të rrije e ta sodisje pyllin, ujërat që rridhnin, ahët që bënin hije, bilbilat që këndonin përmallshëm dhe ulërimën e largët të një kafshe, do të mendoje se ky ishte perëndim i bukur i një kohe që s'kthehej më...

...Pastaj Halili u kthye me ngadalë drejt guvës për të takuar zanën, për ta parë a ishte çmagjepsur, apo ndofta kishte vdekur edhe ajo (këtë nuk e dinte mirë). Ndërkohë ajo kish ndjerë dhimbje në trup, humbje fuqie, një ndjenjë të çuditshme të paprovuar më parë, pastaj kish dëgjuar krismën dhe më pas kish rënë pa ndjenja disa çaste, e verdhë dyllë në fytyrë. Kjo gjendje i zgjati pak kohë, ajo u përmend dhe me një ndjenjë krejt tjetër nga e më parshme, me një dhembisuri në shpirt, me frikë, me duar të dredhura, doli nga guva për të marrë vesh se ç'ishte bërë. Aty, pranë një mështekne, lëkurbardhë, u afrua Halili mbi kalë. E pa të zbehtë, të vrarë, po përsëri të bukur, veçse me një bukuri tjetër, dhe i zbriti kalit. Një vështrim i thellë, i dëshpëruar, njerëzor i syve të saj e preku dhe e drodhi. Si duket magjia dhe mospërfillja prej zane kishte marrë fund. Ndenjën një cast pa folur, pastaj Halili i tha:

- Unë jam vëllai i vogël i atyre të dy vëllezërve që vranë njëri-tjetrin nga magjia jote. Edhe historinë e babait tonë ti e di mirë. E dëshpëruar pa masë, edhe nëna vdiq. Më thanë se forca jote, ndofta edhe jeta fshihej te dhia briartë dhe unë e vrava që të qetësoja shpirtin dhe të shpëtoja tërë djemtë e kësaj ane, që mund të ndeshnin me sytë e tu ... Kur e pashë dhinë ashtu të vrarë, më erdhi kaq keq, më keq se të kisha vrarë një njeri. Po shpirti i njerëzve të mi nuk më linte të qetë. Le të pushojnë tani në varr dhe unë le të marr mbi

vete mëkatin tim. E di, ti ke bërë edhe shumë të mira, po koha juaj mbaroi ...E vetme këtyre viseve, nuk kishe ç'bëje më, mirësia të kishte ikur nga shpirti, kishte mbetur mospërfillja dhe ligësia...

Ajo e dëgjoji në heshtje: asnjë shenjë zemërimi, asnjë shenjë kryeneçësie, asnjë e qeshur e çuditshme dhe tallëse nuk doli nga goja e saj. Ishte e vrarë, e dëshpëruar, po me një shprehje të butë të pafuqishme, ndonëse as nuk lutej e as nuk ulej në gjunjë para forcës njerëzore. Eci drejt dhisë së vrarë, e pa me lot në sy, e përkëdheli me dorë, ndenji dhe një kohë të shkurtër në këmbë para saj, pastaj u kthye nga Halili. Ndjente në shpirt një dhembshuri të madhe, të thellë dhe, për herë të parë në jetën e saj prej zane, po i shkonte ndërmend se kjo, ndofta, ishte ajo ndjenjë e madhe që i dallonte njerëzit, dhe se ajo po bëhej njeri i zakonshëm. Atëherë i rrodhën lotët çurk dhe buza i qeshi pakëz midis lotëve.

- Halil, të më falësh. Po një tjetër forcë vepronte tek unë. Ashtu isha gatuar dhe s'bëja dot ndryshe. Të kërkoj falje për të këqijat që ju kam bërë, për hidhërimet që ju kam sjellë... Po të duash më fal ... Unë jam tani si të gjithë ju, një vajzë e zakonshme malësie.

Halili u prek thellë, e pa me vëmendje. ishte përsëri e bukur, po me një bukuri të qetë, të njerëzishme, edhe zëri i saj vinte i ëmbël, vajtues. Ajo ishte tani një vajzë e hajthme, që kishte nevojë për përkrahjen e njerëzve. Lotët i rridhnin nga sytë. Dhe Halili, zemërmadh, duke ndjerë këtë ndryshim, duke kuptuar se ç'kishte ndodhur në shpirtin e saj e mishëroi, iu dhimbs. Dhe dihet mirë dhëmbshuria është një shenjë e parë dhe, ndofta, më e thella e asaj ndjenjë të madhe dhe të bukur që quhet dashuri. Dhe vështrimi i syve të Zanës, tani të mençur dhe depërtues, vështrimi përkëdhelës dhe i butë, tregonte se edhe asaj, bashkë me shqetësimin, me tronditjen dhe dyshimet për jetën e vet të ardhme, po i lindte një ndjenjë e ngrohtë dhe ngazëlluese që nuk e kishte provuar më parë. Djali ishte i pashëm dhe kurajoz. Po a do ta falte.? Dhe Halili e zuri për dore, e hipi në vithe të kalit, duke marrë rrugën e kthimit. Po e linin pyllin me ahët e dendur, me pishat degëndara, me mëshitekna trupholla...

Halili ishte qetësuar, nuk kishte në shpirt mëdyshje për vendimin e marrë, e ngiste kalin ngadalë dhe e ndjente mirë erën e trëndelinës që fshihej midis barërave dhe dëgjonte këngën e bilbilit. Pastaj i tha Zanës të mbahej mirë, i ra kalit dhe ky rendi me trok nëpër pyll...

I gjalli dhe e rilindura qëndronin bashkë në një kalë, një pjesë e shpirtit të saj kishte vdekur dhe tani dalëngadalë do të zinte vend shpirti njerëzor, me forcën dhe dobësit e veta, me gëzimet dhe brengat. Veç këngët e saj, këngët e zanës, prapë ato këngë do të mbeteshin të gjalla, sepse qeniet e mrekullueshme i kishin marrë hua nga njeriu dhe tani duhej t'ia kthenin po njeriut...

*D. Shaplllo*



### ***Fjalë dhe shprehje***

*bjeshkë/ë-a* – mal i lartë me kullota verore

*guv/ë-a* – vrimë e madhe në shkëmb, shpellë

*duke qëmtuar* - këtu: duke zgjedhur

*shkonte udhë e pa udhë* - ikte pa ditur se ku shkonte

*të ndeshnin me sytë e tu* - të shiheshin me ty

*iu dhimbs ajo* - i erdhi keq për të

*trok-u* - zhurma që bëjnë thundrat e kalit gjatë ecjes



### ***Komentojmë tekstin***

- Për se u ngjit lart në bjeshkë Halili?

- Çfarë u kishte ndodhur babait dhe vëllezërve të tij?

- Tregoni me hollësi si e vrau dhinë Halili dhe çfarë ndjeu ai për të?

- Ç'ndryshime i ndodhën Zanës pas vrasjes së dhisë?

- Ritregoni me fjalët tuaja dialogun ndërmjet Zanës dhe Halilit?



### ***Detyrë***

Bëni një përshkrim me temë “Zana, mbretëresha e pyllit” sipas përfytyrimit që keni për Zanën.

# GJËEGJËZAT

Ç'ËSHTË NJË E Ç'ËSHTË NJË...

Kur i lidh ikin, kur i zgjidh rrinë? (Opingat, këpucët)

Bie në ujë s'laget? (Dielli)

Dy vëllezër mbajnë zjarr në dorë e nuk digjen? (Masha)

Dhjetë motra me nga një sini mbi krye? (Gishtat dhe thonjtë)

Një kuti plot inxhi? (Goja me dhëmbët)

Një litar i gjatë i gjatë, gjysmë i njomë gjysmë i thatë? (Dimri dhe behari)

Gjithë gjënë e ha e të ngopur s'ka? (Mullixhiu)

I ati me rroba të gjelbërta, i biri me rroba të kuqe? (Burbuqja dhe lulja)

Një qen i zi ruan shtëpinë e tij? (Çelësi i derës)

Rrumbullak strumbullak me ca flutura në bark? (Kungulli)

Një kuti me katër feta buke. (Arra)

Një poçe kos përmbi shtëpi. (Hëna)

Kudo vete, shtëpi me vete. (Breshka)

Mbret nuk është e mban kurorë, orë s'ka e njeh çdo orë? (Gjeli)

Ka s'është e brirë ka, gomar s'është e samar ka, ngado shkon argjend lëshon? (Kërmilli)

Një kamare, plot sqepare? (Goja me dhëmbët)

## Shënim

Gjëegjëzat janë krijime të shkurtra që përbëjnë një gjini të veçantë. Ato paraqesin përshkrim të tërthortë e të ngjeshur (zakonisht në vargje) të një sendi ose të një dukurie, që i jepet dikujt për ta gjetur se çfarë do të thotë p.sh.:

Ha me bark dhe vjen përçark. (Mulliri)



## Detyrë

Mblidhni dhe shënoni në fletore edhe gjëegjëza të tjera.



# DR. GJILPËRA "SHËRON" ARIFENË E ZYLFIKAR AGAIT

... - Nesër, - tha Zylfikar agai, - urdhëroni këtu: unë kam me thirr avukatin për me e mbaru punën.

Ashtu caktuan kohën dhe doktori me axhentin e Kamorres u ngritnë të shkojnë.

- Ju kam rixha, urdhëroni rrini dhe pak, - tha Zylfikar agai. – po bëhet kafja dhe sa të bahet kafja du me ju lypë një nder.

- Urdhëroni, - iu përgjigj dr. Gjilpëra dhe u ul përsëri.

- Kam gruan të sëmur, heqim bej, dhe du një ilaç.

Dr. Gjilpëra i preu fjalën menjëherë:

- Ajo është gjë e pamundur, jam mjek vetëm për burra, s'jam mjek grash.

- Axhaip! Po pse? – pyeti Zylfikar agai.

- Se zotni doktori e di që burrat shqyptarë janë erzilli e s'duan me i nxjerr gratë - tha Ibn-el-Kelbi.

- Aferim, heqim bej, - bëri Zylfikar agai.

- Kam nër mend të sjell një grua doktore nga Evropa, një doktoreshë, për të shikuar gratë, - vazhdoi dr. Gjilpëra.

- Axhaip! Paska dhe gra heqime n'Evropë? – bëri Zylfikar agai.

- Ka shumë dhe disa janë mjekesha të mira, - u përgjigj dr. Gjilpëra. Jam i bindur se në një vend me namus' si Shqipëria, e vetëma udhë që të këqyren gratë – e sëmura ashtu siç duhet është të sjellin ca doktoresha.

Arifeja e fshehur prapa derës, nxori përsëri zërin e hollë të saj: – Po neve, grave të sëmura si do të na bëhet halli, doktor bej? Na kemi me vdekë gjersa të vijn doktoreshat.

Dr. Gjilpëra u mejtua pak: - Unë kam shpikur dhe një sistem të ri, - tha, - në ca raste mund të shikoj një njeri me anë të një veqili. Fjala vjen, në vend të zonjës këtu, mund të këqyr burrin e saj, të ndershmin Zylfikar aga; dhe po të jetë nevoja të jap nonjë ilaç, do t'ia jap Zylfikar agait: dhe jam i bindur se ashtu zonja do të shërohet.

Dhe i tërhequr nga ironia e tij, Dr. Gjilpëra zhvilloi me fjalë më të gjata sistemin e një medicine by proxy, mund të thoni inglisht. Kujtonte se dëgjonjësit mirrin pjesë te tallja e hollë dhe e çmojin. Po çudia e tij qe shumë e madhe kur, duke mbaruar, zbuloi që ata kishin marrë fjalët e tij për të vërteta dhe ishin që të tre plot me entuziazmë.

- Vallahi asht një usull fort i bukur, heqim bej! – tha Zylfikar agai.  
- Aman, doktor bej, këqyrni Zylfikar agën dhe shpëtomëni mu të mjerën!  
– u lut zëri i hollë i Arifësë prapa derës.  
- Zotni doktor, bani himmet dhe mbarojeni këtë punë, - shtoi axhenti i Kamorres.

Dr. Gjilpëra kish rënë në një trap të ngrehur me duart e veta. Po të mohonte ndihmën e tij duke zbuluar ironinë, mund që këto shpërte primitive ta mirrjin shakanë si një sharje dhe ahëre kushedi se ç'mund të ngjiste. Nga ana tjetër, ç'marrëzi më e çuditshme se të përpiquej të shëronte Arifenë, duke i dhënë ilaçe Zylfikarit!? I vetmi shpëtim ish në të lënë punën për më tutje në qoftë se mund t'i bindte këta njerëz të mbarë ta lejin provën për më vonë.

- Po presim pra, doktor bej, - qortoi me butësi zëri i hollë prapa derës.  
- Më falni që ju bëra të prisni, tha dr. Gjilpëra. – Ju lutem zonjë, si e ndjeni veten dhe ku kini të dhëmbura?

- E para e punës, më mendojnë dhëmballat shumë, s'më zë gjumi prej të dhimbunave.

E para e punës, domethënë Arifeja kish dhe të tjera halle veç dhëmballave. Dr. Gjilpëra u ngrit dhe hapi nofullat e Zylfikar agait. Pesë dhëmbë ishin të prishur liksht, dhe do të qe fitim për shëndetin e Agait sikur të nxirreshin. Mirëpo dr. Gjilpëra, ndonëse dinte çdo gjë që mund të dihej për dhëmbët, s'kish aspak stërvitje praktike në këtë degë.

- S'kam darat këtu, ta lëmë punën për një herë tjetër, - tha doktori.  
- Qyqja unë u fika! – Aman, doktor bej, kini merhamet! Kemi na darë. Lejla, shpjeri darën doktor beut, - thirri Arifeja.

Dhe para se të mbetej kohë për protestim, vajza e vogël Lejlaja hyri me një darë të frikshme dhe ia dha dr. Gjilpërës.

- Kjo asht darë për të shkukur gozhdë! – protestoi mjeku me një tingull lutjeje në zërin e tij.

- Heqim beu ka hak, - bëri Zylfikar agai i verdhur, -ta lëmë për një herë tjetër.  
- Ke frykë, Zylfikar agë; jazëk të qoft! – tha Arifeja.  
- Bahu trim, Zylfikar agë! Asht sevap, se e ke gru, - shtoi Ibn-el-Kelbi.  
- Aman, doktor bej, mos e ndigjo Zylfikar agën, - insistoi Arifeja.  
- Sillni një legen dhe një kupë ujë të kripur, - urdhëroi doktori.

Ca çaste më vonë Lejlaja i pruri. Ahëre dr. Gjilpëra, i djërsitur nga kjo skenë e çuditshme, mori darën dhe hapi nofullat e Zylfikar agait. Të tre dhëmbët e para duallnë pa mundim, i katërti kish rrënjën aq të shëndoshë sa u thye maja, po rrënja s'lëvizte. Zylfikar agai lëngonte.

- Gajret Zylfikar agë, - bërtiste gruaja.

- Gajret, se e ke gru! Dale të të mbaj unë gojën të hapur, - tha Ibn-el-Kelbi, dhe ia hapi nofullat aq shumë, sa dukej sikur do të shkallmoheshin. Duke përmbledhur tërë fuqinë në dorë dhe në krahë të tij, dr. Gjilpëra shkuli dhe këtë dhëmballë xanaxare. Dhëmbi i pestë dhe i fundit doli pa mundim. Zylfikar agai bëri uf, medet! Shpëlaun gojën, kërkoi një kupë ujë të ftohtë, piu, bëri përsëri uf, medet! dhe porositi thingjill për nargjilen. Dr. Gjilpëra u ul në shilte dhe fshiu djersën e ballit. Lejlaja pruri thingjill dhe të gargalisurit e nargjilesë u dëgjua përsëri.

- Si e ndien veten tashi, Arife, pyeti më në fund Zylfikar agai.

- Jam shumë mir'. S'kam më të dhimbuna, - erdhi përgjigja e papritur. Dr. Gjilpëra hapi sytë. A kish përpara një ngjarje shërimit nga besimi i fortë në shërimin e pritur, apo mos kish të bëjë me një grua të bezdisur nga kafshëritë e një burri të ashpër, e cila kapi këtë rast për të nxjerrë inatin e mundimeve që hiqte? Dr. Gjilpëra kish dëgjuar se gratë e Tiranës janë shakaxhesha të mëdha; dhe ndonëse Zylfikar agai s'dukej njeri i keq, s'dukej as të dinte se dhe gruaja ka të drejtën e saj. Kush i di tragjeditë e përditshme në jetë të një gruaje barbari? Tragjedi aq të vogla për të huajin sa s'duken në sy, po aq të mëdha për viktimën, sa qëllojnë si sëpata në zemër të saj dhe lënë plagë të përjetshme.

FAIK KONICA

### ***Vepër me përmbajtje satirike***

Kjo pjesë është shkëputur nga vepra “Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, shkruar e botuar në vitin 1924 në gazetën “Dielli” të Bostonit – Amerikë dhe ribotuar në Tiranë, më 1993 “Faik Konica – Vepra”. **Përmes satirës** autori përshkruan gjendjen e rëndë ekonomike, prapambetjen, varfërinë e mjerimin e popullit në atë kohë.



### ***Fjalë dhe shprehje***

*veqil-i* – zëvendës, përfaqësues i diçkaje

*këqyr* – shikoj

*ndonjë* – ndonjë

*ironi-a* – tallje që bëhet në mënyrë të mbuluar e të hollë

*usull-i* – këtu: një zakon, një sistem

*beqim-i* – mjek

*bani himmet* – këtu: ju lutem, bëni shërbimet

*axhent-i* – (agjenti) një person i ngarkuar me punë nga një shoqëri

*kini merhamet* – këtu: kini mëshirë

*protestim-i* – shpreh kundërshtimin për diçka

*jazëk* – turp, faqja e zezë

*sevap-i* – mëshirë, bamirësi

*gajret-i* – këtu: durim

*xanxare* – këtu: të vështirë

*gargalisurit* – këtu: llokoçitja

*nargjile-ja* – lloj çibuku i vendeve të Lindjes që lidhet me një enë me ujë

*barbar-i* – këtu: njeri që sillet keq



### **Komentojmë tekstin**

Pse dr. Gjilpëra nuk donte ta vizitonte Arifenë: ishte vërtet mjek vetëm për burra apo mendoni se i ka ndodhur ndonjë ngjarje e hidhur kur ka dashur të vizitojë ndonjë grua?

Ç’mentalitet godet autori?

Çfarë sistemi të ri kishte shpikur doktori për të shëruar gratë? Flitni për ironinë që përmban propozimi i doktorit për të vizituar burrin në vend të gruas.

Pse Arifeja ngul këmbë që të vizitohet?

Cilat janë idetë që shpalos autori në këtë pjesë?

Shpjego me fjalët tuaja si i kuptoni këto fjalë:

“... ndonëse Zylfikar agai s’dukej njeri i keq, s’dukej as të dinte se edhe gruaja ka të drejtën e saj”.

Vërnini re me kujdes gjuhën e personazheve dhe të autorit. Nënvizojini shmangiet nga norma letrare. Cilat prej tyre bëhen me qëllim prej autorit, (për të dhënë mjedisin, nivelin kulturor artistik të personazhit, etj.).

### **FAIK KONICA (1875 – 1942)**



Është njëri nga lëvruesit më të mëdhenj të gjuhës shqipe, publicist, studiues dhe përkthyes. Lindi në Konicë në vitin 1875. Në vendlindje mori mësimet e para në gjuhën turke, arabe dhe greke. Studioi në liceun e Stambollit dhe i përfundoi në Francë. Në Bruksel drejtoi gazetën “Dielli” dhe më pas “Trumbeta e Krujës”. Qe sekretar i përgjithshëm i Federatës “Vatra”. Mbrojti çështjen shqiptare në Konferencën e Amasadorëve në Londër. Ka shkruar:

“Nën hijen e urmave” (1924), “Doktor Gjilpëra, zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, “Katër përralla nga Zullulandi”, “Shqipëria si m’u duk...”. La në dorëshkrim të shkruar anglisht veprën: “Shqipëria – kopshti shkëmbor i



Evropës Juglindore” e cila u botua në vitin 1957. Ka shkruar edhe shumë artikuj, pamflete, shënime, ese etj. Vdiq në vitin 1942 në Amerikë.

## SUBJEKTI

Veprat e gjinisë letrare epike, të gjinisë dramatike dhe të llojit epiko-lirik (poema, balada, romani në vargje) përpos temës, idesë, kompozicionit, kanë edhe subjekt. Gjinia letrare lirike nuk ka subjekt.

Subjekti është tërësia e ngjarjeve, e veprimeve, e konflikteve nëpërmjet të të cilave dalin në pah karakteret e tiparet dalluese të personazheve dhe zbulohet përmbajtja e një veprë letrare.

Subjekti ndahet në disa pjesë përbërëse, që u përgjigjen etapave të zhvillimit të konfliktit themelor të veprës. Këto pjesë janë: paraqitja e veprimit, zhvillimi i veprimit, kulmi, peripecia (shthurja), zgjidhja.

## KOMPOZICIONI I VEPRËS LETRARE

Ka vepra, si veprat lirike dhe epiko-lirike, që janë të ndërtuara në vargje. Të tilla janë këngët popullore, poezitë e poemat etj.

Vepra të tjera janë të ndërtuara në prozë, si: tregimet, novelat, romanet. Veprat në prozë janë kryesisht me subjekt dhe me personazhe.

Mënyra se si i organizon shkrimtari ngjarjet në vepër, si i vendos personazhet, marrëdhëniet që kanë ata me njëri-tjetrin, përbën kompozicionin (ndërtimin) e veprës. Kështu te balada “Atdheu dhe dashuria”, poeti tregon me radhë disa ngjarje dhe na njeh me disa personazhe. Vitoja që shkon në krua, takimi me turkun, vendosja e dy trimave ballë për ballë dhe njohja e tyre. Në këtë baladë janë tri personazhe, të cilat autori i vendos dy përballë të tretit. Duke përshkruar ngjarjet, autori jep edhe të dhëna për secilin personazh. Kjo baladë ka një bosht, pra flitet vetëm për një ngjarje kryesore.

Ka vepra, si romanet, që përshkruajnë shumë ngjarje në të cilat marrin pjesë shumë personazhe. Këto vepra janë ndërtuar me disa linja subjekti.

Ka vepra në të cilat subjekti ndërtohet sipas rrjedhës së ngjarjeve, por ka edhe të tilla që në fillim jepet zgjidhja, mandej zhvillimi i ngjarjes.

Në poezitë, ku nuk ka subjekt e personazhe, ndjenjat dhe mendimet i shfaq vetë poeti.

**Në veprën dramatike** kompozicioni është më i ndërlikuar. Aty mbi-zotëron dialogu dhe monologu. Personazhet vendosen përballë njëri-tjetrit. **Veprat dramatike** ndërtohen me akte, skena ose pjesë.

Në kompozicionin e veprave asgjë nuk duhet të jetë e tepërt. Çdo pjesë, çdo veprim duhet të ndihmojë për shtjellimin e plotë të temës së veprës, për zbërthimin e ideve të saj, me qëllim që ato të kuptohen mirë dhe të ndikojnë në ndjenjat dhe në mendimet e lexuesit.

# KULTURA

Ideali i njeriut të mësuar është në ditët tona specializimi në një degë. Disa vjet shkolle të mesme, pak vjet në universitet, një periudhë studimi të edhshëm për të kaluar provimet dhe, me të dhënë diplomën në xhep, puna mer fund për shumicën tonë. U bëmë specialistë, mësua një zanat, siguroham një mjet jetese dhe qëllimi u arrit. Kush u bë nëpunës, kush çeli një zyrë private, kush një klinikë, kush një dyqan...

Çdo njeri prej nesh e ka në dorë të shpëtojë nga automatizimi i specialistit duke u bërë njeri me kulturë. Kultura është thesari më i çmuar i njeriut të qytetëruar; ajo është stolja e mendjes, lartësimi i shpirtit, shkathtësia e ndjenjave, freskia e shpirtit...

Por kultivimi i vetvetes nuk është një send që mësohet në shkollë. Secili duhet ta gjejë vetë mënyrën më të mirë për të mos e humbur interesimin për çështjet e mëdha që kanë lidhje me fatin e njeriut dhe zhvillimin e shoqërisë, për të mos vdekur për së gjalli në rutinën e një pune mekanike. Rruga më e provuar që kanë ndjekur titanët e mendimit është kureshtja e gjallë që nuk na le të kënaqemi me atë që dimë. Asgjë nuk duhet të na lerë indiferentë. Të kemi syrin e çelur dhe një etje të pashuar për dituri. Të mos kërkojmë zhurmën e poteren për të hutuar veten tonë, të shqyrtojmë vetveten deri në thellësinë e instinkteve që buçasin atje brenda, të analizojmë ndjenjat tona, të ndjekim një mendim, të radhitim në një çip të mendjes ose mbi një copë letre përshtypjet që na kanë lënë leximet, udhëtimet, kontakti me njerëzit. Të kontrollojmë veten duke parë se si kanë menduar, kanë ndier, kanë jetuar njerëzit e shquar të çdo kohe, të dimë të shijojmë ëndjen që ndien njeriu me kulturë, kur ndjek rrymën e mendimeve që i kalojnë nëpër mendje jashtë vullnetit të tij, si një film kinematografik. Abuzimi i kulturës është aq i dëmshëm sa dhe ngrënia e tepërt për llupësin e babëzitur. Qëllimi nuk është të ngarkojmë trurin me çdo lloj diturie. Kulturën duhet ta kundrojmë sinj mjet për të lartësuar veten nga pikëpamja intelektuale e morale, ashtu edhe për tu bërë sa më i vlefshëm i shoqërisë. Kultura është kondita e domosdoshme e çdo përparimi të vërtetë të individit në lidhje me kolektivitetin. Ajo është zana hyjnore që i jep kuptimin lirisë. Të kesh për shumë sende nuk është vetëm një kënaqësi në vetvete, një mjet ideal për të mos u mërzhitur, por edhe një mjet për tëmos e ndier veten

si të huaj, si të izoluar në botën ku jetojmë.

Njeri me kulturë nuk është vetëm ai që interesohet për literaturë, për muzikë, për tablo e skalitje të stërholluar. Kultura e vërtetë na çel rrugën e së vërtetës. Në vend që ta qullojë e t'i shuajë energjinë, kultura i ngjall njeriut në shpirt pasoinet më të zjarrta. Përmes kulturës ne çmojmë vlerën e mendjes që është e para nga vlerat shpirtërore, shohim se nëpër çfarë kallëpe kalon e vërteta për të triumfuar, stërvitemi të urrejmë gënjeshtren e falsitetin ndër të gjitha petkat që i vesh moda e ditës. Nuk duhen shumë të ardhura për t'u bërë njeri me kulturë. Këtë luks mund t'ia lejojë vetvetes edhe më i varfri njeri, mjafton të ketë pak zgjim dhe vullnet. Sepse nuk është nevoja të mplakesh nëpër bibliotekat e muzetë. Mjafton të këqyrësh rreth e rrotull, të vëzhgosh, të krahasosh, të vrasësh mendjen për të kuptuar si është ndërtuar kjo gjë, pse punon kjo makinë, e të tjera. Vetëm se interesimi për të tilla çështje lyp një farë modestie. Prandaj kultura e vërtetë duhet të jetë modeste, mbasi ajo nënkupton që çdo njeri për veten e tij të ndjejë nevojën për të ditur gjithçka kanë vepruar dhe kanë menduar të gjithë njerëzit e tjerë.

*Tajar Zavalani (1903-1966)*



### ***Komentojmë tekstin***

Përse bëhet fjalë në tekst?

Për cilin njeri themi se është i kulturuar?

A mund të quhet njeri i kulturuar vetëm se ai që ka kryer shkollë të lartë?

Çfarë mesazhi (porosi) na jep autori?



### ***Detyrë***

Shkruani dhe ju një mesazh 6-8 rreshta, me të cilin t'ju drejtoheni shokëve tuaj, në lidhje me vlerën e madhe të kulturës në jetën e çdo njeriu.



## POEMA E MJERIMIT

Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,  
kafshatë që të mbetë në fyt edhe të ze trishtimi,  
kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta,  
që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert' e mpita  
edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin  
të tanë jetën e vet derisa të vdesin.

E mbi ta n'ajri, si qesëndi,  
therin qiellën kryqat e minaret e ngurta,  
profetent dhe shejtent në fushqeta të shumëngjyrta  
shkëlqejnë. E mjerimi mirfilli ndjen tradhti.

Mjerimi ka vulën e vet të shëmtueme;  
asht e neveritshme, e keqe, e turpshme;  
balli që e ka, syt' që e shprehin,  
buzët që më kot mundohen ta mshefin –  
janë fëmitë e paradijes e flitë e përbuzjes,  
të mbetunat e flliqta rrethepërqark tryezës  
mbi të cilin hangri darkën një qen i pamëshirshëm  
me mbark shekulluar, gjithmon i pangishëm.  
Mjerimi s'ka fat. Por ka vetëm zhele,  
zhele fund e maje, flamujt e një shprese  
të shkymë dhe të copëtuem me të dalun besë.

Mjerimi tërbohet në dashuri epshore.  
Nëpër skaje t'errta, bashkë me qejë, mijë, maca,  
mbi pecat e mykta, të qelbta, të ndyta të lagta  
lakuriqen mishnat, si zhangë, të verdhë e pisa,  
kapërthehen ndjenjat me fuqi shtazore,  
kafshojnë, përpijnë, thithen, puthen buzët e ndragta  
edhe shuhet uja, dhe fshihet etja  
n'epshin kapërthyes, kur mbytet vetvetja.  
Dhe aty zajnë fillin të marrët, sherbtoret dhe lypsat,

që nesër do linden me na i mbushë rrugat.  
Mjerimi në dritzen e synit te kërthini  
dridhet posi flaka e mekun qirini  
nën tavan të temuem dhe plot merimanga,  
ku hije njerzish dridhen ndër mure plot danga,  
ku foshnja e msueme qanë si shpirt' i keq  
tu' ndukë gjithë e shterruna e të zezës amë;  
e kjo prap' shtatzanë mallkon zot e dreq,  
mallkon frytn' e vet, mallkon bar' n e randë.  
Foshnj' e saj nuk qesh, por vetëm lëngon,  
e ama s'e don, por vetëm mallkon.  
Vall sa i trishtueshëm asht djepi i skamit,  
ku foshnjën përkundin lott edhe të fshamit!

Mjerimi rritë fëmin' në hijen e shtëpive  
të nalta, ku nuk mrrinë zalli i lypsis',  
ku nuk mund t'u priset qetsia zotnive  
ku bashkë me zonja flejnë në shtretënt e lumnis',  
mjerimi pjek fëmin' para se të burrnohet;  
don të msojë t'i hiki grushtit q'i kërcnohet,  
atij grushti që në gjumë e shtrëngon për fytit  
kur fillojnë kllapitë e etheve prej unit  
dhe fëtyrën e fëmis' e mblon hij' e vdekjes,  
një stoli e kobshme në vend të buzqeshjes.  
Një fyt kurse piqet dihet se ku shkon,  
- q'asht edhe fëmija në bark të dheut mbaron.

Mjerimi punon, punon dit' e natë,  
tu' i vlue djersa në gjoks edhe në ballë,  
tue i zhigatun deri në gujë në baltë  
e prap' zorrët nga uja i bahen palë - palë.  
Shpërblim qesharak! Për qindenjë afsh  
në ditë - vetëm: lekë tre-katër dhe "marsh!"

*Millob Gjergj Nikolla – Migjeni*

## Shënim

Krijimi më i rëndësishëm i Migjenit me temë sociale dhe një nga kryeveprat e letërsisë shqiptare, pa dyshim se është “**Poema e mjerimit**”. Ajo është thurur si një tregim për gjendjen tragjike të masës së varfër.

Duke klithur dhembjen, na jep pamje dhe skena rrëqethëse, figura njerëzish të mbërthyer nga një trishtim i rëndë. Mjerimin e indinjon hendeku i pabarazisë shoqërore, kontrasti në mes të luksit të të pasurve dhe jetës varfanjake të shumicës së njerëzve.



### Fjalë dhe shprehje

*s'kapërdibet* – nuk gëlltitet

*qesëndi* – qëndrim tallës

*zhele* – copë e shqyer që varet nga një rrobë e vjetër

*i mekun* – flakë e dobët e qiriut

*lëngon* – dergjet nga sëmundja

*kllapi* – gjendje e njeriut kur e humb vetëdijen



### Komentojmë poezinë

1. Kush e frymëzoi poetin për ta shkruar këtë poemë?
2. Si e përshkruan gjendjen e vështirë të masës popullore?
3. Cilën shtresë shoqërore e mallkon poeti dhe pse?
4. Analizoje pjesën e fundit të poemës.
5. Cila është tema kryesore në këtë poemë?

### Tema e veprës letrare

Tema e veprës letrare është një rreth i caktuar dukurish që zgjedh poeti nga realiteti dhe i përgjithëson në vepër.

Çdo vepër letrare ka temë të caktuar. Ato mund të jenë të nduarnduarshme si p. sh. ngjarjet, personat, dukuritë e ndryshme shoqërore, marrëdhëniet klasore, jeta e përditshme, veset e një individi, veset shoqërore etj. P.sh.: tema e veprës së N. Frashërit “Bagëti e buqësi” është himnizimi i natyrës shqiptare dhe i punëve të blegtorisë e buqësisë. tema e vjershës së Migjenit “Poema e mjerimit” është mjerimi i shtresave të varfëra të qytetit etj.



## MIGJENI (1911 – 1938)

Milosh Gjergj Nikolla është poet dhe prozator. Migjeni është pseudonimi i tij. Lindi në Shkodër më 1911, në një familje të varfër qytetare. Kaloi një fëmijëri të vështirë, sepse mbeti jetim qysh i vogël. Mësimet e para i mori në Shkodër, kurse mësimet e mesme, në Manastir. Punoi mësues në Vrakë, Shkodër e Pukë. Migjeni qe kryesisht poet, por shkroi dhe tregime dhe skica të bukura proze. Disa nga poezitë e tij i botoi në shtypin e kohës e më vonë i përmbloodhi në një vëllimth me titull “Vargjet e lira”. Shkrimet e tij, poezi e proza, Migjeni i botoi kryesisht në revistën “Bota e re”, tribunë e letrarëve të rinj, që botohej në Korçë.

Jeta e Migjenit qe e shkurtër. Vdiq nga turbekulozi në një senatorium të Italisë në moshën 27 vjeçare. Ka shkruar pak, por vepra e tij është e fuqishme. Shkrimet e tij poetike dhe në prozë janë përkthyer në disa gjuhë të botës. Ai i këndoi rinisë dhe është quajtur “poet i rinisë”. Për meritat e tij i është dhënë titulli “Mësues i Popullit”.

## NJË MBRËMJE NË LURË

Udhëtojmë drejt Lurës. E vërteta është që, zakonisht prapa fjalës tingëlluese “Lurë”, shtrihen të pestë liqenet e saj me tërë bukurinë dhe magjinë e tyre. Askush nuk mund ta ndajë Lurën nga liqenet e saj. Prandaj, kush udhëton drejt Lurës, udhëton drejt liqeneve të saj.

Por, këtë muaj të nxehtë vere, Lurën është vështirë ta ndash edhe nga diçka tjetër. Këtë muaj, gati dyqind studentë po hapin atje një rrugë pyjore. Ata kanë ardhur nga larg, në fushën e vogël midis maleve, me kazmat, lopatat, humorin dhe të folurin e tyre të ndryshme nga ajo e vendasve. Lura e vogël, e largët, ka këtë muaj dyqind mysafirë. Dyqind mysafirë nuk janë pak. Dhe këta janë dyqind studentë, pak të çutidshëm, pak rrëmujaxhinj, ashtu siç janë studentët.

Rruga kalon midis kodrinave të buta, të gjelbra. Majë kodrave ngrihen kullat e gurta malësore, dritare të vogla të ngushta, frëngji, sharapllore për të luftuar. Duket sikur horizontet e hapura u vrisnin sytë këtyre kullave, ndaj i kanë zvogëluar fare dritaret. Këtë gjë e kishte diktuar logjika e jetës. Për derisa nga jashtë mund të hynte bashkë me rrezet e diellit edhe plumbi, atëherë sa më pak diell në jetën e zymtë të malësorëve.

Kullat ngrihen në të gjitha drejtimet. Herë përballë njëra-tjetrës, herë të vetmuara fare.

Kulla dhe frëngjitë e saj. Drama e gurtë e jetës së malësorit. mbi ato frëngji ka shtirë ai që ndodhej përjashta, nga ato frëngji është mbrojtur ai që ndodhej brenda. Dhe të dy ndodheshin mbi të njejtën tokë, mbi tokën amëtare.

Tani frëngjitë heshtin. Krismat gjakmarrëse po zhyten dalëngadalë në harresë. Ato nuk janë fshehur në ndërgjegjen që të shpërthejnë një ditë përsëri, ato po shkulen një herë e përgjithmonë nga zemra e malësorit tonë. Asnjë forcë nuk mundi ta shkulte nga ndërgjegja e malësorit gjakmarrjen. As ligjet, as arti, as përpjekjet e intelektualëve të ndershëm. U desh një tërmet i tillë si Lufta Nacionalçlirimtare për të shkundur këtë zakon të tmerrshëm.

Ndonjë fshatar i Lurës na tregon, jo pa njëfarë krenarie të lehtë, se në krahinën e tyre gjakmarrja kishte qenë më e butë se te ata, si do qoftë, kishin vendosur disa rregulla, të cilat i respektonin me rreptësi. Kështu, p.sh. në Lurë ishte e ndaluar që t'i prishje gjakësit kafënë e mëngjesit (d. m. th. të qëlloje me pushkë në kullën e tij, kur ai pinte kafënë). Ishte e ndaluar, gjithashtu, të qëlloje



në katin e kullës ku ishin gratë. Në qoftë se ndodhte kjo, atëherë një komision nga fshati e hetonte çështjen dhe shkelësit e rregullave dënoheshin rëndë. Kishte edhe rregulla të tjera. Të gjitha këto tregojnë se arsyeja e shëndoshë popullore, jeta mundahej ta luftonte këtë vetasgjësim. Mundahej, por më kot. Qëllonte që përbindëshi i gjakmarrjes, qetësohej, për ca kohë, ose më mirë dukej sikur qetësohej, sepse, pa pritur, një mëngjes ai sulej përsëri edhe më me tërbim, që të bënte kërdrinë mbi jetën njerëzore. Derisa lodhej dhe prapë strukej që të shpërthente një ditë prapë, dhe kështu vazhdonte kjo histori. S'ka sesi të mos i mendosh të gjitha këto kur udhëton nëpër malësitë tona.

- Mirëdita!

Përshtëndesin çdo njeri ose të panjohur, përshtëndesin me seriozitet dhe me zë të fortë. Ata të vegjlit, (po me atë tingull dhe seriozitet madje ndoshta me më shumë seriozitet) na përshtëndesnin me një fjalë që nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë.

- Mirëdreka!

Përshtëndetja e mirditorëve të vegjël është e dashur dhe kurioze për udhëtarin. Ne gëzoheshim kur i shihnim që larg dy ose tre bashkë, të vegjël fare, gëzoheshim sikur të gjenim një hije ose një burim përpara. Dhe mezi prisnim sa të na afroheshin dhe të na përshtëndesnin të parët.

- Mirëdita!

- Mirëdreka!

Ne pyesim ku janë studentët vullnetarë, dhe ata na tregojnë. Përmes fushës së Lurës shtrihet rruga e re, vende-vende hapur, vende-vende jo. Vullnetarët janë shpërndarë në një vijë të gjatë. Puna është e vështirë dhe dielli djeg. Megjithatë, fshatarët na thonë se ata punojnë mirë. Madje nuk e prisnim të punonim kështu. Njerëz me shkollë të lartë, mendonin, kazma do t'i dërmojë.

Rruga e hapur, si çdo rrugë e hapur ka historin e saj të vogël të përditshme. Këtu toka është e fortë, aty duhen prerë ca plepa të bukur e të lartë në një vend thonë se fshatari ka mundësi të ketë lëvizur natën piketat, në mënyrë që të shpëtojë njëzet e pesë centimetra tokë nga ana e tij. Veçanërisht të vjen keq për plepat. Për një shirit toke dy pëllëmbë, që duhet marrë nga ana e një fshatari, priten këta viganë të bukur.

Dhe kështu rruga vazhdon të hapet. Ndoshta do ta quajmë më vonë "Rruga e studentëve". Por kjo s'ka rëndësi. Lurasit do t'i kujtojnë për shumë kohë mysafirët e zhurmshëm, që erdhën nga larg, që punuan, kënduan, thanë anekdoda, dhe pastaj ikën duke lënë prapa rrugën, këtë kujtim të madh e të drejtë mospërmes pllajës.

Mbasdite, ndërsa vullnetarët pushojnë, ne vendosim të shkojmë te liqenet.

Liqenet janë lart, në mal. Rruga gjer tek ata është e gjatë.

Ne ecim midis pishave që zhurmojnë mbi kokat tona me një shushurimë të fuqishme, të freskët. Befas na shfaqen liqenet, njëri pas tjetrit, ma tepër të gjelbër se të kaltër të rrethuar nga malet dhe pishat. Si gjithmonë, kur ndodhesh përpara gjërave të bukura, është vështirë t'i përshkruash. Fjalët janë të zbehta përpara ujit dhe gjelbërimit që përbëjnë gjithë ato nuanca të kësaj bukurie të gjallë. Piktori ulet në heshtje te një gur. Nxjerr bojërat dhe fillon të hedhë në akuarel një pjesë të pamjes. Është ora e muzgut. Tonet e ngjyrave ndryshojnë me shpejtësi. Në akuarelin e tij, bashkë me ujin e pastër, blerimin e pishave dhe copat e trungjeve të kalbura, nis e shfaqet muzgu. Edhe pak, dhe nëpër fushë do të duket errësira e dobët, e dridhshme. Por piktori e mbaron akuarelin përpara se të bjerë mbrëmja. Ne vërtitemi një copë herë brigjeve, unë mundohem të fut në kamerën e fotoapararit diçka nga ky muzg dhe pastaj nisën të zbresim.

Te vullnetarët arritëm vonë. Tani ata kanë ngrënë darkën dhe po rrinë nën tendën e mensës, në gjysmëerrësirë. Njëri i bie kitarës. Të tjerët dëgjojnë. Shkëlqejnë në errësirë cigaret. Një vajzë ka mbështetur kokën te dora. Është ora kur njeriu qëllon të bëhet ndonjëherë i heshtur. Ç'nuk të kujtohet në këtë orë.

Ismail Kadare



### **Fjalë dhe shprehje**

*humor-i* - gjendje shpirtërore gazmore, këtu: shakatë

*vendas-i* - banori që ka lindur në atë vend

*frëngji-a* - një e çarë si dritare e vogël në kulla e kështjella

*sharapoll-i* - pjesë e dalë në murin e një kulle, si një ballkon i mbyllur me frëngji

*diktoj* - zbuloj, gjej, pikas

*kurioze* - këtu: që të zgjon kureshtjen, e çuditshme

*piketë-a* - kunj i shkurtër druri që ngulet në tokë

*pllajë-a* - rrafshnaltë

*akuarel-i* - pikturë e bërë me bojëra uji

*ton-i* - këtu: hollësi




### **Komentojmë tekstin**

Pse shkrimtari thotë se atë muaj të njetë vere Lurën nuk mund ta ndash as nga liqenet e saj, as nga vullnetarët?

Si përshkruhen kullat e malësorëve, si janë ndërtuar ato?

Për ç'zakon prapanik bëhet fjalë në këtë reportazh? Krahasoni këtë zakon me atë që thotë Pashko Vasa te pjesa “Jetesa e shqiptarit”. Ç'gjëra të përbashkëta gjeni? A ruhen më këto zakone të vjetra?



### ***Detyrë***

Cilat janë pjesët e përshkrimit të bukurisë së liqeneve të Lurës që ju bëjnë më tepër përshtypje?

### ***Reportazhi***

Te tregimi “Plaku prej bore” A. Nesin na tregon një ngjarje të cilën ai e ka trilluar vetë. Po kështu, edhe Mehmeti i vogël është një personazh i trilluar prej tij. Kurse në pjesën e mësipërme “Një mbrëmje në Lurë” I. Kadare na flet për një udhëtim në Lurë, për studentët, malësorë e vende që nuk janë trilluar prej tij, por janë të vërtetë. Në këtë rast, themi se nuk kemi një tregim, por një reportazh.

Reportazh quajmë përshkrimin artistik që u bëhet ngjarjeve dhe njerëzve të vërtetë.

Reportazhet botohen nëpër gazeta, revista, transmetohen nga radioja, dhe të shoqëruar me filmime, edhe nga televizioni.



# SHPELL' E DRAGOBISË

*(Elegji për Bajram Currin)*

Kur tufani e çthuri fenë,  
Kur tirani e krrusi atdhenë,  
Mi një brek të Dragobisë  
Priret Flamur' i lirisë.

Atje nisi, atje mbaroj,  
Atje krisi, atje pushoj,-  
Rrufe-shkab' e Malësisë,  
Në një shkëmb të Dragobisë.

Vendi dridhej, ay mbeti  
Se s'tronditej nga tërmeti.-  
Dif drangoj i Dragobisë,  
Trim tribun i Vegjëlisë.

O Bajram, bajrak i gjallë,  
More nam me gjak në ballë,  
Te një shpell' e Dragobisë,-  
Yll i rall' i burrërisë.

Thon' u-shtri e thon' u-vra,-  
Po ti s'vdiqe, or Baba,  
As te shkëmb' i Dragobisë,  
As të zëmr' e Djalërisë.

As je vrar' e as po vritesh  
Legjendar Ante po rritesh.-  
Dithiramb i Dragobisë,  
Tmerr, panik i mizorisë.

Me Zjarr Shenjt u-ndrit kjo shpellë,  
Gjer në qjell u-ngrit Kështjellë  
Për çlirimn' e Shqipërisë  
Katakomb e Dragobisë.

FAN S. NOLI

### **Shënim**

Poezia “Shpell” e Dragobisë“ e shkrimtarit të letërsisë shqiptare F.S.Noli është një elegji kushtuar trimit kosovar Bajram Curri, i cili luftoi me trimëri të rrallë kundër pushtuesve osmanë, shovinistëve serbë dhe kundër Ahmet Zogut. Bajram Curri nuk u arratis jashtë atdheut as pas Revolucionit të Qershorit, por përkundrazi qëndroi maleve të Shqipërisë ku u rrethua në Shpellën e Dragobisë (katund në Malësinë e Gjakovës) dhe u vra duke u për-pjekur të çajë rrugën me armë në dorë.



### **Fjalë dhe shprehje**

*Dragobi* – mal në Veri të Shqipërisë

*tufan-i* – erë e vrullshme zakonisht me shi të madh

*Ante* – vigan mitologjik, bir i Neptunit dhe i Tokës

*drangoj* – qenie e trilluar

*tribunë* – vend i ngritur në krye të një salle

*tribuni* – veprimtar i shquar shoqëror, që me fjalët e zjarrta dhe me shkrimet e fuqishme mbron të drejtat e popullit

*dithiramb* – fj.gr.këngë liturgjike për nder të Dionisit

*katakomb* – galeri e nëndheshme me disa tunele të gjata ku varroseshin dikur të vdekurit

*dif* – qenie e trilluar në përralla me trup jashtëzakonisht të madh.



### **Komentojmë vjershën**

Cila është ideja e kësaj poezie?

Si e përshkruan Noli figurën e Bajram Currit?

Pse Bajram Curri nuk e braktisi atdheun pas Revolucionit të Qershorit?

Analizoj strofat 5-6 të vjershës?



### **Detyrë**

Mësojeni vjershën përmendsh.



## FAN S. NOLI (1882 – 1965)

Fan Stilian Noli lindi në fshatin Qytezë (Ibrik Tepe) të Adrianopojës. Qysh i ri mori pjesë në lëvizjen atdhetare të Rilindjes, në fillim në Misir dhe më vonë në SHBA, ku u bë një nga udhëheqësit kryesorë të kolonisë shqiptare të atjeshme. Në Shqipëri jetoi në vitet 1920 – 1924, duke marrë pjesë gjallërisht në jetën politike të vendit, ku pas fitores së Revolucionit Demokratiko Borgjez të Qershorit, kryesoi qeverinë e dalë prej tij. Me kthimin e Zogut, u largua nga atdheu, por e ruajti gjithnjë dashurinë për të, për të shtypurit, për njerëzit e punës. Në letërsinë shqiptare është i njohur me këto vepra: “Albumi” (poezi), “Historia e Skënderbeut” (histori) etj. Fan Noli u shqua edhe si përkthyes me shumë talent. Vdiq në vitin 1965 në SHBA.

## POLISINDETI DHE ASINDETI

Figura stilistike me të cilën poeti bën përsëritjen e një lidhëze ndërmjet fjalëve dhe fjalive të ndryshme quhet polisindet. P.sh.polisindetin e gjejmë në vargjet:

“Dhe më le mua plakën kërcure”

“Dhe më le arën pa mbjellë pesë vjet”.

Asindet i është figura stilistike e kundërt me të parën që sajohet kur poeti bën radhitjen dhe emërtimin e gjërave ose kuptimeve pa i përdorur lidhëzat.

“Sa e dua jetën  
se atje gjej të vërtetën  
yjtë, hënën, hapësirën  
të murgërit, natën, ditën...”

# BESA

MERUSHE – **me rëmbim të math.**

Ah! Rexhep!... ti këtu?... Ah! Perëndi!

REXHEP – **hyn brenda, dhe duke pushtuarë Merushen.**

Ah! Merushe! arçë të të shpëtonj ty!

MERUSHE – **duke rëfyer Selfon me gisht.**

Hesht... se...

REXHEP – **duke hedhur dorën në koburet.**

Ai cili është?... Gjaksori i t'yt eti?... Ay që të rëmbheu ty?...

**Me kobure në dorë këcen mi te.**

MERUSHE – **duke zënë Rexhepnë!...**

REXHEP – **i mahnitur.**

Ah! Merushe!... ti për zot i del këti a?...

MERUSHE – **me zemërim e habitur.**

Për zot më thua?... Unë do t'i dal për zot këti a? Ah! Rexhep!... mua më thua këto!...

REXHEP - Kur qëna kshu! lermë të vras!... t'i mar gjaknë e atës tënë... dhe ty të të shpëtonj nga dora e tij.

**Prapë kërkon t'i hidhet Selfos.**

MERUSHE – **me rëmbimin e zë Rexhepnë.**

Rexhep!...

REXHEP - Ç'është... Merushe... na është se e do thumë!...

MERUSHE – **me zemërim**

Ah! Mua më thua?... **(e hidhëruar)** Ç'të duash bëjë po ta dish që po ryn në gjaktë të të dyvet ne!... që të dyve do të na vrasin!

REXHEP – **i habitur.**

Vërtet!... **(si mejtohet pakë)** Kur është punë eja... eja të të shpëtonj ty një herë pa, pastaj vinj e mar dhe gjaknë e t'im eti!... **(duke lutur Merushes)** Ah! falmë mua!... falmë!... Merushe... nga hidhërimi i tepër... e humba vethenë; po të mos humbasim kohë!... **(duke rëfyer dritaren)** Eja të të xbres këtej ty!

**Me ngadalë shtyhet dera.**

MERUSHE – **me rëmbim të madh.**

Ah! po vinël!... Rexhep!... ikë til!... pshihu...çpejt!...

**Ryn Fetahu; Rexhepi xjer koburen; për një herë ryn Vahideja.**

## PËRFLIM VIII

Të parët, FETAH VAHIDE.

MERUSHE – **duke u hedhur në gjitë të së ëmës.**

Ah! Mëmëza ime!

REXHEP – **duke qasur Vahidesë.**

Mëmël dhe ti këtu?!...

**Fetahu i qaset Selfos e vështron**

VAHIDE – **ngadalë.**

Ti nga erdhe?... (**Rexhepi rëfen dritaren**) Ky njeri! (**duke rëfyer Fetahnë**) do të më marrë gjaknë burit, do të më shpëtonjë t'ime bijël!... më dha Besël!... Ku është gjaksori? Cili është!...

REXHEP - Ja; po fle.

FETAH - Ky është?...

**Unjet e puth nga sytë Selfon.**

MERUSHE – **duke pushtuar të ëmën.**

Perëndia s'ka lënë njeri në të keq!... Mëmëz, unë s'pritnje shpëtim as nga nonjë anë fare!...

**Vahideja për një herë I pushton Rexhepnë e Merushen dhe i puth pastaj pa vënë re Fetahnë zënë e kuvëndojnë me ngadalë.**

FETAH – **duke puthur djalën, me vethe.**

Djali!... biri i vetëm!... kur shkova e lash foshnjël! Tani qënka bërë burrël!... Ah! po e shoh dhe një herë me sy djalën! po, ah!... qysh e shoh?... më mirë të mos e paskishe parë... me dorë t'ime... A!... Jo... s'kuxonj dot... (**si mejtohet pakë**) Po fjala?... beja që bëra?... besa që lidha?... A! kuxim...kuxim... (**nxjer koburen me tmer e ngreh si e puth dhe një herë djalën, ja kthen drej në krahuer**) Ah! ç'bënj unë?... dritën e syrit! Djalën kërkoj ta vras! Jo!... po... Ah! (**e zë një të drithtur në trup, koburja për një herë xbrazet, Selfua goditet në krahëror, lot pakë dhe ep shpirtin; koburja i bije nga dora Fetahut. Fetahu i tmeruar dridhet dhe hiqet prapa me zë**) Ah! djalën!... t'im bir vrava!...

VAHIDE, REXHEP, MERUSHE – **duke nxituar drej tij, të tre për një gojë.**

Yt bir?...

FETAH – **i tremuar vete drej kufomës të birt.**

Ashtu!... djali!... djali im qe!... Unë jam Fetahu!... pas njëzet vjet, sot me të këthyer në shtëpi bëra, këtë të keqe... (**duke vështruar dorën e tij me**



tmer) Ah! u thafsh o dorë!... qysh kuxove e shtive në krahor të djalit!...

**I bije për sipër të birit dhe qan.**

VAHIDE – **duke vështruar me tmer në sy Fetahnë.**

Ah! ç'farë atë pa mëshirë?... Pse s'më the kur qënka yt bir?... Ç'bëre o faqe zi?... djalën tënt!...

FETAH – **duke ngritur më këmbë me kuxim të madh.**

Motra ime!... s'i ka për të mbetur njeriut kjo jetë!... vdekja është udhë e përgjithshme! Një ditë më parë, një ditë më pastaj s'ka nonjë ndryshim!... Si mjerë ata që vdesin me turp mi krye!... pa vdekja me nder, është gëzim i përgjithshëm!... Im bir e kërkoi vetë këtë!... t'ia kish bërë nonjë tjetër shkonte me turp... pa si t'ja bënj vetë...

VAHIDE – **me zemërim i pret fjalën.**

T'ja bësh ti!... I ati!... Ah! një që nxat dorë mi dritët të syrit, është m'i keq se një egërsirë!...

FETAH - Nga një që s'mban fjalën, nga një që prish benë, nga një që s'qëndron në besë, nga një që s'ruan nderë; kjo është një mijë herë më e lehtë. Kjo në është egërsirë, ajo tjetra është më e keqe!... Unë në vrava t'im bir, për të mbajtur besën e vrava! Solla në ven dhe nderin e shtëpisë!... unë punën t'ime bëra! (**duke rrëfyer kufomën e Selfos**) Ja!... gjaknë e burit ta mora!... gjaksorin e vrava!...

VAHIDE – **me hidhërim e pret fjalën.**

... Të mos e kishe bërë më mirë! se dhe sytë s'na shihnin një tmer kaqë të madh.

FETAH – **s'e pret fjalën.**

Vajzën ta shpëtoval!... (**me një dorë zë Merushen, me tjetrën zë Rexhepnë prej dore**) ja, bijë; ty të shpëtoval!... po t'ap ne i dashuri!... ja! djalë! të dashurën ta shpëtoval; dhe ty po t'ap ne i dashuri!... edhe unë po u ap zemrën, dashurinë t'uaj bashkë me vethet t'ime do ta shpije në varr!... bijtë e mij! pas kësajmë s'ua rëmben njeri dëshirat e zemërës!... ju të jini fatbardhë!... njeri tjatrën ta doni!... (**duke rrëfyer Vahidenë**) dhe mëmën ta doni!

VAHIDE – **e helmuar u rëfen Fetahnë.**

Dhe atën ta doni!... Ky është ata i juaj!... në këtë jetë dhe në atë është vëllaj im!

FETAH – **së pshehtazi nxjer koburen dhe e ngreh.**

Jo! unë edhe më s'e sosa punën! gjaknë e burit ta mora, vajzën ta shpëtoval dhe tani do të mar gjaknë e djalit! (**e kthen koburen drej krahorit dhe e xbras**) Unë gjaksor i t'im biri!

**Bie.**

VAHIDE – **duke nxjerë koburen.**

Edhe unë do të mar gjaknë e një trimi si ty!... Do ngre këtë trupnë e shkretë, q' u bë ngjajë e dy vrasjeve!... çë dua këtë jetë të zezël...

**E ngre koburen.**

REXHEP – “**duke zënë dorën e Vahidesë**”.

Mëmë!...

MERUSHE – **duke rënë nër këmbët të së ëmës.**

Mëmë e dashur! neve ku na le?

FETAH- **i plandosur me mundim të math ngrihet, ja rëmben nga dora koburen Vahidesë.**

Jol!... se ti u duhesh këtyre!

**Për një herë Sylçeja, Rapua, Xhakua, Evrenozi, me armë nër duar me rëmbim ryjnë brënda.**

SAMI FRASHËRI

## Shënim

Ky fragment është shkëputur nga drama “Besa” e autorit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Sami Frashëri. Është drama e parë nga autorët e Rilindjes, e shkruar në gjuhën turke, por me subjekt shqiptar.

Subjekti i dramës është ky: Rexhepi e dashuron Mirushen po ndesh në kundërshtimin e Demir Beut që do ta martojë vajzën me Selfon, të birin e Fetahut. Demir Beu vepron me kryeneçësi dhe përpiqet të imponohet. Selfua lakmitar dhe egoist i tërbuar bën çmos që t’ia arrijë qëllimit e të marrë Mirushen përkundër tyre, veç dashurisë së dy të rinjve, ngrihet dhe Ziberi e Vahidja. Drama përfundon tragjikisht kur Fetahu, për besën e dhënë, vret të birin, edhe pse 20 vjet nuk e kishte takuar.



### Fjalë dhe shprehje

*arçë* – gropë e vogël

*kobure* – revole



### Komentojmë dramën

Cila është tema që trajtohet në këtë fragment dhe te drama në përgjithësi?

Cilat janë personazhet pozitive e cilat negative?

Përshkruaji karakteristikat e Demir Beut dhe të Ziberit?

Si e vlerësoni veprimin e Fetahut?

Në cilin dialekt është shkruar drama?

## ***Drama***

Është një shfaqje që, me ndihmën e fjalës e të veprimit, përfytyron konflikte të ndryshme të interesave vetjake ose shoqërore të njerëzve, pa pasur karakter tragjik.

Krijimet dramatike kanë këtë strukturë:

**Akti** - është pjesa e krijimit dramatik, që luhet në skenë që nga çasti kur ngrihet perdja deri në mbylljen e saj.

**Pamja** - është pjesa më e vogël e aktit (praktikohet në rastet, kur akti është i gjatë dhe ka nevojë të ndërrohet scena).

**Skena** - sajohet atëherë kur në skenë paraqitet ose largohet një person (aktor), i cili shkakton ndryshim.

Këtu bëjnë pjesë **ndriçimi, muzika dhe kostumografia.**



## ***Detyrë***

Ndajeni fragmentin në role dhe luajeni në klasë.



## **SAMI FRASHËRI (1850 – 1904)**

Filozof, dijetar, gjuhëtar dhe gazetar i shquar. Lindi në fshatin Frashër të Përmetit. Së bashku me vëllanë Naimin, kreu mësimet në Janinë. Jetoj në Stamboll dhe u përfshi në luftën për çlirimin kombëtar. Duhet theksuar se biblioteka e Samiut kishte mbi 20.000 vëllime. Sami Frashëri ka shkruar vepra me rëndësi si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë turke. Vepra “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është, ç’do të bëhet”, është vepër që ua rrëfen rrugën shqiptarëve se si duhet të organizohen për të ecur përpara. Rëndësi të vaçantë ka edhe drama “Besa”, të cilën e ka shkruar në gjuhën turke, por tema është marrë nga e përditshmja shqiptare.



# NË MANASTIR TE MIGJENI

Shënim -

Ky fragment është marrë nga pjesa me të njëjtin titull në të cilën autori përshkruan ngjarje dhe vende ku kanë jetuar dhe punuar disa nga shkrimtarët më të mëdhenj shqiptarë. Në pjesën e mëposhtme flitet për Manastirin, vendi ku studioi Migjeni.

Kur kolegët së gjuhës e letërsisë shqipe të Universitetit të Shkupit më pyetën se cilin nga qytetet e Maqedonisë do të dëshiroja të vizitoja, unë pa mëdyshje u përgjigja: “Manastirin”. Kishte plot arsye që e vija në krye të dëshirave të mija këtë qytet, por në radhë të parë, se këtu kishte jetuar e mësuar Migjeni...

Zbresim në rrugë dhe dalim në krahun tjetër për të hyrë në një udhë të ngushtë që hapet ndërmjet ca ndërtesave të vjetra. Menjëherë bie në sy mure të moçme, porta të harkuara, kangjella të hekurta në trajta të ndryshme. Sa më tepër futemi në brendësi, aq më qartë vëmë re se koha në këtë mëhallë të qytetit nuk ka vënë dorë.

“Kjo ishte rruga jonë më e shkurtër që na çonte në seminar”, - thotë at Rada dhe merr të ecë para nesh, duke përshkruar me të shpejtë udhën deri në krye të saj e aty ndalet. “Shikoni dhe shkollën tonë, shkollën e Milloshit”. I shqipton këto fjalë me nostalgji, po edhe me një krenari të përmbajtur. Nxitojmë të gjithë të dalim te kthesa, prej nga duket shkolla, prapa ca drurëve të lartë.

Ishte pak a shumë siç e kisha përfytyruar, një pallat i vjetër, ngrehinë hije rëndë e solide që të kujtonte një kështjellë mesjetare po që pamjen e kohës së vet ia jepnin ndoshta vetëm zbukurimet e fasadave, trajtat e dritareve të mëdha, vijat e thella, që përshkonin faqet e mureve anësore. Kapërcemë pragun e portës dhe futemi në oborr. ndërtesa trikatëshe është e rrethuar nga oborri i madh, ku lëshojnë hije drurët të gjata me kurora të gjera. Diku për-

para vjen çezma, një çezmë e lartë, ndërtuar me pllaka guri të skalitur dhe me një lyfyt, nga rrjedh akoma ujë. Këtu vinin të gjithë seminaristët në kohën e pushimeve në mes orëve të mësimit. Ky ishte një nga vendet e preferuara të Milloshit, ku e shikoje shpesh, siç e përshkruajnë kujtimet e shokëve. Afrohemi dhe pimë ujë te lyfyti metalik, i nxjerë nga koha e gjashtë, ku ka shuar etjen sa e sa herë Milloshi. Tani gjurmët e jetës së tij mund t'i ndeshësh në çdo hap. Sytë i mbajmë gjithnjë nga at Rada, i cili lëviz sa andej-këtej. Ne i shkojmë pas. Ai na prin në një shteg dhe na nxjerr prapa ndërtesës së shkollës. Një kënd i shkretë, i mbuluar nga bari dhe ferrat, kun ë mes tyre zbardh një gur i madh. “E shihni këtë gurr? Ky ishte guri që vinte e ulej shpesh Milloshi. Mбай mend që këtu ai lexonte ose shkruante diçka në një fletore, me pamjen e tij përherë meditative” - thotë At Rada.

Ngjisim pastaj shkallët e përparme të shkollës dhe futemi brenda. Ca shkallë të mëdha, siç na duken të mëdha, në përmasa gati cikloprike të gjitha gjymtyrët e ndërtesës, muret e larta, korridoret e gjata, sallat, dyert dhe dritaret, tavanët e thellë. E me gjithë këto përmasa, drita brenda sikur është e mpakët. At Rada na tregon me radhë klasat, zyrat, këndet e shkollës që s'i gjendet fundi dhe ndalet para derës së një salle të madhe.

“Në këtë sallë ishte atëherë biblioteka e seminarit, më e madhja e të gjitha shkollave të Bitolit. Sigurisht, një bibliotekë në radhë të parë me letërsi kishtarë, që nga Bibla dhe konfesionet e Shën Agostinit e deri te revistat fetare të kohës. Sa për letërsinë artistike, filozofike e përgjithësisht kulturore ishte tepër e kufizuar dhe arsyet kuptohen lehtë. Kuptohet dhe se biblioteka e shkollës sonë për një njeri si Milloshi nuk ishte e mjaftueshme ose më mirë s'u përgjigjej kërkesave dhe interesave të tij, megjithëse mbante libra në gjuhë të ndryshme e në radhë të parë serbokroatisht. Në këtë gjuhë do të lexonte dhe ai, ndërsa me kohë do të lexonte në rusisht dhe në frëngjisht. Librat laikë që kërkonte Milloshi i gjente jashtë seminarit, në bibliotekën e gjimnazit, të akedemisë tregtare e sidomos në bibliotekën publike të Bitolit.

Asokohe s'kishte seminarist serioz që të mos e njihnte Dostojevskin, Turgenievin, Tolstoin, Gogolin, përgjithësisht letërsinë klasike ruse, po Milloshi me rrethin e tij të ngushtë lexonte dhe letërsinë e re, Gorkin e Majakovskin. Ai kishte për zemër dhe letërsinë moderne amerikane, si S. Levisin, Xh. Londonin, shkrimtarë si Travenin me shokë. Më kujtohen botimet e Nolit, shtëpia botuese më e njohur e asaj kohe për nga idetë e përparuara, librat e së cilës ia shikoja shpesh Milloshit në duar. Çdo gjë që ai do të lexonte, nuk do të mbetej pa lënë gjurmë në formimin e tij, që mori një drejtim të veçantë e të përshpejtuar në krahasim me të tjerët. Në qoftë se

nxënësit e shkëlqyer i zotëronin mësimet dhe librat që rekomandoheshin në seminar, Milloshi, pa lënë pas dore mësimet, ndiqte rrugën e studimit në mënyrë gati të pavarur. E bënte këtë jashtë mësimet e jashtë klase, me synime të caktuara e sistematike, sido që kjo kushtonte shëndet, kohë, energji. Vetëm kështu mund të kuptohet si e mori gjithë atë kulturë dhe si e fitoi atë horizont. Nuk e teproj po të them se Milloshi për ne shokët ishte pasuri kulturore, burim diturish, një bibliotekë gjithnjë e hapur. Ai diti të na drejtonte sa herë lypnim ndihmë ose krejt vetiu me shembullin e tij”.

*Nasho Jorgaqi*



### ***Komentojmë tekstin***

Në cilin qytet ka studiuar Migjeni?

Çtregon për natyrën e Migjenit dhe karakterin e tij kjo pjesë?

Nga mënyra se si është shkruar kjo pjesë i përket llojit të udhëpërshkrimit.



### ***Detyrë***

- Proveni dhe ju të bëni një shkrim në formën e udhëpërshkrimit.

- Bëni një përshkrim të vendit ku keni qenë.

## **UDHËPËRSHKRIMI**

Udhëpërshkrimi është një lloj i veçantë i të shkruarit, ku ndërthuret shkrimi publicistik (i gazetave dhe revistave) me shkrimin letrar. Përveçse autori sjell fakte dhe dokumente konkrete, ai bën edhe përshkrime tërheqëse, me anën e të cilave e njëh lexuesin me vende e zakone të ndryshme. Udhëpërshkrimet mund të qëndrojnë dhe si botime më vete, siç ndodh me librin “Udhëtime letrare” të Nasho Jorgaqit. Në tekstin e mësipërm, lexuesi e njëh Migjenin nëpërmjet veprës së tij, por ai bëhet më i afërt, pasi lexon për vendin ku ka jetuar shkrimtari.

# KUSH E SOLLI DORUNTINËN

Duke ecur me kujdes për të mos bërë zhurmë, Stresi iu afrua krevatit ku ishte shtrirë plaka. Koka e saj ishte mbështjellë me një kapuç të bardhë.

- Zonjë, - i foli me zë të ulët. - Zonja Mëmë, - (kështu e thërrisnin zakonisht qysh nga vdekja e fëmijëve). - Jam Stresi më njihni?

Ajo hapi sytë. Ata dukeshin të ftohtë nga tmerri e nga zija. Një copë herë ai e duroi vështrimin e saj, pastaj, duke e afruar kokën edhe më te nën kresa e bardhë, pëshpëriti:

- Si jeni Zonja Mëmë?

Shenja që bëri ajo me sy ishte e pakuptueshme.

Doruntina ka ardhur mbrëmë? - pyeti Stresi.

E shtrira bëri “po” me sy. Pastaj sytë e saj vazhduan ta vështronin drejt Stresin, sikur kërkonin diçka prej tij. Stresi qëndroi ca çaste në mëdyshje.

- Po si ndodhi? - Pyeti ai fare ultazi. - Kush e solli?

Plaka mbuloi sytë me njërën dorë dhe nga një lëvizje e kokës u kuptua se humbi ndjenjat. Stresi i kapi dorën dhe me vështirëzi i gjeti pulsën. Ai punonte.

Thirre njërën nga gratë, - i tha Stresi me zë fare të ulët ndihmësit. Tjetri doli dhe u kthye pas pak bashkë me një grua. Stresi e la dorën e plakës dhe me po ata hapa të kujdesshëm ju afrua krevatit ku ishte shtrirë Doruntina. Tani i dalloi flokët e saj të verdhë mbi nënkresë. Në zemër ndjeu një sëmbim, por ai rrinte disi mënjëanë, i pa përzier me ngjarjen që sapo kishte ndodhur. Ishte një sëmbim i vjetër, që kishte lidhje me dasmën e saj, tre vjet më parë, atëherë kur ai, Stresi, në çastin që ajo po largohej hipur mbi kalin e bardhë të nusërisë, midis karvanit të krushqve, kishte ndier një pikëllim të tillë në zemër, sa që gati kishte pyetur veten me zë: po ç’kam kështu? Ishin të gjithë disi të pikëlluar dhe jo vetëm nëna e vëllezërit, por krejt gjindja, sepse ajo ishte e para vajzë që martohej kaq larg, mirëpo pikëllimi i Stresit ishte i një natyre të veçantë. Dhe në ato çaste që ajo po ikte, ai befasi e kishte kuptuar se ajo ndjenjë e ëmbël, që e kishte pushtuar kohët e fundit për të s’kishte qenë veçse dashuri. Por ajo kishte qenë një dashuri tjetërlloj, e holluar si mjegulla mbi një hapësirë të pamatë, e padendësuar asnjëherë, e frenuar prej tij qetësisht. Ishte si vesa e mëngjesit, kishte rënë vetëm minutat para zgjimit dhe pastaj, në orët

e tjera të ditës dhe të natës që tërhequr gjithmonë. Dhe i vetmi çast, kur ajo mjegull kaltëroshe që përpjekur të dendësohej e të krijonte një re, ishte çasti i ikjes së saj. Por ai kishte qenë çast i shkurtër, që ishte haruar shpejt.

Në këmbë para shtratit të saj, Stresi vështrroi një copë herë fytyrën e Doruntinës. Ishte po aq e bukur si atëherë, në mos më tepër, me atë vijën e buzëve që ia bënte ato të rënda dhe të lehta njëkohësisht.

- Doruntinë, - i foli ai me zë të ulët, - ti ke mbërritur mbrëmë pas mesnate, apo jo?

Ajo bëri një “po” me sy. Stresi deshi ta shtynte edhe pak pyetjen që e mundonte, por ajo i doli vetvetiu:

- Po kush të solli?

Sytë e saj mbetën të palëvizshëm nën vështrimin e tij.

- Kush të solli, Doruntinë? - përsëriti ai.

Ajo nuk ia hiqte sytë, me atë boshësi të pashpresë në mes.

- Ti i the nënës se të solli yt vëlla Konstandini, apo jo?

Ajo bëri prapë “po” me sy. Stresi u përpoq të gjente shenjat e çmendërisë në sytë e saj, por ata, si edhe më parë, ishin të zbrazur nga gjithçka.

- Po ti ndërkaq besoj se e ke marrë vesh se yt vëlla ka tre vjet që s’është më, - tha Stresi me po atë zë të shuar. Lotët para se t’i shihte tek ajo, i ndjeu brenda vetes. Ishin ca lot tjetërlluj, gjysmë të dukshëm, gjysmë të prekshëm. Në atë lotëri fytyra e saj u bë edhe më e largët. Ç’më gjeti kështu, dukej sikur thoshin tani sytë e saj. Pse s’më besoni...

Stresi ktheu kokën ngadalë nga ndihmësi i tij dhe nga gruaja tjetër që po rrinte pranë shtratit të zonjës plakë dhe u bëri me shenjë të dilnin. Ai u përkul prapë mbi gruan e re dhe i lëmoi dorën.

- Po si erdhe, Doruntinë? Si e bëre gjithë këtë udhë të gjatë?

Sytë e saj, të zmadhuar jashtë mase, diçka përpiquej t’i mbushte.

*Ismail Kadare*

## **Shënim**


Në bazë të novelës, nga është shkëputur ky fragment, qëndron balada e Konstandinit dhe e Doruntinës, ku vëllai i vdekur ngrihet nga varri, pasi i ka dhënë besën motrës në ditën e dasmës, se do ta sjellë ai në shtëpinë e nënës. Stresi, një nga personazhet kryesore të novelës, është një nëpunës rendi në kohën e Perandorisë së Bizantit. Atij i duhet të hetojë ardhjen e çuditshme të Doruntinës në shtëpinë e nënës së saj. Titulli i novelës Kush e solli Doruntinën është dhe pyetja kyç rreth së cilës zhvillohen veprimet në novelë.





### ***Komentojmë tekstin***

Kur dhe ku zhvillohet ngjarja?  
Cilat janë personazhet kryesore?  
Si përfundon ngjarja?  
Cila është porosia e tekstit?



### ***Detyrë***

Lexoni në tërësi veprën e I. Kadaresë.

## **IDEJA E VEPRËS LETRARE**

Në çdo vepër letrare (tregim qoftë, dramë ose vjershë) autori ka kurdoherë diçka të vlefshme për të na mësuar. Ai pra, jo vetëm që na tregon një ngjarje ose na paraqet një përshkrim artistik, por na thotë edhe se ç'mendon, ç'ide ka ai për atë ngjarje e përshkrim, ç'mësim duhet të nxjerrim prej saj. Pikërisht këtë quajmë ide të një veprë letrare. Kështu p.sh. ideja e tregimit “Kurorat e Masar beut” është se luftën çlirimtare kundër pushtuesve nazifashist e bënë njerëzit e thjeshtë të qytetit e të fshatit. Ideja e “Këngës së Dhoqinës” është se shqiptari për të mbajtur fjalën e dhënë (besën) ngrihet edhe nga varri.

## **TE HANI I BISHTANAKËS**

Kosovari kishte një copë herë që po ngrinte e po ulte sytë, duke parë herë muzeqarin, herë briskun që shkiste mbi faqen e duhanit e mund t'ï rëndonte dorën. Deshi të lëvizte, t'ï vinte pranë e të lidhte kuvend me të. Por sa i zorshëm qenkësh me këta fusharakët, me këta njerëzit e bregut të detit. Shqiptarë ishin vërtetë dhe këta, të një balte e të një gjaku, po sa ndryshe visheshin, sa keq e vërtisnin gjuhën brenda në gojë, aq sa ai, bir Kosove, nuk ua merrte vesh mirë fjalët, sa të mbyllur e tinzakë që ishin. Kështu i ishin dukur myzeqarët ato dy ditë që kishte mbetur në han, duke vajtur lart e poshtë nëpër Fier, nga një zyrë në tjetrën, për të rregulluar punën e truallit ku do të ngrinte shtëpinë dhe çeshtjen e dynymëve që do t'ï jepeshin si tokë buke. Kjo mospërfillje e përbuzje që pati nisur t'ï mblidhej në zemër muhaxhirit, siç mblidhet ujë në gropë, i kishin rënduar atij vetulla e buzë dhe e kishte bërë që të shikonte shtrembër e me gjysmë syri myzeqarët, me të cilët do të rronte pas

këtaj në fqinjësi. Në këtë urrejtje të çuditshme e pa ndonjë shkak shtuar e shtruar gjatë rrugës që nga fusha e lartë e Kosovës e gjer në hapësirat e ulëta të Myzeqesë, ashtu siç shtohen e shtrohen ujërat e lumit gjatë rrugës së tij nuk ishin pa gisht edhe njerëzit dërguar në Kosovë për të zgjedhur familjet që do të emigronin në Shqipëri. Ata u premtonin tokë me lyrë dhe u përkëdhelnin ndjenjën për sundim atyre që kishin shkuar jetën gjithmonë në robëri.

Edhe Sylejman Tafili pati ardhur me këto mend. Mirëpo sot, përpara këtij fusharaku të zbuar nga toka e tij, që si kërmilli me shtëpinë ngritur në maje të qerres, kishte marrë rrugën e madhe e të panjohur me një dridhje po dhe me një fije shprese në zemër. Sylejman Tafili e ndjeu veten të pazot për të urryer e përbuzur këtë vendas, në fatin e të cilit ai shikonte fatin e vet. Si të gjithë njerëzit, përballë të njëjtit short të jetës, pëprara vuajtjeve dhe shpresave të njëjta bashkohen e duhen, ashtu edhe ky kosovar shtatmadh, me mustaqet e lëpira përpjetë-përpjetë, me qelipoçen e bardhë hedhur mbi sy, sikur të ishte ai zot i kësaj fushe të gjerë të mbetur pa zot, e ndjeu veten vëlla me vendasin e pikëlluar që po priste me takijen në duar, t'i shtoheshin atë ditë mjerime të reja.

Muhaxhiri s'e mbajti dot druajtjen e tij ndaj këtij myzeqari kur e shoqja, Zenepja, u ngirt dhe shkoi brenda bashkë me plakën. Ndjekur pas nga sytë kureshtarë të familjes së tij, ai i vajti pranë Pilo Shpiragut.

- Granija si granija, he burrë, e burrat...! - dhe i ra në sup myzeqarit.

- Apo e dredhim ka një duhan Kosove?

Megjithëse ishte harruar në brengën e vet e s'i bëhej për asgjë dhe Pilo Shpiragut i qe çarë hunda për një cigare duhan. Hallet që e kishin mbytur, ia ndezën edhe më fort këtë dëshirë, kur kosovari i vuri përpara kutinë erëmirë. Si la mënjanë takijen, mori kutinë e vendosi mbi njërin gju dhe nisi ta dridhte, pa pyetur shumë nga i vinte ky duhan nga një vendas apo nga një i huaj.

Kosovari që po priste në këmbë t'i thoshte gjëkafshë ky vendas aq i kursyer në fjalë, i zgjati një qese të endur me rruaza, në fushën e kuqe të së cilës nxinte një shqiponjë me dy kokë.

Piloja, pa thënë prapë asnjë gjysmë fjale, me atë ngadalsinë e parë, nxori që andej masatin, gurin, çau një fije eshkë, e ndreqi mbi gurin strall dhe i dha veglës me fuqi.

Eshka lëshoi një bisht të hollë tymi që i gudulisi hundët dhe si xixëllojë një grimë, u shua.

Kqyre, kqyre, - tha Sulejmani, - as eshka s'dëgjon me marrë aq shpejt, e ti, o myzekjar, kërkon m'u ba babë menjëherë. - Piloja që i kishte dhënë zjarr eshkës, ndezi cigaren dhe s'foli.

Gratë plaka dhe nusja kosovare dukeshin sikur edhe ato po merrnin e po jepnin të dridhnin ndonjë cigare duhan atje brenda në dhomë. Duke vajtur pas mendjes së Sotës, kishin marrë e ndehur një qilim, kishin shtruar mbi të shtatzënë që s'po lirohej dot, kishin zënë secila nga një vetull të qilimit duke e ulur e duke e ngritur shtrojën, po e rrëkëllenin ijë më ijë nusen e gjorë, ashtu siç shkarrëzohet pulishti në pluhur kur i kruhet.

I sertë qenka i flamosuri! - nisi të kollitej e të shikonte cigaren Pilo Shpiragu.

- Helbete, duhan Kosove asht... - vuri buzën në gaz me njëfarë domethënie Sulejman Tafili.

Piloja ngriti sytë prapë, sikur donte të gjente kuptimin e kësaj shprehjeje.

- Si duket edhe ju kosovarët, nuk bini poshtë duhanit, për nga sertëllëku që nuk iu lanë të rrini në vend tuaj, po ju dhanë udhën...

Sulejman Tafili rrudhi ballin. Një hije armiqësore ia mvrenjti vetullat. Po zemërimi i tij, sikur të ishte nisur për tjetër vend, ashtu siç bën reja që mbledh sy këtu e zbrazet diku gjetkë, nuk plasi aty nën qiellin e ulët të atij hani.

- Pra, bre burrë, se jena tuj prit gzim nën ket pullaz!... - dhe kosovari ktheu kokën dhe pa nga oda ku të dyja gratë po merreshin me shtatzënë. Pastaj, duke tundur kokën ashtu siç bënë sa herë kërkonte te shuante inatin në veten e tij, iu kthye Pilo Shpiragut:

- Ndigjo, o myzekjar, edhe ket fjalë prej meje. Na, kosovarët, jena shqyptarë një gjaku e kur zbresim nga mali vimë me u zanë tokat kndej, na kqyrni si me ju pas grabitë dhenat tueja, po sikur me ardh i hueji e me ju zanë bash truëllin tuej, ashtu siç na i ka zanë në Kosovë, ç'kishit me ba?

- I ke kot këto fjalë, or byrazer... - iu përgjigj urtë Piloja sikur të mos i kishte rënë fare në sy zemërimi i kosovarit. - Ne këtejza nuk kemi hise në gjënë e perëndisë as tokë që kemi, as truall që kemi, as kasolle që kemi, vetëm shpirtin na kanë lënë, por le të na e marrin edhe atë, se na ka ardhur në majë të hundës...

Mospërfillja, me të cilën i tha këto fjalë vendasi, e preku thellë muhaxhirin. Në këmbë gjer në atë kohë, Sulejman Tafili u ul mbi thesin ku kishte ndenjur edhe Pilo Shpiragu.

- Aij! Punojnë me shqyptarin çka s'punohet as me hasmin...hej...hej...! Ne na zbën krajl, ju begu...

- A më sheh, mua ti?... - tundi kokën dhe e pa drejt në sy Pilo Shpiragu, sikur deshi me të vërtetë ta pyeste kosovarin. S'më lanë xhandarët e gehallarët të takohesha as me vëllazëri e krushqi, as me shokë e miqësi, po, me natë kur fshati ishte në gjumë, më nxorën në mes të katër udhëve

dhe më dhanë duart...

Pilo Shpiragu, sikur t'ia kërkonte shpirtin të shprazej pak nga gjithë ai maraz që i ishte mbledhur atë ditë në zemër, pa le të qe ky i huaj as vendas, u mat t'ia tregonte kosovarit të ngjarat e tij.

Jakov Xoxa

## Shënim

Fragmenti është shkëputut nga romani “Lumi i vdekur” i shkrimtarit të letërsisë bashkëkohore shqiptare Jakov Xoxa, ku pasqyrohet fati i një familjeje fshatare por, duke e përshkruar edhe fatin e disa fshatarëve të tjerë, e posaçërisht të një familjeje refugjatësh kosovarë. Romani është i ndarë në tri pjesë (libra). Në pjesën e parë paraqet familjen e Sylejman Tafilit, udhëtar që nuk di nga t'ia mbajë; në pjesën e dytë familja vendoset në tokë të huaj, të shfrytëzuar dhe të përçmuar nga bejlerët. Ndërkaq, në fund të pjesës së tretë, ajo rishtaz mësyn rrugën për t'u kthyer në vendlindje.

Sipas llojit ky roman është shoqëror (social).



### Fjalë dhe shprehje

*muzeqar* - banor i Muzeqesë

*dynym* - pjesë toke me sipërfaqe 1000 metra katrorë

*mubaxhir* - njeri që largohet nga vendbanimi e vendoset në një vend tjetër

*takije* - lloj kësule me majë të ngushtë prej pëlhere të bardhë

*rruzë* - kokërr e vogël e rrumbullakët prej qelqi

*masat* - lloj mjeti primitiv për të bërë zjarr me eshkën

*shkarëzobet* - rrëshqet dheu

*pulisht* - kërriq (i vogli i gomarit)



### Komentojmë tekstin

Cila është tema kryesore e fragmentit?

Cila është ideja kryesore apo porosia e shkrimtarit?

Ç'i bashkoi këto dy familje?

Përshkruani shqetësimin e familjes kosovare.



### Detyrë

Gjeni shprehjet frazeologjike dhe zëvendësoni ato me një fjalë tjetër

**Romani shoqëror** - është vepër e gjatë letrare e gjinisë epike, e shkruar në prozë që pasqyron një rreth të gjerë ngjarjesh e dukurish nga jeta shoqërore. Llojet kryesore të romanit janë: aventurier, historik, shoqëror, psikologjik, humoristik, satirik, fantastik etj. Ndër romanet e para në letërsinë tonë janë: “Shkodra e rrethuar” nga N. Nikaj(1913), “Lulja e kujtimit” nga F. Postoli, “Çlirimtarët” nga Dh. Shuteriqi, “Ata nuk ishin vetëm” nga S. Spasse, “Kënetat” nga F. Gjata etj.



### JAKOV XOKA (1923- 1979)

Jakov Xoxa në letërsinë shqipe është i njohur si romancier, novelist dhe tregimtar. Lindi në Fier ku mbaroi shkollën fillore, ndërsa të mesmen e kreu në Korçë. Pasi përfundoi studimet e larta për letërsi, një kohë punoi si gazetar dhe më vonë si profesor i letërsisë në shkollën e lartë. Nga viti 1965, Jakov Xoxa filloi të merret kryesisht me krijimtari letrare. Në fillim shkroi skica, reportazhe dhe regjime, të cilat janë pëmbledhur në “Novela” 1 dhe 2. Në letërsinë shqipe u bë i njohur me romanet: “Lumi i vdekur”, “Juga e bardhë” dhe “Lulja e kripës”. Është marrë edhe me stilistikë dhe teori të letërsisë.

## ANËS LUMENJVE

Arratisur syrgjynosur,  
rraskapitur dhe katosur,  
po vajtoj pa fund, pa shpresë  
anës Elbës, anes Spresë.  
Ku e lam ‘e ku na mbeti,  
vaj-vatani e mjer-mileti,  
anës detit i palarë,  
anës dritës i paparë,  
pranë sofrës i pangrënë,  
pranë dies i panxënë,  
lakuriq dhe i dregosur,  
trup e shpirt i sakatosur.  
Seç e shembën derbederët

mercenarët dhe bejlerët  
seç e shtypën jabanxhinjtë  
seç e shtrydhën fajdexhinjtë,  
seç e pren e seç e vranë,  
ç'e shkretuan anëmbanë  
nën thundrën e përdhunës  
anës Vjosës, anës Bunës.  
Çirrem, digjem i vrerosur,  
sakatosur, çarmatosur,  
as i gjall', as i varrosur,  
pres një shenj' e pres një dritë,  
pres me vjet e pres me ditë,  
seç u tera, seç u mpaka  
seç u çorra, seç u mplaka,  
larg prej vatrës dhe prej punës,  
anës Rinit, anës Tunës:  
Çakërdisur, batërdisur,  
përpëlitur dhe zalisur,  
ëndërroj pa fund, pa shpresë,  
anës Elbës, anës Spresë.  
Dhe një zë vëngon, nga lumi,  
më buçet, më zgjon nga gjumi:  
se mileti po gatitet,  
se tirani lebetitet,  
se pëlçet, kërcet furtuna,  
fryhet Vjosa, derdhet Buna,  
skuqet Semani dhe Drini,  
dridhet beu dhe zengjini,  
se pas vdekjes ndriti jeta  
dhe kudo gjëmon trumbeta:  
Ngrehuni dhe bjeruni,  
korrini dhe shtypini,  
katundar' e punëtore,  
që nga Shkodra gjer në Vlorë!  
Ky ilaç e ky kushtrim  
më bën djal' e më bën trim,

më jep forcë e më jep shpresë,  
anës Elbes, anës Spressë.  
Se pas dimrit vjen një verë,  
që do kthehem një herë  
pranë vatrës, pranë punës,  
anës Vjosës, anës Bunës.  
Arratisur, syrgjynosyr,  
rraskapitur e katosur,  
brohoras me bes e shpresë,  
anës Elbës, anës Spressë.

Fan S. Noli

### **Anafora dhe epifora**

Kur në fillim të çdo vargu fillohet me fjalë të njejtë kemi **anaforën**.

E kundërta e anaforës është epifora.

Në çdo varg, kur në fund përsëritet fjalë e njejtë kemi **epiforën**.

P.sh.:

**Anës** detit i palarë

**Anës** dritës i paparë,

Pranë sofrë i pangrënë...

P.sh.:

Po thot dielli: a **ndarja eme!**

Ka thënë hëna: a **ndarja eme!**



### **Fjalë dhe shprehje**

*i katosur* - i dërmuar, i rënë shpirtërisht, i zvogluar

*u mplaka* - u dobësua

*ushton* - buçet

*afër Tunës* - afër Danubit



### **Komentojmë poezinë**

Cila është ideja kryesore e poezisë?

Në çfarë gjendjeje përshkruhet Shqipëria në atë kohë?

Në strofën e parë, Noli shpreh pesimizëm për gjendjen e atdheut në atë kohë. Pse e bën këtë?

Në cilën strofë vërehet besimi për një të ardhme më të lumtur?



### **Detyrë**

Lexoni me vëmendje strofën e parë dhe të fundit dhe tregoni se ç'vini re.

Gjeni anaforën në vjershë.

## ODA E BURRAVE

Prishja e katit të dytë nuk shkoi aq shpejt sa shpresonte nipi i Demës. Punëtorët e prishnin me kujdes oxhakun e odës së burrave dhe nipi i Demës e kuptoi se nuk do t'i shërbenin gjë tullat e oxhakut që thyheshin copë-copë posa i shkulje nga muri. Assesi nuk mund t'i shpëtonte as zbukurimet në harkun e tij, ku mes dy trëndafilave, qëndronte një yll gjashtëcepash. Dy shqiponja dykrerërshe zbukuronin pjesët anësore të oxhakut dhe ngjanin si shpendë krahëhapur që i frynin zjarrit të mos shuhej. Ai relief kishte mbetur i shënuar në fotografitë dhe nipi i Demës shpresonte se mjeshtrit e njohur të Stambollit, që kishin stolisur aq mure të brendshme të xhamive të atjeshme, nuk do ta kishin të vështirë të kopjonin atë që do të shihnin në fotografitë e shumta të mureve të odës së burrave. Më në fund, damarët e brendshëm të kullës ishin aq të shumtë, sa ishte e pamundur të mos i dëmtoje dhe t'i shkulje të pa lënduar nga ajo tërësi e brendshme e barkut të kullës. Ai sa kaq e kup-





toi se kulla s'ishte ajo që shihej nga jashtë, se mbi të gjitha, kulla ishte sajese e përbërë nga shumë pjesë të brendshme, se ajo ishte ndërthurje shkallësh, vendkalimesh, odash të ndara ashtu që familjarët ta dinin nga mund të lëviznin ata, e nga miqtë, duke mos e ngatërruar mbretërinë e njëri-tjetrit, duke qenë i pashënuar, por i dukshëm kufiri deri ku u takonte failjarëve e deri ku miqve të kullës, deri ku fëmijëve e grave e deri ku burrave të familjes. Pastaj, nuk mund ta gaboje rrugën duke ecur nëpër divanhanen dhe odat e kullës e të kaloje nga njëra pjesë në tjetrën, të shkoje aty ku nuk e kishte vendin, sepse te oda e burrave mund të arrihe vetëm nëpërmjet shkallëve të miqve, nga ana e pasme e kullës. Ato të çonin drejt te dera hyrëse e katit të parë, nga vazhdonte ngjitja nëpër shkallët e drunjta drejt divanhanes së katit të dytë, ku nuk mund ta gaboje derën e zburuar të odës së burrave. Shkallët për familjarët, gjithashtu të drunjta dhe me rrethojë anësh, që lidhnin divanhanen e katit të parë me çardakun e katit të dytë, ndodheshin nga ana e kundërt e shkallëve për miqtë, ndaj ata që shkonin lart e poshtë nuk mund të shiheshin me njëri-tjetrin. Nëpër ato shkallë ngjiteshin vitoret e shtëpisë, kur u çonin ushqim burrave, apo kur papritur duhej të afroheshin te dera e odës së burrave, të trokitnin lehtë në të, sa ti jepnin shenjë kryeplakut se kishte ndodhur diçka dhe ai duhej të dilte jashtë, të dëgjonte atë që do t'ia pëshpëriste në vesh ndonjëra nga gratë, që të mos dëgjonin ata që ishin brenda në odë. Pastaj kryeplaku do kthehet në dhomë dhe nëse ishte lajm që duhej ta dinin të tjerët, do të përfitonte nga heshtja e tyre, që rregullisht zgjaste aq sa atij i duhej të ulej në vendin e më parshëm, pranë oxhakut dhe do e ndante lajmin me ata që pritnin të kthehej, me burrat e tjerë të ulur këmbëkryq në dhomë, që gjithashtu kishin dëgjuar trokitjen e lehtë në derë dhe e dinin se ajo kishte vetëm një domethënie: “O i zoti i shtëpisë, kemi për ty një lajm që nuk e pret! “Nëse kryeplaku të familjes do t'i përcillej diçka që nuk duhej të nxirrej jashta kullës, kryeshtëpiari do të ulej në vendin e vet dhe duke gëlltitur në vete helmin e lajmit të zi, apo nektarin e atij gazmor, do shtirej se nuk kishte ndodhur gjë prej gjëje, do bëhej sikur nuk kishte dalë fare jashtë dhe se nuk kishte biseduar me askënd, pra edhe sikur ndonjë nga familjarët të kishte dhënë shpirt, ai do ta nxiste vazhdimin e bisedës me pyetjen: “Hë burra, ku e lamë bisedën?” Jo njëherë kishte ndodhur që i zoti i shtëpisë të vazhdonte bisedën me miqtë dhe pasi kishte marrë lajmin për ndonjë ndodhi të rëndë në familje...

*Kim Mehmeti*



### ***Fjalë dhe shprehje***

*divanhane* - korridor i gjerë në katin e dytë nga ku dilet në çdo dhomë  
*vitore* - grua e shkathët, punëtore që lind shumë fëmijë

## *Shënim*

Ky fragment është shkëputur nga romani “Kulla dykatëshe” e Kim Mehmetit, që është një nga veprat më të mira të tij. Kulla është objekt apo strumbullor rreth së cilës shtjellohen të gjitha ngjarjet e kohës.

Për romanin “Kulla dykatëshe”, kritiku i njohur akademik Ali Aliu thotë se është më i miri deri më sot i Kim Mehmetit. Ky roman vjen si kurorë e ciklit romanor mbi fshatin e tij metaforik tek i cili, në vazhdim, është kthyer rish-tazi për të marrë atë që i ka mbetur, për të shpalosur shtresimet, pjesët ende të fjetura të së vetëdijshmes. Kulla, si kryepersonazh i fshatit emblemantik, simbol i qenies fizike dhe shpirtërore, si traditë mitike dhe historike, vjen shtyllë qendrore e sfidës, vjen si Kanun, si nyje ku lidhet fati individual me atë kolektiv, si nyje ku ndërlihet e kaluara me të sotmen dhe me ëndrrat për të ardhmen...

**Kim Mehmeti** ka lindur në vitin 1955 në f. Gërçec të Shkupit, ku edhe jeton. Është shkrimtar bilingual, i cili shkruan edhe në gjuhën maqedonase. Ka botuar më shumë se dhjetë libra, nga të cilët: “Pluhuri që mbin”, “Dënesje”, “Bolero”, “Fati”, “Fati i Fatushes”, “Ritet e Nishanes” etj. Të gjithë veprat e tij janë botuar edhe në shumë gjuhë të botës.

## KONICA DHE QËLLIMI I JETËS SË TIJ

Konicën për herë të parë e kam pjekur më 1906. Atë ditë s’kam për ta harruar kurrë. Më shkroi nga Londra se do të mbërrinte në Boston i veshur me kostum shqiptar, me qëllim që fotografia t’i botohej nëpër gazeta dhe kështu të shfrytëzonte rastin për t’i trumbetuar botës çështjen kombëtare shqiptare, që ishte edhe qëllimi i jetës së tij. Shqeva sytë nga habia. Aso kohe, si prift i modës së shkuar që isha, mbaja një mjekër të gjatë e të zezë, që, të them të drejtën, fëmijët e Bostonit ma shihnin me çudi. E merrja me mend sesa do të habiteshin kur të më shihnin krah për krah me një burrë të veshur me fustanellë shqiptare. Ndonëse der më atëherë s’kisha parë fustanellë shqiptare, e merrja me mend se duhej të ngjasonte me fustanellën greke, që nuk ndryshon

shumë nga një fustan balerine. Unë vija i shkurtër dhe i ngjeshur. Konica ish i gjatë e i hollë. Të dy bashkë do të ngjanim si Don Kishoti me Sanço Pançën që sapo kishin dalë nga një cirk. Habia ime ishte vërtet e madhe kur pashë se fëmijët e Bostonit e harruan fare mjekrën time dhe mbetën të admiruar pas Konicës. Atëherë e kuptova se fustanella shqiptare nuk ngjasonte aspak me simotrën e saj qesharake greke. Ajo i afrohej më tepër fundit skocez dhe i shkante shumë për shtat një burri të pashëm si Konica.

Rasti e sjell që në këtë libër të Konicës këndonjësi të njihet edhe me ndryshimin midis kostumit grek dhe atij shqiptar. Grekët vërtet që e kanë huajtur nga shqiptarët, po, duke u rrekur për ta stolitur edhe më, e kanë bërë si tepër grarishte.

Por Konica nuk më habit vetëm me veshjen e tij. S'po u besoja veshëve kur nisi të më "ligjeron" për çfarëdo teme që të shkon ndër mend. Ishte njeri me kulturë të madhe. Gijom Apoliner (Guillaume Apollinaire), një shkrimtar francez, që ishte mik i tij e quante "enciklopedia që ecën", dhe që "e fliste frëngjishten si francez i lindur". Një tjetër shkrimtar francez, Zhyl le Metre (Jules le Maitre), ka shkruar për te: "Cet entranger qui ecrit si bien notre langue" (Ky i huaj ka shkruar kaq bukur gjuhën tonë).

Si studiues i pasionuar pas muzikës, Konica adhuronte Vagnerin. Vagneri dhe veprat e tij ishin një nga gjërat e para për të cilat më foli. Ai më këshilloi të shihja dhe Parsifalin, kur u dha për herë të parë në Boston, më 1910. Tridhjetë vjet më pas, kur vdiq, duke ditur sesa shumë e donte Vagnerin, iu luta organistit që, gjatë gjithë ceremonisë së varrimit, të luante pjesë të tij.

Tani të themi dy fjalë për vendin që zë Konica në historinë e Shqipërisë së sotme. Si mysliman që ishte dhe si bir i një familjeje aristokrate nga Shqipëria e Jugut, Konica i kishte të gjitha mundësitë të zinte një pozitë të lartë në Perandorinë Turke, ku bënte pjesë dhe Shqipëria që nga vdekja e Skënderbeut. E vërteta është se gjatë shekujve shumë shqiptarë kishin marrë ofiqe të larta në Perandorinë Turke. Për shembull në të ri të Konicës, veziri i madh apo kryeministri i Perandorisë Turke, Ferid Pasha, Ishte shqiptar nga Vlora.

Por Konicës nuk i pëlqente kjo karrierë. Misioni që i caktoi vetes ishte lufta për pavarësinë e Shqipërisë. Që nga viti 1897 gjer më 1912 Konica dhe Shahin Kolonja, botuesit e dy revistave shqipe jashtë atdheut, "Albania" dhe "Drita", ishin dy nga pionierët e luftës për pavarësinë e Shqipërisë. Në sundimin turk shqiptarët e kishin fshirë nga kujtesa lavdinë e shkuar nën Skënderbenë. Konica ishte ai që rizbuloi dhe trumbetoi Skënderbenë dhe flamurin e tij, shqiponjën e zezë me dy krerë mbi fushën e kuqe. Ky flamur u bë simbol i pavarësisë kombëtare dhe u ngrit më 1912 në Vlorë nga Ismail Qemali, ku

Shqipëria u shpall shtet i pavarur.

Konica është një nga krijuesit e prozës shqipe. Kur pata vendosur të radhi-tesha dhe unë në kryqëzatën që luftonte për pavarësinë e Shqipërisë, gjëja e parë që më ra në sy, ishte mungesa e plotë e veprave letrare shqipe me ndonjë vlerë artistike. Por kur shkova në Egjipt më 1902, Spiro Dine, një patriot shqiptar, më dha koleksionin e revistës “Albania” të Konicës prej vitit 1897 deri më 1903. I lexova faqe më faqe dhe që në atë çast në shkrimet e Konicës gjeta atë që kërkonim; letërsi të mirë shqipe. Konica, gjithashtu, zbuloi dhe popullarizoi njerëz të tjerë shqiptarë të letrave, si Kristoforidhin, Mitkon, Fishtën, dhe Çajupin. Me këshillën dhe nën drejtimin e tij, unë kam përkthyer disa vepra të Shekspirit, Ibsenit, Edgar Allën Poes dhe “Don Kishotin” e Servantesit. Gjithë shkrimtarët shqiptarë që erdhën pas Konicës janë nxënësit e tij, përfshirë këtu edhe shkruerit e këtyre radhëve.

Fan Noli

### **Biografia dhe autobiografia**

Biografia dhe autobiografia janë histori të jetës së njerëzve, pra janë ngjarje të vërteta. Në një **autobiografi** autori shkruan historinë e jetës së vet. Në një **biografi**, autori shkruan historinë e jetës së dikujt.

Paragrafët e mëposhtëm flasin për aktorin e madh me famë botërore **Aleksandër Moisiu**. Ai është një nga figurat e shquara të popullit tonë.

*Aleksandër Moisiu ka dalë nga vatra e familjes së Moisivë të Kavajës. Lindi në Trieste me 2 prill 1879. Kur ishte 4 vjeç, familja e tij u rikthye në Shqipëri. Në Durrës shtëpia e Moisiut ishte jo shumë larg detit, pranë mureve të kështjellës shekullore. Kur u bë gjashtë vjeç, u regjistrua në shkollën fillore...*

*Moisiu kishte një fytyrë me një plasticitet të mahnitshëm... Ai dinte t'i jepte fytyrës së vet shprehjen e një fëmije që çuditej, lakminë e njeriut me kënaqësi të pangopur, shprehjen e saktë dhe të caktuar të një delikatese të mbël, si edhe të një talljeje therëse.*

## KORBI



Një mes – nate të bezdisur  
Tek këndonja i zalisur  
Disa prralla dhe magjira  
Të një shkence të harruar,  
Tek dremitnja i kapitur  
Befas vjen një e trokitur,  
Me ngadale e goditur  
Përmi derë t'odës sime.  
“Dikush është, thashë, jashtë  
Që troket mi derën time-  
Vetëm kjo, dhe asgjë më.

Ah, e mbanj nër mënt fort mirë,  
Ishte dimr' i ftoht' i ngrirë,  
Dhe n'oxhakun shkrump të nxirë  
Urët shuheshin në hi.  
Desha të gëdhihej dita,  
Se më kot nga librat prita  
Të më ngushëllonte drita  
Për të lumurën Lenorë,  
Vajz' e rrallë dhe rezore,  
Q'i thon' Engjëjtë Lenorë,  
Përmi dhe pa emër më.  
Era frynte që përjashta,  
Rrihte perdet e mëndafshhta  
Dhe më ngjethte dhe më derthte  
Tmerre që s' i ndjeva kurrë.  
Dhe tani që të pushonte  
Zemr' e mjerë që lëftonte,  
Goja po më bëlbëconte:  
“ Dikush do të hynjë brënda;  
Nonjë vizitor i vonët  
Që kërkon të hynjë brënda.

Kjo do jet' e asgjë më".  
Mblodha veten menjëherë  
Edhe frikë më pa ndjerë:  
"Zot, i them, a Zonjë, fajin  
Ndjemani, ju lutem shumë,  
Se për Zotin po dremitnja,  
Aq ' e hollë ish trokitja  
Aq ' e lehtë ish goditja  
Përmi derë t'odës sime  
Sa mezi ma zuri veshi."  
Dhe e hapa derën sheshit,  
Errësirë ' e asgjë më.

\* \* \*

"Mbyll-e gojën, dreq a shpëndë!  
Ngrihem dhe thërres më këmbë,  
Çporru prap mun në djall,  
Në skëterrë dhe në zall!  
Pëndë mos me shkunt të zezë  
Të më rrej ' e të më ndezë;  
Mos ler shenjë të gënjeshtëtrës  
Që më the, po shko prej derës!  
Nxirr-m'a qipin tënt prej zëmrës  
Thyej qafën jashtë derës!"  
Thotë Korbi: "Kurrë më".

Edhe Korb'i zi i humbur  
Qëndron edhe i patundur  
Mi të zbetin bust Pallade  
Mun mi derë t'odës sime.  
Edhe sytë i shkëndritnin  
Si prej djajsh që ëndërritin  
Edhe llamba që ndrit sipër  
Ja heth hien përmi dhe;  
Shpirti im nga ajo hie  
Që valon atje mi dhe  
Do mos ngrihet – kurrë më.

*Edgar Allan Poe*

## ***Shënim***

Poezia “Korbi” është shkruar nga shkrimtari Edgar Allan Poe. Këtë poezi si dhe shumë poezi të tjera të letërsisë botërore i ka shqipëruar me sukses poeti, demokrati ynë F. S. Noli.

Korbi simbolizon vdekjen, zinë.

Në vjershë përshkruhet një natë e tmerrshme, ku gruaja e poetit, Lenora, lëngon e sëmure për vdekje, e poeti rri zgjuar dhe e ruan duke lexuar libra të ndryshme...



## ***Detyrë***

Zgjidhni dhe mësojeni një pjesë të kësaj vjershe përmendsh.

# **TË FALEM O MËSUES!**

Ky fragment është shkëputur nga shkrimi me të njëjtin titull i shkrimtarit nga Kosova Ramiz Kelmendi, i cili ia kushton mësuesit të tij dhe njëkohësisht poetit të njohur kosovar, Esad Mekuli. Ky shkrim është botuar te një gazetë e kohës “Jeta e re”.

Esadi, vetë, nuk shkroi shumë. Po penën ua mprehu bukur shumë dhe jo një herë të tjerëve. Seç mu kujtua mu në këtë çast ai rrëfimi i Erih Kostnerit për njeriun i cili u hodh në ujë për të shpëtuar fëmijën që po fundosej dhe harroi se vetë s’dinte të notonte, prandaj - u mbyt...

Esadi, me vetëdije të plotë e ndërgjegje prej misionari, mbyti krijimtarinë e vet origjinale në të mirë të krijuesve të rinj.

Ja, që, shkrimtari s'është shkrimtar vetëm me veprën. Jo rrallë ai e dëshmon veten dhe me jetën. Se mos historia e letërsisë njih pak raste, kur biografite e begata e të lavdishme të ca shkrimtarëve janë në përpjestim të zhdrejtë me cilësinë, e sidomos me sasinë e veprave të tyre? Apo, ç'është më e keqja, kur veprat janë vepra të mëdha. Me cilësi të larta, e jeta, bëmat e autorëve të tyre, janë për turp, për hiç gjë, të ulëta?

Jeta e Esadit, ndërkaq është vepra e tij. Siç, pa u hamundur fare mund të thuhet: vepra e Esadit është vepra e tij.

Ndryshe nga rastet e sipërme, kur është fjala për Esadin, atëherë mes jetës e veprës së tij mund të vemë, lirisht, shenjën e barazimit.

Ato njëjtësohen, bashkëveprojnë dhe vetëshpjegohen.

Esadi jeton për veprën, me veprën. Qetësisht. Prajshëm. Me përkushtim. Me vetëmohim.

Esadi jeton me veprën e tjetrit. Esadi flijohet për veprën e tjetrit.

Dhe - kjo s'është slogan.

E di kush sa letra u shkroi Esadi bashkëpunëtorëve të "Jetës së re" për një çerek shekulli?

Letra inkurajuese, fjalëmbra, miqësore, kolegjiale, letra prej redaktorësh letrarë, që s'i gjejmë më - siç i thonë një fjale - as në film, pale në jetë.

Nga epistorali i Esad Mekulit - ja një detyrë e ngutshme për dashamirët e jetës dhe të veprës së tij.

Unë s'e pata atë fat të kem një letër të tij private për kaq vjet.

Sepse - jetova me të.

Unë pata një tjetër fat: komunikimin shumë të sheshtë, të drejtpërdrejt me të. këtu në Prishtinë. Në redaksi (a më mirë në redaksinë!).

Me fjalën e drejtpërdrejt atësore, në fillim. Kolegjiale, më vonë. Miqësore, dashamirëse - gjithmonë.

S'kam se si të mos i përmend dy-tri sosh, që s'i kam harruar kurrë. Dy-tri kontakte nga ajo mori.

Si u njohëm?

Isha një anonim i madh në mbarim të viteve '40. Një nxënës tetëmbëdhjetëvjeçar, që u shqua, thanë ndër të tjerë vetëm me një gjë: hartimet.

Edhe kisha një lakmi të madhe ato ditë: të provoja të shkruaja diçka për publik. Vjersha, do të thoni, tregime? Gjepura. As më shkonte mendja, pale ç'mundësi kisha, edhe po të doja. Se mos kisha nga të mësoja, se mos botohej ndonjë fletushkë, a revistë letrare? Punë përrallash. Lakmoja t'i shkruaja "Zërit të rinisë" të paktën një lajm për aktivitetin jashtëshkollor të organizatës së rinisë të shkollës sime. Vë bast se s'është gëzuar kush më shumë se unë,



kur i pashë tre-katër rreshta, që s'i njoha fare t'ishin të miat, por që mbanin emrin dhe mbiemrin tim t'ishin botuar në fund të një faqeje në "Zërin". Mandej edhe një tjetër, edhe një. Kur u avancova në faqet e "Rilindjes", po ashtu me të tilla shkrime, kryesisht me lajme të shkurtra, fillestare, gazetareske, pa ditur t'u gjej as atyre pesë pyetjeve elementare - u bëra i pari ndër shokë!

Zura të shkruaja tregime.

Kur qëllonte të më botohej ndonjë në "Rilindje" e në "Zërin" - s'gjeje njeri më të lumtur se unë. E po të ndodhte, në të rrallë, të ma botonte ndonjë z. Esad në "Jetën e re", po a mund të matej kush më me mua?! As e merr kush sot me mend krenarinë që ndjenjim, mburrjen, rrahagjoksin, po të na botohej gjë në "Jetën e re". Ishte kjo surprizë nga më të rrallat, ndaj edhe më të lakmuarat.

Jetonim për ata dy muaj, gjersa dilte nga shtypi revista jonë, të shihnim "kontributin letrar" tonin. Mirëpo, rrallë ndodhte e të mos na ndalonte në rrugë z. Esad e për të na thënë mendimin e vet për vjershat e tregimet tona, më të shumtën duke na udhëzuar si e sit a shkruanim më mirë, veçse pa harruar kurrë që të na inkurajonte, gjithsesi, të uleshim e të shkruanim prapë. Edhe para kësaj, ndërkaq, këshillën e vet më të shpeshtë e kish: "Mirëpo, mirëpo... mbi të gjitha, lexoni, lexoni. Duhet lexuar sa më shumë. Vepra sa më të mira. Autorë sa më të njohur. Lexoni dhe mësoni. mandej uluni dhe shkruani"

Dhe unë - lexoja.

*Ramiz Kelmendi*



## ***Detyrë***

Shkruani disa nga cilësitë e E. Mekulit, me të cilat e përshkruan autori. Për se e quan Mësues?

Bëni dhe ju një shkrim për një nga mësuesit ose njerëzit që ju ka ndihmuar së tepërmi.



# UDHA E SHKRONJAVE

Ëndërronit vjersha të bukura,  
poema, tregime, romane, lëmë letërsie,  
lavra shkencore - sofrë diturie  
për ta shuar urinë e gjuhës, të shkrimit,  
për të jehuar në këngët e zogjve, të luleve  
në tridhjetë e gjashtë melodi,  
në tridhjetë e gjashtë bukuri.

Zemra regëtinte tridhjetë e gjashtë  
tinguj n'simfoni,  
syri kërkonte tridhjetë e gjashtë bardhësi,  
në mendje ndriçonin tridhjetë e gjashtë madhështi.

Pas tridhjetë e gjashtë pritash  
shndërroheshit në ylberë - në skifterë.

Ne, tridhjetë e gjashtë ushtarë  
tridhjetë e gjashtë shigjetarë.

Ne, tridhjetë e gjashtë sy,  
tridhjetë e gjashtë diej.

Pas tridhjetë e gjashtë ortiqesh  
pas tridhjetë e gjashtë tajfunesh-rrëzoheshim,  
pas tridhjetë e gjashtë ngricash,  
pas tridhjetë e gjashtë tufanesh - madhëroheshim.

Me dëshirat e martirëve ushqeheshim, gjallonim  
me urtinë e popullit pleqëronim,  
se në damarët e tij gjetëm burimin,  
me forcën e tij ushqenim shpëtimin.

Ne, gjuhëshpatat, va e pa va,  
në libra u rritëm, u bëmë kala.

Na pagëzuan “farë e djallit”!  
e ne u bëmë buka e shkollarit.

Në lumin e dijes - flamurtare,  
tridhjetë e gjashtë heroina  
- në libra, në abetare!

*Rabmi Tuda*

### ***Shënim***

Kongresi i Alfabetit të gjuhës shqipe u mbajt në Manastir në vitin 1908. Alfabeti i sotëm i gjuhës shqipe u caktua në këtë Kongres, i propozuar nga shoqëria “Bashkimi” e Shkodrës, përfaqësues i të cilës ishte Gjergj Fishta. Në Kongres edhe shoqëria “Agimi”, e përfaqësuar nga Ndre Mjeda si dhe ajo e Stambollit u paraqitën me propozimet e tyre, por si më i përshtatshëm, nga Komisioni i Alfabetit u pranua ai i “Bashkimit”.



### ***Komentojmë poezinë***

Për çka bën fjalë poezia?

Çka dini për Alfabetin e gjuhës shqipe?

Çka do të thotë poeti me vargjet:

“Pas tridhjetë e gjashtë ortiqesh,  
pas tridhjetë e gjashtë tajfunesh-rrëzoheshim,  
pas tridhjetë e gjashtë ngricash  
pas tridhjetë e gjashtë tufanesh-madhëroheshim...”?

Ku e gjetën qëndrimin, burimin dhe shpëtimin shkronjat?

Tregoni domethënien e vargjeve:

“Na pagëzuan farë e djallit  
e ne u bëmë buka e shkollarit...”



# FYELLI I GDHENDUR NË GUR

Në muzeun arkeologjik të Durrësit ruhet një lapidar i lashtë, ku është gdhendur një fyell.

Djaloshi ilir me emrin Altin qe një fyelltar i madh e i përmendur i qytetit Epidamn. Ai i binte fyellit aq bukur, sa askush nuk i rrezistonte dot kureshtjes për të dëgjuar mrekullitë e tingujve të tij, që mbi të gjitha ngjallnin etjen e dëshirën për liri. Djaloshi luante për detarët e peshkatarët e varfër, për popullin e thjeshtë. Ishte përhapur fjala se fyelli i tij kishte veti magjike, se me anën e tingujve mund të gjelbëronte tokën e shkretë e të çelte gjethe e lule në pemët e zhveshura, se mund të bënte të frynte era për velat e barkave e të anijeve të qytetit për t'u kthyer në agim në breg, pranë familjeve.

Çfarë nuk tregonin njerëzit për fyellin e djaloshit ilir me emrin Altin!

Ai kishte mbetur jetim që në moshë të njomë, pa nënë e pa baba, pa asnjë njeri të afërm.

Fyellin e mësoi nga një bari që kulloste dhentë buzë lumit në verilindje të qytetit. Por shpejt ai mësoi kaq mirë t'i frynte, sa ua kaloi gjithë fyelltarëve të tjerë të qytetit. Fama e tij përhapej kudo. Altini i binte fyellit në molo, ku vinin anije nga të gjitha brigjet e Mesdheut.

Detarët e këtyre anijeve mallëngjeheshin kur e dëgjonin, u kujtohej zjarri i vatrës së tyre në atdheun e vet dhe u dukej se dëgjonin fjalët e ngrohta të të dashurve.

Altini ishte mjaft bujar. Edhe një fëmijë i vogël, po t'i lutej që t'i binte fyellit, ai nuk përtonte aspak dhe ia plotësonte dëshirën. Ai ishte mik i gjithë qytetit, i skllëvërve të kriporeve të Epidamnit, i gurëskalitësve, i kuajrritësve e tjegullbërësve. Të gjithë e donin shumë e krenoheshin për fyelltarin e dalë nga gjiri i tyre.

Në qytet rronte edhe patrici i pasur Klaud. Ai e kishte smirë dhe e urrente fyelltarin ilir Altin. Njëherë ai i kërkoi fyellin për t'ia blerë, por Altini s'pranoi. Atëherë Klaudi urdhëroi shërbëtorët e tij që t'ia rrëmbenin. Shërbëtorët e zbatuan urdhrin. Ata iu hodhën një ditë në befasi djaloshit Altin dhe ia rrëmbyen fyellin e çmuar. Patrici Klaud e mori në duar dhe provoi t'i binte. "Ky është fyell magjik dhe mua do të më bëjë të famshëm..." Ai urdhëroi njerëzit

të mblidheshin rrotull për ta dëgjuar. Njerëzit u mblodhën e po prisnin.

Klaudi, duke u krekosur, i fryu fyellit. Por tingujt e tij s'kishin fare ëmbëlsi e melodia nuk ishte melodi. Njerëzit mbyllën veshët, se s'i duronin dot tingujt pa kuptim e të çjerrë që nxirte Patric Klaudi.

Ky u inatos e përplasi fyellin përtokë, e shkeli me këmbë dhe pështyu mbi copërat e thyera.

- Ky qenka një fyell majft i keq, - tha dhe u largua.

Djaloshi Altin vazhdoi të endej midis plebjeve e skllëverve të qytetit Epidamn. Njerëzit i luteshin të luante për ta, por Altini s'kishte më fyell.

Për ca kohë ai u zhduk nga qyteti. Kur u kthye, mbante në dorë një fyell të ri, që e kishte marrë tek barinjte e maleve. Ai filloi të luante.

I gjithë populli i thjeshtë u gëzua. Dëgjoji Patrici Klaud se djaloshi kishte gjetur një fyell të ri, me të cilin merrte ca melodi të mrekullueshme, që edhe gurët i bënë të ndjeshëm.

“Ah, - mendoi Patrici Klaud, - si nuk e kuptova se fyelli që mora unë s'ishte i vërtetë, por një kopje e keqe. Djaloshi ma ka hedhur.

Por këtë radhë s'më shpëton dot”.

Shërbëtorët e tij ia rrëmbyen prapë fyellin e ri djaloshit Altin e ia dhanë zotit të tyre. Klaudi e rrotulloi nëpër gishtat e duarve. Për çudi, edhe ky ishte njëlloj si i pari. Klaudi i fryu me sa fuqi që kishte. Por tingujt që nxori ishin përsëri nga ata tingujt që të kujtonin vetëm zhurmat pa kuptim. “Pra, edhe ky s'qenka fyelli magjik”, - klithi i zëmëruar Klaudi dhe e hodhi përdhe, e shkeli me këmbë me një inat të patreguar...

Po me djaloshin Altin ç'u bë? Ai mbeti pa fyell, por përsëri shkoi te barinjte e maleve e sollti një të tretë. Kaq bukur i binte, sa njerëzit e harronin urinë dhe s'e ndienin më etjen, të leckosurit në dimër s'e ndienin acarin. Patrici Klaud ia rrëmbeu dhe fyellin e tretë. Provoi t'i binte vetë, por, si me dy të parët, ai nxori vetëm disa vërshëllima që s'dëgjoheshin dot. Pastaj e shtypi me këmbë.

Fyelltari i qytetit gjeti një fyell tjetër të ri. Kënga e tij për të varfërit, si një thirrje kushtrimi për liri, nuk pushoi kurrë. Në të vërtetë, ai s'kishte pasur asnjëherë ndonjë feyll magjik. Ai luante me gjithë shpirt e ndjenjë, prandaj meloditë qenë aq të mira e i bënë njerëzit të ëndërronin.

Kaluan vite e vite. Djaloshi Altin u bë burrë e u bë plak. Gjithmonë me fyell në dorë. Ua mësonte mjeshtërinë e tij fëmijëve të popullit. Më në fund, nga pleqëria e vuajtjet e rënda që kishte kaluar në jetë, fyelltari plak, i zbehtë e i dobësuar, ndjeu se po vdiste. Mbi kokë i rrinte biri i vogël i një peshkatari, të cilit i kishte mësuar mjeshtërinë e tij.

- Sillmë fyellin, - tha plaku Altin i zbardhur nga thinjat. Fëmija ia solli. Plaku përmbloodhi forcat me sa mundi dhe filloi t'i binte. Nisi një nga meloditë që i pëlqente më shumë. Për fat të keq, koka iu rrëzua në krahëror, nga duart i ra fyelli e plaku vdiq pa e mbaruar melodinë. Fëmija, që i rrinte pranë, me lot në sy e me shumë dhimbje në zemër, ngriti fyellin. Ai e dinte si duhej ta nderonte fyelltarin e madh të popullit. S'kishte nderim më të madh për të se sa të vazhdonte melodinë e lënë përgjysmë. Kur djali i vogël e mbaroi melodinë, rreth tij qenë grumbulluar plebejtë, sklevërit e litarëve të anijeve, remëtarët, peshkatarët e gurskalitësit e qytetit.

- Të lumtë! - i thanë ata djalit të vogël.

- Edhe ti do të bëhesh një fyelltar i madh!

Altinin e varrosën në dheun e kodrës së qytetit Epidamn. Mbi varrin e tij ngritën një lapidar të bardhë mermeri, ku një gurskalitës gdhendi në mermer figurën e një fyelli. Ai ishte fyelli i legjendës së madhe, i mrekullive që bën shpirti i njeriut të thjeshtë, fyelli që lulëzon stinat, që lulet e pemëve i kthen në fruta, që ndez yjet e bardha, që i rrit më shpejt fëmijët e vegjël, u jep shëndet të dobtëve e fuqi të pafuqishmëve. Fyelli i përjetshëm i këngëve të popullit.

*Moikom Zeqo*



### ***Komentojmë tekstin***

Ç'paraqet fyelli magjik?

Pse fyelli nxirrte tinguj pa kuptim kur atij i frynte Klaudi?

Ç'bëri Patric Klaudi kur dëgjoji se djaloshi kishte sjellë fyell tjetër?

Cila pjesë e tekstit ju duket më e prekshme?

Ç'u bë me vazhdimësinë e fyelltarit të madh?

Si e shprehën mirënjohjen gurskalitësit ndaj tij?

Ç'porosi na jep autori me këtë tekst?



### ***Detyrë***

Bëni një hartim në lidhje me tekstin.



## KUR MUNGON ATDHEU

Aty diku të bëhej se ishte De Rada ose pak para se të shkelja në Maki, ai kishte dalë në ballkonin e dhomës së punës e vështronte në horizont. Nuk dëshironte t'ia prishte qetësinë askush. Në kujtesën e arbëreshëve poeti ishte gjallë dhe çdo fjalë, mesazh e lëvizje e tij ishte kyçur në ndërdijen e tyre. Kjo disi na përkujton atë thënien e Gerard Genettit: “hapësira letrare është kujdesja e njerëzve”. Dhe sapo ishte gjetur në ballkon, njëri nga të afërmit, kishte pëshpëritur: maestro ishte bërë nevrík. Ka rënë mjegull e dendur tash e sa kohë dhe nuk mund ta shihte Arbërinë tej detit. Tek e kisha dëgjuar këtë, më ishte parafytyruar një vëllam yni Serembe. Tërë kohën u kallëzonte arbëreshëve një histori të dhembshme:

Arbëria matanë detit, na kujton

Se ne të huaj jemi te ky dhe.

(vrull)

Mua udha shpesh më ka qitur tek arbëreshët. Më vonë isha ambientuar me ta. Mbaja mend kangjela nga lashtësia, historira për Motin e Madh e deri ndonjë fjalë të rrallë, që i kishte shpëtuar harresës. Më fascinonin ngjyrat e rrobave, rregullimi e pastërtia e fshatrave, mikpritja, por më tmerronte vetmia e tyre. Kisha bërë gjumë edhe te ndonjëri. Dhe nuk mund ta harroj një mik, që në një poezi timen hyri si Zef. Kishte rënë nata dhe ai kishte kyçur derën dy herë. Si kudet, një rrotullim i çelësit nuk kishte mjaftuar. Pse ai çelës ishte sjellë ashtu, pakëz me nervozizëm. E kisha kuptuar tek kisha kujtuar prapë vargun tragjik të Serembes: “se ne të huaj jemi tek ky dhe...”

Në rastin e parë kur nga prania e De Radës ndaheshim vështirë, kemi të bëjmë me gjakimin e krijuesit për rrënjën e vet, hulumtimin e prejardhjes, të origjinës. Në të dytin shtrohet problemi i identitetit: se kush janë e nga janë? Pra, ç'është ajo që në grumbullin e madh njerëzor i dallon popujt? Dhe, duke u kujtuar vazhdimisht arbëreshëve se rastësia i kishte qitur aty ku janë, në të vërtetë Serembe forconte identitetin e tyre, që, fatkeqësisht, vendi amë kontribuoi pak për arsye që na janë të njohura. Ndërsa ai çelësi, që Zefi ynë e kishte sjellë dy herë në derë, simbolizon frikën, ankthin. Mund të përballej me ndonjë të papritur? Arbëreshët u gjetën në një qytetërim krejt tjetër, që i kishte

kanunet e veta dhe që vepronin ashtu siç dëshironin ndaj një kolektivi njerëzor, që detin e kishin kaluar edhe me një gjysmë trapi. E, Shqipëria ishte vetëm një nocion gjeografik. E varfër, e thyer, e shkelur dhe e derdhur nën mbretërinë e hënës anadollake, ku përshpërteje ose shënohej ndonjë ngjarje nga kohët e lavdisë. Dhe, një Zot e shpëtoi. Mungonte organizimi, shkolla shqipe, krijuesi që do ta bënte çështje çdo rrënim. Pra, në një situatë kllapie, mund të bënte gjë Shqipëria për degët e shkëputura? Fqinj të gllabërues e kishin hedhur në ruletë, duke u falënderuar fuqive të mëdha, dhe ia vidhnin historinë, ia nëpërkëmbnin gjuhën e dinjitetin. Shkurt, Shqipëria ishte tokë për kusuritje, ndërsa përreth formoheshin shtet kombet në dëm të saj. Tej detit arbëreshët jetonin në ankth: si ta ruanin atë që e kishin shpëtuar nga vendi amë. Kishin probleme me kujtesën, sepse duhej përcjellë diçka brezi brezit. Krijuesi arbëresh qëndronte përballë vetvetes. Dhe raporti ndërmjet tyre e Evropës ishte i njëjtë siç ishte me Shqipërinë: një zhgënjim që patjetër më vonë do të lëvizë gjërat. Pra, kthimi nga vetja dhe rikrijimi i të humburave nga kalvari historik, ku ngjarjet merrnin përmasa mitike. Dhe e vetmja gjë që bënte të shpresojnë ishte kujtesa, shpalimi i saj, hedhja e parë e dridhjeve shpirtërore në fletën e bardhë. Megjithatë shqiptari edhe më mbeti iluzionist dhe vështirë krijoi miq. Naim Frashëri i kishte kushtuar poezi Francisko Krispit, sapo ky kishte hipur në karrigën e Presidencës Italiane. Besonte se Shqipëria më në fund dilte në dritë, po poeti ynë kishte harruar se karrigia Shqipërinë shpesh e solli buzë humnerës.

Mirëpo, vetëdija kombëtare kishte zënë të zgjohej: kur nuk fliste Shqipëria, flisnin gjymtyrët e saj të derdhura, ku kontribut të madh do të japin pa dyshim edhe arbëreshët. Gjaku i shprishur kishte filluar të dëgjohej. Çështje e tyre u bë edhe mbiëgzistenca e Shqipërisë, e Kosovës dhe çdo skaj i etnisë. Nga Moti i Madh ishte shfaqur vizioni i atdheut të ardhshëm. Ky ishte një libër që vazhdonte të shkruhej nga lashtësia e nuk dihej se kur do të mbyllej. Sidoqoftë, shqiptarët iu kthyen vetes dhe krijojnë raporte të tjera me Evropën.

*Ali Podrimja*



### ***Komentojmë tekstin***

Pse mban teksti këtë titull simbolik?

Cilët janë njerëzit, të cilëve u mungonte atdheu sipas autorit?

Kush fliste atëherë kur nuk fliste mëmëdheu?

Cilat janë ato gjymtyrë që përmend autori në pjesën e fundit të tekstit?



## Shënim

Teksti në fjalë është një ese. Ai paraqet një moment nga realiteti i ditëve tona, që u bë frymëzim për autorin, kur që në vizitë në trojet e arbëreshëve në Kalabri e Sicili. Teksti “Kur mungon atdheu”, është shkruar në stilin e gazetarisë. Mundohu që në orën e mësimit me arsimtarin të bisedoni rreth gazetave, emisioneve të radios, të televizionit si dhe t’i dalloni ato private nga shtetërore.

## ESEJA

Eseja është artikull i gjatë a studim me karakter kritik ose publicistik, i cili trajton në mënyrë të përgjithshme çështjet shoqërore, shkencore, letrare, kulturore etj.



### ALI PODRIMJA (1942)

Ali Podrimja lindi në Gjakovë më 1942. Këtu mbaroi shkollën fillore dhe të mesme, kurse studimet i kreu në Prishtinë (Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare). Punoi në gazetën “Rilindja”, pastaj kaloi në redaksinë e Botimeve të “Rilindjes”, ku vazhdon të punojë edhe tash. Ali Podrimja shkruan kryesisht poezi. Përveç librit të tregimeve “Loja në diell” (1967), botoi këto përmbledhje me poezi: “Thirrje” (1961), “Shamijat e përshëndetjeve” (1963), “Dhimbë e bukur” (1967), “Sampo” (1969), “Lum Lumi” (1982), “Fundi i gëzuar” (1988), “Zari” (1990), “Në bisht të sorrës” (1994) etj.



# QORTIMET E VJESHTËS

Qemal Stafa ishte nxënës shkolle, djalë 16 vjeçar, kur shkroi këtë tregim të bukur. Lexojeni me kujdes dhe mundohuni ta kuptoni thellë se sa shumë e donte ai popullin.

E shifja çdo mëngjes, kur shkoja në shkollë.

Gjithmonë në të njëjtën skutë, e njajta fytyrë zeshkane, e mbulueme me lesh të gjatë, lëshonte ngandonjëherë vezullime të argjendta.

Vuajtjet, ma tepër se koha, kishin lanë në faqet e tij të vrazhda gjurmë të thella, të shumta.

Në verë shiste pemë. Në dimër gështenja të pjekme. Të gjithë fëmijët e lagjes e njëfshin. Kur shkojshin në shkollë, u ndalshin te skuta e ngushtë për me blemun gështenja.

Nganjëherë, ndonjë kalama i thoshte diçka në vesh, atë ditë nana nuk i kishte dhanë të holla.

Burri tundte kryet e lodhun prej mendimevet.

Dhe vente buzën në gaz. Atë buzë të tham, që rrallë kishte qeshë.

Fëmija mbushte xhepin me gështenja dhe u largonte, i gëzuem.

Kur afrohej vera, atij i binte një hije mjerimi. I vinte keq që u largojshin blersat e tij të vegjël.

Paret e humbuna?

Jo!

Ai copën e mjerë të bukës dhe të djathit për vete dhe për fëmijët (se kishte dy fëmijë të bukur si pranvera) e fitonte dhe tue u shitë të mëdhenjve pemë.

Por diçka ndiente metë kur nuk shifte buzëqeshjet e kalamajvet që shkojshin me u mbyllë në muret e rrepta të shkollës, kur nuk ndigjonte zanat e gëzueshme të tyne.

\* \* \*

Fëmijët diftojshin shumë sende për atë.

Kishte pasë dikur një fëmi, një kërthi të njomë dashurie, që me zanat e veta të gëzueshme, binte lumtuni në shtëpinë e gështejpjekësit (pse kishte pasë edhe ai një shtëpi).

Një ditë engjëlli kishte lanë babën dhe nanën. Pranverë e artë që shkimet e pakohë. Rrezet e mekët drite që davaritet në mjerim.

Nji jehonë vaji kishte përshkrue qetësinë e shtëpisë së varfër. Mbas disa

ditësh, grumbullimi i njerëzve që kishte marrë kërthinin, kishte kthye... Kishte marrë me vete edhe nanën e smut.

Ma vonë, një grumbull tjetër njerëzish me armë dhe me rroba të njiillojta, kishte qitë nga shtëpia me pak rraqe mbas krahu burrin e mjeruar me dy fëmijë.

Një ditë, kur po merrja gështenjat e zakonshme, vëreja diçka që më çuditi: gështejpekësi kishte mbulue gjoksin e vet leshtak me një rrobë të vjetrueme. Ishte mëngjes i rrebët. Binte borë e bardhë virgjinore, që flokë-flokë lëshonte mjerimin mbi kolibet e unjëta dhe gëzim mbi pallatet e ndritshme...

Kur më dha gështenjat, burri u kollit. Fytyra i mori një ngjyrë të zjarrtë. Për një çast vrulli u ul dhe përnjëherë burri u zverdh...Shikoi dy fëmijët, që po androrojshin qetësisht mbi dërrasat e vjetrueme të arkave të prishura. Dhe psherëtimi.

Unë e kuptova.

Binte borë. Ishte ftohtë.

Mbas asaj dite ai u kollit shpesh. Zhurma e vrullshme e sëmundjes grise e ndaloi shpeshherë prej punës.

Burri vërente trishtueshëm fëmijët dhe vente dorën në gjoks.

Një ditë nuk e pashë ma.

Fëmijët që blejshin gështenja, u mjeruan.

\* \* \*

Nji mbramje vjeshte kthejshe në shtëpi. Erë e rrebët e furishme frynte nga veriu. Binte shi i ngrimë tetori që shtjen dridhjet në zemër.

Nën një strehë gjysmë të shkatërrueme, strukë në pallton e vjetër, pashë një burrë të këputun.

Kryet e thimë i mbështetej mbi gjoksin e ngushtë. Në dy kockat e prehnit të tij pushojshin dy krena të vegjël.

U afrova.

Gështejpekësi me dy kërthij. Flejshin tue u dridhë.

Desha të flas. Por një ndjesi e çuditshme më urdhënoi mos me e prishë atë qetësi mjerimi. Dhe unë u largova i poshtëruem, kur vëreja rrobat e mia të ngrohta.

U largova me një mendim dhe një dënim në zemrën time. Dënova shoqinë njerëzore, premtova...

Ishte mbramje vjeshte. Binte shi. Frynte erë.

*Qemal Stafa*



### ***Fjalë dhe shprehje***

*skutë-a* - kënd, qoshe


*diçka ndiente metë* - diçka i mungonte

*kërthi-në* - foshnjë  
*shkimet* - mbarohet, shuhet  
*e mekët* - e dobët, e pafuqishme  
*e smuet* - e sëmurë  
*rraqe* - tesha shtëpie  
*virginore* - e pastër, e pa prekur  
*grise* - brerëse, gërryese, prishëse  
*u mjeruan* - u trishtuan, u mërzitën  
*kocat* - kockat  
*ndjesi-a* - ndjenjë



### ***Komentojmë tekstin***

Ç'thotë autori në pjesën e parë për gështenjapjekësin?  
Ç'tregonin fëmijët për gështenjapjekësin?  
Kush ia mori plaçkat e shtëpisë e përse ia mori?



### ***Detyrë***

Përshkruani tekstin me fjalët tuaja.

#### **Tipizimi i personazhit**

Në veprat flitet kryesisht për njerëzit, për jetën, për përpjekjet dhe punën e tyre. Shkrimtari përpiket që këta njerëz, ose si i themi në letërsi, këto personazhe, t'i paraqesë sa më qartë. Për këtë ai bën portretin e tyre, i tregon në lëvizje, d.m.th. se si bisedojnë, si punojnë, ç'marrëdhënie kanë me njerëzit e tjerë etj. Në këtë mënyrë ne kemi të mësojmë rreth një personazhi, të njihemi me të. Ne e kuptojmë se si është një personazh: nga paraqitja e tij e jashtme (fytyra, trupi, veshja), nga veprimet që kryen, nga fjalët që përdor kur bisedon, nga mënyra se si silllet me të tjerët, nga lëvizjet që bën kur bisedon, punon, nga fjalët që përdor autori kur flet për të, nga fjalët që thonë personazhet e tjera për të. Kështu, për shembull se çfarë njeriu është gështenjapjekësi, në tregimin e mësipërm, zbulohet nga portreti që i bën autori, nga veprimet që kryen, nga sjellja e tij me nxënësit etj. Nga tërë këto, nxjerrim përfundim se gështenjapjekësi është një njeri punëtor, por i varfër, një njeri që i do njerëzit, i do fëmijët; ai është i dobët, i ushqyer keq, i veshur keq, por zemrën e ka plot ndjenja fisnike etj. Në këtë mënyrë ne mund të hetojmë edhe personazhe të tjera në këtë tregim, si: xhandarët, fëmijët e shkollës, madje edhe autorin që tregon këtë ngjarje.

# KTHIMI I GJERGJ KASTRIOTIT NË KRUIJË



Kjo pjesë është shkëputur nga libri “Histori e Skënderbeut” e Fan Nolit (1882-1965) i cili është një figurë e ndritur e kulturës shqiptare. Ky libër është një nga veprat më të mira që i janë kushtuar heroit tonë kombëtar, Skënderbeut.

Në mur, përsipër vatrës, varej një shpatë e kohërave të vjetra, që s’e ngre dot njeriu i sotëm as me dy duar. Qe palla e Kastriotëve, e mbajtur brez pas brezi prej trimave që nxori ajo derë e shkëlqyer. Turqit e shkelën dhe e plaçkitën kështjellën, po pallën s’e nganë, se asnjë s’qe i zoti ta përdorte.

Vojsava e varfër ngre kryet shpesh dhe shikon atë shpatë dhe i mbushen sytë me lot. Qan nëna për një bir, qan shpata për një burrë!... Ç’u bë ai djalë, ku është ai trim? Gjer kur do të valojë mbi fortesën e Krujës ai flamur i tiranit të huaj? Gjer kur do ta presë nëna të birin, Kruja të zotin, Shqipëria t’anë, bota trimin që s’ka shokë?

Po njëherësh hapet dera dhe hyn brenda një luftëtar i hijshëm, fisnik dhe madhështor, hundëshkabë, syptetit, me mjekër të gjatë dhe të derdhur, i veshur me çelik dhe i armatosur gjer në dhëmbë... Vojsava kthehet, e shikon, përpigjet të ngrihet, por qëndron si i ngrirë nga kjo pamje e papritur. Fërkon sytë se mos sheh ëndërr. Luftëtari që hyri, është gjallë i shoqi. Gjon Kastrioti, por më i ri, më i bukur, më i lartë...

- Në mos je hije a fantazmë, që vjen të gënjesh një të varfër, qyqe të neveritur, ti je im bir, ti je Gjergji im... Folë, folë mos më mundo!...

Po luftëtari nuk flet dot. Ai, që s’i ishin mvrejtur sytë as nga shigjetat, kur i binin breshër mbi supe, dhe as nga qindra të vrarë e të plagosur përçark, qan tani si çilimi, bie në gjunjë, i puth dorën princeshës së nderuar, po lotët e mbytin e s’thotë dot “Unë jam!”. Po nëna e mori vesh. E njohu nga syri, e njohu nga fytyra, e njohu nga sjellja. Pastaj e njohu më mirë ajo dhe Shqipëria si dhe bota nga ato që bëri. Ai qe i tëri dhe i gjallë Gjergj Kastrioti. Si mori bekimin e nënës dhe u bë dy herë më i fortë se më parë, rrëmbeu shpatën, që varej në mur, sikur t’ishte e lehtë si pendë, e ngjeshi pas brezit dhe shkoi kaluar në fortesë...

Kruja që dukej si e shkretuar, lëviz dhe ngjallet. Burra, gra, fëmijë janë

mbledhur në shesh të qytetit. Ca të gëzuar këndojnë si në dasmë, të tjerët qajnë, të gjithë shikojnë nga maja e fortesës dhe bërtasin e brohorasin. Flamuri i huaj u hoq dhe tani valon në erë flamuri i Shqipërisë. Për atë gëzohet populli, për atë tingëllojnë këmbanat, për atë gjëmojnë topat. Ato që ngajnë nën atë flamur, nën atë kryeushtar, i shkruan historia me shkronja të arta, i buçasin malet, brigjet dhe gurët e Shqipërisë, i tregojnë përrallat dhe legjendat e leqve dimrit rreth vatrës.

Fan S. Noli



### **Fjalë dhe shprehje**

*vatër* - vendi rrëzë oxhakut ku ndizet zjarri

*pallë-a* - shpata

*tiran-i* - sundimtar, pushtues

*bekim-i* - urimi

*shkoi kaluar* - shkoi i hipur në kalë



### **Komentojmë tekstin**

Çfarë i kujton Vojsavës shpata e varur në mur?

Çfarë bëri Skënderbeu pasi mori bekimin e nënës?

Ku shihet mallëngjimi dhe gëzimi i nënës që njohu të birin?



### **Detyrë**

- Ilustrojini këto njohuri me fragmentin e më sipërm, duke u bazuar te:

a) Ngjarja (vërtetësia dhe fantazia e autorit),

b) Personazhi i nënës (përshkrimi i ndjenjave saj),

c) Personazhi i Skënderbeut (sa është real dhe sa i fantazuar).

**Romani historik** për nga gjatësia ndryshon nga tregimi dhe novela. Romani është lloj i gjatë i prozës, në të cilën rrëfimtari rrëfen një ose më shumë ngjarje, ka më shumë personazhe dhe zgjidhen më shumë konflikte. Koha dhe vendi zënë shumë më tepër vend në roman se në një tregim. Në romanin **historik** “Historia e Skënderbeut” autori bazohet në ngjarje historike të vërteta dhe në personazhin historik, Skënderbeu. Po megjithatë, F. Noli ngjarjet i përshkruan me fantazinë e tij si shkrimtar dhe derdh në to ndjenjat dhe mendimet e veta. Kjo bëhet me qëllim që libri i tij të ndryshojë nga një libër historik që jep vetëm fakte ngjarjesh dhe nuk është emocionues.

# MALLI PËR JUG

Në krah shiponje në fluturim,  
Me mall të nisem në vendin tim  
Dhe mbi Stamboll të ngrihem lart,  
Pastaj të zbres në Kukush – grad  
Dhe ta shoh diellin a qesh, a qan,  
Apo në mjegull kokën e mban.

Nëse dielli më pret si murg  
I pikëlluar në re e muzg,  
Do arratisen sërishëm larg  
Në një breg tjetër, në tjetër cak,  
Atje ku dielli më i ngrohtë del,  
Atje ku qielli plot yje mbjell.

Këtu Bunaca më mbyt me shkrumb.  
Këtu dhe toka nën mjegull humb.  
Furtunë e borë e mure gri,  
Acar i hidhur e qiell i zi.  
Shtrëngatë resh e akuj vdekje,  
Mendime sterrë e ankth me vete.

Ah, s’dua, s’dua të rri qyqar,  
Të shoh veç akuj e bloz e varr.  
M’i vini flatrat, m’i ngjitni krahët,  
Të marr si zogu rrugën e largët.  
Të sillem qiellit në fluturim,  
Ta shoh dhe Strugën dhe Ohrin tim.

Në kodrat tona agimi shkret  
Dhe dielli shpirtin pyllit ja jep.  
Hap gjoksin toka – margaritarë  
Dhe nxjerr nga gjiri shëndet e arë.

Shikoj liqenin – liqeni zbardh  
Apo kaltrohet, a nxihet larg ...  
Në fushë e male, si Perëndia,  
E perëndishme vjen bukuria.

T’i bie fyellit – me shpirt të qesh  
Pastaj në mbremje – të shkoj të vdes.

KONSTANDIN MILLADINOV

*Përshtati dhe shqipëroi  
Dritëro Agolli*



### **Fjalë dhe shprehje**

*i pikëlluar* – i dëshpëruar

*do arratisem* – do të marr arratinë, do të iki, do të largohem

*bunaca më mbyt me shkrumb* – errësira, mjegullina më mbyt, më djeg

*s’dua të ri qyqar* – s’dua të rri si qyqe, vetëm



### **Komentojmë poezinë**

Pse poeti kërkon krah shqiponjash dhe për ku donte të fluturojë?

Ku gjendej në atë kohë poeti?

Pse e përmend ai Strugën dhe Ohrin (ç’e lidhte me ta)?

Ç’paraqesin vargjet e fundit rreth gjendjes së tij shpirtërore?

Në strofën e tretë dhe të fundit, kemi një figurë të fuqishme letrare.

Cila është ajo?

## **KONSTANDIN MILLADINOV (1830 - 1862)**



Konstantin Milladinov dhe vëllai i tij Dimitri janë fytyra të njohura të letërsisë maqedonase nga Struga. U morën me mbledhjen e folklorit që e përfshinë në përmbledhjen “Almanah” (Zbornik). Shkruajtën edhe poezi me tematikë atdhetare (ku bën pjesë edhe kjo vjershë) – për çka qenë të ndjekur dhe të internuar.



## PRIAMI I LUTET AKILIT

Kur hyri Priami Brenda në çadër, Akilin e gjeti ndenjtur. Antomedonti dhe Alkini qëndronin në këmbë për t'i shërbyer. Akili sapo kishte mbaruar së ngrëni e së piri, por sofrat nuk ishin ende. Askush prej tyre nuk vuri re, kur Priami hyri brenda dhe i pushtoi gjunjët me krahët e tij të pafuqishëm. Së pari Priami i puthi duart gjakatare Akilit, ato duar që i kishin vrarë aq djem dhe ia kishin lënduar shpirtin. Akili dhe shokët përreth, kur panë aty Priam hyjnorin, shikuan të çuditur njëri-tjetrin në sy. Pa e mbledhur ende nga kjo e papritur, Priami iu drejtua Akilit:

- Baba ke dhe ti, O Akil, pinjoll i Zeusit. Ai është plak si unë në buzë të varrit. Ndoshta dhe atij i bien në qafë dhe s'ka njeri që t'i dalë zot, se edhe ti nuk i je pranë. Po unë i mjeri që pata gjithë ata djem dhe nuk di në më mbeti ndonjë gjallë. Kur erdhën danajt kisha pesëdhjetë djem kreshnikë, por shumë prej tyre m'i vrau mizori Ares. Vetëm njëri prej tyre i dilte zot qytetit dhe të gjithëve, trimi i dheut, Hektori, biri im, ai që ti e vrave tek mbronte Trojën. Kam ardhur këtu tek anija, për t'u lutur ty me dhurata të çmuara. Dëgjo hyjnitë, o Akil Pelidi, babë ke dhe ti, por kij mëshirë për mua, mbasi unë jam më i mjerë se ai. Unë afrova buzët tek duart gjakatare, që më vranë djemtë.

Akili u shkreh në vaj. Pamja e Priamit i solli mall për të atin, ia mori plakut duart, që ia kishte mbi gjunjë. Priamit i shkonin lotët rrëke për kryetrimin Hektor. Dhe Akili herë vajtonte të atin dhe herë Patroklin. Çadra e tij gjëmonte nga vajtimi i të dyve. Pasi u shkreh mirë në lotë, Akili iu afrua Priamit, i preku flokët dhe mjekrën borë të bardhë dhe me fjalë të ëmbla, i foli.

- O i shkreti ti për gjithë të zezat që të hoqi zemra. Po si vallë vrapove të vish këtu fill i vetëm? Paskë me të vërtetë zemër prej çeliku. Eja, ulu mbi këtë fron, se kështu kanë vendosur hyjnitë, mjaft me lotë. Në portë të Olimpikut ndodhen dy amfora të mëdha, njëra e mbushur me të mira e tjetra me të liga. Por Zeusi i përziën amforat dhe kështu na qëlloi herë me të mira dhe herë me të liga... Tim atë, Peleun, ditën që lindi, hyjnitë e mbuluan me dhurata dhe e bënë të lumtur e të pasur. Ai vërtet ishte vdekatar, por për nuse i dhanë hyjneshën Tetis. Por as ai nuk është i lumtur, se s'po e sheh që i biri të gëzojë pasurinë. Dhe unë qëndroj larg atdheut tim për të keqen tënde dhe të trojanëve të tjerë, o plak. Edhe ti ke qenë me nam për pasurinë dhe djemtë e tu

të shumtë, por ka dhjetë vjet që luftërat, humbja e bijve e brengat s'të kanë sosur. Na ka hije të qëndrojmë si burrat e t'i lëmë vajet nga që për këtë ka urdhëruar Zeusi. Është e udhës të ruhemi nga të liga të tjera.

- Mos më thuaj të lutem, o pinjoll i Zeusit, përderisa im bir, Hektori, dergjet para çadrave, pa varr e pa nder, - foli Priami, - Të lutem, lermë të shoh njëherë me sy e prano shpërblesat e mia.

- Dëgjo, o plak, mos i shty mëtej fjalët. Unë vetë kisha menduar të ta kthej djalin. Me fjalë e lutje mos i zgjo brengat, sepse vetë Zeusi ka urdhëruar. Po fole kështu do të nxjerr nga çadra edhe pse më lutesh. Plaku u tremb nga fjalët e Akilit, prandaj edhe nuk foli më.

Akili doli nga çadra i shoqëruar nga dy miqtë e vet, Antomedoni dhe Alkini. Zgjidhën kuajt dhe mushkat nga karoca e Priamit dhe ulën të gjitha dhuratat e vyera, që do të blatoheshin për Hektorin. Ai nuk desh që Priami të shihte të birin të përbaltur e të zhgëryer, prandaj urdhëroi që ta lanin trupin e Hektorit e ta lyenin me vaj trëndafilash.

Robinat e lanë dhe e lyen trupin e Hektorit, pastaj e mbështollën me një gunë të bukur dhe i hodhën përsipër një prej velenxave më të bukura, që Priami kishte sjellë me vete. Akili ngriti trupin e Hektorit dhe e vuri mbi koçinë e hijshme të Priamit, Pastaj iu drejtua Patrokli me këto fjalë: "Të lutem Patrokël mos më mbaj mëri, por merre sikur unë i dhashë trupin e Hektorit tët eti. Për të Priami më solli dhurata fisnike dhe unë do të të ruaj prej tyre një pjesë të mirë."

Akili u kthye përsëri në çadër, u ul në fronin e vet dhe iu drejtua Priamit: "Tët bir, o plak ta ktheva, ashtu siç e deshe. Atë e ke në qivur dhe mund të shkosh ta shohësh e ta marrësh, kur të agojë dita. Tani, o plak, të mendojmë për të ngrënë, se për të qarë mbi trupin e tët biri do të kesh kohë kur të kthehesh në Trojë." Akili nuk priti më gjatë, por kapi një runzë të bardhë dhe e theri në çast. Antomedonti solli bukë të ngrohtë dhe e ndau mbi tryezë dhe kanistra të bukura.

Mishin e prenë thela-thela dhe e poqën për merak në hell. Sofra u gatit sa kaq dhe të gjithë e thyen urinë me të ngrënë e me të pirë. Priami i mrekulluar vështronte Akilin azgan e të pashëm, por edhe Akili sodiste me habi fytyrën fisnike të Priamit dhe kujtonte ligjerimet e tij të urta. Pas këtij dueli të heshtur vështrimesh, Priami iu drejtua Akilit:

- Tani lejomë të bie në shtrat, o pinjoll i Zeusit, se që kur ti ia more shpirtin tim biri, Hektorit, nuk kam vënë gjumë në sy, kam qarë, duke kërkuar mijëra hidhërime e duke u ngjyer me plehun e oborrit. Që atë ditë nuk kisha shtënë gjë në gojë, përveç se sonte që u ngopa me të ngrënë e me të pirë.

Pasi urdhëroi robinat t'i bënte gati shtratin, Akili iu drejtua me shaka Priamit:

- O plak i mirë, më mirë fli përjashta çadrës, se po të pa ndonjë akejas, shkon e lajmëron Agamemnonin dhe ai nuk ta kthen kufomën. Sa ditë kërkon për t'i bërë nderimet Hektor hyjnorit?

- Po qe se më lejon vërtet t'i bëj nderimet e duhura tim biri, do të më bëje vërtet një nder të madh. Për nëntë ditë resht do të bëjmë gjëmën, të dhjetën ditë do t'i bëjmë varrimin, të njëmbëdhjetën do t'i ngremë muranën, kurse të dymbëdhjetën ditë, po deshët, luftojmë përsëri.

- Ashtu siç do ti, do të bëhet, - tha Akili këmbëshpejti.

Të gjithë ranë të flenë pa frikë në zemër.

Omeri



### ***Fjalë dhe shprehje***

*sofra nuk ishte çuar* – sofa, (tryeza) nuk ishte pastruar

*pinjoll-i* – trashëgimtari

*në buzë të varrit* – gati duke vdekur

*qivur-i* – arkivoli, arka ku vendoset i vdekuri

*azgan* – trim, me shtat të lartë e të fuqishëm

*të bëjmë gjëmën* – ta vajtojmë

*muranë-a* – grumbull gurësh të vendosur në vendin ku është varrosur një njeri.



### ***Komentojmë tekstin***

Përse Priami shkoi në çadrën e Akilit. Bëni lidhjen ndërmjet pjesës së parë që lexuat dhe pjesës së dytë.

Çfarë fjalë lutëse i drejtoi Priami Akilit?

Për ç'arsye Akili u mallëngjye dhe si veproi më pas ai?

Ritregoni me fjalët tuaja dialogun e fundit që u zhvillua ndërmjet Priamit dhe Akilit.



### ***Detyrë***

Mësoni përmendsh lutjet që i drejton Priami Akilit. Duhet të respektoni intonacionin (deklarativ) që kërkon ky lloj stili për të shprehur ndjenjat e mendimet.

## PO UNË DUA TË MËSOJ

Banoja bashkë me Harillën në një konak buzë detit. Ishte edhe ai nxënës si unë. Valët që përplaseshin në tokë i dëgjonim gjithnjë. Edhe Harilla ishte nga një familje e varfër. Edhe atij i kishin thënë: “Shko nga të duash, gjeje vetë fatin, s’ke mi si të të ndihmojmë“. Dhe ja, u bashkuam që të dy. Dy njerëz me të njëjtin fat. Po ç’kishim, e ndanim bashkë, si vëllezër e kaluar vëllezërve.

Për konakun nuk paguamim gjë. Nuk e di si e kishim rregulluar punën për këtë. Vetëm mbaj mend se nuk na thoshte njeri në fund të muajit: “Qeranë, jep-mëni qeranë“.

Konaku ishte i vogël. Dritaret piqeshin me tokën. Dikur ato kishin pasur xhama, po ishin thyer dhe ne u kishim vënë kartona, teneqera, gazeta. Po të mos hapje derën, edhe ditën ishte errësirë aty brenda.

Unë kisha një shtrat prej hekuri pa susta. Kisha kaluar në hekurat tela dhe sipër vija një dyshek të vjetër, mbushur me kashtë. E kujtoj edhe tani. Kur bija për të fjetur, më vriteshin brinjët e më zinte gjumi me dhembje.

Edhe Harrilla nuk e kishte shtratin më të mirë se timin. Edhe ai lumë e det e kishte. Kishim që të dy nga një çull të vjetër, që me siguri do të ishin bërë nga gjyshet apo stërgjyshet tona. Mbuloheshim me to dhe, të lodhur siç ishim, na zinte gjumi, një gjumë i rëndë plot ëndrra, të cilat ia tregonim njëri-tjetrit në mëngjes.

Kur u ktheva natën me faqet tërë gjak dhe me pantallonat të grisura, Harillën e gjeta duke lexuar shtrirë në krevat. Kur më pa, u trondit dhe më tha:

- E ç’je bërë kështu!? Kush është ai i poshtër që të ka rrahur?

Si ia tregova ngjarjen, Harilla më pyeti me lot ndër sy:

- Po sa kohë do të vazhdojmë kështu?

- Po si thua, - iu përgjigja unë, - ta lëmë shkollën?

- Një herë them ta lëmë, një herë them të mos e lëmë.

- Po ku të shkojmë?

Heshtëm. Pastaj filluam përsëri bisedën.

- A e ke mësuar mësimin?

- Nuk e sheh si jam? Kështu, në këtë gjendje ta mësoj mësimin? Pa ngrënë dhe me rrobat copë - copë?!

Më dha një gjilpërë dhe qepa pantallonat që ishin prej drilloje të zezë.

- Sa bukur di të qepësh! – më tha.

- Po të duash, t’i qep edhe të tuat...

- E, ti je rrobaqepës e kaluar rrobaqepësit! Ku ta dija unë! Mirë të ka thënë babai: “Bëhu rrobaqepës”.

Po edhe Harilla ishte i zoti si këpuctar. Ai i arnonte vetë këpucët.

Pastaj Harilla më tregoi një ngjarje shumë të hidhur. Sipas rregullave që kishte atëherë, nxënësit e jashtëm, domethënë ata që nuk kishin bursë nga shteti, duhej të paguanin pesëdhjetë lekë në tre muaj! Për ne kjo ishte një shumë e madhe. Pesëdhjetë lekë bashkë ne nuk i bënim kurrë.

Kur kishin hyrë në klasë nxënësit, mësues Musai, një njeri zemërmirë, i kishte thënë me keqardhje:

- Po s’pate pesëdhjetë lekët, taksën e këtyre tre muajve, do të ikësh nga shkolli. Nuk mund të vazhdosh mësimet. Kam urdhër të prerë nga drejtori.

- Unë ika, - më tha Harilla, - dhe të gjithë nxënësit më shikonin me dhembje.

Me gjithë hallet që kishte, edhe Harilla ishte i pari në mësimet. Nuk ia kalonte kush.

Ç’padrejtësi! Të jesh i pari në mësimet, të jesh i varfër, të jesh i ndershëm dhe të mos kesh pak ndihmë nga shteti! Kurse ata që nuk mësonin dhe që ishin të pasur, se rronin mbi kurrizin e të tjerëve, ndihmoheshin edhe nga shteti me bursa e me të gjitha!

Atë natë denjëm gjer vonë duke folur me njëri – tjetrin për çështje të ndryshme, sikur të ishim të mëdhenj. Ishim pjekur para kohe nga vuajtjet dhe mundimet.

Harilla kishte marrë edhe një letër nga i ati, në të cilën ai shkruante: “Tani e tutje s’jam në gjendje të të dërgoj asnjë grosh. Mezi rregullova një karroqe misër dhe nuk di si të bëj më tutje. Mendo dhe vepro! Po s’të dhanë bursë, nisu për në fshat dhe puno me ne. Kështu qenka e shkruar për ty. Fatit nuk i dilet përpara”.

Mua më erdhi një mendim në kokë:

- Me këto lekët që kemi të bëjmë tregti.

- Tregti! Po ç’tregti?

- Ja, - i thashë unë i gëzuar. – Të blejmë mollë ose dardha. Në shkollë, ata që kanë bursë, sidomos bijtë e bajraktarëve, si hanë mirë e mirë, duan të hanë edhe pemë. Ata i blejnë, po t’ua shpiem ne. Do të fitojmë ndonjë gjë patjetër.

- E provojmë.

- E provojmë, - thashë dhe unë.

Dhe me këto fjalë na zuri gjumi.

Jashtë era fërshëllente aq shumë, saqë nxirrte edhe gjarpërinjtë nga foletë.

Po ne i kishim shtrënguar aq fort velenxat e vjetra, saqë edhe dhjetë vetë të mblidheshim, nuk na i hiqnin dot, sikur të mos donim vetë t’i lëshonim.

\* \* \*

Thamë dhe filluam nga puna. E nisëm tregtinë me dy lekë. Për ne ishin shumë dy lekë. Unë i mora dhe me një trastë në dorë shkova në Vlorë. Ishte ditë pazari. I rashë njëherë pazarit në të katër anët dhe më në fund gjeta ca dardha. E mbusha trastën dhe përsëri më këmbë mora rrugën për në Ujin e Ftohtë, në konak, të takohesha me Harillën.

Rrugës mendoja:

- Sikur të ha edhe unë një kokërr!

Po nuk hëngra, se pastaj ç'do të mbeteshin për shitje? Edhe Harilla, sapo më pa me trastën në dorë, më tha duke qeshur:

- Mos ke ngrënë ndonjë...

Unë i bëra be dhe rrufe.

Ai më ra krahëve:

- Të besoj, - më tha.

Kur shkuaam në shkollë, bijtë e bajraktarëve dhe të të pasurve, që kishin ngrënë dhe kishin pirë mirë, donin edhe pemë. Ne i kishim numëruar që përpara dardhat dhe na dilte se, nga të dy lekët, do të nxirrnim një lekë fitim. S'ishte fitim i vogël!

- Me lekun që do të fitojmë, - i kisha thënë Harillës, - do të blejmë dardha të tjera dhe do të fitojmë gjysmë leku. Kështu, do të na bëhet një lek e gjysmë.

Filluam të bënim veprime aritmetike, ashtu si kishim mësuar në shkollë. Sipas llogaritjeve tona, dilte se edhe pesë muajt e shkollës që na kishin mbetur, do t'i kalonim me fitimet që do të kishim nga shitja e dardhave dhe e mollëve. Kështu që s'kishim nevojë të kërkonim gjë nga shtëpia. Po edhe sikur të kërkonim, kush mund të na jepte? Prindët nuk kishin për vete!

Madje, - i thashë unë një ditë Harillës, - ne mund të kursejmë që të ndihmojmë edhe familjet tona, se edhe ato janë më keq se ne.

Në fillim qeshëm që të dy me këtë mendimin tim, por më vonë Harillës i pëlqeu shumë fjala ime.

Kështu filluam nga "tregtia". Herë shkoja unë në Vlorë, herë shkonte Harilla. As unë as ai nuk vinim në gojë asnjë kokërr mollë apo dardhë, se mendonim që do të na uleshin fitimet!

Jeta e rëndë na kishte bërë të mendonim si njerëz të mëdhenj. Nuk është mosha që e rrit njeriun, po mendimet, njohja e jetës, lufta me jetën, të përpjetat dhe të tatëpjetat e jetës.

Unë gjeta edhe një burim tjetër për të shtuar të ardhurat. Në shkollën tonë ishte edhe një djalë, djali i një të pasuri, i një sipërmarrësi të peshkut në Pashaliman. Ai nuk shkonte mirë me mësim. Quhej Hajredin. Hajredini më zuri në rrugë dhe më tha:

- Po të më bësh dy herë mësim në ditë, do të të jap një kile peshk të kripur si shpërblim.

Unë aty për aty nuk i dhashë përgjigje, se s'dija ç'ti thosha. Po, në mbrëmje, kur u takova me Harillën, ia tregova këtë ngjarje. Ai më ra krahëve dhe më tha:

- Kape e mos e lër. Herë i jap unë mësim, herë i jep ti. Ai është kokëtul dhe ka nevojë. Pastaj edhe djalë sipërmarrësi është.

- Mirë, po ç'do ta bëjmë peshkun?

- E hamë...

- Një kile peshk të kripur në ditë të hamël! Po ku do ta gatujmë?!

- Herë e hamë për vete, herë e shesim te ndonjë familje këtu pranë. Pyes unë dhe gjej ndonjë familje nevojtare.

Dhe Harilla pyeti; gjetëm edhe vendin ku ta shisnim peshkun. Tani na u grumbulluan shumë punë bashkë. Mësimë kishim për të përgatitur, mollë edhe dardha do të blinim dhe do të shisnim, mësim Hajredinit do t'i jepnim...

S'kemi ç'të bëjmë, do të përpiqemi. Me luftë merret kalaja, na kishte thënë mësues Musai, kur na kishte folur për proverbat.

\* \* \*

Kuptohet se s'kishim elektrik në konakun ku banonim. Kishim një llambë me vajguri dhe atë e ndiznim natën. Kishim kujdes të mos shpenzonim shumë vajguri. Në verë e kishim mirë, se mësonim ditën, po në dimër, kur nata është e gjatë dhe dita e shkurtër, do të mësonim natën dhe na duhej më shumë vajguri!

Një mbrëmje unë isha i lodhur dhe doja të flija. Harilla mësonte. I thashë:

- Nuk e fikim llambën dhe flemë?

- Jo, kam ende për të mësuar.

- Mëso nesër në mëngjes. Ashtu si thua ti, shpenzojmë shumë vajguri.

- Po unë nuk mund të fle pa mësuar.

- Do të bësh si të them unë!

- Kush të pyet ty!

- Si kush më pyet mua?! E kemi përgjysmë. Ti e ke blerë?!

- Unë do mësoj dhe ti bëj si të duash!

- Fike, të thashë!

Për të parën herë bëja fjalë me Harillën. Gjatë gjithë kohës që ishim bashkë si s'i thamë plaç me gojë njëri-tjetrit!

U nxeëm. Asnjëherë s'ishim nxehur aq shumë, as unë, as ai.

- Fike!

- S'e fik!

Dhe unë hodha dorën ta tërheq llambën dhe ta fik.

Edhe ai hodhi dorën të ma tërhiqte.

Tërhiq unë, tërhiq ai, ra poçja e llambës përdhe; vajguri u shpërnda në dyshe-menë e vjetër dhe mori zjarr. Për pak u dogjëm të gjallë brenda. Hodhëm velenxat sipër zjarrit dhe i shkelëm me këmbë. Zjarri u shua.

Pastaj ndenjëm që të dy përballë njëri-tjetrit pa folur.

Nuk na zuri gjumë atë natë.

Sa net të tjera kishim ndenjtur kështu pa gjumë!

Në mëngjes u përgatitëm për në shkollë dhe, duke shkuar rrugës, i thamë njëri-tjetrit duke u përqafuar:

- Ç'ishte ai budallallëk që bëmë mbrëmë!

Nga ajo ditë miqësia jonë u forcua edhe më shumë.

Shkollën e mbaruam që të dy bashkë me notën “shumë mirë“.

Jeta na rrahu që të dyve.

Kaluam uri, ecëm zbathur e zhveshur, patëm shumë pengesa gjatë rrugës; shtëpia që gati të na zinte kaq herë. Kushedi sa herë na rektiu zemra! Net të gjata dimri kaluam nën haure e karakatina, po më në fund jeta fitoi.

Vetëm ai që nuk përkulet përpara vuajtjeve fiton në jetë.

*Aleks Çaçi*

## **Shënim**

Ky tekst është marrë nga novela “Na hoqën çatinë“. Aleks Çaçi këtu paraqet jetën e vështirë të një familjeje të varfër, e cila që e detyruar të punonte te qehaja. Të dy shokët patën të njëjtin fat, gjë që shihet edhe nga teksti i zgjedhur.



### **Fjalë dhe shprehje**

*drilloje* – lloj stofë i leshtë

*trastë* – torbë

*bijtë e bajraktarëve* – fëmijët e të pasurve



### **Komentojmë tekstin**

Cilat janë personazhet kryesore të kësaj novele?

Kush u kish thënë: “Shko nga të duash, gjeje vetë fatin, s’kemi si të të ndihmojmë“?

Ku banonin këta dy shokë?

Si u gjendën, për t’i përballur problemet ekonomike?

Cili që shkaku që dy shokët u grindën ndërmjet tyre?

Cila është ideja kryesore e këtij teksti?

Mundohu të gjesh porosinë e autorit në këtë novelë.

**Novela** është lloj i prozës, më i shkurtër se romani, por më i gjatë se tregimi apo rrëfenja. Ajo ka një numër të kufizuar personazhesh; ngjarjet zhvillohen rrotull një motivi qendror dhe arrihet në një përfundim të befasisëm. Novela ka ngjashmëri me përrallën, veçanërisht kur tek ajo gërshetohen elementet reale me ato fantastike. Në novelë rrëfimi i autorit mbizotëron në raport me dialogun.



# NË QYTETIN E LILIPUTËVE

Nuk e di se ç'u bënë shokët e mi të barkës, ata që iu qepën shkëmbit, dhe ata që mbetën në anije ; po besoj se u mbytën të gjithë: sa për mua, notova më tym dhe për fat më shtyu era nga ana e tokës. U shtriva në një lëndinë, ku bari ishte fare i njomë dhe i butë, si mëndafshi; dhe pas një çikë më mbërtheu një gjumë i rëndë, që s'e kam bërë kurrë në jetë; dhe fjeta pothuaj nëntë orë, sa kur u zgjova, dielli ishte ngritur lart. Bëra të ngrihem, po nuk u ngrita dot; i shtrirë siç isha në kurriz, ndjeva këmbët e krahët i kisha lidhur nga të dy anët për tokë; po kështu ishin lidhur edhe flokët, që i kam pasur të gjatë e të trashë. Madje pashë plot fije shumë të holla rreth trupit, nga sjetullat e gjer te kofshët.

Papritmas ndjeva se më lëvriu diçka te këmba e majtë, nga ku më kaloi ngadalas në kraharor e po më ngjitej pak nga pak në mjekër. Pashë një njeri të gjallë, që nuk e kishte shtatin as gjashtë gishtërinj të gjatë që mbante në duar një hark e një shtizë. Po në këtë kohë pash se e ndiqnin pas edhe të paktën nja dyzet të tjerë. I habitur siç mbeta, lëshova ca britma aq të forta, sa të gjitha ato krijesa të vockla u larguan të llahtaritura.

Kur pushuan britmat, dëgjova njërin prej tyre që thirri:-Tolgo Fonak- dhe në atë çast ndjeva se ma shpuan dorën e majtë më se njëqind shigjeta të vockla e të holla si gjilpëra. Pastaj lëshuan në erë një breshër tjetër shtizash që më binin në trup, sido që nuk i shikoja, dhe plot të tjera më nguleshin në fytyrë, që përpiqesha t'i largoja me dorën e djathtë.

Kur e panë ata kocomicë se po rrija urtë, i prenë të shtënat, po nga zhurma e poterja, që sa vinte e shtohet, kuptova se edhe ata po roitnin si bleta. Përballë veshit të djathtë, për më tepër se një orë, dëgjova zhurmë njerëzish që punonin. Kur ktheva kokën nga ajo anë, aq sa më lejonin kunjët e kordonat, pashë se kishin ngritur një tribunë ndonjë këmbë e gjysmë të lartë që mund të nxinte nja katër nga këta xhuxhmaxhuxhër - dhe nja dy a tri palë shkallë për t'u ngjitur. Së andejmi njëri prej tyre, që dukej njeri me rëndësi, më mbajti një ligjëratë të pasosur, që nuk e kuptova fare.

Iu përgjigja me pak fjalë, po me një theks të përlur, duke ngritur dorën e majtë dhe sytë ndaj diellit, sikur t'i qaja hallin se po vdisja urie, meqë s'kisha vënë gjë në gojë prej shumë orësh, para se të mbytej anija.

Ai zbriti nga tribuna, urdhëtoi të vendosnin plot shkallë në të dy brinjët e mia, nëpër të cilat u ngjiten ndo njëqind veta, që pastaj m'u drejtua nga goja, të ngarkuar me kofina plot me mish, që ishin grumbulluar e dërguar atje me urdhër të mbretit, me t'u marrë vesh se kisha arritur unë. Vura re se kishte çdo

lloj mishi, nga kafshë të ndryshme, po nuk i dallova dot se ç'ishin kur i shijova. Kishte kofshë, shpatulla, brinjë që dukeshin si prej dashi, të gatuar mirë, por më të vockla se krahët e një laureshe. Gllabëroja njëherësh nja dy a tri të atilla bashkë me tri bukë të mëdha, sa plumbat e pushkës. Tek m'i binin gjithë këto të ngrëna, ata dukeshin shumë të habitur e të mahnitur, që shikonin trupin tim sa një mal dhe atë urinë time të pasosur.

Bëra një shenjë tjetër për t'u treguar se kisha etje; duke parë se s'kisha të ngopur në të ngrënë, ata menduan se edhe etja ime nuk mund të shuhej lehtë dhe gjetën një marifet të bukur: ngritën me mjeshtëri një nga vozet më të mëdha që kishim sjellë me verë, e rrokullisën gjer te dora ime, pastaj e ngritën më këmbë dhe i hapën grykën. E rrëkëlleva njëherësh pa mundim, se nuk kishte më tepër se një gjysmë litër; i përngjante disi verës së Burgonjës, por ishte edhe më e shijshme. Më sollën një fuçi tjetër, e piva dhe ua bëra me shenjë të më binin ca të tjera, po i kishin mbaruar. Si panë që bëra gjithë këto mrekullira, zunë të thërrisnin nga gëzimi dhe të hidhnin valle mbi krahërorin.

Pas një copë here, kur panë se isha ngopur, para meje doli një nga të parët e vendit, që e kishte dërguar Madhëria e tij, mbreti. Ai e mori vesh që i lutesha të më zgjidhnin; më dha të kuptoja se do të më shpinin ashtu siç isha, po duke m'u zotuar me ca shenja të tjera se do të më jepnin të haja e të pija sa të më shihnin sytë, dhe se do të më mbanin shumë mirë.

Pas pak kohe dëgjova një breshër duartrokitjesh, që ndërpritej dendur nga brohorimat.

Ai popull e ndan qimen më katërsh në matematikë e në mekanikë, shkencë që mbreti i tyre i nxit e i përkrah. Perandori ka ca makina të mrekullueshme për mbartje, që mund të ngrënë anije lufte (nganjëherë nëntë këmbë të gjata) dhe t'i shpien nga pyjet ku janë ndërtuar, gjer në bregdet. Pesëqind inxhinierë e zdrukthëtarë u ngarkuan të stisnin një prej këtyre makinave, që të më mbartte mua. Ishte një qerre shtatë këmbë e gjatë e katër e gjerë, që mbahej mbi njëzet e dy rrota, e ngritur nje gjysmë këmbë nga dheu. Një mijë e pesëqind nga kuajt më të mirë të perandorit më tërhoqën gjer në kryeqytet, sipas nesh, nja gjysmë milje më tutje.

Ecëm pa reshtur tërë ditën e ditës dhe natën e gdhiva në fushë, me pesëqind roja përçark, gjysma me pishtarë dhe gjysma me harqe dhe shigjeta, gati të më gjuanin po të merrja arratinë. Ndaj të gdhirë vazhduam udhën dhe aty nga dreka arritëm afër kryeqytetit. Gjithë oborrtarët, me perandorin në ballë, kishin dalë të më shikonin, po oficerët madhorë nuk e lanë Madhërinë e tij ta vinte kokën në trastë, duke hipur mbi trupin tim.

Nuk e them dot me fjalë habinë e poteren e popullit, kur më panë që u ngrita e po barisja. Meqë vargonjtë e këmbës së djathtë ishin afro gjashtë këmbë të

gjata, jo vetëm mund të veja e të vija në një hapësirë gjysmë rrethi, po kisha mundësi të hyja barkas gjer te dera e madhe dhe të shtrihesha në faltore.

*Xhonorat Swift*

## **Shënim**

Kjo pjesë është marrë nga libri "Udhëtimet e Guliverit" i shkrimtarit anglez Xh. Swift. Në kapitullin e parë të librit flitet për udhëtimet e personazhit kryesor, Guliverit, të cilit i mbytet anija dhe ai gjendet në një ishull ku jetonin liliputët, njerëz me shtat shumë të vogël. Në këtë libër gërshetohen bukur ngjarjet reale me ato fantastike.



### **Fjalë dhe shprehje**

*liliput-i* – njeri me trup të vogël, gishto

*iu qepën shkëmbit* – u ngjitën shkëmbit

*pas një çike* – pas pak

*poter/e-ja* – zhurmë e madhe, shamatë, e shkakuar nga zërat e njerëzve

*po roitnin* – këtu: po shtoheshin

*kocomi-u* – personazh përralle, një fëmijë i zgjuar, por me trup të vogël

*tribun/ë-a* – vend i ngritur e i zbukuruar para një sheshi, ku rrinë udhëheqësit

*kofin/i* – kosh i madh i thurur me purteka, që përdoret për të mbajtur fiq, rrush

*gjetën një marifet* – gjetën një mënyrë të përshtatshme të bukur

*ai e ndan qimen* – ai është shumë i zgjuar dhe i zoti

*mbart* - shpie diçka nga një vend në tjetrin

*faltor/e-ja* – vendi ku falen besimtarët

*këmb/ë-a* – masë gjatësie, një këmbë është e barabartë me 30,5 centimetra.



### **Komentojmë tekstin**

Çfarë kishte ndodhur me barkën dhe me shokët e Guliverit?

Çfarë ndjeu dhe çfarë pa Guliveri kur u zgjua nga gjumi?

Si arritën ta ushqenin dhe ta transportonin atë liliputët?

Përse liliputët e ndaluan luftën kundër Guliverit?



### **Detyrë**

Lexojeni romanin në tërësi.

# LETTRAT DHE LLOJET E LETRAVE

Letra është një lloj njoftimi me shkrim që shkruesi i bën marrësit.

Ja disa shembuj të letrave të llojeve të ndryshme: urime, falënderime, kërkesa, njoftime, ftesa, etj

Kuvendit të Qytetit Zyra e lojërave	----- adresa
I nderuar zotëri, Po ju drejtohem me një ankesë për këndin e lojërave në rrugën Park. Vetëm javën e fundit kanë ndodhur dy aksidente. Vëllai im Albi, ra nga rrëshqitësja dhe theu krahun. Do të isha shumë i kënaqur, po të bënit diçka për këndin tonë të lojërave.	----- përshëndetje
Me respekt Beni Rusi	----- përmbajtja e ankesës
	----- mbyllja dhe nënshkrimi

- Letër falënderimi

<i>Shkup, 2 prill 1996</i>
<i>E dashur Blerta</i>
<i>Albumi i fotografive që ma dërgove për ditëlindje, ishte një dhuratë shumë e përshtatshme. A e beson që deri tani është mbushur pothuaj gjysma? Mamaja më lejoi që, për të festuar ditëlindjen të ftoja disa shokë e shoqe, të shtunën, të qëndronin një natë në shtëpinë tonë. Ishte një natë e mrekullueshme. U zëbavitëm shumë. Arta na bëri disa fotografi. Të premtoj se do të dërgoj ndonjë. Për ditëlindje më sollën gjithashtu një radio të re, tri albume dhe një palë xhinse. Ishte një ditëlindje shumë e bukur.</i>
<i>Faleminderit shumë për dhuratën.</i>
<i>Të përqafoj</i> <i>Besa</i>

- Ftesa

Shkup, 29 mars 1996

E dashur Mimoza

Të ftoj të marrësh pjesë në festën që do të organizoj për ditëlindje, të shtunën më 31 mars, në orën 5 pasdite.

Mbrëmja do të bëhet në shtëpinë time.

Shpesoj se do të vish.

Të përshëndes

Lulja

### **Telegrami**

Telegrami është njoftim ose lajm që jepet me anën e ndërlidhjes telegrafike; fletë që përmban këtë njoftim a lajm. Mund të jetë telegram përshëndetje, urimesh, falënderimesh, ngushëllimesh etj.



# FILMI DHE KINEMATOGRAFIA

Filmi është lloj i veçantë i artit, i cili jepet para publikut. Filmin e kanë zbuluar vëllezërit Lymier në Francë më 1895. Deri më 1927 filmat kanë qenë pa zë. Sipas gjatësisë, filmat ndahen në:

- a. Të gjatë - mbi 2500 m
- b. Të mesëm deri më 2500 m
- c. Të shkurtër deri më 600 m

Sipas gjinisë, ndahen në: **artistikë, dokumentarë dhe vizatimorë** (të animuar). Brenda gjinive pastaj ndahen edhe llojet e filmave artistikë: **historik, kriminal, shkencoro-popullarizues, dramatik, komik** etj.

**Zhurnali i filmit dhe reportazhi filmik** janë lloje të gazetarisë filmore.

## **Sinopsisi**

- Është paraqitja koncize e temës së filmit. Sinopsisi është faza paraprijëse e **skenarit**.

## **Skenari filmik**

- Është plani i përpunuar i veprimit të filmit. Skenari është teksti, në bazë të të cilit incizohet filmi. Shkrimtari i skenarit quhet **skenarist**. Pasi të jetë pranuar sinopsisi, skenaristi nis ta shkruajë skenarin. Pasi të jetë pranuar skenari, shkruhet **libri i incizimit**, i cili është rezultat i bashkëpunimit midis regjisorit dhe skenaristit.

## **Sekuenca**

- Është njësia më e vogël dhe më e shkurtër e montimit të filmit, e cila është e barabartë me **skenën** dhe **pamjen** në veprën dramatike teatrore.

## **Kuadri filmik**

- Është pjesë e filmit e incizuar me një hap të pandërprerë (me një veprim të pandërprerë) të kamerës. Filmat pa zë incizoheshin me kuadro të shkurtra, kurse filmat bashkëkohorë me kuadro më të gjatë.

## **Regjisor**

- Është krijuesi i shfaqjes teatrore ose i veprës filmike. Ai është udhëheqësi artistik i ekipit teator ose i skenarit filmik (si dhe i dramave televizive dhe radiodramave). Në incizimin e filmave dhe dramave televizive regjisorit për-cakton radhitjen e incizimit të skenave dhe të sekuencave.

Ndriqimi dhe muzika janë elemente përbërëse të kinematografisë.

# GAZETAT DHE REVISTAT

- Gazetat dhe revistat janë si organe informuese.
- Revistat janë një lloj i masmedias. Po ç'është masmedia?
- Vëreni me kujdes skemën e mëposhtme:



Llojet e ndryshme të masmedias njihen më mirë, kur u përgjigjemi katër pyetjeve: **kush?**, **çfarë?**, **si?**, **kujt?**

- Punë me grupe.

Provoni të hartoni një revistë për të rinj që u përgjigjet interesave dhe kërkesave tuaja. përpiloni në fillim një listë temash.

## Mbani mend

- Revista janë një lloj i masmedias. Ato janë organe informuese.
- Për të njohur më mirë një revistë, duhet t'u përgjigjeni pyetjeve: **Kush?**, **Çfarë?**, **Si?**, **Kujt?**

Gazetat dhe revistat i përgatisin:

- redaktori përgjegjës,
- gazetarët,
- lektorët
- redaktori teknik,
- ilustratori, etj.

NJOHURI  
PËR GJUHËN



# PROBLEME TË DREJTSHKRIMIT TË ZANOREVE DHE TË BASHKËTINGËLLOREVE

## A. Drejtshkrimi i zanoreve

### Drejtshkrimi i zanoreve e dhe ë

Vëreni fjalët e shkruara me të zeza.

...Gjatë gjithë jetës mua më ka shoqëruar një frikë e pashpjegueshme, një **brengë** e **brendshme**, thujse një makth. Kryeneç dhe i mbyllur në të gjithë situatat e vështira të jetës jam futur në kafkullin tim dhe çdo goditje të fatit e kam përballuar jo vetëm pa u **trembur**, por sidomos edhe pa u emocionuar.

Fjalët që kanë **e** të theksuar para bashkëtingëlloreve **m, n, nj** shqiptohen dhe shkruhen me **e**: vend, i shtrembër, qendër, shenjë, trembur, brengë, zemër, zemëroj, qendër, e enjte, shenjë, etj.

**Formoni fjalë të tjera me fjalët mend, vend, emër.**

**Lexoni me zë fjalët:** i pashembullt, kuvend, përmend, i ndenjtur. **Në cilën zanore bie theksi i fjalës? Shkruajini ato.**

### **MBANI MEND**

Shkruhen me **e** dhe jo me **ë** fjalët që kanë **e** të theksuar para bashkëtingëlloreve **m, n, nj**: **shenjë, qendër, shëmbëllej** etj.

Shkruhen me **ë** dhe jo me **e** fjalët që në dialektin e veriut kanë **â** (a hundore) në vend të **ë**-së: **shkëmb, dëm, dhëmb-i, kënd, këngë** etj.

Por me **ë** shkruhen këto fjalë: **shënoi, shënim, qëndroi, qëndrim** etj.

## *Ushtrime*

Në vend të pikave vini zanoren që mungon dhe shkruani nga një fjali me secilën prej tyre:

v...nd\_\_\_\_\_

më dh...mb dh...mbi\_\_\_\_\_

q...ndër\_\_\_\_\_

(i) shtr...njtë\_\_\_\_\_

**Gjeni fjalët e shkruara gabim. Shkruani saktë trajtën e tyre dhe thoni si janë formuar.**

Gjëja më e shënjtë, më e pastër dhe më e shtrënjtë, e ndodhur brënda njeriut, nuk i nënshtrohet asnjëherë shkatërrimit. Stresi u përpoq të gjente shenjat e çmëndurisë në sytë e saj, por ata, si edhe më parë, ishin të zbrazur nga gjithçka.

Ai i shembëllente shumë t'et.

Kuvendi i burrave kishte filluar.

Gjëndja ishte e tensionuar. brënda bënte shumë vapë.

**Shkruajini këto vargje të Naim Frashërit sipas drejtshkrimit të sotëm të gjuhës standarde shqipe.**

Zemra jote në kraharort tënt

Është hekur brenda n'ergjënt

Dhe në linj' atykraharuar

Si ndë dhe gur'i paçmuar.

**Zanorja ë e theksuar në trup të fjalës**

Shkruhen me **ë** dhe jo me **e** fjalët që në dialektin e Veriut kanë â hundore në vend të **ë** – së, p.sh.: **běj, dëm, dhëmb, këngë, këngëtar, i(e) ëmbël, lëmë, zë, thëllëzë** etj.

Me **ë** shkruhen edhe fjalët: **shënoj, shënim, qëndroi, qëndrim, shëmbëllej**.

P.sh.: Mbjaj shënim nxënësit që qëlluan në shenjë.

Shkruhen dhe shqiptohen me **ë** të gjitha fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara nga këto fjalë: **dëm, lëng, këmbë, dhëndër, këngë** etj. P.sh.: **dëm-dëmtoj, dëmtim, i dëmtuar**.

lëng- lëngëzgj, lëngëzim, i lëngëzuar etj.  
këmbë- këmbësor, këmbadoras, këmbalec.  
dhëndër- dhëndëroj.  
këngë-këngëtar etj.

## Zanorja u

Me u shkruhen në të gjitha rasat emrat dhe mbiemrat që mbarojnë me –  
**ull, ur**, p.sh.: **akull, kukull-kukulla, kungull, flutur, fluturim, shembull, shembullor, i bukur, hekur** etj.

Por nuk shkruhen me u fjalët: **tingëllon, tingëllim, bashkëtingëllore**, si dhe **shëmbëllej**.

Shkruhen dhe shqiptohen me y dhe jo me u fjalët: **frytdhënës, i frytshëm, trysni, virtyt, mysafir, mysliman, lyp, zymbyl** etj.

Shkruhen me i dhe jo me y fjalët: **ai, krimb, krip, kripë, qilim, bilbil, hip, hipje ( jo hypje)** etj.

## *Ushtrime*

**Shkruani si duhet fjalët e mëposhtme:**

nânë, çashtje, shkâmb, dhândër, i këndshëm.

## Grupet e zanoreve

Gjuha jonë përveç zanoreve ka edhe grupe zanoresh. Grupet e zanoreve shkruhen dhe lexohen të plota. p.sh.:

**ua:** muaj, duar, buall, dragua, grua, ftua etj.:

**ye:** lyej, ngjyey pyes, pyetje, arsyey, i arsyeshëm, fyell, fyej, krye etj.;

**ue:** mësues, dëgjues, ndërtes, i gëzueshëm, i shoqërueshëm etj.;

**ie:** diell, miell, qiell, e diel, diellor, fier etj.

Në grupet e tjera të zanoreve që kanë i të patheksuar (ai, oi etj.), kjo duhet të shkruhet dhe të shqiptohet me i (dhe jo j), p.sh.: **vëllai im, babai im** dhe jo vëllaj im, babaj im; **ftoi** e jo ftoj.; **shkroi** e jo shkroj; **punoj** e jo shkroj etj..

## B. Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve

Rikujtohuni!

Ç'janë bashkëtingëlloret? Si ndahen ato?

Bashkëtingëlloret e zëshme **b, d, dh, g, gj, v, z, zh, x, xh**, në trup të fjalës ose në fund të saj shqiptohen si të zëshme, p. sh.:

**elb** dhe jo elp;

**gjemb** e jo gjemp ose gjëmp;

**fund** e jo funt;

**mund** dhe jo munt;

**shkund** e jo shkunt ;

**bredh** e jo breth;

**gardh** e jo garth;

**zbardh** e jo zbarth;

**djeg** e jo djek;

**burg** e jo burk;

**varg** e jo vark etj.

**qengj** e jo qenq;

**u përgjigj** e jo u përgjiq;

**zogj** e jo zoq;

**hidhte** e jo hithte; por:

**mëngjes** e jo mëngjez etj.

### Bashkëtingëlloret s, z në fillim të fjalës

Rikujtohuni!

Ç'janë parashtesat? Përse shërbejnë ato?

Lexoni me kujdes fjalitë e mëposhtme dhe përqendrohuni në fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Pasi punoi shumë, vendosi të çlodhej pak nën hijen e një arre.


Po të mos e vazhdonte punën edhe më tej, asgjë nuk do të **zbulonte**.

Ai qe **skuqur** shumë dhe nga **zemërimi** i madh filloi t'i merrej goja.


Dita kishte **zbardhur**, por askush nuk po lëvizte.

Fjalët që fillojnë me **s-, z -** nistore, të ndjekura nga një bashkëtingëllore, shkruhen kështu:

me **s -**, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e shurdhët **f, k, p, q** ose nga një bashkëtingëllore e tingullt **m,n,l**, p.sh.:




me z-, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme b, g, gj, v:




### Bashkëtingëlloret sh, zh, ç në fillim të fjalës

Fjalët që fillojnë me sh, zh, ç shkruhen kështu:


me **sh-**, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e shurdhët (**f, k, p, q, t, th**), p.sh:



me **zh-** kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme **b, d, g, gj, v:**



c) me **ç** kur kjo ndiqet nga një zanore ose një bashkëtingëllore e tingullt: **l, ll, r, rr, m, n, nj, j)**



**Kini kujdes!**

Shkruhen me **sh** – fjalët **shmang, shlyej, shndërroj, shndrit** dhe ato që formohen prej tyre.

## Ushtrime

1. Në vend të pikave vini shkronjën që duhet: s, sh, z, zh, ose ç.

.....verdh, .....fungjer, .....doganoj, .....këmbej

.....rrenjos, .....madhim, .....mbrapsje,.....mangie, .....ndritnin.

2. Lidh secilën nga fjalët e shtyllës së parë me të kundërtën e saj në shtyllën e dytë:

vesh	çorganizoj
organizoj	zbërthej
mbërthej	zhvesh
bllokoj	zhbllokoj
rregulloj	çrregulloj

Shkruani nga tri fjalë të formuara me secilën nga parashtesat:

S.....

Z.....

Ç.....

sh.....

zh.....

## Drejtshkrimi në rastet e takimit të bashkëtingëlloreve

Në gjuhën shqipe, përveç shkronjave të thjeshta kemi edhe dyshkronjësia që shënojnë një tingull si: **dh, gj, ll, nj, sh** etj.

Ndonjëherë qëllon të takohen shkronjat **g** ose **n** me **j** dhe për të mënjeluar shqiptimin e këtyre shkronjave si një tingull i vetëm **gj** ose **nj**, në vend të **j** shkruhet **i**: **djegje, shmangie, parathënie, rënie, marrëdhënie** etj.

Kur takohen **d** me **t** ose **t** me **sh** (në formim fjalësh), shkruhen dhe shqiptohen të dyja bashkëtingëlloret, p.sh.: **i dyqindtë, i argjendtë, lindte, i përshtatshëm, i sotshëm, u rritsh, arritsha** etj.

Kur takohen dy bashkëtingëllore të njëjta ato ruhen dhe shqiptohen të dyja:

Në të **pyettë** dikush përgjigju. E **gjettë** e mira. Vizato një trekëndësh kënddrejtë.

Kur takohen shkronjat **l** dhe **r** si dhe **r** me **rr** shkruhet vetëm **ll** ose **rr**. P.sh.: **përreth, dembellëk, hamallëk.**

## Grupet e bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng, ngj**

Lexoni me vëmendje vargjet e këngës popullore dhe dalloni grupet e bashkëtingëlloreve.

Në mëngjes pa zbardhur drita  
dëgjova një zë u ngrita.....

- Më beso moj grykëzënë  
ta dish ç`më ka gjetur mbrëmë  
mu shkullnë dhentë e mu trembnë  
gjesdisa malin me këmbë.....

Grupet e bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng, ngj** shkruhen gjithmonë të plota si në fillim, ashtu e në trup dhe në fund të fjalës, p. sh.:

**mb:** mbaj, mbesë, mbjell, mbush, mbeten; i ëmbël, këmbë, kumbull, thembër; gjemb, humb, krimb, plumb, shkëmb, shkumb, thumb etj;

**nd:** ndaj, ndej, ndërmarre, ndriçoj; andej, këndoj, prandaj, përmendesh; fund, kuvend,, mend, vend, përmend, shkund etj;

**ng:** ngacmoj, ngarkesë, ngel, ngroh; brengë, këngë, kungull, mëngë, shtëllungë, tingull etj.; bung, cung, trung, peng, shmang etj.

### ***Ushtrime***

Shkruani nga dy fjalë që të kenë grupet e bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng, ngj.**

U vini fjalëve të mëposhtme njëriën nga bashkëtingëlloret **s, sh, z, zh, dhe thoni cilat nga këto janë antonime:** vendos, qetësoj, fryj, armatos, lodhen, dukem, përdorim, dredh, paguaj, këput, këmbej, prish, lirim, bllokoj, orientoj, rregullim, thur.

Gjeni nga dy fjalë që janë formuar me ndihmën e parashtesave **sh, zh, ç** dhe krijoni me to nga një fjali. (Përdorni “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”).



## Formoni fjalë duke i lidhur me shigjetë pjesët përbërëse:

mos	shitës
kujdes	herë
shpesh	je
mish	sulmim

Në vend të pikave vini shkronjën e duhur dhe formoni fjali me secilën fjalë:

dhën....e, qen...e, shmang...e, ngrën..e, parathën..e, shkupian...a., biolog...a.

## Disa probleme drejtshkrimore të shumësit të emrave dhe të mbiemrave

Rikujtohuni!

Si e formojnë shumësin emrat dhe mbiemrat?

A keni hasur në raste të tilla kur emrat e gjinisë mashkullore në shumës e ndryshojnë gjininë?

A keni hasur emrat të gjinisë mashkullore që e kanë trajtën e shumësit si të njëjësit?

Keni mësuar se emrat, sidomos ata të gjinisë mashkullore, shumësin e formojnë në mënyra të ndryshme. Si me mbaresën:

- **a**: një lis – ca **lisa**,
- një burrë - ca **burra**,
- një cilindër-ca **cilindra**;
- me **ë**: një qytetar – ca **qytetarë**,
- një tetovar – ca **tetovarë** etj.

Por, kemi edhe emra mashkullorë që në njëjës in e pashquar mbarojnë me

- **ës, -ues, -yes**, trajtën e shumësit e kanë njësoj si të njëjësit, p.sh.:
- një nxënës – disa **nxënës**,
- një lexues – disa **lexues**,
- një gostivaras – disa **gostivaras**,
- një rrëfyes – disa **rrëfyes** etj.

Kini kujdes!

Të gjithë këta emra, në trajtën e shquar në emërore dhe kallëzore, para mbaresës – **të** marrin një – **i** për lehtëshqiptim: nxënësit, lexuesit, gostivarasit, rrëfyesit etj.

Emrat dhe mbiemrat që mbarojnë me – **ër, ërr, -ël** në numrin shumës, në trajtën e shquar e rrëzojnë **ë-në**, p.sh.:

një **emër** i ri – disa **emra** të rinj,  
një **kodër** e ulët – disa **kodra** të ulëta,  
një mëngë e **shkurtër** – disa mëngë të **shkurtra**.

Plotësoni me trajtën e numrit shumës:

një pupël zogu – disa .....  
një lodër e vogël – disa .....  
një kokërr e vogël – disa .....

Një numër emrash kanë dy trajta shumësi, sipas kuptimeve të ndryshme të emrit, p.sh.:

Emri **pikë** në shumës përdoret edhe në formën **pikat**, me kuptim të një sasive fare të vogël lëngu: **pikat e shiut** dhe pikët me kuptim vlerësimi në garat sportive: skuadra jonë i **fitoi pikët**; klasat – shtresat a grupet e mëdha të njerëzve dhe klasët në shkollë: **klasët e ulëta** të shkollës fillore.

Disa emra femërorë që në njëjësin e pashquar mbarojnë me –i, -e, -a ose –o të theksuar, si edhe me –e, -o të patheksuar e kanë trajtën e shumësit si të njëjësit, p.sh:

një **qersh**i – ca **qersh**i, një tepsi – ca tepsi;  
një **ide** – ca **ide**, një rrufe – ca rrufe, një rrëke - ca rrëke etj;  
një **kala** – ca **kala**; një shaka - ca shaka, një bela- ca bela etj.;;  
një **byro** – ca **byro**; një tablo – ca tablo etj.;;  
një **anije** – ca **anije**; një lule – ca lule, një shishe – ca shishe etj;  
një **depo** – ca **depo**, një pallto – ca pallto, një triko – ca triko etj.

Emrat mashkullorë që e formojnë shumësin me mbaresat – e, - ra, **e ndryshojnë gjininë në numrin shumës**. Në gjininë femërore vihen edhe mbiemrat që i përcaktojnë në shumës:

një **vend i bukur** – ca **vende të bukura**,  
një **mal i lartë** – ca **male të larta**,  
një **mall i lirë** – ca **mallra të lira**,  
një **fshat i elektrifikuar** – ca **fshatra të elektrifikuara**,  
ujë **i ftohtë** – ujëra **të ftohta**.

Gjeni edhe ju shembuj të tjerë dhe formoni fjali me ta.

# PËRDORIMI I DREJTË I NYJAVE

## Nyjat e përparme te përcaktorët emra

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni trajtën e nyjës së përparme.

Albana është nxënëse **e** klasës **së** tetë.

Ajo mban një bluzë **të** bukur.

Kur e vesh bluzën **e** kuqe, duket edhe më **e** bukur.

Ia dhashë librin një shoku **të** fëmijërisë.

Emrat e rasës gjinore shkruhen me nyjë **të** kur ndodhen pas një emri mashkullor në gjinore, dhanore, rrjedhore të shquar dhe **së**, kur ndodhen pas një emri femëror në gjinore, dhanore, rrjedhore të shquar:

Zyra e kryetarit **të** bashkësisë lokale të fshatit ndodhet afër shkollës.

U kremtua Përvjetori i shpalljes **së** pavarësisë.

Kur një emër femëror në gjinore njëjës përcaktohet nga dy e më shumë emra të bashkërenditur në rasën gjinore, emri i dytë përcaktues e të tjerët pas tij marrin nyjën **të** e jo së, p.sh.:

Në shkollat e mesme mësohet historia e Kohës **së** vjetër, **të** Mesme e **të** Re.

Sjellja e vajzës së urtë, **të** zellshme dhe **të** shkathët na mahniti shumë.

Po kështu veprohet kur kemi dy e më shumë mbiemra të nyjshëm ose numërorë rreshtorë.

Kam mjaltë të cilësisë së parë, **të** dytë e **të** tretë.

Kur dy emra në rasën gjinore përcaktojnë një emër të gjinisë mashkullore në rasën emërore përdoret nyja **i** dhe jo **e**, p.sh.:

Libri i gjuhës **i** klasës së tetë doli nga shtypi.

U caktua rendi **i** ditës **i** mbledhjes.

Por, kur përcaktojnë një emër të gjinisë femërore përdoret nyja **e**.

Fjala e nderit **e** shqiptarit, stina **e** verës **e** këtij viti etj.

### **Kini kujdes!**

Kur një emër në rasën gjinore përcakton jo një emër, por gjithë grupin emëror përdoret nyja **e**: Akademia e Shkencave e Maqedonisë dhe jo

Akademia e Shkencave të Maqedonisë p.sh.: Akademia e Shkencave e Maqedonisë do të jetë organizatore e një simpoziumi të rëndësishëm.

Kur ndeshen dy nyja **së** në rasën gjinore të emrave të nyjshëm atëherë, nyja e parë **së** zëvendësohet me **të**. P.sh. Fjalës **të së** motrës nuk ia vuri veshin. Po kthehet prej shtëpisë **të së** bijës. Kërkesat tona i përgjigjen detyrës **të së** sotmes e **të së** ardhmes.

### *Ushtrime*

**Gjeni nyjat e përdorura gabim. Shkruajini si duhet.**

1. Ajo i ngjan figurës së të Bukurës së Dheut.
2. Po kthehej prej shtëpisë së të bijës.
3. Hartimi i nxënësve së të gjashtës klasë ishte në nivel.

**Vini nyjat e përparme në shembujt e mëposhtëm:**

1. Punimet e stinës së pranverës, ....verës, .....vjeshtës do të vazhdojnë edhe sivjet.
2. Drejtoria e shkollës, lagjes,.....qytetit,.....
3. Veshjet e krahinës,.... Korçës,....., ...Dibrës, ...Mirditës dallohen njëra nga tjetra.
4. Kultura e vërtetë na çel rrugën e .... vërtetës.
5. Projekti i ndërtesës ... shkollës...kulturës...

## PËRDORIMI I SHKRONJAVE TË MËDHA

Me shkronjë të madhe shkruhen:

a) emrat dhe mbiemrat e njerëzve, epitetet ose ofiqet që janë pjesë përbërëse të tyre, si p.sh.: **Gjergj Kastrioti, Ismail Qemali, Naim Frashëri; Gavril Dara i Riu, Leka i Madh, Mark Shalëgjati** etj.;

b) emrat të përveçëm të kafshëve: **Balashi, Baloja, Rosinanti** etj.;

c) emërtimet gjeografike e territoriale-administrative: **Adriatiku, Ballkani, Drini i Zi, Sharri, Amerika Latine, Gadishulli Ballkanik** etj.;

ç) emërtimet e periudhave të ngjarjeve historike: **Rilindja Kombëtare Shqiptare, Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Kongresi i Manastirit, Lufta e Dytë Botërore** etj.;

d) titujt e librave, të gazetave, emrat e rrugëve, firmave etj., vihen në thonjëza dhe vetëm fjala e parë shkruhet me të madhe: **“Bagëti e bujqësia”, “Koha ditore”, “Bota e re”** etj.;

dh) emrat e planetëve shkruhen me të madhe: **Marsi, Jupiteri, Dielli, Hëna, Toka** etj.;

e) emërtimet e monumenteve të kulturës: **Xhamia e Jahja Pashës, Dea e Butrintit** etj.

## **Disa probleme në përdorimin e shkronjave të mëdha tek emrat e përveçëm**

a. Titujt e librave, të gazetave, dhe të firmave vihen në thonjëza dhe vetëm fjala e parë shkruhet me shkronjë të madhe: **“Koha e re”, “Fakti”, “Gazeta shqiptare”** etj. Në qoftë se fjalët e tjera brenda thonjzave janë emra të përveçëm ato shkruhen me shkronjë të madhe: shkolla **“Faik Konica”**.

b. Nyjat dhe pjesëzat e mbiemrave të huaj, përveç emrave kinezë dhe vietnamezë etj., shkruhen me shkronjë të vogël, kur jepet i plotë emri dhe mbiemri dhe me shkronjë të madhe kur jepet vetëm mbiemri: **Leonardo da Vinçi**, por **Da Vinçi, Vincent van Gog**, por **Van Gog, Jeronim de Rada**, por **De Rada**.

c. Emrat **Dielli, Hëna, Toka** kur nuk përdoren si terma të astronomisë shkruhen me të vogël: Një fëmijë pa nënë si një natë pa hënë. Perëndimi i diellit na zuri jashtë fshatit.

d. Emrat e përgjithshëm, kur përdoren për të treguar qenie të personifikuara (në fabula, përrallë etj.) shkruhen me shkronjë të madhe: **Përralla** gjet një ditë të **Vërtetën; Plaku i Vitit të Ri**; Të lumtë, o **Arbër**, se na zbardhe faqen!.

e. Emrat e përveçëm, kur përdoren për të shënuar tipin përkatës shoqëror shkruhen me shkronjë të vogël: **ciceron, donkishot**.

f. Emrat e shteteve, të partive, të organizatave, të shoqatave, të ndërmarrjeve etj., kur shkurtohen shkruhen me shkronja të mëdha, pa pika. P.sh.: **SHBA, OKB, NATO, UNESKO, FIFA**, etj.

### **Përdorimi i shkronjave të mëdha në tekste të shkruara**

a. Pas dy pikave në ligjëratën e drejtë fillohet me shkronjë të madhe, p.sh.: Populli ynë thotë: **“Trimi i mirë me shokë shumë”**.

b. Kur radhiten paragrafë të veçantë (ligje, vendime etj.) që nisin me

kryerresht dhe mbarojnë me pikë.

c. Emrat e popujve në gjuhën shqipe shkruhen me shkronjë të vogël: shqiptarët, maqedonasit, turqit, kroatët etj.

d. Datat e plota mund të shkruhen me shifra dhe me shkronja:

28.11.1912                      28 nëntor 1912

28.XI.1912                      30 mars 1996

### ***Ushtrime***

**Plotësoni fjalitë dhe vini aty ku duhet thonjëzat.**

Unë jetoj në rrugën \_\_\_\_\_

Vëllai im mëson në shkollën \_\_\_\_\_

Në televizor pashë filmin \_\_\_\_\_

**Kopjoni fjalitë dhe vini shenjat e pikësimit.**

Kaluan ditët e nxehta Dita e parë e shkollës filloi

Sa brohoritje e madhe dëgjohet Paskan ardhur disa nxënës të rinj Sa qenke rritur Ardit

Cili është atje A kanë ardhur të gjithë

Zemra i dridhej kur kujtonte vendlindje

A mos e kishte marrë malli për tingëllimën e zileve

**Shkruani nga tri fjali që të mbarojnë me pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditje.**

# PËREMRI VETOR

Rikujtohuni!

Cilat janë llojet e përemrave?

Ç`është përemri vetor?

Ç`regon përemri vetor i secilës vetë?

## Përdorimi i trajtave të plota dhe të shkurtra të përemrave vetorë

Vëreni me kujdes pasqyrën e lakimit të përemrave vetorë dhe tregoni kategoritë gramatikore të tyre.

Vetat	NJËJËS			SHUMËS		
	I	II	III	I	II	III
Rasat	unë	ti	ai, ajo	ne	ju	ata, ato
Emërore	unë	ti	ai, ajo	ne	ju	ata, ato
Gjinore	-	-	(i,e) atij, asaj	-	-	(i,e) atyre
Dhanore	mua, më	ty, të	atij, i, asaj i	neve, na	juve, ju	atyre,u
Kallëzore	mua, më	ty, të	atë, e	ne, na	ju, ju	ata, i ato, i
Rrjedhore	(prej) meje	(prej) teje	(prej) atij,	(prej) nesh	(prej) jush	(prej)atyre

Nga pasqyra e mësipërme shihet qartë se përemrat vetorë kanë këto kategori gramatikore:

Në të tria vetat përemrat vetorë kanë **numër njëjës** dhe **shumës**.

Vetëm në vetën e tretë ata dallohen edhe sipas **gjinisë**.

Në rasat **dhanore** dhe **kallëzore** kanë një trajtë **të plotë** dhe një trajtë **të shkurtër**.

Përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë nuk përdoren në **rasën gjinore**.

**Konkretizoni çdo rast në tabelë.**

Përemrat vetorë **të vetës së parë** dhe **të vetës së dytë njëjës** dhe **shumës: unë, ti, ne, ju** nuk zëvendësojnë emra që janë përmendur më parë, por tregojnë:

- vetën a personin që flet ose që shkruan (**folësin**);

- vetën a personin së cilës i drejtohet mesazhi (**bashkëfolësin**).

Pra, ata nuk janë në kuptimin e vërtetë të fjalës përemra vetorë, por tregues të vetës.

Përemrat e vetës së tretë: **ai, ajo, ata, ato** janë përemra në kuptimin e plotë të fjalës. Ata zëvendësojnë emra tashmë të përmendur dhe tregojnë qenien ose objektin për të cilin flitet.

### Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë

Në pasqyrën e lakimit shihet qartë se përemrat vetorë në rasën **dhanore** e në **kallëzore** kanë, veç trajtave **të plota** dhe trajta **të shkurtra**. Trajatat e shkurtra shërbejnë për të shprehur kundrinorin e drejtë dhe kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë dhe përdoren vetëm ose krahas trajtave të plota.

A i tregove atij?

Nuk i tregova.

Ndodh shpesh që trajta e shkurtër e rasës dhanore **mua më** të shkrihet me trajtën e shkurtër të rasës kallëzore **atë e** dhe të fitohet forma **ma**. Prej **më+e=ma**. P.sh.: Këtë stilolaps vëllai **ma** dha mua. Për ta bërë më të qartë këtë formë pyesim: Kujt ia dha këtë stilolaps vëllai? Përgjigja do të jetë **mua më** (në rasën dhanore) + cilin **atë e** (në rasën kallëzore – stilolapsin).

Në këto raste e para është në rasën dhanore, kurse e dyta është në rasën kallëzore.

### Pasqyra e trajtave të shkurtra të bashkuara

dhanore + kallëzore njëjës	dhanore + kallëzore shumës
më + e = ma	më + i = m`i
yë + e = ta	të + i = t`i
i + e = ia	i + i = ia
na + e = na e	na + i = na i
ju + e = ju a	ju + i = jua
u + e = ua	u + i = ua

Trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara vendosen zakonisht para foljes.P. sh.:

Skënderi nuk e kreu dot detyrën; ai na e tregoi shkakun.

Kur folja është në mënyrën urdhërore, trajta e shkurtër ose trajta e shkurtër e bashkuar vendoset si para dhe pas foljes ose mund të vendoset edhe midis temës dhe mbaresës së foljes:



Mos e bëj detyrën aq shpejt! Bëje detyrën si duhet!

Ndize dritën,të lutem. Ndizeni dritën, ju lutem.

Dua të vij në shëtitje. **Më** merrni edhe **mua**, ju lutem. Ju lutem, merrmëni edhe **mua**.

### Ushtrime

1. Plotësoni tekstin e mëposhtëm me përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra ose të bashkuara që duhen.

....mund t'.....pushtojmë kështjellat e tyre, por, në fund të fundit.....janë një grumbull gurësh që.....mund të.....marrin përsëri, ashtu siç.....morëm.....  
Ka gjëra të tjera që duhet t'.....sulmojmë qindra herë, qindra vjet me radhë për t'.....gjymtuar sadopak.

Mevlan Çelebiu ishte kaq i uritur,saqë këtë herë mori hallvë pa pritur t`.... propozonte miku i tij.

2. Gjeni trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara të përemrave vetorë.

**Thoni kur u dhe të janë pjesë të foljes dhe kur janë trajta të shkurtra.**

1. Fytyra iu skuq ngadalë nga kënaqësia.

2. Ti e di që këtyre vështirësive do t`u bëjmë ballë vetë.

3. Djali filloi të fliste gjithmonë e më shpejt, sikur të kishte frikë se tjetrit do t`i mbaronte durimi për ta dëgjuar.

4. Po të mos vepronte kështu do t`i ndodhte ndonjë fatkeqësi: do ta verbonte ndonjë degë, do t`i binte përsipër ndonjë trung ose do ta gjuante rrufeja.

5. Unë do të të plotësoj tri dëshira,pasi kaq e kam forcën.

3. Zëvendësoni emrat në kllapa me përemrat vetorë.

1.....(djemtë) ishin shpërndarë duke kërkuar shokun e tyre.

2. Kishim vendosur që të mos u tregonim.....(shokëve) për.....(zbulimin tonë).

3. E pyete.....(arsimtarin) për kushtet e konkursit?

4. A mund t`i japësh.....(Zanës) një porosi nga mua?

5.....(Arbrit të vogël) iu skuqnë faqet nga të ftohtit.

4. Ktheni në mënyrën urdhërore foljet e fjalive të mëposhtme. Shkruani fjalitë e formuara.

1. Ti do ta pyesësh nënën. Ju do ta pyesni nënën.

2. Ti do t`i thuash motrës. Ju do t`i thoni motrës.

3. Ti do t`ia rregullosh punën vëllait. Ju do t`ua plotësoni dëshirën prindërve.

# GJUHA SHQIPE GJUHË INDOEVROPIANE

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane, në të cilën përfshihen këto gjuhë ose degë gjuhësore: indishtja, iranishtja, armenishtja, greqishtja, shqipja, gjuhët italice, gjuhët kelte, gjuhët gjermanike, gjuhët baltike e gjuhët sllave.

Gjuhët indoevropiane janë dëshmuar me anë të shkrimit në periudha të ndryshme të historisë, duke filluar që nga shekulli IV i erës sonë (gjuhët gjermanike) dhe duke vazhduar gjer në shek. XV – XV të erës sonë (gjuhët baltike), gjë që vlen edhe për gjuhën shqipe.

Afërsitë e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera të kësaj familjeje janë dëshmuar prej gjuhëtarëve të huaj e tanë të shekujve nëntëmbëdhjetë e njëzet të cilët kanë bërë studime krahasuese të gjuhëve duke u mbështetur në veçoritë e sistemit gjuhësor të gjuhës shqipe, duke i krahasuar këto, me veçoritë e sistemeve të gjuhëve të tjera indoevropiane.

Në këtë fushë studimi ndër të tjerë dallohen shkencëtarët e huaj Boppi, Majeri etj., si dhe gjuhëtari ynë i shquar Çabej etj., të cilët bënë krahasime të fjalëve të ndryshme të gjuhës shqipe që kanë afri me gjuhët indoevropiane, si p.sh.: **djeg**: lituanisht **degu**, sllavishtja e vjetër **žeg** (zheg); **emër**: prusishtja e vjetër **enmen**, sllav. e vj. **ime**; **mal**: letuanisht **mala**, buzë, skaj, anë, breg, rumanisht **mal**, breg, bregdet, etj.

## ORIGJINA E GJUHËS SHQIPE

Shqipja si gjuhë indoevropiane është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Ajo është vazhdim i ilirishtes, i gjuhës së popullsisë ilire që ka banuar në brigjet lindore të Adriatikut dhe të Jonit të paktën që nga mijëvjeçari i parë i erës sonë.

Nga ilirishtja nuk kemi dokumente të shkruara. Janë ruajtur vetëm disa fjalë të shkëputura që shpjegohen vetëm me anë të shqipes, si: **sika** (thika), **pele** (pleq), **aspetos** (i shpejtë); disa emra gjeografikë: *Dyrrabu* (Durrësi),

*Butroti* (Butrinti), *Scodra* (Shkodra), *Lissus* (Lezha), *Dardania* (lidhet me fjalën shqipe dardhë), *Delminium* (lidhet me fjalën shqipe delme, dele, *Dimalum* (lidhet me fjalën shqipe *di* (dy) dhe mal, *Barduli* (emër njeriu lidhet edhe me emrin Bardhyl), e të dy me fjalën i bardhë.

Këto fjalë na shërbejnë vetëm si dëshmi, për ekzistimin e ilirishtes, sepse, disa fjalë, me kalimin e shekujve, e kanë ndryshuar formën edhe kuptimin, kështu që nuk përdoren më. Kjo gjë ka ndikuar që në historinë shqiptare që nga koha antike e deri në Mesjetë për mungesë zbulimesh na paraqitet një pikëpamje e errët lidhur me ilirët.

Megjithatë, në shekullin e dytë të erës sonë gjeografi Ptolomeu në Aleksandri të Egjiptit në hartën e tij botërore përmend për herë të parë fisin **Albanói** me qytetin **Albanópolis**, midis Durrësit dhe Dibrës. Nga ky emër fisi populli shqiptar e ka trashëguar emrin **Albanon** ose **Arbanon** prej nga vjen edhe forma popullore **Arbëresh** dhe **Arbënesh**, emër ne të cilin na quajnë edhe popujt e tjerë, si: italianët: **Albanesi**, serbët: **Arbanasi**, **Allbanci**, grekët: **Arvanites**, turqit: **Arnavut-arnaut**.

Nga shekulli i dytë gjer te shekulli i njëmbëdhjetë shqiptarët nuk zihen ngoje.

Në shekullin e njëmbëdhjetë nga kronistët bizantinë përmenden shqiptarët si dhe vendi i tyre me emrin: Albanoi, Albanitai – Arbanitai emër ky që është i gjallë edhe sot.

Gjithashtu edhe autorët e vjetër të veriut përmendin Arbëni (Shqipëri) dhe arbënesh (shqiptar).

Emri i ri në literaturë del për të shënuar gjuhën te Buzuku, më 1555 **qi vjen me thashun shqip**, Pjetër Budi (1621) **shqip të na e thotë**. Pra emri shqip lidhet me gjuhën dhe jo me emrin e shpendit shqipe – shqiponjë, siç thekson edhe gjuhëtari ynë i shquar Eqrem Çabej.

Gjuha shqipe është folur shumë herët, është gjuhë e gjallë, që flitet edhe sot, por që me shkrim është dokumentuar mjaft vonë.

## DOKUMENTET E PARA TË SHKRUARA TË GJUHËS SHQIPE

Dokumentet e para të shkrimit shqip janë: 1) “ **Formula e pagëzimit** ”, shkruar nga Pal Ëngjëlli, kryepeshkop i Durrësit në kohën e Skënderbeut (1462), me qëllim që fëmijët të pagëzohen nga vetë familjet, kur s’mund të

dërgohen në kisha apo s'mund të shkojë prifti për t'i pagëzuar ata. Kjo është një frazë e shkurtër: “ Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit” (Unë të pagëzoj në emër të atit, të birit e të shpirtit të shenjtë).

“**Fjalorthi**” i **Arnold von Harff**-it është dokumenti i fundit i shek. XV, është një listë fjalësh e shprehjesh shqip-gjermanisht e shkruar prej gjuhëtarit gjerman Arnold von Harff e shkruar më 1496. Von Harffi, i cili duke kaluar në viset të banuara me shqiptarë, nga Ulqini e deri në Durrës kishte shënuar pak fjalë edhe ndonjë shprehje a fjalë shqipe, përbri të cilave kishte vënë edhe përkthimin gjermanisht. Është shkruar me alfabetin gjerman.

“**Perikopeja e ungjillit**”, e cila përbëhet prej dy pjesësh të vogla shqipe që ndodhen brenda një dorëshkrimi greqisht të shekullit XIV – XV, e shkruar në dialektin toskërisht.

Por vepra e parë e shkruar në shqip, për sa dihet deri më sot, është “**Meshari**” i Gjon Buzukut, i vitit 1555. Ai është shkruar në dialektin e Veriut me alfabetin latin e me disa shkronja cirilike dhe disa të veçanta për të pasqyruar tingujt e veçantë të shqipes. Vepra ka rëndësi historike dhe gjuhësore, sepse është dëshmia e parë më e plotë e gjendjes së dialektit të Veriut të pjesës së dytë të shek. XV dhe shërben për t'i njohur format e shqipes veriore në një periudhë më të hershme.

Vepra e dytë është “**e Mësueme e krishterë**” e Lekë Matrëngës, që u botua në Romë më 1592. Është shkruar me alfabet latin dhe në dialektin e toskërishtes – të së folmes të arbëreshve të Italisë. E më pas vazhdojnë veprat e shkrimtarëve të tjerë të veriut si: Pjetër Budit, Bogdanit etj.

Më poshtë po japim një pjesë të shkurtër nga vepra „Meshari”:

“ Ndë vjetët 1554 njëzet dit ndë mars zuna nfill e mbarova ndë vjetët 1555, ndë kallënduar 5 ditë. E se për fat në keshë kun mbë ndonjë vend fëjyem, u duo, tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë ma i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtojnë ndë e mirë... përse nuk çuditem se në paça fëjyem, këjo tue klenë ma e para vepërë fort e fështirë për të vepuom ndë gjuhët tanë...”.

( Në vitin 1554 njëzet ditë të marsit e fillova dhe e mbarova në viritin 1555, në dhjetor 5 ditë. E në se, për fat, do të kem gabuar kund më ndonjë vend, unë dua ku të jetë gabimi, ai që të jetë më i ditur se unë, atë gabim e lus ta ndreqë...Sepse nuk çuditem në paça gabuar, duke qenë kjo vepra e parë e fort e vështirë për t'u punuar në gjuhën tonë...)

Si dokument i parë i plotë i gjuhës shqipe, kjo vepër ka vlerë të madhe gjuhësore. Ajo i ndihmon gjuhëtarët ta shohin zhvillimin e gjuhës shqipe gjatë këtyre 450 vjetëve dhe të depërtojnë në historinë e saj.

## KONGRESI I MANASTIRIT

Gjuha letrare shqipe është rezultat i punës, i përpjekjeve dhe i luftës shekullore të popullit shqiptar i cili e ka ndier gjuhën amtare si diçka të pandarë nga vetja e tij. Përpjekjet për formimin e gjuhës letrare shqipe të njësuar kanë filluar që në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe morën një karakter veçanërisht të organizuar pas formimit të shoqërisë “Drita” të Stambollit.

Gjatë Rilindjes gjuha letrare u zhvillua në lidhje të ngushtë me gjuhën e gjallë të popullit. Rilindësit shkruan përgjithësisht në dialektin e tyre. Prandaj u krijuan dy variante të gjuhës letrare: varianti letrar i Veriut dhe varianti letrar i Jugut.

Kështu gjer në fillim të shek. XX gjuha shqipe nuk kishte një trajtë të vetme të shkruar për komunikim publik. Kjo gjë vazhdoi gjatë periudhës së Rilindjes e cila parashtrroi zgjidhjen e çështjes së alfabetit të përbashkët, gjë që u realizua më 1908 me Kongresin e Manastirit – Kongresin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe që kemi sot.

Çështja e njësimin të gjuhës vazhdoi edhe më tej. Ajo u trajtua në vite 1916-1918 nga Komisia Letrare e Shkodrës, ku bënë pjesë shkrimtarë të shquar, të cilët bënë hapa seriozë për drejtshkrimin e shqipes. Vendimet e Komisionit Letrare i pranoi edhe Kongresi i Lushnjës (1920) të cilat u miratuan më 1923 nga qeveria për t’u zbatuar në arsim, në administratë dhe në botime në vitet e mëpasme. Kjo është edhe përpjekja e parë për një gjuhë shqipe të përbashkët letrare ( gjuhë standarde), e cila për normën letrare nisej nga varianti letrar i mesëm.

## KONGRESI I DREJTSHKRIMIT

Përpjekjet për një drejtshkrim të përbashkët dhe një gjuhë letrare të përbashkët vazhduan edhe më tej deri në Kongresin e Drejtshkrimit 1972. Kongresi i Drejtshkrimit kurorëzoi me sukses rrugën e gjatë e të vështirë të formimit e të zhvillimit të gjuhës sonë letrare, duke marrë parasysh shkallën e zhvillimit të saj. Kështu në vitin 1956 u hartua udhëzuesi drejtshkrimor që pati parasysh të dyja variantet letrare.

Në nëntor të vitit 1972 u mbajt në Tiranë Kongresi i Drejtshkrimit të Shqipes, ku morën pjesë delegatë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi e arbëreshët e Italisë. Kongresi vendosi normën e drejtshkrimit të shqipes standarde që përdoret edhe sot.

# GJUHA LETRARE DHE DIALEKTET E GJUHËS SHQIPE

Lexoni me vëmendje poezinë „Mëmëdheu” të Çajupit dhe dy strofat e para të poezisë “Dallëndyshe eja” të Filip Shirokës. Në cilët dialekte janë shkruar këto poezi. A janë në gjuhën standarde (letrare)? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Gjuha shqipe flitet në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi, në luginën e Preshevës tek arbëreshët e Italisë e të Greqisë dhe në çdo vend tjetër ku jetojnë shqiptarët jashtë atdheut. Gjuha e përbashkët kombëtare përfshin gjuhën letrare dhe gjuhën dialektore.

Gjuha letrare është formuar nga gjuha popullore nga e cila vazhdon të pasurohet me fjalë e shprehje të reja. Në gjuhën shqipe dallohen dy dialekte: dialekti i Veriut ose gegërishtja dhe dialekti i Jugut ose toskërishtja. Këto dialekte i ndan lumi Shkumbin. Në të djathtë të Shkumbinit flitet gegërishtja, në të cilën hyjnë edhe të folmet e Kosovës dhe të Malit të Zi dhe pjesa më e madhe e të folmeve shqipe të Maqedonisë veriperëndimore; ndërsa në anën e majtë të tij flitet toskërishtja që përfshin edhe disa fshatra të rrethit të Prespës, të Manastirit dhe të Strugës. Por, këtë dialekt e flasin edhe arbëreshët e Italisë dhe të Greqisë. Dialektet e shqipes janë mjaft të afërta me njëri – tjetrin, prandaj nuk paraqesin kurrfarë pengesash që shqiptarët të merren vesh njëri me tjetrin.

Dallimet kryesore ndërmjet këtyre dy dialekteve hasen kryesisht në fushën e fonetikës, por mund të vërehen edhe në leksik e më pak në morfologji dhe në sintaksë.

Dallime fonetike e leksikore hasen edhe brenda një dialekti. P.sh.: cucë (caucë), në të folmen e Tetovës; gocë në të folmen e Tiranës; çikë në të folmet e Kosovës e të Veriut.

Shumë fjalë dialektore të Veriut apo të Jugut sot kanë gjetur vend në gjuhën letrare. Kjo do të thotë se fjalët dialektore janë burim i pashtershëm i gjuhës letrare.

Ato, përveç tjerash, shërbejnë edhe për t’i zëvendësuar huazimet e panevojshme, si: abuzim=keqpërdorim, akuzë=padë, start=nisje etj.

Përdorimi i fjalëve krahinore (dialektore) në letërsi sjell koloritin, zakonet dhe mendësinë e krahinës.

Shkrimtari Jakov Xoxa në romanin “Lumi i Vdekur” përdor mjaft krahinorizma, sepse e tërë ngjarja vendoset në një krahinë. Për përhapjen e dialektizmave rol të madh luajnë shkrimtarët me veprat e tyre artistike.

Gjuha standarde ( letrare shqipe) është varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar. Ajo përfshin gjuhën që përdoret në shkollë, në dokumente zyrtare, në botime si dhe në komunikimin zyrtar. Gjuha standarde po ashtu përdoret në të gjithë mediet shqiptare dhe në stacionet radiotelevizive që emetojnë (flasin) shqip.

Shqipja standarde është pasuria dhe arritja më e madhe e kombit shqiptar. Ajo nis me veprat e para shqipe duke kaluar nëpër një rrugë të vështirë të zhvillimit të saj dhe që u kurorëzua me Kongresin e Drejtshkrimit, që u mbajt në Tiranë, nga 20-25 nëntor 1972.

## PËRCAKTUESIT E EMRIT

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç’pjesë të ligjëratës janë fjalët që shoqërojnë emrat në grupet emërore?

Ishim larguar nga katundi. Bisedonim, thoshin historira **të tëra**, kujtime **të paharruara**, kurse befaz unë mbeta në vend, se sytë e mi ndeshën përpara një vendi **të trishtuar**, plot me qiparisa **të gjatë**, që lëshonin një hije **të gjatë** dhe, më një kënd, gjendej një portë **e madhe**, shumë **e madhe**. Desha të dija ç’vend ishte ai që lëshonte ato hije **të vdekjes** dhe që aq shpejt mua më shastisi. U bëra gati të pyesja shokun, po e kuptova prej hekurave **të derës**, nga munda të dalloja kryqe **të bardhë** e **të shumtë**.

Fjalët e shënuara me të zeza janë **emra**, **mbiemra** dhe **përemra**.

Gjatë përdorimit në fjali, emri shoqërohet shpesh nga fjalët që e përcaktojnë: **emra** të tjerë, **përemra**, **mbiemra**, **numërorë**, **forma të pashtjelluara** foljore.

### Emri si një përcaktues i një emri

Emri që përcakton një emër mund të tregojë:

- **përkatesi**: shtëpia **e dajës**, libri **i nxënësit**;
- **cilësi**: njeri **i gojës**, burra **të penës**;

- **vend a origjinë:** mollë **Prespe**, djathë **Sharri**;
- **lëndë:** vathë **argjendi**, gotë **qelqi**;
- **përmbajtje:** thes **me miell**, shportë **me qershi**;
- **synim:** dëshira **për punë**;
- **vepruesin:** hartimet e **nxënësve**, korrigjimet e **mësuesit**.

Nga shembujt e mësipërm shihet se emri si një përcaktues vë në marrëdhënie me sendin ose frymorin.

## Mbiemri si karakterizues i emrit

Mbiemri luan rolin kryesor për karakterizimin e një emri. Ai shpreh një cilësi të sendit, të dukurisë ose të frymorit, të treguar nga emri i përcaktuar.

Ai mund të jetë:

- **i nyjshëm:** princ i **lumtur**, shtëpi e **bukur**, burrë i **sjellshëm**;
- **i panyjshëm:** burrë **trim**, plak **zemërbardhë**, grua **flokëverdhë**.

### Ndërtimi

Përcaktori i shprehur me mbiemër mund të jetë:

- **përcaktor i paveçuar**, që ligjërohet e shkruhet menjëherë pas emrit që përcakton:

Trungjet e **dendura e të larta** të pishave ngjanin si rroje **të rrepta**.

- **përcaktori i veçuar** nga emri që përcakton, ndahet me anë të një pauze (pushimi) nga fjalët e tjera, p.sh.:

Trungjet e pishave, **të dendura, e të larta**, ngjani si roja të rrepta.

- përcaktori i veçuar i shprehur me mbiemër është i zgjeruar me fjalët e tjera dhe në këtë mënyrë spikat cilësinë e një sendi dukuri a frymori. Ndonjëherë theksimi i cilësisë gërshetohet edhe me shprehjen e marrëdhënieve rrethanore, p.sh., të shkakut:

Majat e lëvozhgës **të mprehta si gjilpërë** ia shpuan mollëzat e gishtave (nga që ishin të mprehta si gjilpërë, nga ky shkak).

- përcaktori i shprehur me një mbiemër të nyjshëm përshtatet me emrin në numër, gjini dhe rasë, p.sh.:

Drita e fortë na i verboi sytë.

Nxënësi i mirë lavdërohet nga të gjithë.

- përcaktori i shprehur me mbiemër të panyjshëm përshtatet me emrin në numër dhe në gjini:



Luftëtari trim dallohet në luftë.

**Plotësoni:** Luftëtarët (trim) dallohen në luftë. **Komentoni shembujt e mësipërm lidhur me përshtatjen.**

- përcaktori i shprehur me mbiemër, sidomos kur është i paveçuar, zakonisht qëndron pas emrit që përcakton. Por, për të shprehur me forcë cilësinë, për ta theksuar, ai mund të dalë edhe para emrit, madje edhe kur është i paveçuar:

Ah, malli i Shqipërisë, malli i Atdheut **të dashur, i shenjt**i mall e dashuri e shenjtë!

### Numërori si përcaktues i emrit

Rikujtohuni!

Ç`shpreh numërori?

Lexoni shembujt e mëposhtëm dhe nënvizoni numërorët.

Shkolla jonë ka 450 nxënës. Tre njerëz po kalojnë rrugës. Tri nxënës të shkollës sonë marrin pjesë në garat republikane. Fatosi kishte marrë me vete tre topa.

Numërori si përcaktues i emrit tregon me saktësi një numër, por i përdorur pa përcaktues të tjerë të emrit, ai ka vlerë të papërcaktuar ( shih shembullin e fundit).

Në këtë rast nuk e dimë çfarë topash kishte marrë Fatosi: topa futbollit, volejbollit etj.(apo topa luftime).

### Përemri si përcaktues (përcaktor) i emrit

Funksionin e përcaktorit e kryejnë edhe përemrat dëftorë:

**Ky, kjo, këta, këto, i këtillë, e këtillë, të këtillë, të këtilla** ( për afër)

**Ai , ajo, ata, ato, i atillë, të atillë, të atilla** (për larg). P.sh.:

Jehona **e këtyre** ngjarjeve u përhap kudo.

Të të thotë miku një fjalë **të tillë** është gjë e madhe.

**Ajo** ngjarje s`harrohet kurrë.

Përcaktorët e emrit janë edhe përemrat dëftorë të shoqëruar me nyjat i, e, të, së; për afër i (e) këtillë, e këtillë; të këtillë, të këtilla, ndërsa për larg: i atillë, e atillë, të atillë, të atilla, që kryesisht përdoren pas emrit: një shok i këtillë – një shok i atillë, një punë e këtillë, një punë e atillë.

# PËREMRI LIDHOR DHE I PACAKTUAR

## Përemri lidhor

Format e përemrit lidhor janë: **që** dhe **i cili** ( e cila, të cilët, të cilat).

Përemri lidhor që ka vetëm një formë edhe për numrin njëjës, edhe për numrin shumës, edhe për gjininë mashkullore edhe për gjininë femërore dhe ai nuk ndryshon, nuk lakohet.

Përemri lidhor i cili ka forma të veçanta për gjininë mashkullore e femërore (i cili, e cila) për numrin njëjës dhe për numrin shumës (të cilët, të cilat).

Në varësi të funksionit që kryen në fjali, ndryshon formë edhe gjatë lakimit:

FORMAT E PËREMIMIT LIDHOR I CILI				
	Gjinia mashkullore		Gjinia femërore	
Rasa	njëjës	shumës	njëjës	shumës
E.	i cili	të cilët	e cila	të cilat
Gj.	i, e të cilit	i, e të cilëve	i, e së cilës	i, e të cilave
Dh.	të cilit	të cilëve	së cilës	të cilave
K.	të cilin	të cilët	të cilën	të cilat
Rr.	(prej) të cilit	(prej) të cilëve	(prej) së cilës	(prej) të cilave

## Roli i përemrit lidhor

Përemri lidhor shërben për të lidhur pjesën e nënrenditur përcaktore me emrin, grupin emëror ose përemrin paraprijës që plotëson, p.sh.: Qielli që gjatë gjithë javës kishte qenë i murrmë, u ça në dy- tri vende, si për të bërë zakonin e së dielës. Në kuvend merrnin pjesë 37 delegatë të cilët përfaqësonin krahina të ndryshme.

Përemri lidhor kryen, gjithmonë një funksion në raport me një fjalë tjetër të pjesës së nënrenditur përcaktore (më shpesh në raport me foljen).

**Kryefjalë:** Dielli shtrinte drejt bregut brezin e tij të kuqërremtë, që (i cili) pluskonte mbi valëzat vogla.

**Kundrinor i drejtë:** Vjersha popullore, kënga ishte vlerësimi më i lartë që (të cilin) populli u jepte ngjarjeve dhe njerëzve.

**Kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë:** Më mbeti pa ftuar vetëm Bekimi, të cilit nuk ia di adresën. Po kështu mund të kryejë funksionin e një kundrinori të zhdrejtë me parafjalë, të një përcaktori dhe të një rrethani.

Si përemra lidhorë mund të shërbejnë edhe **përemrat pyetës kush, cili, ç** kur nuk shërbejnë për të pyetur, por për **të lidhur** një pjesë të nënrenditur me **pjesën nga e cila ajo varet**. Në këtë rast këta përemra mund të zberthehen në dy përemra, nga të cilat i pari është përemër dëftor ose i pacaktuar kurse i dyti përemër lidhor që, p.sh.:

“Për Shqipërinë ditët e mira paskëtaj vijnë. Lum **kush** të rrojë ta shohë zonjë” (kush → ai që).

Këshillohu **me cilin** të duash ( me cilin → me atë që).

Ushtrime.

1. Dalloni përemrat lidhorë dhe thoni ç’funksion kryejnë në pjesën e nënrenditur.

Në fund të një are ishte një kumbull që kishte zberthyer sumbullat e para.

Ishte një qiell që të kujtonte pranverën. Të kujtonte netët e qeta të prillit, që të befasojnë me gjelbërimin e tyre të ri. Vajza ndoqi me interesim këngën e një bilbili, që tundej në një degë lisi.

## Përemri i pacaktuar

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza.

Bariu mbeti i shtangur me letër dhe florinj në dorë. Nuk dinte se ç’të bënte tani. Ushtari me fytyrë të qeshur i tha fjalët më të rënda që kanë dëgjuar ndonjëherë veshët e mi: Kjo gjë ishte sekrete dhe po të dëgjonte **ndokush**, që të dy mund të mbesin pa kokë!...

“ Si t’ia bëj tani?..- mendoj edhe pak dhe letrën e futi në kraharor, kurse florinjte i futi shpejt e shpejt në një gropë në rrënjë të plepit të gjatë qindvjeçar.

Në mbrëmje, kur u kthye grigja në fshat, nisi të pyesë tërthorazi të zotin e shtëpisë, ku bunte atë natë, se cili nga fshatarët ishte më i shkolluari.

Më i shkolluari?! – u step fshatari. – Çfarë të shkolluarësh! Ne as që kemi parë me sy si duket shkolla.

Domethënë **askush** nuk di të lexojë në fshat?! – pyeste djaloshi, thuajse nuk i besonte.

**Askush..**

As kryeplaku?

As ai.

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë përemra të pacaktuar.

**Përemrat e pacaktuar përdoren në vend të emrave për të treguar frymorë, dukuri ose sende në mënyrë të pacaktuar.** P.sh.:

Kush trokiti në derë? - pyeti **babai**.

Kush trokiti në derë? - pyeti **ai**.

Kush trokiti në derë? - pyeti **njëri**.

Po ta analizojmë këtë fjali do të vërejmë se në fjalinë e dytë është përdorur përemri vetor **ai**, ndërsa në fjalinë e tretë përemri i pacaktuar **njëri** që përdoren në vend të emrit babai. Vetëm se kur themi **ai** kemi të bëjmë me një person të caktuar, kurse kur themi **njëri** personi lihet i pacaktuar.

Pra edhe përemrat e pacaktuar përfaqësojnë në fjali emra vetëm se ky përfaqësim bëhet në mënyrë të pacaktuar.

Përemrat të pacaktuar janë: **një, njëri, njëra, disa, ca, fare, dikush, ndokush, askush, kurrkush, ndonjë, ndonjëri, ndonjëra** etj.

Disa përemra të pacaktuar ndryshojnë sipas gjinisë, si p.sh: **njëri – njëra, ndonjëri-ndonjëra, secili-secila, cilido-cilado, të gjithë-të gjitha, tjetri-tjetra** etj.

Zakonisht përemrat e pacaktuar që ndryshojnë sipas **gjinisë** edhe lakohen.

Më poshtë po japim tabelën e lakimit të disa përemrave të pacaktuar.

Rasa	GJINIA MASHKULLORE	GJINIA FEMËRORE
E.	njëri – ndonjëri - secili	njëra – ndonjëra - secila
Gj.	i, e njërit - ndonjërit - secilit	i,e njërës – ndonjërës - secilës
Dh.	njërit - ndonjërit - secilit	njërës - ndonjërës - secilës
K.	njërin - ndonjërin - secilin	njëren – ndonjëren - secilën
Rr.	(prej) njërit - ndonjërit - secilit	(prej) njërës – ndonjërës - secilës

Po ashtu lakohen edhe përemrat e pacaktuar **dikush, kushdo, disa, askush, kurrkush** etj., por pa pësuar ndonjë ndryshim në gjini.

Rasa	dikush	ndokush	disa	askush
E.	dikush	ndokush	disa	askush
Gj.	i, e dikujt	i,e ndokujt	i,e disave	i,e askujt
Dh.	dikujt	ndokujt	disave	askujt
K.	dikë	ndokënd	disa	askënd
Rr.	(prej) dikujt	(prej) ndokujt	(prej) disave	(prej) askujt

Nuk lakohen këta përemra të pacaktuar : **një, ndonjë, shumë, tërë.**

Përemrat e pacaktuar, në përgjithësi **nuk ndryshojnë** sipas numrit.

Disa përemra të pacaktuar kanë **kuptim mohor**, si p.sh.: **askush, kurrkush, asnjë, asnjëri** etj.

Disa përemra të pacaktuar përdoren edhe **veç**, edhe **të shoqëruar me emra**. Dhe në këtë rast kryejnë funksionin e kryefjalës a të kundrinorit, si p.sh: Garat olimpike i ndoqën **të gjithë**. Garat olimpike i ndoqën **të gjithë** nxënësit e shkollës sonë.

Kur përdoren krahas emrave, janë fjalë përcaktuese ose përcaktorë të grupit emëror.

### MBANI MEND

Përemrat e pacaktuar përdoren në vend të emrave për të treguar frymorë, dukuri ose sende në mënyrë të pacaktuar.

Përemrat e pacaktuar nuk ndryshojnë sipas numrit.

Përemrat e pacaktuar **gjithë** dhe **kurrë**, kur përdoren si pjesë e parë e fjalëve të përbëra, ë-ja në fund të kësaj pjese nuk shkruhet. Pra jo **gjithëçka, kurrëgjë**, por: **gjithçka, gjithsecili, gjithfarë, kurrëgjë, kurrkush**.

Ndërkaq përemrat e pacaktuar **njëri-tjetri** dhe **shoqi –shoqin** shkruhen me vizë në mes.

### Ushtrime

1. **Secilën fjali pyetëse bashkoheni me vijë me përgjigjen e saj.**  
 Kush foli në mbledhjen e prindërve? Ai kishte qenë nxënës i at Gjergj Fishtës.  
 Kë rrethuan fëmijët? Ata i dhuruan lule mësueses.

Kujt i dhuruan lule ata? Fëmijët rrethuan shkrimtarin.  
Nxënës i kujt kishte qenë ai? Në mbledhjen e prindërve foli kujdestari i klasës.

2. Në cilat raste janë përdorur gabim përemrat pyetës? Pse janë përdorime të gabuara?

Kush erdhën dje?  
Cilët nxënës erdhën dje?  
Kush nxënës erdhi me vonesë?  
Kush erdhi me vonesë?  
Kujt nxënëse i humbi stilolapsi?  
Kush djalë u kthye?  
Kush u kthye?  
Cili i kthye?

3. Formoni nga një fjali me përemrat e pacaktuar të mëposhtëm:  
njëri, ndonjëra, secila, dikush, asnjë, të gjithë.

## FOLJA DHE VEÇORITË E SAJ

Rikujtohuni!

Ç'janë foljet ?  
Në çka ndryshojnë ato?  
Ç'funktion kryejnë në fjali?

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza. Klasifikoni sipas zgjedhimit foljet e rregullta në shtylla. Dalloni temën dhe mbaresën e tyre.

.....Po qe se vajza **del** bashkë me mua, ai **ka** njëfarë besimi, por edhe unë **frikohem**, se vajza **është** e tillë se **mund t'i hedhë** syrin shumëkush, pastaj ajo **mban** në qafë edhe një testament që ia **ka shkruar** e ndjera nënë **për ta ruajtur** nga çdo e keqe.

Fjalët e shkruara me të zeza janë folje. **Ato tregojnë (emërtojnë) një veprim, një gjendje ose një të qenë të kryefjalës.**

Veprimin e shprehin në kohë, mënyra dhe forma të ndryshme.

Folja ka tri veçori (karakteristika) kryesore që e bëjnë të dallohet nga klasat e tjera të fjalëve:

Ndryshon sipas **kohës: lexoj** (sot), **lexova** (dje), **do të lexoj** (nesër).

Ndryshon sipas **vetës: merr** forma të ndryshme në varësi të vetës së cilës i përket kryefjala, pra nëse kryefjalë është folësi, bashkëfolësi (bashkëbiseduesi) apo një i tretë.

Është **bërthamë e fjalisë – tip:** siguron bashkimin e pjesëve përbërëse të fjalisë nëpërmjet të lidhjeve shumë të ngushta me kryefjalën dhe me fjalët e ndryshme plotësuese (kundrinorët, rrethanorët). Ajo zë një vend qendror në fjali, duke qëndruar midis kryefjalës, nga njëra anë, dhe kundrinorëve e rrethanorëve, nga ana tjetër.

Mësuesi më **dha** një libër *leximi*.

Kr.

F.(Ka.)

Ku.

## Foljet ndihmëse dhe foljet gjysmëndihmëse

Lexoni me vëmendje fjalitë e mëposhtme. Vëreni foljet e shkruara me shkronja të zeza. Tregoni si janë përdorur ato.

Këtu **ishte** shkolla jonë. Aty **kishte** shumë pemë të mëdha.

Çdo gjë **ishte** shkatërruar nga lufta. Vetëm te hyrja e shkollës **kishte** mbetur një dru arre.

Më në fund ora e mësimit **filloi**.

Ai **filloi** t'ia **lidhte** plagën me shumë kujdes.

Nga shembujt e mësipërm shihet se disa folje janë përdorur:

**me kuptim të plotë**, shih foljet: **ishte** dhe **kishte** në fjalinë 1 dhe **filloi** në fjalinë 3.;

disa **për të shënuar fillimin e veprimit të emërtuar nga folja** që vjen pas, shih shembullin në fjalinë 4: **filloi** t'ia **lidhte**.

Kur **përdoren si mjete gramatikore foljet ndihmëse kam dhe jam** e humbasin kuptimin e tyre **dhe kthehen në fjalë shërbyese**. Ka gjithashtu disa folje, që në lidhje me foljet e tjera, përdoren me kuptim të zbehur: foljet


gjysmë ndihmëse ( **filloi, mund, duhet** etj).

**Foljet ndihmëse** shërbejnë për të ndërtuar kohët e përbëra të foljes. Në gjuhën shqipe foljet ndihmëse janë foljet **kam** dhe **jam** që vihen përpara pjesores së foljes themelore kam shkruar, kam mbetur, kisha shkruar, kisha mbetur, do të kem shkruar, do të kem mbetur, është shkatërruar, ishte shkatërruar.

Thoni cila prej tyre përdoret për formën veprorë të foljes dhe cila për formën joveprorë.

Foljet **jam** dhe **kam** shërbejnë si **folje ndihmëse**, edhe kur përdoren për të ndërtuar format foljore të tipit **kam për të larë, kam për të mbetur, jam duke larë, jam duke mbetur**.

Foljet ndihmëse zgjedhohen në të gjitha mënyrat dhe kohët dhe ato u japin kohëve të përbëra të foljes kuptimet gramatikore të vetës dhe të numrit:



**Foljet gjysmëndihmëse** janë ato që **përdoren me kuptim të zbehur** dhe që në fjali e humbasin mëvetësinë e tyre të zakonshme.

Më në fund ora e mësimit **filloi** (folje e mëvetësishme me kuptim të plotë).

Ai **filloi** t'ia lidhte plagën me shumë kujdes. (folje gjysmëndihmëse jo e mëvetësishme që shfaqet në fjali për t'i dhënë një nuancë kryerjes së veprimit të emërtuar nga folja **të lidhte** dhe për të kumtuar se ky veprim është në fillim të tij).

## A. Foljet gjysmëndihmëse mund, duhet, do

Këto folje gjysmëndihmëse paraqesin veprimin e shprehur nga folja themelore si të mundshëm, të lejueshëm, të detyrueshëm, p.sh.:

Vetëm një pendë poetike **mund** të përshkruajë meritat e tyre. Ata mund të kenë ardhur dhe nuk na kanë gjetur..

Marrëveshja **duhet** të mbetet midis nesh.

Ata janë djem të mirë dhe **duhen** ndihmuar.



## B. Foljet gjysmëndihmëse filloj, nis, zë

Këto folje gjysmëndihmëse përdoren për të shprehur fillimin, vazhdimin, mbarimin e veprimit të emërtuar nga folja që vjen pas dhe që është themelorja:

Hëna e bukur që sapo **filloi** të dilte shkëlqen në zallin e Përroit të Thatë.

E mori djalin dhe **nisi** t'i lëmonte flokët.

Ai **vazhdoi** të vraponte edhe më tej.

Iliri nuk **pushonte** së foluri.

Në tri rastet e para, folja gjysmëndihmëse ndiqet nga lidhorja e foljes themelore. Në rastin e katërt (**pushoj**) folja gjysmëndihmëse ndiqet nga një formë e ngurosur e tipit **së foluri, së ngrëni** etj.

### MBANI MEND

Foljet **kam** dhe **jam** shërbejnë për të ndërtuar **kohët e përbëra të foljes**: kam mbetur, kisha mbetur, pata mbetur; jam larë, isha larë, qeshë larë.

- Foljet gjysmëndihmëse **mund, duhet, do** e paraqesin veprimin e shprehur nga folja themelore si të mundshëm, të detyrueshëm, të lejueshëm: vetëm një pendë poetike mund të përshkruajë meritat e tyre.

- Foljet gjysmëndihmëse; **filloj, nis, zë; vazhdoj, mbaroj, pushoj**, foljet modale përdoren për të shprehur **fillimin, vazhdimin** ose **mbarimin** e veprimit të emërtuar nga folja që vjen pas: Familja nisi të flasë.

- Duhet pasur kujdes, kur foljet gjysmëndihmëse filloj, nis, zë janë në të kryerën e thjeshtë folja në lidhore që vjen pas, mund të jetë në të pakryerën ose në të tashmen, p.sh.:

1. Ai filloi të ngjitet me kujdes nëpër shkëmbinjtë e puthitur e të mbuluar me myshqe.

2. – Ja, ja filloi të ngjitet! Po ngjitet te shkëmbi.

Është në të pakryerën kur folja themelore tregon një veprim që është kryer para çastit të ligjëritimit. Është në të tashmen, kur folja themelore tregon një veprim që vazhdon të kryhet edhe në çastin e ligjëritimit .

Foljet gjysmëndihmëse së bashku me foljet që vijnë pas formojnë kallëzuesin e përbërë në fjali.

# MËNYRA KUSHTORE DHE KOHËT E SAJ

Lexoni dialogun e mëposhtëm dhe gjeni foljet.

Genci: Ku do t'i kalosh pushimet verore, Ilir?

Iliri: Nuk kam vendosur ende dhe ndoshta nuk do të shkoj askund, do të rri në shtëpi.

Genci: Pse nuk vjen me mua në Sarandë?

Iliri: **Do të vija** me gjithë qejf, por kësaj here do të na vijnë mysafirë (miq) nga Australia: Xhaxhai me familjen.

Genci: Po të vinit edhe ti e Valoni, **do të kalonim** shumë mirë.

Iliri: Po ti, sikur **do të shkoje** në fshat, te gjyshi, pse paske ndërruar mendje, mor Genc?

Genci: Ashtu është, **do të kisha shkuar** vërtet, se më pëlqen shumë klima malore, mirëpo Adelina nuk mund të vijë atje. Mjeku e ka këshilluar të shkojë në plazh pa tjetër, përndryshe **do t'i shtohet** reumatizma.

Me siguri vërejtët se foljet e theksuara dallojnë nga foljet e tjera, sepse këto janë në mënyrën kushtore.

Me anën e mënyrës kushtore **folësi** tregon **një veprim që mund të kryhej, po të plotësohej një kusht i caktuar**. Kushti zakonisht shprehet me një pjesë të nënrenditur kushtore folja e së cilës është ose në të pakryerën e lidhore ose në më se të kryerën e saj, si p.sh.:

Po të vinit edhe ti e Valoni, do të kalonim shumë mirë.

Po të mbante koha mirë, do të shkonim në shëtitje.

↓  
pjesa e nënrenditur  
me folje në mënyrën lidhore

↓  
pjesa kryesore  
me folje në mënyrën kushtore

## Zgjedhimi i foljes në mënyrën kushtore

Mënyra kushtore ka dy kohë: **një kohë të thjeshtë: të tashmen** dhe **një kohë të përbërë: të kryerën**.

Koha e tashme ndërtohet me pjesëzën **do** (si e ardhmja) dhe të pakryerën

e lidhore, p.sh.: B.

**Koha e kryer** e mënyrës kushtore ndërtohet (formohet) me të tashmen e kushtores të foljeve ndihmëse kam, jam + pjesorja e foljes përkatëse: **do të kisha shkuar, do të isha larë.**

Pasqyra e zgjedhimit të foljeve: **mësoj, kap, ngre**, në kohën e tashme dhe të kryer në të tria vetat e numrit njëjës.

Koha	Zgjedhimi I		Zgjedhimi II		Zgjedhimi III	
	veprore	joveprore	veprore	joveprore	veprore	joveprore
E tashme	do të mësoja	do të mësohesha	do të kapja	do të kapesha	do të ngrija	do të ngrihesha
	do të mësoje	do të mësoheshe	do të kapje	do të kapeshe	do të ngrije	do të ngriheshe
	do të mësonte	do të mësohej	do të kapte	do të kapej	do të ngrinte	do të ngrihej
E kryer	do të kisha mësuar	do të isha mësuar	do të kisha kapur	do të isha kapur	do të kisha ngritur	do të isha ngritur
	do të kishe mësuar	do të ishe mësuar	do të kishe kapur	do të ishe kapur	do të kishe ngritur	do të ishe ngritur
	do të kishe mësuar	do të ishe mësuar	do të kishe kapur	do të ishe kapur	do të kishte ngritur	do të ishte ngritur

Zgjedhoni foljet e mësipërme në numrin shumës.

### Përdorimi

a) **Koha e tashme e mënyrës kushtore** përdoret për të treguar një veprim që mund të kryhet para ose pas çastit të ligjërimit, po të plotësohet një kusht i caktuar. Pra, në dallim nga mënyra dëftore, **realizimi** i veprimit nuk paraqitet i sigurt, por i mundshëm, p.sh.:

Po të kisha kohë, **do të mësoja** më mirë.

Po të shterte lumi, **do të fillonin** punimet për urën. (kusht i mundshëm)

b) **Koha e kryer e mënyrës kushtore** përdoret për të treguar një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, por që gjer në çastin e ligjërimit paraqitet si i parealizuar, me që nuk është plotësuar një kusht i caktuar; p.sh.:

Po të kisha pasur kohë, do të kisha mësuar më mirë.

Po të kishte shterur lumi, do të kishin filluar punimet për urën.

Ky kusht nuk u plotësua deri në çastin e ligjërimin, ky veprim nuk u realizua.

Forma mohore e foljes në mënyrën kushtore ndërtohet duke i paravënë foljes pjesëzën mohuese **nuk** ose **s'**: nuk do të fillonim.

## Ushtrime

**1. Gjeni foljet në tekstin e mëposhtëm dhe i klasifikoni sipas mënyrës dhe kohës.**

Omeri i Mujit dukej sikur rritej me ditë. Hodhi shtat aq shpejt, sa të gjithë do të habiteshin, po të mos ishte djalë kreshniku.

Ata që e kishin smirë, thoshin se Omeri i paska ngjarë të atit nga trupi, por jo nga forca e shkathëtësia. S'ishte çudi që të bëhej qullac, si ata që mezi ulen të zgjidhin lidhëzat opingave. Këto fjalë arritën deri te veshët e nënës së Omerit, Ajkunës, prandaj ajo e shikonte me merak të ardhmen e djalit. Më mirë të kishte trupin të shkurtër e të fortë, sesa të ishte i ngathët.

**2. Në vend të pikave vini lidhëzat e duhura:** në qoftë se, po, sikur, po qe se, në rast se etj.:

.....do të binte shi, nuk do të shkonim në ekskursion. ....ta dija, nuk do të kisha ardhur. ....vjen ti, nesër do të shkojmë në Ohër.....ta shohësh nga lart, qyteti duket një mrekulli e vërtetë.

**Thoni ç'tregon e ardhmja e thjeshtë: një veprim të çastit apo një veprim që zgjat.**

Nesër do të regjistrohem në kursin e gjuhës angleze.

Kjo ngjarje do të mbahet mend një kohë të gjatë.

Që nesër do të punojmë më shumë në kompjuter.

Pas një muaji do të jepet koncerti i Ardit Gjebresë dhe i grupit të tij "Projekt – Jon".

Pas një jave do të ndryshojë koha.

**Ktheni në mënyrën kushtore foljet e kohës së ardhme në fjalitë e mëposhtme:**

Po të kem kohë, do të shkoj në teatër.

Miranda mendon se do të dalë shumë mirë në provimin e gjuhës shqipe.  
Me siguri do t'u shkojë mendja se jam në lumë.  
Unë di se ju do të bëni të pamundurën.

Ushtrime

**Lexoni pjesën e mëposhtme duke vënë në formën e duhur foljet gjysmëndihmëse në kllapa:**

Orkestra (filloj) të luante përsëri. Daulla (zë) të gjëmonte si bubullimat në maj. Gërneti i çau mes për mes bubullimat e daulles. Ajo (vazhdoj) të ngrihej mbi to, e mbrehtë dhe e brishtë.

Dasma (duhet) të kishte arritur kulmin e saj. Orkestra (vazhdoj) të luante pa pushim. Këngëtari (nis) të këndonte me pasion këngë atdhedashurie.

Pas pak kohe (filloj) të dëgjohet një melodi e mallëngjyeshme.

**Format foljore joveprore të ndërtuara me foljen ndihmëse jam zëvendësoni me foljen kam dhe vëreni ndryshimet sipas vetës, numrit, kohës, mënyrës: jam pranuar, qeshë matur, isha pranuar, qenkam matur.**

**Përpara foljeve themelore me shkronja të zeza përdorni folje gjysmëndihmëse që tregojnë: a) fillimin e veprimit; b) vazhdimin e veprimit; c) mbarimin e veprimit.**

Në fytyrat e të dyve shkëlqente dielli i porsalindur. Në hapësirë fluturonin shqiponjat.

Një skifter, dehur nga juga e bardhë, qëndronte pezull në ajër. Mentori e mbante në shpinë çantën e shkollës.

# MËNYRA HABITORE DHE KOHËT E SAJ

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe gjeni foljet.

Në ç'mënyrë janë ato?

Analizoni foljet e shkruara me shkronjë të zeza? Krahasojini me foljet e tjera?

Toni u ngrit në mëngjes si zakonisht, hapi dritaren dhe vështroi jashtë: një shtresë e bardhë kishte mbuluar gjithçka. Zgjati kokën përjashta dhe pa me vëmendje.

“**Paska rënë** borë”, - tha me vete dhe i thirri të vëllait: - Ilir zgjohu shpejt dhe eja shih, sa **qenka mbuluar** gjithçka me borë. Do të lozim me topa bore sot.

Pa mbaruar mirë këto fjalë, Iliri u dha tek dritarja.

- Ua, sa shumë që **paska rënë!** - ia bëri Iliri, në fillim, pa e parë mirë, pastaj duke fërkuar sytë përgjumësh, shikoi më mirë dhe plot gëzim tha:

- Pse nuk thua, mor Toni, sonte **qenka bërë** kiameti, paska rënë një pëllëmbë bore e më shumë.

Foljet në mënyrën habitore shprehin një veprim të papritur që është kryer në të shkuarën ose që kryhet në çastin kur flasim.

Habitorja përdoret për të shprehur dyshim, mospajtim a ironi ndaj një pohimi të një tjetri. Habitorja ka katër kohë: kohën e tashme, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën.

Pasqyra e zgjedhimit të foljeve mësoj, kap, ngre

Koha	Zgjedhimi I		Zgjedhimi II		Zgjedhimi III	
E tashme	veprore	joveprore	veprore	joveprore	veprore	joveprore
Nj.	mësuakam	u mësuakam	kapkam	u kapkam	ngritkam	u ngritkam
	mësuake	u mësuake	kapke	u kapke	ngritke	u ngritke
	mësuaka	u mësuaka	kapka	u kapka	ngritka	u ngritka
Sh.	mësuakemi	u mësuakemi	kapkemi	u kapkemi	ngritkemi	u ngritkemi
	mësuakeni	u mësuakeni	kapkeni	u kapkeni	ngritkeni	u ngritkeni
	mësuakan	u mësuakan	kapkan	u kapkan	ngritkan	u ngritkan
E pakryer	mësuakësha	u mësuakësha	kapkësha	u kapkësha	ngritkësha	u ngritkësha
	mësuakëshe	u mësuakëshe	kapkëshe	u kapkëshe	ngritkëshe	u ngritkëshe
	mësuakësh	u mësuakësh	kapkësh	u kapkësh	ngritkësh	u ngritkësh
	mësuakëshim	u mësuakëshim	kapkëshim	u kapkëshim	ngritkëshim	u ngritkëshim
	mësuakëshit	u mësuakëshit	kapkëshit	u kapkëshit	ngritkëshit	u ngritkëshit
	mësuakëshin	u mësuakëshin	kapkëshin	u kapkëshin	ngritkëshin	u ngritkëshin
E kryer	paskam mësuar	qenkam mësuar	paskam kapur	qenkam kapur	paskam ngritur	qenkam ngritur
	paske mësuar	qenke mësuar	paske kapur	qenke kapur	paske ngritur	qenke ngritur
	paska mësuar	qenka mësuar	paska kapur	qenka kapur	paska ngritur	qenka ngritur
	paskemi mësuar	qenkemi mësuar	paskemi kapur	qenkemi kapur	paskemi ngritur	qenkemi ngritur
	paskeni mësuar	qenkeni mësuar	paskeni kapur	qenkeni kapur	paskeni ngritur	qenkemi ngritur
	paskan mësuar	qenkan mësuar	paskan kapur	qenkan kapur	paskan ngritur	qenkan ngritur
Më se e kryer	paskësha mësuar	qenkësha mësuar	paskësha kapur	qenkësha kapur	paskësha ngritur	qenkam ngritur
	paskëshe mësuar	qenkëshe mësuar	paskëshe kapur	qenkëshe kapur	paskëshe ngritur	qenke ngritur
	paskësh mësuar	qenkësh mësuar	paskësh kapur	qenkësh kapur	paskësh ngritur	qenka ngritur
	paskëshim mësuar	qenkëshim mësuar	paskëshim kapur	qenkëshim kapur	paskëshim ngritur	qenkemi ngritur
	paskëshit mësuar	qenkëshit mësuar	paskëshit kapur	qenkëshit kapur	paskëshit ngritur	qenkeni ngritur
	paskëshin mësuar	qenkëshin mësuar	paskëshin kapur	qenkëshin kapur	paskëshin ngritur	qenkan ngritur

Ushtrime

1. Plotësoni tabelën e mëposhtme me format e duhura të foljes në mënyrën habitore:

Veta	e tashme	e pakryer	e kryer	më se e kryer
Unë	kaluakam			
Ti		kërkuakëshe		
Ai, ajo				paskësh vrapuar
Ne	dëgjuakemi			
Ju			paskeni shkuar	
Ata, ato				qenkëshin larë

2. Shkruani 6 fjali me folje të ndryshme në mënyrën kushtore dhe habitore.

3. Në vend të vijave vini një të një nga foljet në kllapa: (qenkësh mësuar, qenkëshin, qenka,...)

1. Ai \_\_\_\_\_ me këtë lloj jete.
2. Ato punë \_\_\_\_\_ bërë lëmsh.
3. I tërë pylli duket sikur \_\_\_\_\_ shkretuar.



# STRUKTURA E GRUPIT EMËROR DHE FUNKSIONET BRENDA TIJ

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm. Vëreni fjalët e shkruara me të zeza dhe tregoni ç'përcaktojnë ato.

„ Etër senatorë, qytetarë të **ndritur** dhe të **pashoq**, unë besoj se, qyteti dhe muret tuaja janë ndërtuar jo nga një mendje **njerëzore**, por më tepër hyjnore, se bëjnë çdo njeri të mahnitet gjer në kulm. Dhe me të vërtetë, kush do të quante veten të pajisur me një dituri aq të rrallë, me një dituri aq **të gjerë**, me gojëtarë aq të madhe, qoftë të fituar për punë, qoftë të dhuruar prej natyre, sa që të mundte a të guxonte jo t'i shpjegonte me hollësi këto vepra të lavdishme, por vetëm t'i kuptonte. Qyteti i Raguzës është quajtur me një emër tjetër më të denjë edhe Epidarium, si një qytet më se i pasur, madje më i çmuar dhe më i lartë se çdo pasuri; dhe më të drejtë e më vend është quajtur Epidarum, sepse cili qytet, cili shtet mund të krahasohet në ditët tona me të?....”

Me siguri keni vërejtur se fjalët **të ndritur, të pashoq, njerëzore, të rrallë, të gjerë** janë mbiemra dhe përcaktojnë emrat që ndodhen para tyre; ndërsa fjalët **tuaja, çdo, këto, cili** janë përemra, që gjithashtu përcaktojnë emrat.

Si mbiemrat ashtu edhe përemrat së bashku me emrat formojnë një grup emëror.

## Struktura e grupit emëror

### Përbërësit kryesorë të grupit emëror

Grupi emëror përbëhet nga:

- a) **emri bërthamë**,
- b) **përcaktuesit e emrit bërthamë** që mund të jenë:  
një mbiemër: qytetarë **të ndritur, mendje njerëzore**, etj.;
- një përemër: muret **tuaja, këto** vepra, **cili** qytet, etj.;
- një numëror: **pesë** nxënës, **tre** burra, **tri** gra etj.

një emër tjetër me ose pa parafjalë: qyteti i **Raguzës**, fjalë **pa vend** etj.;


- një paskajore: dëshira **për të mësuar**;

një pjesë e nënrenditur përcaktore: letrat **që ka shkruar**.


### Paraqitja skematike

Grupet emërore mund të paraqiten në mënyrë skematike

#### Grupi emëror



#### Emri bërthamë



### GRUPI EMËROR

Në secilin degëzim të skemës së dytë vendosni fjalën që duhet.

Në tekstin e mësipërm dalloni përcaktuesit e shprehur me mbiemra, me përemra dhe me emra.

### Zëvendësimet e mundshme

Për të dhënë një ide të njëjtë mund të zgjedhim grupet e ndryshme emërore e kjo bëhet duke i zëvendësuar përcaktuesit e emrit. Në këtë mënyrë ndryshon edhe stili i komunikimit.

Kështu, për një vajzë të mirë mund të themi: një vajzë **shpirtmirë** – një vajzë **që ka shpirt të mirë**.

### Funksionet brenda grupit emëror

Ndani në dy shtylla grupet emërore:

Grupet emërore të formuara emër+mbiemër

Grupet emërore të formuara me emër+emër

Tregoni ç'funktion kryejnë mbiemrat në fjalitë e mëposhtme:

Natyra po fundosej në detin **e zjarrtë**.

Ndjen detin **e shqetësuar**.

Në shembujt e mësipërm mbiemri është lidhur drejtpërdrejt me emrin, pa ndërmjetësinë e një foljeje dhe kryen funksionin e epitetit.

Krahasoni dy shembujt e mësipërm me këtë:

Ardi është **i shqetësuar**.

Ç'vërejtët? Në shembullin e fundit, mbiemri i shqetësuar lidhet me foljen jam (është) dhe është kallëzuesor.

Mbiemri si përcaktues i emrit mund të përdoret i paveçuar (shih shembujt e mësipërm) dhe i veçuar p.sh.:

**I kënaqur shumë**, trajneri fluturonte nga gëzimi.

Trajneri, **i kënaqur shumë**, fluturonte nga gëzimi.

Dini, **i dëshpëruar**, përplasi shkopin.

### Ushtrime

1. **Me emrat:** qiell, libër, sjellje, mal, qytet **ndërtoni grupe emërore duke u shtuar këtyre mbiemra.**

2. **Me emrat bërthamë:** vajzë          shok          shkollë          kopsht

**Ndërtoni grupe emërore sipas këtyre modeleve:**

**përemër dëftor + emër bërthamë**

**përemër dëftor + emër bërthamë + mbiemër i nyjshëm**

**përemër i pacaktuar + emër bërthamë + emër në gjinore**

**emër bërthamë + përemër pronor + mbiemër i nyjshëm**

**numëror + emër bërthamë + mbiemër + emër me parafjalë**

3. **Në fjalitë e mëposhtme nënvizoni me një vijë mbiemrin përcaktor të paveçuar dhe me dy vija mbiemrin përcaktor të veçuar.**

1. Të lyera me bojë të bardhë, ndërtesat dalloheshin që nga larg.

2. Lokomotiva e re, e shkëputur nga vargu i gjatë i vagonëve, kaloi në shinat paralele.

3. Njeriu punëtor çmohet nga të gjithë.

4. **Lexoni fjalitë e mëposhtme, gjeni grupet emërore dhe përcaktuesit e shprehur me emra i zëvendësoni me përcaktues të shprehur me mbiemra.**

1. Gjatë dimrit veshim rroba prej leshi.

2. Ardiani është nxënës me talent.

3. Besiana ka veshur bluzë mëndafshi.

4. Dje mësuam diçka me rëndësi.

# STRUKTURA THEMELORE E FJALISË

## Rikujtohuni !

Cilat janë gjymtyrët kryesore të fjalisë? Po gjymtyrët e dyta (plotësuese)?

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm. Gjenerali fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra.

Vapë e madhe. Pushimet po mbarojnë. Drita është sa e lumtur, aq edhe e pikëlluar. Ajo bëri shëtitjen e fundit nëpër fshat. Me shumë mbresa e kujtime largohen nga fshati. Kudo mbretëronte qetësi e madhe. Lart në qiell lundronin dy tri re si floku i dëborës. Një herë e lehtë i lëvizte ato, ashtu siç e lëvizin anijen valët e detit. U err. Një mjegull e bardhë lundron mbi luginë. Do bjerrë shi.

Ky tekst përbëhet nga fjali të thjeshta dhe të përbëra. Dy fjalitë e para dhe dy të fundit janë fjali të thjeshta, por me strukturë (ndërtim) të ndryshme.

Fjalja e parë **Vapë e madhe** ka vetëm një gjymtyrë kryesore që shprehet me një grup emëror (togfjalësh emëror).

Fjalja **U err** po ashtu shprehet vetëm me një gjymtyrë kryesore, me **folje-kallëzuesin**.

Në gjuhën shqipe ka edhe një tip fjalie ku mungon një nga gjymtyrët kryesore.

Këto quhen **fjali njëkryegjymtyrëshe**. Varësisht nga gjymtyra që mungon ato mund të jenë:

Fjali foljore ku kallëzuesi nuk shoqërohet nga kryefjala:

**Vetëtin**. Rrugës kishte plot njerëz.

Fjali emërore ku mungon kallëzuesi:

**Natë**. Qiell i kaltër. Vapë e madhe. Ja deti.

Pra fjalja tip përbëhet nga dy grupe fjalësh: nga **grupi emëror (GE1)** që mund të jetë edhe një emër i vetëm dhe nga **grupi foljor (GF)**.

Grupi foljor përmban në vetvete foljen – kallëzues ( F ) dhe një grup tjetër emëror (GE2): kundrinorët e foljes, rrethanorët ose kallëzuesorin e kryefjalës



## Kryefjala dhe veçoritë e saj

Kryefjala është pjesë e domosdoshme që duhet të njihet, sepse prej saj fillojnë lidhjet e fjalëve të tjera, e sidomos ajo e foljes ( kallëzuesit ), e cila duhet t'i përshtatet kryefjalës.

### Vendi i kryefjalës

Ajo ndodhet shpesh para foljes:

a) **Rrezet** e diellit pranveror *u derdhën* mbi majat e thepisura të maleve.

Por, kur duam ta theksojmë, ta vëmë në dukje më shumë, kryefjala del në fund, pas foljes: Mbi majat e thepisura të maleve u derdhën **rrezet** e diellit pranveror.

b) **Përshtatja e kryefjalës me foljen** (kallëzuesin) . Kryefjala i përcakton foljes vetën dhe numrin (njëjës ose shumës) . Pra, **folja përshtatet në vetë dhe në numër** me kryefjalën:

Nxënësi **përparon** në mësim.

Nxënësit **përparojnë** në mësim.

c) Mund të **zëvendësohet me një përemër vetor** (nga ai, ajo, ata, ato) (të përemërzohet):

Besniku punon në kopsht. Ai punon shumë.; ose me një përemër pyetës (kush?, cili?, cila? etj.) te fjalitë pyetëse : Kush (Cili) u vonua? – Valoni.

d) nga pikëpamja gramatikore kryefjala tregon atë që kryen a që pëson veprimin ose që ndodhet në gjendjen e shprehur nga folja:

**Ai** s'kishte parë ujëvarë më magjepse.

**Ujëvara** dukej si e argjendtë.

### Shprehja gramatikore e kryefjalës

Kryefjala shprehet :

a) me **një emër**: **Arta** shkruan bukur. **Dita** sapo kishte nisur të zbardhte.

b) me **një përemër**: **Ai** ishte gazmor.

c) me **një grup emëror**: **Fytyra e tij e skuqur** tregonte shqetësimin shpirtëror.

d) me **një pjesë të nënrenditur në fjalinë e përbërë**: U pa qartë **se kjo punë s'mund të bëhet**.

Në një fjali mund të ketë disa kryefjalë homogjene, që i përkasin të njëjtës foljeje, si p.sh.: **Genci, Agimi dhe Petriti** janë shokë të ngushtë .

# GRUPI FOLJOR

Lexoni tekstin e mëposhtëm. Vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza dhe tregoni se çfarë shprehin ato.

Dafina **kishte hipur** në malin e Apolonisë që **të përgjonte** nga lart lëvizjet mbi fushën e përmytur. Sytë iu **vagëlluan** nga lotët dhe të mugëtit e mbrëmjes. **Brodhi** tatëpjetë kodrës dhe e **mbajti** frymën në buzë të kënetës. Që atje **mund të shihet** më mirë, në të ngrysurit e natës, që **tkurr** horizontin, ardhjen e lundrës me të shoqin dhe të birin...

Fjalët e shkruara me të zeza janë kallëzues (folje). Tregoni në ç`kohë e mënyrë janë foljet. Ç`përfaqësojnë ato në fjali ?

Folja në fjali përfaqëson **kallëzuesin, atë që thuhet për kryefjalën.**

Pra, gjymtyra e dytë e fjalisë është kallëzuesi, i cili mund të shprehet vetëm me një folje në një nga mënyrat vetore, si: **kishte hipur, vagëlluan, brodhi** etj.

Në pjesën më të madhe shprehet me një **grup foljor**, me një **mbiemër**, një **emër** ose një **grup emëror** dhe quhet **kallëzuesor i kryefjalës**, sepse lidhet me kryefjalën nëpërmjet foljes si: **jam, dukem, mbetem** etj. Dallojmë dy lloj kallëzuesorësh:

1. **Kallëzuesorin e kryefjalës** dhe 2. **Kallëzuesorin e kundrinorit të drejtë.**

1. Kallëzuesori i kryefjalës **është një mbiemër** që përshtatet në gjini numër dhe rasë me kryefjalën dhe **tregon një karakteristikë të qenies a të sendit** që emërtohet nga kryefjala e foljes: Brigjet e Adriatikut janë **të mrekullueshme**.

Ai zakonisht ndodhet pas foljes, por kur duam ta theksojmë e vëmë në krye të fjalisë, p.sh.: **Të mrekullueshme** janë brigjet e Adriatikut.

Kur kallëzuesori i kryefjalës është mbiemër, përshtatet në gjini, numër dhe në rasë me kryefjalën: Hëna **duket e zbehtë**. Teuta u zgjodh **deputete**. Artani u emërua **drejtor i shkollës**.

## Shënim

Kur kallëzuesori shprehet me një mbiemër, përemër a grup emëror dhe lidhet me kryefjalën me foljen **jam**, në tekstet gramatikore quhet edhe kallëzues emëror.

## Kallëzuesori i kundrinorit të drejtë

Analizoni fjalitë e mëposhtme.

Në dhomë siguresën e gjeta **të djegur**.

Shokun e lashë **të gëzuar**.

Në shembujt e mësipërm fjalët **të djegur** dhe **të gëzuar** janë kallëzuesorë të kundrinorëve të drejtë.

a) Kallëzuesori i kundrinorit të drejtë është një mbiemër, emër ose grup emëror që lidhet me kundrinorin e drejtë nëpërmjet foljesh: **kam** (për, si), **gjej**, **caktoj**, **zgjedh** etj.

b) Ai vendoset zakonisht pas foljes dhe pas kundrinorit të drejtë, por kur duam ta theksojmë e vëmë para foljes, madje edhe para kundrinorit, p.sh.: **Të madhe** e kishte zemrën nënë Tereza. **Të matur** e kishte fjalën.

c) Kur është i shprehur me mbiemër, përshtatet në gjini, numër dhe rasë me kundrinorin e drejtë.

### Ushtrime

1. Dalloni gjymtyrët kryesore në fjalitë e mëposhtme. Aeroplani ra në det. Nata po afrohet. Drita e ditës tretet dalëngadalë dhe mbi tjegullat e shtëpive, mbi fletët e pemëve, një ngjyrë manushaqeje shtrihet dhe i mbështjell. Hijet bëhen më të dendura, më të zeza.

2. Formoni fjali me fjalët dhe grupet e fjalëve :

a)	anëtar	b)	jam
	shkencëtar		u larguan
	të gjithë		fluturoj
	pilot		nis të flas
	fëmijë		punoj
	shkrimtar		stina e vjeshtës

Ndërroni numrin e emrit ose të përemrit kryefjalë dhe bëni përshtatjen e foljes.

Kjo është e vetmja ndërtesë në lagjen tonë . Ai gjuan me zagarin e tij. Langoi po e ndiqte këmba – këmbës kaprollin. Mësuesi im është i sjellshëm. Ai foli bukur në miting. Uji i liqenit duket i pastër.



# RRETHANORËT DHE LLOJET E TYRE

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza.  
Ç`funktion kryejnë ato në fjali?

Në pranverë fusha e gjerë ishte veshur me ngjyra dhe me blerim të freskët. Pikat e shiut rrokulliseshin në faqet e pjerrëta të çatisë, duke shpejtuar të binin sa më parë në tokë e pastaj të avulloheshin dhe të ngjiteshin prapë atje lart, në qiellin e kaltër. Porsa pushoi shiu, bujqit shkuan në fushë. Ata ia filluan punës menjëherë.

Fjalët e shkruara me të zeza tregojnë rrethanat në të cilat kryhet një veprim, prandaj quhen rrethanorë.

Shprehja e rrethanave në fjalinë e thjeshtë bëhet nëpërmjet rrethanorëve:

-me anë të ndajfoljeve të ndryshme,

-me emra me ose pa parafjalë dhe

-me forma të pashtjelluara të foljes (me paskajore, përcjellore dhe pjesore),  
ndërsa në fjalinë e përbërë: me pjesët e nënrenditura rrethanore.

Sipas rrethanës që tregojnë rrethanorët marrin edhe emra:

-rrethanor vendi: Bujqit shkuan në fushë.

-rrethanor kohe: Kam lindur në fshat.

-rrethanor mënyre: Fliste bukur.

-rrethanor shkaku: Fytyra iu çel nga gëzimi.

-rrethanor qëllimi: Kemi ardhur në shkollë për mësim.

rrethanor sasi: Flisnin shumë.

## Gjymtyrët homogjene

Lexoni me vëmendje fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza. Ç`funktion kryejnë ato në fjali?

**Fusha, kënetat, qielli, kodrat** kishin fituar atë ditë një ngjyrë të zbardhuar. Gjëmonte **qielli** dhe **toka**.

Tash po i **shoh** e po i **njoh** të gjithë.

Atje tej dëgjohej hingëllimi i **dëshpëruar, i mallëngjyer, i ngjirur, i kapitur** i një kali.

Fjalët e shkruara me të zeza janë gjymtyrë homogjene dhe janë të barasvlershme për nga funksioni që kryejnë në fjali dhe i përkasin së njëjtës gjymtyrë fjalie.

Në shembujt e fjalive 1. dhe 2. kemi kryefjalë homogjene, në fjalinë 3. kallëzues homogjenë, ndërsa në fjalinë 4. përcaktor homogjenë.

## Gjymtyrët homogjene sipas funksionit

### a) Kryefjalë homogjene:

**Urtësia** dhe **dituria** e dëbojnë varfërinë.

**Drita** dhe **Arbëri** janë nxënës shembullorë.

Jo vetëm **shkolla**, por edhe **familja** ndikojnë në edukimin e fëmijës.

### b) Folje - kallëzues homogjenë:

As nuk **fle** dot dhe as zgjuar **s'mund të ri**.

Gjithë kohën **punonte, lexonte** dhe **shkruante**.

### c) Kallëzuesorë homogjenë:

Vera **ishte e nxehtë** dhe **e thatë**.

Rrobat e tregonin Bujarin **më të rritur, më serioz**.

### d) Përcaktorë homogjenë:

Kishte sy **të errët, të butë, të thellë** e si **të trishtuar nga një brengë**.

Populli ynë ka një folklor **të pasur e të gjerë**.

### e) Kundrinorë homogjenë:

Ajo kërkonte prej fëmijëve të saj **guxim e këmbëngulje, urtësi e durim**.

Jo vetëm **Agronin**, por edhe **Petritin** i njoh qëmoti.

### f) Rrethanorë homogjenë:

Kjo punë bëhet ose **tashti** ose **kurrë**.

**Mbi pemë** e **mbi çatitë** e shtëpive lejlekët kishin ndërtuar foletë e tyre.

## Përdorimi i presjes te gjymtyrët homogjene

Midis gjymtyrëve homogjene që nuk bashkohen me lidhëza, vihet presje: P.sh: Majat e maleve, pemët, çatitë e shtëpive dhe fushat ishin zhytur në një hije të thellë.

Presje vihet edhe para lidhëzave kundërshtore po, por, si dhe para lidhëzave të përsëritura dhe para pjesës së dytë të lidhëzave dyshe:

Ishte vajzë e bukur, por e papërmbajtur.

## Ushtrime

### 1. Dalloni gjymtyrët homogjene dhe thoni se cili është funksioni i përbashkët që kryejnë në fjali.

Urdhëroi të ndalohet grumbullimi i njerëzve në rrugë, në sheshe ose në shtëpi.  
Ajo ishte një nga ditët më të paharruara e më të lumtura.

Bardhësia e dëborës shtrihej në malet e larta, në shkrepat, në rrëpirat.

Trimëria dhe liria janë nënë e bijë.

E ndiente veten edhe të kënaqur edhe të lumtur në mes të këtyre të rinjve.

Pa buke e pa rroba, pa këpucë e pa fishekë kam jetuar e kam luftuar dhe jam vvarë e jam prerë tërë jetën me armiqtë.

### 2. Shkruani dy fjali ku të përdorni lidhëzën e dyfishtë:

a) jo vetëm ....., por

b) lidhëzën e përsëritur ose..., ose

c) lidhëzën po (por).

## TIPAT E FJALIVE DHE STRUKTURA E TYRE

Lexoni tekstin e mëposhtëm. Vëreni fjalitë dhe shenjat e pikësimit që janë përdorur në fund të tyre. A dallohen ato njëra prej tjetrës?

Një mbrëmje unë isha i lodhur dhe doja të flija. Harilla mësonte. I thashë:

- Nuk e fikim llambën dhe flemë?

- Jo, kam ende për të mësuar.

- Do të bësh si të them unë!

- Kush të pyet ty!

- Si kush më pyet mua?! E kemi përgjysmë. Ti e kë blerë?!

- Unë do mësoj dhe ti bëj si të duash!

- Fike të thashë!

Fjalitë që janë dhënë në këtë tekst ndryshojnë njëra prej tjetrës për nga kuptimi, për nga mënyra e të shqiptuarit të tyre dhe për nga shenjat e pikësimit.

Gjatë komunikimit sa herë që marrim fjalën, ne i njoftojmë të tjerët për diçka ose pyesim për gjërat që nuk i dimë ose i urdhërojmë e i nxisim për të bërë diçka, ose shprehim ndonjë dëshirë ose emocion të veçantë.

Kështu, dallohen disa tipa fjalish: dëftore, pyetëse, dëshirore dhe thirrmore.

## Fjalja dëftore

**Me anët të fjalisë dëftore folësi paraqet atë që di, atë që mendon, atë që ndjen, atë që ka bërë, atë që ka ndodhur.** Me një fjalë, folësi i jep një informacion bashkëbiseduesit të vet. P.sh.:

Po i afrohem pyllit. Duhet shuar zjarri.

Fjalja dëftore shqiptohet me një intonacion tregues, zakonisht të qetë, të njëjtë me një ritëm mesatar. Në të shkruar në fund të saj vihet pikë.

## Fjalja pyetëse

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni përse shërbejnë ato.

A i doni përrallat?

A nuk e zgjidhe ende detyrën?

A vilet rrushi në vjeshtë?

Mos do të vish tek unë nesër?

Fjalitë pyetëse janë ato që shërbejnë **për të pyetur** për diçka që nuk e dimë.

Me anën e fjalisë pyetëse folësi i bën një pyetje bashkëbiseduesit të vet dhe pret një përgjigje prej tij.

Dallojmë dy lloj fjalish pyetëse:

Fjala pyetëse **tërësore** dhe fjalja pyetëse **e pjeshme**.

### A. Fjalja pyetëse tërësore

Fjalja pyetëse tërësore shërben për të pyetur për diçka që **nuk e dimë në mënyrë të plotë** ose për t'u siguruar për vërtetësinë e një fakti që nuk e njohim. Kësaj fjalie **mund t'i përgjigjemi** me **po** ose **jo** ose me ndonjë fjalë tjetër e barasvlershme me to, si **sigurisht, pa dyshim, aspak, në asnjë mënyrë** etj.

Nga ana ndërtimore, fjalja pyetëse tërësore ka këto karakteristika:

a) Shpesh kryefjala del pas foljes e në mjaft raste në fund të fjalisë.

b) Mund të përdoren pjesëzat: **a, vallë, a mos**.

- Vallë, a ishte punëtor i zellshëm Ahmeti?

c) Mund të mos bëhet asnjë lëvizje dhe asnjë shtesë dhe pyetja të realizohet vetëm me anë të intonacionit:

- Shkëlzeni ishte mburravec?

## B. Fjalja pyetëse e pjesshme

Fjalja pyetëse e pjesshme shërben për të bërë një pyetje **që nuk lidhet me veprimin e foljes**, por me **kryefjalën, kallëzuesorin, kundrinorin** apo me **rrethanorin** dhe nuk mund t'i përgjigjemi me **po** ose **jo**. P.sh.:

**Kush** reciton bukur? (Besimi- kryefjalë)

Nxënësi i cilës shkolle është Besimi (i shkollës së mesme- **përcaktor**)

**Kur** do të shkoni në teatër? (të dielën- rrethanor)

**Ç**'shkruan Fisniku? (një letër - kundrinor)

Në fund të fjalisë pyetëse vihet pikëpyetje.

## Fjalja nxitëse

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni se ç'shprihen ato. Në ç'mënyrë e kanë foljen- kallëzues.

**Më ndihmo** pak, të lutem.

**Ejani** nesër për drekë te ne, - e ftoi motra.

**Dil përjashta!** – i bërtiti mësuesi.

**Të nisemi** menjëherë.

Këto janë fjali nxitëse.

Me anën e fjalisë nxitëse folësi i jep një urdhër bashkëbiseduesit ose i shfaq një kërkesë për realizimin ose mosrealizimin e diçkaje. Këto fjali shprehin **një urdhër të prerë, një këshillë, një kërkesë, një propozim a një lutje**. P.sh.:

- Ndall!- thirri roja.

Fjalitë nxitëse foljen - kallëzuesin e kanë zakonisht në **mënyrën urdhërore**, por përdoret edhe koha e tashme e mënyrës lidhore, si dhe e tashmja dhe e ardhmja e dëftores.

Gjejini këto përdorime në fjalitë e mëposhtme:

Fillojmë atëherë shokë!- tha Arta.

Do të bësh ashtu si të them unë,- i tha i ati.

Thuajti Skënderit të mos vonohet.

Me vlerën e një fjalie nxitëse na paraqiten edhe disa fjali pa folje, si p.sh.:  
Shpejt!- Qetësi! Mos?- Jo?

## Fjalja dëshirore

Lexoni fjalitë e mëposhtme. Ç'shpreshin ato?

- **Ah sikur të kem një kompjuter!**
- **Ju këndoftë zemra, o bijtë e mi!** – uroi xha Miti nga fundi i zemrës.
- **Qofshi gjithmonë të gëzuar, o djemtë e mi!**
- **Dalshi faqebardhë!**

Fjalja dëshirore, ashtu si edhe fjalja nxitëse, shërben për të shprehur vullnetin e folësit për realizimin e mosrealizimin e një veprimi ose të një dukurie, por ky vullnet i folësit shprehet në mënyrë dëshirore (këndoftë, qofshi, dalshi etj.) dhe në mënyrën lidhore (të kem).

## Fjalja thirrmore

Analizoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni llojin e tyre.

- **Hajde, o Skënder, ç'zemër që më paske!**
- **Edhe ju paskeni shkuar në shëtitje?!**
- **O sa bukuri ka tufa, sa gas bie bagëtia!**
- **O moj flutur krahëshkruar, eja këtu tek unë!**

Të gjitha llojet e fjalive: **dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore** mund të jenë fjali thirrmore, dhe të shprehin një ndjenjë të fuqishme: habi, admirim, gëzim, entuziazëm, zemërim, padurim etj.

Në të folur, fjalja thirrmore karakterizohet nga një ton i ngritur në një pjesë të komunikimit dhe nga një theks intensiteti të veçantë mbi fjalë të caktuara.

Në fund të fjalive thirrmore vihet pikëçuditje.

Fjalitë thirrmore shpesh foljen e kanë në mënyrën habitore dhe shoqërohen me pasthirrma si dhe me pjesëza dhe përemra e ndajfolje pyetëse:

Sa qenke rritur! Ç'vepër madhështore!

Dalloni fjalitë thirrmore në shembujt e mësipërm.

## Fjalja mohore

Kur folësi shpreh një mendim në ligjërim, njëkohësisht bën edhe vlerësimin e thënies lidhur me realitetin për cilin flitet. Kështu që të gjitha fjalitë, sipas kumtimit mund të jenë pohore dhe mohore. Fjalitë pohore pohojnë a miratojnë diçka si të vërtetë. P.sh.:

Toka duhet punuar mirë.

Të mirën e do çdo njeri.

Fjalja mohore tregon se veprimi ose dukuria e shprehur nuk kryhet ose kryhet, por me disa kufizime. Pra, këto fjali shprehin një mohim. Në këto fjali para kallzuesit përdoren pjesëzat mohuese **nuk, s', pa, mos, as** dhe atëherë kemi mohim të thjeshtë. P.sh.:

Besa **nuk** e zgjidhi detyrën.

Lindita e zgjidhi problemin **pa** vështirësi.

Ka disa lloje ndërtimesh mohore, por më kryesoret janë: **mohimi i plotë ose tërësor, mohimi i pjesshëm, fjalët përgjigje – mohuese.**

Pjesëzat **nuk, s'** dhe **mos** përdoren për të treguar se veprimi nuk është kryer, nuk kryhet ose nuk do të kryhet. Pjesëzat **nuk** dhe **s'** përdoren para foljeve në mënyrën dëftore, kushtore e habitore. Ndërsa pjesëza **mos**, para foljeve në mënyrën dëshirore, urdhërore dhe lidhore. P.sh.:

Nuk shkon në shëtitje.

Nuk do të shkojë në shëtitje.

Nuk shkuaka në shëtitje.

**Jepni shembuj të përdorimit të pjesëzave mohuese në bashkëvajtje me folje në mënyra të ndryshme.**

Mohimit tërësor mund t'i shtohen edhe fjalë të tjera si: **kurrë, më, asnjëherë, për të treguar se mohimi nuk do të kryhet asnjëherë, në asnjë çast.**

Ai nuk do të shkojë **kurrë** në kurbet.

Ai nuk do të shkojë **kurrë më** në kurbet.

Ai nuk do të shkojë **asnjëherë** kurbet.

## Mohim i pjesshëm

Mohim të pjesshëm kemi atëherë kur nuk mohohet folja, por një gjymtyrë (përbërës) tjetër e fjalisë. Përdoren më shpesh pjesëzat mohuese, **pa, jo**:

Ai shkoi në punë **pa** mjete.

E ftuan në dasmë Blertën, **jo** Vjosën.

Fjalive mohore u përgjigjemi me pyetjen: **jo, kurrë, asnjë, asgjë** etj.

E takove Ilirin?

- Jo

Fjalja mohuese mund të përforcohet: **-jo, sigurisht që jo** etj. ose të zëvendësohet nga një shprehje emocionale: - **Kurrë në jetë; në asnjë mënyrë** etj.

Ushtrime

### 1. Dalloni fjalitë mohore. Tregoni me se janë ndërtuar ato.

Nuk e di po i Edit s'është. Po mos u mërzit e mos fli, moj nënë, se nuk do të vonohemi. S'e ka lexuar këtë libër?

Me të ligun as mos u miqëso, as mos u gjakëso.

Lajka nuk të bën të madh.

### 2. Lexoni pjesën dhe thoni ç'tip fjalish janë.

Maturantët, duke bërë shaka e duke qeshur, u radhitën te shkallët e shkollës.

- Gati jeni?....Shikoni këtu!.....- tha Gojarti. "Shtrak" u dëgjua shprehja e aparatit.

- Me shëndet! Bëfshi fotografi edhe më të bukura!

Turma e të rinjve u shpërnda gjithë duke qeshur.

Rrofsh Gojart!....More, po qenke tamam fotograf ti! Si se paskemi ditur?!  
Tani e tutje nuk do të të thërrasim më Gojart, por Arti artisti.

### 3.Fjalitë e mëposhtme dëftore kthejini në fjali pyetëse dhe pyetëse thirrmore.

#### Shkruajini fjalitë.

Asnjë qytet te ne nuk është më i bukur se Ohri.

Ende s'e ka takuar vëllanë Agroni.

Ligji nuk lejon të ndërtohet këtu.

Largësia midis yjeve matet me kilometra.

## RENDI I FJALËVE NË FJALI

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza dhe ato me të pjerrëta. Ç'funksion kryejnë ato?

Filloi të binte shi i imtë dhe atij iu duk se vija e filmave të shpërdorur kishte dalë nga ekranet për të pushtuar qiellin gri. **Orana** dilte si nga ekranet për të zënë pamjen rreth e rrotull. **Ajo** u impononte të gjithëve diçka. Edhe **qielli** kishte marrë ngjyrën e syve të saj.

- **Ti** do të bëhesh mësuese e mirë,- tha Gjergji.

- Nuk e ndien lëvizjen e shkollës? – filloi ajo pa e përfillur. Në mëngjes



dhe pasdite dhjetëra fëmijë shkojnë nga një fshat në tjetrin, në shi dhe në erë. Duken si zogj dimri. I kanë krahët e ngrirë.

Në gjuhën tonë ka një farë lirie në rendin e fjalëve (gjymtyrëve) në fjali. Shumë prej tyre mund të zënë vende të ndryshme në fjali.

Zakonisht, fjalët në fjali radhiten sipas një rendi pak a shumë të caktuar dhe ky është **rendi normal** për të shprehur qartë mendimet tona.

Por, kur duam të shprehim më fuqishëm një ide ose një emocion e ndryshojmë rendin normal të përbërësve të fjalisë, me qëllim që ta theksojmë më shumë atë gjymtyrë që dëshirojmë.

**Rendi normal i gjymtyrëve të fjalisë dëftore është:**

<b>Kryefjalë</b>	<b>përcaktor</b>	<b>folje</b>	<b>kundrinor</b>	<b>përcaktor i kundrinorit</b>
Era	e fortë	theu	degët	e pemëve.

Në **fjalinë pyetëse** kryefjala ndodhet zakonisht **pas foljes**.

Kur ke qenë për herë të fundit në Prishtinë (**ti**)?

Kur duam të theksojmë një gjymtyrë të fjalisë p.sh. kryefjalën , atëherë mund të bëjmë zhvendosjen e saj:

Linditën e vogël nëna e kishte përkundur në një djep druri. (kundrinor i drejtë).

Ndihej gëzimi i madh i fëmijëve.

Mund të dalë në krye të fjalisë edhe një nga plotësorët e foljes, zakonisht një rrethanor, por edhe kundrinor e kallëzuesor:

**Si luan** vërsulu. (rrethanor mënyre)

Nëpërmjet veçimit të një përbërësi të fjalisë më shpesh të një rrethanori ose përcaktori:

**I rrëmbyer** nga kujtimet; Dini u hodh përpjetë.

Më shpesh ndërrimi i fjalëve bëhet:

Sidomos në poezi:

Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla **mjerimi**.

Ushtrime

**1. Analizoni rendin e përbërësve të fjalive të mëposhtme dhe thoni për secilin përbërës në është në rend normal apo është zhvendosur për t'u vënë në dukje.**

1. Zbulimi i pikturave dhe i skulpturave të vjetra flet për traditat e lashta

të popullit tonë. 2. – Me nder e kemi fituar bukën tërë jetë. 3. Kishin çelur lulet e para të pemëve. 4. – Filloi përsëri bora! – tha gjithë gëzim Beni i vogël.

2. Çfarë rendi fjalësh ka përdorur Asdreni në këtë poezi? Analizoni dhe komentoni.

Lart, Shqipëri,  
ti je e zonja!  
me trimëri,  
porsi shqiponja,  
armiqve të mos u fshihesh!  
Si burrë sulu, ata dërrmoji,  
Me gjak të drejtat mbroji!  
Përpara shko, përpara!

## FJALIA E THJESHTË DHE FJALIA E PËRBËRË

Rikujtohuni!

C`është fjalia e thjeshtë?

Si e dallojmë fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbërë?

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni nga sa folje kanë ato. Vëreni fjalitë nën a) dhe nën b).

a) **E dua** detin.

Deti **është** si **një nënë** zemërgjerë.


Mallkimi i nënës **të zë**.

b) Mua deti kurrë s'më **ka mallkuar**, se unë nuk **jam zemëruar** me të...

Mora një levrek të madh nga ata që **kisha nxjerrë**, i çava barkun dhe **i futa brenda** një dinamit të tërë.

Tri fjalitë e mësipërme, nën a) janë fjali të thjeshta, sepse kanë vetëm nga një folje (kallëzues) në një nga mënyrat vetore. Ndërkaq, fjalitë nën b) janë të përbëra, sepse secila fjali ka më shumë se një folje në një nga mënyrat vetore.

Fjalja e thjeshtë apo pjesë e fjalisë së përbërë quhet ajo që ka vetëm një folje në një nga gjashtë mënyrat vetore: dëftore, lidhore, dëshirore, kushtore, habitore dhe urdhërore, ndërkaq format e pashtjelluara të pjesores, paskajores, përcjellores e mohores nuk mund të jenë bërthama fjalie dhe si të tilla nuk formojnë as fjali, as pjesë të fjalisë së përbërë, por mund të shërbejnë vetëm si gjymtyrë fjalie.



Të dy llojet e fjalive kanë të përbashkëta:  
 kumtojnë një përmbajtje të plotë;  
 gjenden ndërmjet dy pushimeve të gjata;  
 kanë intonacion të përfunduar.

### MBANI MEND

Fjalja e thjeshtë është ajo pjesë e fjalisë që ka vetëm **një folje** në një nga 6 mënyrat vetore. E këto janë: **mënyra dëftore, lidhore, kushtore, dëshirore, habitore** dhe **urdhërore**. Ndërkaq format e **pashtjelluara të pjesores, paskajores, përcjellores** e **mohores** nuk mund të jenë bërthama fjalie dhe si të tilla nuk formojnë as fjali as pjesë të fjalisë, por mund të shërbejnë vetëm si gjymtyrë fjalie.

Fjalja e përbërë quhet ajo fjali e cila përbëhet të paktën nga dy ose më shumë pjesë fjalish (ka dy e më shumë folje) në një nga mënyrat vetore.

Fjalitë e përbëra janë dy llojesh: a) **fjali të përbëra me bashkërenditje** dhe b) **fjali të përbëra me nënrenditje**.

## MJETET GJUHËSORE TË FJALISË SË PËRBËRË

Fjalja e përbërë përbëhet nga dy a më shumë pjesë.

Mjetet me të cilat lidhen pjesët e një fjalie të përbërë janë:

a) **lidhëzat** që mund të jenë:

- bashkërenditëse: **dhe, edhe, por, kurse ose, apo, prandaj** etj. P.sh.: Ai ishte i lodhur, por në fytyrën e tij shkëlqente hija e një gëzimi djaloshar.

- nënrenditëse: **se, sepse, në qoftë se, ndonëse** etj. P.sh.: Të mos

harrojmë se shpirti i një kombi është gjuha amtare.

b) **fjalët lidhëse**: përemrat lidhorë: **që, i cili** dhe ndajfoljet: **ku, nga, kur** etj. P.sh.: Dëgjohej vetëm shushurima e Shkumbinit që rridhte si gjithnjë në rrapet shekullore.

c) **Intonacioni**-fjalitë lidhen ndërmjet tyre pa lidhëza e mjete lidhëse. P. sh.: Zure gjarprin, shtypi kokën.

Ushtrime

1. **Dalloni mjetet që lidhin pjesët e fjalisë së përbërë në fjalitë e mëposhtme:**

Kur vdiq Skënderbeu, asnjë sy nuk mbeti i papërlotur. Mbretëresha dhe i biri dymbëdhjetë vjeçar të gjunjëzuar përpara kufomës së tij, po lebetitnin. Princërit rreth e rrotull po qanin si foshnjat dhe vajtonin pas mënyrës shqiptare me këngë.

Disave ju pëlqejnë më shumë librat, që janë me temë nga astronomia.

Është më lehtë të bësh pyetje, sesa t`u përgjigjesh atyre. Mund të vish edhe ti, por me kusht që të tregohesh i kujdesshëm.

## RRETHANORI I KOHËS

**Rikujtohuni!**

Ç`tregojnë rrethanorët?

Me cilën gjymtyrë lidhen në fjali?

### Shprehja e rrethanës së kohës në fjalinë e thjeshtë

Lexoni fjalitë e poshtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç`shprehin ato?

Aliu punon **prej mëngjesi**, e gjer **në mbrëmje**.

**Dje** ra shumë shi.

Punimet e Kongresit të Manastirit përfunduan më **23 Nëntor 1908**.

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë rrethanorë kohe.

Rrethanori i kohës tregon **kohën a çastin** kur kryhet një veprim dhe

shtrirjen e tij në kohë, përkatësisht kohëzgjatjen a mbarimin e veprimit. (Shih shembujt e mësipërm).

## Shprehja kohës në fjalinë e thjeshtë ose në një pjesë të fjalisë së përbërë

Çasti (koha) e veprimit mund të shprehet:

a) me ndihmën e kohëve të foljes:

Në mbrëmje ai **u takua** me shokët.(çasti i kohës ë shkuar).

Nesër **do të shkojmë** në ekskursion (çasti i kohës së ardhme).

Por, kohët e foljes rrallë përdoren të vetme dhe koha përcaktohet me saktësi me ndihmën e rrethanoëve të kohës që mund të shprehen:

b) **me një grup emëror rrethanoor**, me ose pa parafjalë:

**Në mbrëmje** iu kujtua vendlindja e tij e dashur.

**Verës** plazhi mbushet me fëmijë.

c) me ndihmën e një ndajfoljeje kohe ose shprehje ndajfoljore: **sot, tani, nesër, dje, shpejt, vonë, sivjet; ditë e natë, ditë për ditë, dy ditë më parë, që sot e kësaj dite etj.** P.sh.: Ai punonte **ditë e natë**, po s'tregoi gjë.

d) me **ndihmën e një forme të pashtjelluar foljore, mohore dhe përcjellore.** P.sh.:

Shkoi në mal **pa gdhirë.**

Beni u kthye në shtëpi **pa u ngrysur.**

Në fjalinë e përbërë dhe me një pjesë të nënrenditur rrethanoore kohore e cila bashkohet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave kohore: **kur, para se, përpara se, sa herë që** etj. **Kur erdhe** t'i tek unë, unë kisha dalë nga shtëpia.

Rrethanoori i kohës shpreh **kohëzgjatjen** (vazhdimin e veprimit) dhe shprehet me një grup emëror rrethanoor që paraprihet nga parafjalët gjatë, deri, gjer. P.sh.:

Bisedova me Astritin **gjatë gjithë mbrëmjes.**

Kjo shitore rri hapur që **nga mëngjesi gjer në mbrëmje.**

Kohëzgjatja mund të shprehet:

a) me ndihmën e kohëve të foljes:

Gëzimi **po shkruan** një letër. (e tashme)

Në mbrëmje, derisa **po lexoja** një roman, më erdhi një shok. ( e pakryer)

b) me ndihmën e një grupi emëror rrethanoor që paraprihet nga parafjalët **gjatë, për** etj. me ose pa parafjalë:

Besa qëndroi **për orë të tëra** (orë të tëra) pa folur.

c) me ndihmën e një ndajfoljeje:  
Besa qëndroi **gjatë** pa folur.

## Shprehja e kohës në fjalinë e përbërë me nënrenditje

Edhe me pjesët e nënrenditura kohore mund të shprehet: **njëkohësi, parakohësi dhe paskohësi.**

1. Hekuri rrihet **sa është i nxehtë.** (njëkohësi)

**Sa të rrosh,** do të mësosh.

2. **Kur erdhe ti, ne kishim shkuar.** (parakohësi)

Mendohu mirë, **para se të flasësh.**

3. **Pasi u nis,** iu kujtua. (paskohësi)

**Pasi i ikën dhentë,** i erdhën mendtë.

# RRETHANORI I VENDIT

## Shprehja e rrethanës së vendit në fjalinë e thjeshtë

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.  
Me ç'pyetje mund t'i gjejmë ato

...**Në oborrin** e shtëpisë së vjetër, **pranë dritares,** gjelbëronin e fëshfërinin degët e gjetet me erë të një lisi të madh shekullor...

**Rrotull tij** ishin mbledhur shumë njerëz.

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë rrethanorë vendi dhe gjenden me pyetjen ku?, në ç'vend?.

**Rrethanori i vendit tregon vendin ku ndodh një veprim ose vendin ku ndodhet një send a një njeri.**

Rrethanori i vendit shprehet me:

**Ndajfolje ose shprehje ndajfoljore vendi: këtu, atje, poshtë lart, diku, kudo** etj. . P.sh.: Shëtita **lart e poshtë,** po s'të gjeta. **Kudo** shikoja gjelbërim.

Me ndihmën e një **grupi emëror me parafjalë: Nëpër rrugët e qytetit** përcëllonte asfalti i nxeur prej rrezeve të diellit.

Rrethanori i vendit mund të shprehë pozicionin, vendin ku ndodh një veprim.

P.sh.: Ai u ngjit lart.

Mund të **shprehë lëvizjen, vendosjen, drejtimin (për ku, drejt cilit vend)**. P.sh.: U nisën **për në Ohër**. Mund të tregojë edhe pikënisjen e veprimit: **që nga, nga ku, për nga**. P.sh.: Ky aeroplan u nis **nga Çikagoja**.

Rrethanori i vendit në fjalinë e përbërë me nënrenditje shprehet me pjesë të nënrenditur vendore. **Ku dhemb** dhëmbi, vete gjuha.

### **Shprehja e kohës në fjalinë e përbërë pa lidhëza dhe në fjalinë e përbërë me bashkërenditje**

Dy veprime ose dy dukuri mund të shprehen njëri pas tjetrit pa lidhëza ose të lidhëzës bashkërenditëse dhe mbi të gjitha të fjalëve **pastaj, më pas** për të përforcuar kuptimin kohor të njëpasnjëshmërisë që shpreh bashkërenditja:

a) pa lidhëza:

Unë erdha këtu, ndenja një kohë të gjatë.

b) me lidhëza:

Djemtë e vajzat morën skitë dhe u nisën për në mal.

Pasi i morën skitë, u nisën për në mal.

### **Ushtrime**

**1. Lexoni fjalitë e mëposhtme, gjeni rrethanorin e kohës dhe thoni me se janë shprehur:**

1. Gjithë këtë rrëmujë që ndodhte jashtë në mesditë, e shikoja nga dritarja e shtëpisë.

2. Ndeshja filloi në orën e caktuar.

3. Puna e filluar herët jep rezultate më të mira.

4. Nga java do të jem në pushime.

5. Gjatë kësaj kohe do të vizitoj muzeun e qytetit.

6. Kështu të punoni djema gjithnjë.

7. Mbrëmjeve gjatë shtatorit bie vesë.

8. Që atë ditë ai s'ka ardhur më.

**2. Vini lidhëzën që duhet me secilën prej fjalive të mëposhtme. Thoni nëse ka parakohësi, njëkohësi apo paskohësi në shprehjen e dy veprimeve.**

1. ....ndodhi kjo ngjarje, puna në tunel ishte në mbarim e sipër.
2. ....përtyp piper, nuk pështyn sheqer.
3. Ekipi mblidhej.....dhe diskutonte për detyrat e ditës së nesërme.
4. Përtype fjalën.....para se ta nxjerrësh.
5. A mund të rrish duarlidhur, .....të tjerët punojmë?
6. ....çlirimit i vetmi mjet për punimin e tokës ishte parmenda e drurit.

### 3. Shndërroni grupet emërore në pjesë të nënrenditura kohore.

- pas lindjes së diellit – para perëndimit të diellit.
- para largimit tonë – me lindjen e diellit
- gjatë udhëtimit tonë – deri në kthimin tonë.

### 4. Ndërtoni fjali të tjera të përbëra sipas këtyre shembujve:

- Pa zbardhur dita, nisej për në punë.
- Me të ardhur gjyshti, të gjithë u ngritën në këmbë.
- Sa herë që kishte kohë të lirë, Drita lexonte.

## RRETHANORI I QËLLIMIT DHE I SHKAKUT

### Shprehja e qëllimit

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç’funktion kryejnë dhe me cilat pyetje mund t’i gjejmë ato?

Agimi mbledh të holla **për ekskursion.**

Puno **për të mirën e popullit.**

Nëna punonte **për djalin e vogël.**

**Fjalët e mësipërme tregojnë qëllimin e kryerjes së një veprimi dhe janë rrethanorë qëllimi.**

Rrethanor qëllimi quhet gjymtyra që tregon qëllimin e kryerjes së një veprimi. U përgjigjet pyetjeve: **përse?, me ç’qëllim?, për çfarë qëllimi? Qëllimi është rezultati që synohet të arrihet me anën e kryerjes së një veprimi.**



## Shprehja e rrethanës së qëllimit në fjalinë e thjeshtë

Rrethana e qëllimit shprehet :

a) me **një ndajfolje pyetëse përse: Përse** ke ardhur këtu?

b) me **një emër ose me një grup emëror** me ose pa parafjalë: Ne kemi ardhur këtu **për mësim**.

c) me **formë të pashtjelluar të paskajores**: Ai shkoi në Amerikë për t'u specializuar **në fushën e kompjuterëve**.

**Në fjalinë e përbërë** rrethana e qëllimit shprehet:

a) me një pjesë të nënrenditur që fillon me një lidhëz qëllimore që, me qëllim që:

Puno që **të mos mërdhish**.

Ne të gjithë punojmë **që të kemi një jetë më të mirë**.

c) nëpërmjet të **një pjese të nënrenditur që nuk fillon me lidhëz**, por me një folje në mënyrën lidhore:

Adil, më ndihmo **të ngarkoj thesin**.

## Shprehja e shkakut

Lexoni fjalitë e mëposhtme, vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'shërbim bëjnë ato? Me ç'pyetje mund t'i gjejmë?

Pemët u thanë **nga ngrica**.

U lodha **së punuari**.

**Për shkakun tënd** u vonova në mësim.

Fjalët e theksuara janë rrethanorë shkakut dhe gjenden me pyetjet: **pse?, për ç'shkak?, për ç'arsye?**

Rrethanor shkakut quhet gjymtyra e dytë e fjalisë që tregon shkakun ose arsyen e kryerjes së një veprimi a të ndryshimit të një gjendjeje. Në këto fjali vihet në dukje **vepruesi** dhe **shkakut**.

**Shprehja e shkakut në fjalinë e thjeshtë ose në një pjesë të fjalisë së përbërë**

Shprehja e rrethanës së shkakut në fjalinë e thjeshtë bëhet nëpërmjet të rrethanorit të shkakut i cili mund të jetë:

a) një ndajfolje pyetëse **pse?:**

**Pse** u vonove mbrëmë?

b) një emër ose një grup emëror rrethanor shkaku i prirë nga parafjalët: nga, prej, ose nga shprehja parafjalore për shkak të P.sh.:

**Nga gëzimi** më kishte ikur gjumi.

Dielli i kuq dukej si i qethur prej ( për shkak) mungesës së rrezeve.

c) me një përemër:

**Prej teje** e pësova edhe unë.

ç) me formë të pashtjelluar përcjellore:

**Duke u ftohur** shpesh u sëmur rëndë.

## Në fjalinë e përbërë

Shprehja e rrethanës së shkakut në fjalinë e përbërë shkakore bëhet me ndihmën e një **pjese të nënrenditur shkakore** që lidhet me pjesën kryesore me lidhëzat: **se, sepse, nga që, me qenë se** etj., p.sh.:

Duart na kishin ngrirë, **nga që ishte shumë ftohtë**.

Shkolla do të ndërtohet aty, **meqenëse ( se, sepse)** kushtet janë më të mira.

Shprehja e rrethanës së shkakut në fjalinë e përbërë bëhet:

a) me ndihmën e pjesëve të lidhura pa lidhëza:

Xhaxhai nuk po më shikonte në sy, ishte nxehur keq **me mua**.

## Shprehja e pasojës

Lidhja e pasojës është gjithmonë e ndërsjella e lidhjes së shkakut. Nga dy dukuri të paraqitura njëra patjetër do të jetë shkak, kurse tjera pasojë, p.sh.:

Pemët u rrëzuan nga era e fortë. ( nga shkak i erës së fortë)

Pasoja ose ( rrjedhimi) mund të shprehet:

**Në fjalinë e thjeshtë:**

a) nëpërmjet të një grupi emëror që është kryefjalë e foljeve: **ndodhi, u shkaktua** etj:

Aksidenti ndodhi (u shkaktua) nga një gabim i shoferit.

b) nëpërmjet një grupi emëror që është kundrinor i drejtë i shprehjeve foljore: **pati për rezultat, solli si pasojë** etj.

Kriza ekonomike **pati për rezultat (solli si pasojë)** rritjen e papunësisë.

**Pasoja ose rrjedhimi në fjalinë e përbërë** mund të shprehet me anë të pjesës së nënrenditur rrjedhimore të paraprirë nga lidhëzat **që, kështu që**:

Flisnin shumë shpejt, **kështu që** nuk mora vesh.

Nuk është i humbur, **që** të mos e dijë këtë gjë.

Por, mund të shprehet me ndihmën e pjesëve pa lidhëza ose të bashkërenditura me lidhëzën dhe:

Ja lajtën mendtë, mund ta humbë kokën.

Ne jemi dy njerëz të ndryshëm, nuk mund të merremi vesh ia prit ajo.

Kishte rënë shumë dëborë dhe nga kjo thyheshin degët e pemëve.

## Ushtrime

### 1. Analizoni fjalitë e mëposhtme. Gjeni rrethanorët e shkakut dhe të qëllimit dhe thoni me se janë shprehur.

Ermira bëri disa gabime nga nxitimi.

Afërdita ngriti kokën për të parë dasmorët.

Mali oshtinte nga gjëmimi i bubullimave.

Nxënësve u shkëlqente fytyra nga lumturia.

Ata erdhën në Shkup për t'u regjistruar në një shkollë të mesme.

Shpesh na vinë shokët e shkollës për vizitë.

### 2. Gjeni rrethanorët e shkakut dhe të qëllimit. Thoni nga ç'gjymtyrë varen dhe me se shprehen.

1. Sytë i shkëlqenin nga lumturia. Këto ia kishte thënë nga inati. Për këtë gëzim të madh jemi mbledhur sonte. Kemi ardhur këtu për të mësuar. Ata shkojnë atje për gjah. Prej meje fitove edhe ti.

### 3. Plotësoni fjalitë me një rrethanor qëllimi. Shndërrojini ato në fjali të përbëra me pjesë të nënrenditura qëllimore.

1. Na erdhën shumë mysafirë.

2. Djemtë shkuan në mal.

3. Afërdita çdo verë shkon në Vlorë.

4. Aeroplanët u ngritën në qiell.

5. Ne erdhëm.

### 4. Plotësoni fjalitë me një rrethanor shkak. Shndërrojini ato fjali në fjali të përbëra me pjesë të nënrenditur shkakore.

1. Zogjtë shtegtarë shtegtojnë.

2. Zemra i dridhej.

3. Duhet të nxitojnë.

4. Aeroplanët u ngritën në qiell.

5. I shndërroni fjalitë në fjali të përbëra me pjesë të nënrenditur rrjedhimore.

1. Uji i liqenit ishte i ftohtë. Adriani filloj të dridhej menjëherë.
2. Futbollisti i lodhur nga loja u ul menjëherë.
3. Dëbora u shkri. Rrugët i mbuloi uji.
4. Atë natë ndenjëm shumë vonë, as dy orë gjumë s'i bëmë.
5. Ndërtoni dy fjali me rrethanorë shkakut dhe dy me rrethanorë qëllimi me formë të pashtjelluar foljore.

## RRETHANORI I KUSHTIT

Lexoni dhe analizoni fjalitë e mëposhtme. Vëreni me kujdes fjalët e shkruara me të zeza. Ç'shpreshin ato?

Në rast alarmi, fikni dritat.

Pa njohjen e ligjeve të natyrës, njeriu nuk do ta mposhtë dot atë.

Në pamundësi të depërtoni përpara, pritni përforcime të reja.

Rrethanori i kushtit shpreh një hipotezë ose kusht nga plotësimi i të cilit varet realizimi i veprimit.

Marrëdhëniet e kushtit në fjalinë e thjeshtë shprehen:

a) me ndihmën e një grupi emëror rrethanor të paraprirë nga parafjalë **pa, me** ose **në rast**:

**Pa pjesëmarrjen aktive** të popullit demokracia nuk mund të jetojë.

**Në rast mosmarrëveshjeje**, çështjen e zgjidh gjykata.

**Me kujdes** më të madh mund të prodhojmë aparate më cilësore.

b) me ndihmën e formës së pashtjelluar mohore:

**Pa i njohur** ligjet e natyrës, njeriu nuk do ta mposhtë atë.

c) me ndihmën e një mbiemri përcaktor të veçuar:

**I veshur** me rroba të trasha, njeriu nuk e ndien shumë të ftohtë.

d) me ndihmën e një ndajfoljeje ose shprehje ndajfoljore:

Për pak, do të kishte mbetur **pa hipur**, po t'i ikte aeroplani.

**Në fjalinë e përbërë me nënrenditje** marrëdhënia e kushtit shprehet me ndihmën e pjesës kushtore, që lidhet me kryesoren me lidhëzat kushtore: **në, në qoftë se, po qe se, në rast se, sikur** etj.

Po u thye buka s'ngjitet më.

Në qoftë se nuk vjen ti, s'do të shkoj as unë në ekskursion.

3. Në fjalinë e përbërë me bashkërenditje:

**Më thuj vetëm një fjalë** dhe unë largohem.

## Ushtrime

**1. Në fjalitë e mëposhtme dalloni rrethanorët e kushtit dhe pjesët e nënrenditura kushtore.**

1. S'e arrin dot pa nxituar.
2. Pa virtyte njeriu s'mund të jetë i lumtur.
3. Me mendje të huaja, mjerë këmbët tuaja.
4. Kur ke zemër, ke edhe krahë.
5. Nëse ke fiq, ke edhe miq.

**2. Nga dy fjali të thjeshta formoni dhe shkruani një fjali të përbërë me pjesë të nënrenditura kushtore.**

1. Kujtove qenin. Bëj gati shkopin.
2. Hëngre hudhra. Të bie erë goja.
3. S'do të korrësh. Mbill urov.
4. Vjosa do të vonohet. Ne nuk do ta presim.
5. S'punove me mend në kokë. Nuk do të kesh asgjë.

# RRETHANORI I LEJIMIT

Lexoni me kujdes fjalitë e mëposhtme. Vëreni fjalët e shkruara me të zeza. Ç'farë marrëdhëniesh shprehin ato?

Punonte sa për dy veta, **me gjithë moshën e kaluar**.

**Pavarësisht nga moti i lig**, pemët dhanë shumë fruta.

Rrethanori i lejimit tregon fakt, në kundërshtim me të cilin kryhet veprimi, fakt që pritej të pengonte veprimin, por që nuk e pengon dhe në fund lejon që të kryhet veprimi.

**1. Kundërshtimi dhe lejimi në fjalinë e thjeshtë** shprehet:

a) me ndihmën e një grupi emëror të paraprirë nga parafjala **me**:

**Me gjithë vështirësitë ekonomike**, ai e kreu shkollën me sukses.

b) me ndihmën e një forme të pashtjelluar mohore të paraprirë nga lidhëza **edhe**:

**Edhe pa dëgjuar**, unë e dija mendimin e tij.

**Edhe duke vrapuar**, s'ka për të arritur në kohë.

c) me një mbiemër të veçuar të paraprirë nga lidhëzat **edhe, ndonëse**,

**megjithëse etj.:**

**Edhe i vdekur**, armiku mbetet armik.

**Ndonëse i lodhur shumë**, Afrimi e vazhdoi punën.

**2. Në fjalinë e përbërë kundërshtimi dhe lejimi shprehen:**

a) me anë të një pjese të nënrenditur lejore që ka në krye këto lidhëza lejore: megjithëse, ndonëse, edhe pse, sado që:

**Megjithëse rruga ishte e largët, dhe e vështirë**, asnjë nga shokët tanë nuk u tremb.

**Edhe pse ishin të lodhur nga punët e ditës**, e ndihmuan fshatin.

**Sado shpejt të vraponte**, Luani nuk e arrinte dot.

**Sado që të kishte punë**, përsëri i ndihmonte prindërit.

## **Ushtrime**

**1. Dalloni grupet e fjalëve ose pjesët e nënrenditura që shprehin kundërshtim e lejim.**

1. Sado që e torturonin armiqtë, ne ishim të sigurt se ai nuk do të tregonte asnjë.
2. Edhe pse dëgjoji të trokitura te porta e madhe e oborrit, Dritani nuk priti më.
3. Djaloshi sado i ngarkuar rëndë, nxitonte përpara.
4. Ai nuk u shtrua në spital, me gjithë këshillat e mjekut.
5. Edhe i sëmurë në shtrat, Gazmendi s'e lëshonte librin nga dora.

**2. Shndërrojini fjalitë e përbëra me bashkërenditje kundërshtore në fjali të përbëra me nënrenditje lejore.**

1. Shumë herët u zgjua atë natë Bekimi, por nuk u ngrit asnjëherë nga shtrati.
2. Korriku ishte në të dalë , po mbi të lashtat e Drithasit nuk ishte vënë drapri.
3. Ai ishte i lodhur, por në fytyrën e tij shkëlqente hija e një gëzimi djaloshar.
4. Stavri nuk e kishte familjen afër, po megjithatë ai e ndjente ngrohtësinë e saj.
5. Në dhomë s'kishte hyrë ende drita e mëngjesit, por Dini nuk e ndezi dritën.

# FJALIA E PËRBËRË ME MË SHUMË SE DY PJESË

Në të folur a në të shkruar nuk përdoren vetëm fjali të thjeshta, por edhe fjali të përbëra me më shumë se dy pjesë. Pjesët e fjalive të përbëra mund të bashkohen me kombinime nga më të ndryshmet të bashkërenditjes dhe të nënrenditjes. Prandaj përbërja e tyre strukturore mund të jetë shumë e ndryshme dhe e larmishme.

Kështu dallohen:

1. Fjali të përbëra me bashkërenditje.
2. Fjali të përbëra me nënrenditje
3. Fjali të përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje.

Rikujtohuni!

**Si ndërtohen fjalitë e bashkërenditura?**

**Me se lidhen ato ndërmjet veti?**

**Sa lloje fjalish të bashkërenditura dallojmë në gjuhën tonë?**

**Analizoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni me çfarë mjetesh janë bashkuar ato.**

Dielli humbi tej, pas kodrave e malet u bënë të errëta. As çizmet nuk i përplasi pas dyshemesë, as zërin nuk e ngriti. Era vinte nga shpatet e maleve dhe sulej poshtë luginës së Kolonjës drejt detit, ndërsa pemët përkuleshin.

**Diskutoni dhe komentoni për to. A mund të qëndrojnë si fjali më vete po t'i ndajmë?.**

**Fjalja e përbëre me më shumë se dy pjesë me bashkërenditje me lidhëza dhe pa lidhëza**

Nga fjalitë e mësipërme po veçojmë fjalinë:

Era vinte nga shpatet e maleve dhe sulej poshtë luginës së Kolonjës drejt detit, ndërsa pemët përkuleshin.

Kjo fjali përbëhet nga tri fjali (tri pjesë) të lidhura ndërmjet veti me lidhëzat **dhe e ndërsa.**

Skematikisht mund ta paraqesim kështu:



### Paraqitni skematikisht këto fjali:

Ata ikën përpjetë, kurse unë zbrita poshtë dhe u futa në kafene.

Nxori jataganin me vështirësi dhe deshi të zbriste shkallët.

Ka raste kur pjesët e fjalive të përbëra nuk lidhen me lidhëza, por me mjete të tjera. Në të folur dallohen nga intonacioni dhe pauza, ndërsa në të shkruar me anë të presjes ose pikëpresjes.

Skema e këtyre paraqitet pak më ndryshe.

Më poshtë po shënojmë skemën e këtyre fjalive.

Do të këndojmë, mos u dëshpëro.

Do të këndojmë	mos u dëshpëro
----------------	----------------

2. Ishte një fushë me lule shumë, nëpërmes saj shkonte një lumë, dy qe po kullotnin bar.

Ishte një fushë me lule shumë,	nëpërmes saj shkonte një lumë,	dy qe po kullotnin bar.
-----------------------------------	-----------------------------------	-------------------------

## Fjalitë e përbëra me më shumë se dy pjesë me nënrenditje

Te fjalitë e përbëra me më shumë se dy pjesë të nënrenditura dallojmë dy forma kryesore të nënrenditjes;


- a) nënrenditjen paralele dhe
- b) nënrenditjen varg ose të varguar.

Nënrenditja është paralele kur me pjesën kryesore lidhen drejtpërdrejt dy ose më tepër pjesë të nënrenditura. P.sh.:

Ata i kishin thënë tashmë të gjitha fjalët/me të cilat njerëzit mund të merren vesh, /megjithëse kishin folur aq pak.




Skema e kësaj fjalie është kjo:



## Fjalja e përbërë me më shumë se dy pjesë

Dy pjesë kryesore bashkërenditen ndërmjet tyre dhe plotësohen nga një pjesë e nënrenditur e shkallës së parë:

Kur arriti autobusi në fshat, (1) hëna kishte dalë dhe (2) fshati kishte rënë në qetësi.



Analizoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni si do të zinin vend në skemë.


Posa plaku i tha këto fjalë, psherëtiu një herë, sikur të merrte frymë.  
Ata e dinin, përse luftonin dhe ku shkonin.

b) Në nënrenditjen varg ose të varguar fjalitë me pjesë të nënrenditur kanë një pjesë kryesore, një pjesë të nënrenditur nga kryesorja, që quhet e shkallës

së parë, një pjesë të nënrenditur nga e nënrenditura e shkallës së parë që quhet e shkallës së dytë, e kështu me radhë. P.sh.:

Po më duket se e kërkon nevoja (fjali e varur e shkallës së parë) të sqarohen çështjet me rëndësi, (fjali e varur e shkallës së dytë) përpara se të shtrënim punën e shoqatës (fjali e varur e shkallës së tretë), që duhej ngritur (fjali e varur e shkallës së katërt).

Kjo fjali e përbërë ka këtë skemë:



Ushtrime


### Bëni skemën e fjalive të mëposhtme.

Përpara syve i doli fushëza e shtrydhur midis një morie kodrash dhe e çarë nga një vazhdë e përdredhur.

Në shtabin kryesor i kishin premtuar se do ta marrin posa t'ia dorëzojë Norës letrën, të cilën e mbante të qepur nën jakën e jelekut.

Ka edhe fjali të përbëra me më shumë se dy pjesë, me lidhje të përzier (me bashkërenditje dhe me nënrenditje) ku kemi kombinime nga më të ndryshmet të nënrenditjes dhe bashkërenditjes. P.sh.:

Mjeku e ndiente veten edhe më të tronditur, sepse ndoshta ishte ngutur, e kishte gjykuar Leksën me të pa drejtë.



## **Bëni skemën e fjalisë së mëposhtme.**

Skënderbeu e tërhoqi ushtrinë në veri, nga mund të vrojtonte lëvizjet e mundshme të sulltanit dhe (nga) mund të rregullonte furnizimin.

Ushtrime

## **Dalloni fjalitë e përbëra me bashkërenditje, me nënrenditje dhe me lidhje të përzier.**

1. Dielli humbi tej, pas kodrave e malet u bënë të errëta. 2. Pas disa çaste mbi kodrën e vogël pllakosi heshtja e natës që prishej vetëm nga zhurma e valëve të detit. 3. Megjithëse ishin ditët e fundit të shtatorit, shi s'pati rënë asnjë bulë dhe ajri ishte i ngrohtë, i palëvizshëm e i rëndë si në kohë vere. 4. Në krye të prillit, Skënderbeu zbriti në Dibër se kishte dëgjuar se një ushtri turke po afrohej në kufi. 5. Kur njeriu rikthehet në vendin ku ka kaluar fëmijërinë gjithçka i duket zakonisht më e vogël: shtëpitë, oborri, lartësitë e mureve.

## **FJALIA E PËRBËRË ME PJESË TË NËNRENDITURA**

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni prej sa pjesësh janë përbërë ato. A mund të qëndrojnë më vete po t'i ndajmë ato në fjali të thjeshta? Vëreni lidhëzat dhe mjetet lidhëse të pjesëve të nënrenditura.

Agroni dalloi Teutën, **që zvarritej përpara tij.**

Fyellin e mësoi nga një bari, **që kulloste dhentë buzë lumit në vendlindjen e tij.**

Klaudi e kuptoi **se djaloshi kishte një fyell të ri.**

Vajzës nuk i kujtohej dita **kur kishte dalë në fotografi.**

**Që atë ditë që u nda nga Tana,** nuk i qeshi buza.

Njeriu **që gënjen** të lë në mes të udhës.

Nga shembujt e mësipërm shihet se pjesët e fjalive të përbëra nuk janë të një vlere, por njëra e plotëson tjetrën. Fjalitë e nënvizuara lidhen me fjalitë kryesore me anë të lidhëzave të ndryshme nënrenditëse dhe kryejnë po ato funksione që kryejnë **gjymtyrët plotësuese në fjalinë e thjeshtë**; d.m.th. funksionin e **përcaktorit, kundrinorit, rrethantorit** etj. .

Fjali të përbëra me nënrenditje janë ato që të paktën përbëhen prej dy pjesësh, nga të cilat njëra është kryesore (e pavarur), ndërsa tjetra e nënrenditur apo e varur nga kryesorja.

Fjalitë e nënrenditura lidhen me kryesoren:

**me anë të lidhëzave të ndryshme nënrenditëse: se, që, si, posi, megjithëse etj.**

b) **me fjalë lidhëse- me përemra lidhorë dhe me disa ndajfolje lidhore: që, cili, cila, ku, kur etj.** sipas funksionit që kryejnë, dallohen disa lloje pjesësh të nënrenditura, si: pjesë përcaktore ffilluese, kohore, vendore, shkakore, kushtore, lejore, rrjedhimore etj.

## Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur përcaktore

Lexoni fjalitë e mëposhtme. Ç'funksion kryejnë pjesët e nënrenditura në fjalinë e përbërë? Me ç'mjete lidhen ato me kryesoren?

Fyellin e mësoi nga një bari, **që kulloste dhentë buzë lumit.**

Njeriu **që vetëm për vete punon**, është si një dru që pemë s'lëshon.

Njeriu **që gënjen** të lë në baltë.

Ohri është një qytet **në të cilin shëtitet me kënaqësi.**

### Funksioni

Ashtu si mbiemrat dhe emrat ose grupet emërore në fjalinë e thjeshtë, pjesa e nënrenditur përcaktore kryen në fjalinë e përbërë funksionin e përcaktorit.

### Ndërtimi

Pjesa e nënrenditur përcaktore lidhet me paraprijësin e pjesës kryesore me përemra lidhorë **që, i cili, e cila, të cilët etj.**, ose mund të lidhet me fjalë lidhëze **ku, kur** të përdorura si përemra lidhorë dhe që mund të zëvendësohet me përemra lidhorë.

Degët e pishave gërshetoheshin si çadra të mëdha **ku mezi depërtonin rrezet e diellit.** ( në të cilat mezi depërtonin rrezet e diellit)

### Rendi i pjesëve

Pjesa e nënrenditur përcaktore varësisht nga vendi ku ndodhet paraprijësi (në fund të pjesës kryesore ose në mes të saj) mund të na paraqitet në dy pozicione të ndryshme:

a) pas pjesës kryesore:

Fyellin e mësoi nga ai bari **që kulloste dhentë buzë lumit.**

b) në mes të pjesës kryesore:

Dini, i cili akoma nuk ishte shkëputur mirë nga ëndërrimet e tij, iu përgjigj me vonesë.

## Përdorimi i presjes

Midis paraprijësit dhe pjesës së nënrenditur përcaktore vihet presje, kur pjesa e nënrenditur, ashtu si një përcaktor i veçuar, vetëm shton diçka për paraprijësin, por nuk

Vetëm atëherë nxënësit e vunë re mësuesin, që ishte kthyer para disa ditësh nga pushimet verore.

Në këtë rast nuk ka nevojë të pyesim: Cilin mësues?, prandaj edhe pjesa e nënrenditur përcaktore vjen pas një pauze të shkurtër dhe në të shkruar ndahet me presje.

Por, kur paraprijësi është një përemër që tregon një person të papërcaktuar atëherë pjesa e nënrenditur shqiptohet menjëherë pas paraprijësit, e në të shkruar nuk ndahet me presje. P.sh.:

Vetëm atëherë nxënësit e dalluan plakun **që rrinte nën hijen e një peme.**

Vetëm atëherë njerëzit e vunë re atë **që rrinte nën hijen e një peme.**

Në këtë rast, pyesim **cilin plak?** ose **cilin?** Përveç kësaj, në vend të përemrit **që** nuk mund të përdorim përemrin **i cili**. Kur pjesa e nënrenditur përcaktore është në mes të pjesës kryesore, në fund të saj vihet presje. **P.sh.:**

Coli, **që nuk e priste këtë pyetje**, mbeti.

## MBANI MEND

**Pjesa e nënrenditur përcaktore** kryen në fjalinë e përbërë rolin e përcaktorit të një gjymtyre të pjesës kryesore, që quhet **paraprijës**.

Ajo lidhet me paraprijësin me anë të përemrit lidhor **që (i cili)** ose me fjalët lidhëse ku, kur, të përdorura si përemër lidhor.

Kur paraprijësi është i dalluar qartë (është i njohur) dhe pjesa e nënrenditur vetëm shton diçka, midis tyre vihet presje.

Kur pjesa e nënrenditur shërben për ta dalluar brenda llojit të vet atë që tregon paraprijësi, midis tyre nuk vihet presje.

**Pjesa e nënrenditur filluese** kryen në fjalinë e përbërë funksionin e kryefjalës (**cila gjë**) ose të kundrinorit të drejtë (**cilën gjë**) të pjesës kryesore.

**Lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave filluese që, se ose drejtpërdrejt me një folje në mënyrën lidhore (po edhe me sikur, në etj.)**

## Ushtrime

1. Ndani me një vijë pingule pjesët e fjalive të përbëra, nënvizoni mjetin lidhës dhe pjesët e thoni llojin e pjesës së nënrenditur.

1. Jeta ime e vërtetë filloi bashkë me ditën që u përmbys kulla e beut.

2. Kur mesnata kish kapërcyer, ai kaloi edhe Mullirin e Ndrekës, të cilin e njohu që nga larg.

3. Ajo vështronte udhën nga kishte ardhur në breg të lumit.
4. Ai që nuk e mban fjalën e dhënë vepron kundër nderit të vet dhe dinjitetit personal.
5. Kënga që sapo dëgjuam u pëlqeu udhëtarëve.

## **2.Ç' funksion kryejnë pjesët e nënrenditura të këtyre fjalive të përbëra.**

1. Me gurët e rëndë e me frëngjitë e lashta, kullat ta thonë shkoqur **se malësorët tanë nuk e kanë njohur kurrë përuljen para cilitdo pushtues.**
2. Ishin tre vëllezër muratorë, **që ndërtonin muret e një kështjellë.** Një plak i urtë u tha **që muret, për të qëndruar, kërkonin një flijim.**
3. Vajzës nuk i kujtohej dita, **kur kishte dalë në fotografi.**
4. Ai i kujtoi shokut kohën, **kur kishin qenë nxënës.**
5. Kjo është punë **që s'bëhet.**
6. Dielli, **që kishte shtangur një copë herë lart mbi kreshta,** u rrokullis prapa maleve.

**3. Lexoni fjalitë e thjeshta. Në vend të përcaktorëve me shkronja të zeza vini një pjesë të nënrenditur përcaktore. Shkruani fjalitë e përbëra që formohen, dhe nënvizoni mjetin lidhës paraprijës.**

1. Degët e mollëve, **mbushur me kokrra të kuqe e të verdha,** po thyheshin nga rëndësia.
2. Në njërën nga shtëpitë të e fshatit, më e larta dhe më e madhja, e kishte çerdhen lejleku.
3. Arkeologët kanë gjetur disa gurë të tipit sëpatë, **dëshmitarë për një kulturë prehistorike të zhvilluar në këtë zonë.**
4. Joan Kukuzeli ka punuar në kapelën perandorake të Kostandinopojës, **e famshme në të gjithë Evropën.**

**Shembull:** Vilet e rrushit, **mbushur me kokrra të bardha, të kuqe e të zeza,** po çaheshin nga ëmbëlsia.

Vilet e rrushit që ishin mbushur me kokrra të bardha, të kuqe e të zeza, po çaheshin nga ëmbëlsia.

## **Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur ffilluese**

### **Funksioni**

Ashtu si emrat, grupet emërore ose përemrat në fjalinë e thjeshtë, pjesa e nënrenditur ffilluese kryen në fjalinë e përbërë funksionin e kryefjalës ose të kundrinorit të drejtë.

Kjo fjali lidhet me lidhëzat filluese se dhe **që** dhe kryen funksionin :

a) **të kryefjalës** dhe quhet fjali filluese kryefjalore:

Dihet **se lumi Vardar buron në Vrutok**. ( Ç'dihet = burimi i lumit Vardar.);

b) të kundrinorit: E dimë **se Toka rrotullohet rreth Diellit** . (Cilën gjë e dimë = rrotullimin e Tokës rreth Diellit.).

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, pjesa e nënrenditur filluese është ose kryefjalë ose kundrinor i drejtë i foljes së pjesës kryesore me të cilin ai ka lidhje të ngushtë.

## Fjalια e përbërë me pjesë të nënrenditur vendore

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur vendore.

1. Ata qëndruan aty **ku udha ndahej për në mëhallën e mësipërme**.
2. Gjuha shkon **ku dhemb dhëmbi**.
3. **Ngado që të hedhësh sytë**, sheh vetëm dëborë.
4. Fëmija kaloi **nga ishte prishur gardhi**.
- 5 Altini, **kudo që të shkonte**, i binte fyellit.

### Funksioni

Në fjalitë e mësipërme pjesët e nënrenditura tregojnë vendin ku kryhet veprimi i shprehur nga folja e pjesës kryesore.

Kjo bëhet ose duke saktësuar përmbajtjen e një ndajfoljeje vendi të pjesës kryesore ose duke plotësuar pjesën kryesore. Shih shembullin 1. Si ndajfolje vendi të pjesës kryesore që saktësohen nga pjesa e nënrenditur vendore përdoren: **aty, atje, andej, deri atje**.

Rrënjët e së keqes lëshojnë degë **aty ku nuk shkulen me kobë**.

Ai shikoi me bisht të syrit **andej nga i erdhi zëri**.

Pjesa e nënrenditur kryen funksionin e rrethanorit të vendit dhe gjendet me pyetjet **ku? nga?**.

### Ndërtimi

Pjesa e nënrenditur vendore bashkohet me pjesën kryesore me lidhëzat nënrenditëse vendore **ku, nga, tek si** dhe me shprehjet lidhëzore **kudo që, ngado që, te do që** etj.

### Rendi i pjesëve

Pjesa e nënrenditur vendore zë pozicione të ndryshme në fjalinë e përbërë:

Kur saktëson një ndajfolje vendi të pjesës kryesore, ajo qëndron ose prapa pjesës kryesore ose në mes të saj:

Ai shikoi me bisht të syrit *andej nga i erdhi zëri*.

Atje **ku lumi ishte i cekët**, kaluan pa vështirësi.

### **Përdorimi i presjes**

Kur pjesa e nënrenditur vendore ndodhet para kryesores ose në mes, ajo ndahet gjithmonë me presje.

## **Fjalialia e përbërë me pjesë të nënrenditur kohore**

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni pjesët e nënrenditura të shkruara me shkronjë të zeza. Ç'funktion kryejnë ato?

**Kur turbullohet**, atëherë kullotet.

Në mëngjes, **kur u zgjua plaka prej gjumit**, pa që shtrati i Mitit ishte bosh.

Hekuri rihet **sa është i nxehtë**.

**Që kur ka ardhur si drejtor**, punët shkojnë mirë.

Fjalitë e mësipërme janë fjali të përbëra me pjesë të nënrenditura kohore.

### **Funksioni**

Pjesa e nënrenditur kohore kryen në fjalinë e përbërë një funksion të ngjashëm me atë të **rrethanorit të kohës** në fjalinë e thjeshtë dhe tregon kohën kur kryhet veprimi i shprehur nga folja e pjesës kryesore.

U përgjigjet pyetjeve : **kur?**, **që kur?**, **deri kur?**.

### **Ndërtimi**

Pjesa e nënrenditur kohore mund të plotësojë rrethanorin e kohës dhe lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse kohore **kur, që kur, sa, derisa, tek, si, pasi, para se, ndërsa, sa kohë që, sapo, porsa** etj. P.sh.:

Vjollcën *e takova dje*, **kur kthehesha nga shkolla**.

Pjesa e nënrenditur kohore mund të shprehë:

a) **marrëdhënie parakohësie** dhe lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse kohore: **para se, përpara se, dhe e** ka foljen gjithmonë në mënyrën lidhore. P.sh.:

Mendohu mirë, **para se të fillosh punën**.



Bleta bën dyllin, **para se të bëjë mjaltë.**

Ecën pa u ndalur, **gjersa u err.**

b) **marrëdhënie njëkohësie** dhe lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse kohore: **kur, tek, sa, ndërsa, sa kohë që.**

S'të shkon kot moti, **kur je i zoti.**

**Sa rron,** mëson.

Kur arriti ushtria shqiptare përpara Beratit, turqit ishin gati së gjithash.;

c) **marrëdhënie paskohësie** dhe lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse kohore: si, pasi, mbasi, sapo, posa, porsa:

**Sa mbaruam mësimin,** filluam të bisedojmë për lojën.

**Posa e pa dhelprën langoi,** iu lëshua me vrap.

### **Rendi i pjesëve**

Pjesa nënrenditur kohore mund t'i zërë të tri pozicionet në fjalinë e përbërë: prapa, në mes dhe pas kryesores. Vërtetoheni këtë me fjali nga shembujt e sjellë më sipër. Vëreni përdorimin e presjes.

### **MBANI MEND**

Pjesa e nënrenditur kohore kryen një funksion të ngjashëm me atë të rrethanorit të kohës në fjalinë e thjeshtë. Ajo mund të zërë të tria pozicionet: para, pas dhe në mes kryesores dhe mund të shprehë marrëdhënie: parakohësie, njëkohësie dhe paskohësie.

Kur ndodhet para pjesës kryesore ndahet me presje: **Kur hahen qentë,** i ha ujku dhentë.

Kur ndodhet në mes vihet ndërmjet dy presjeve: Bleta, **para se ta bëjë mjaltin,** e bën dyllin.

Kur vjen pas kryesores nuk ndahet me presje: Hekuri rrihet **sa është i nxehtë.**

Lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse kohore.

### **Ushtrime**

Dalloni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur të këtyre fjalive të përbëra dhe tregoni llojin e tyre.

Ku e ke punën, shtro gunën.

Mos e lëndo ku i dhemb.

Ruaje zogun sa e ke në dorë.

Në mbrëmje, kur dielli i purpurt iu afrua majës së Bjeshkëve të Nëmura, djemtë shkuan në kampin e skiatorëve.

Vëllai erdhi atëherë kur nuk e prisnin .

Vrapoi me shpejtësi derisa u zhduk thellë në pyll.

2. Më poshtë janë dhënë lidhëzat e nënrenditura kohore dhe vendore dhe pjesa kryesore. Plotësoni pjesën e nënrenditur.

Ku.....vete gjuha.

Ku....., atje shkonte.

Ngado që .....këndonte.

Kur ..... , çelin lulet.

Para se..... i bëj detyrat.

Pasi .....bujku e mbjell farën.

3. Ndërtoni dhe shkruani nga dy fjali të përbëra me pjesë të nënrenditur kohore që shprehin marrëdhënie:

parakohësie,

njëkohësie,

paskohësie.

## Fjalta e përbërë me pjesë të nënrenditur shkakore

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni ato të shkruara me shkronja të zeza.

E lëndoi se **është tamam burrë**, mburrej gjyshja.

Nuk fjeti gjyshi, **sepse fëmijët bënëin zhurmë**.

Ardiani u gëzua shumë **se e takoi Artanin**.

**Meqenëse ishte vjeshtë**, puna mbeti për verën e motit të afërm.

### Funksioni

Pjesa e nënrenditur shkakore kryen në fjalinë e përbërë një funksion të ngjashëm me atë të rrethanorit të shkakut në fjalinë e thjeshtë:

Nuk i pëlqente, **sepse nuk i shkonte pas qejfit**.

### Ndërtimi

Pjesa e nënrenditur shkakore lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse shkakore: **se, sepse, ngaqë, për shkak se, për arsye se, meqë, me qenë se, përderisa** etj. U përgjigjet pyetjeve: **përse?**, **për ç'arsye?**, **për**

ç'shkak? etj.

### Rendi i pjesëve

Pjesa e nënrenditur shkakore mund të ndodhet :

**a) para kryesores:**

**Meqë ishte vonë**, nuk shkova te shoku.;

**b) në mes:**

E lëvdoi, **se është tamam burrë**, mburrej gjyshja.;

**c) në fund:**

Bekimi më pëlqen, **se i del zot çdo pune të vështirë**.

### Përdorimi i presjes

Komentoni përdorimin e presjes në shembujt e mësipërm.

Në çdo pozicion qoftë, pjesa e nënrenditur gjithmonë ndahet me presje.

## Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore

Analizoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni ç'funksion kryejnë fjalitë e shkruara me shkronja të zeza:

Stadiumi nuk nxinte më, **kështu që mjaft sportdashës mbetën jashtë**

Ishte një situatë e tillë, **që askush se kursente veten.**

Ulëriti njëherë **sa u tund pylli.**

### Funksioni

Pjesa e nënrenditur rrjedhimore tregon rrjedhimin a pasojën e një veprimi a të ngjarjeje për të cilën bëhet fjale në pjesën kryesore:

U bë një tollovi e madhe, **kështu që s'u kuptua asgjë.**

### Ndërtimi

Pjesa e nënrenditur rrjedhimore lidhet me kryesoren me lidhëzat nënrenditëse: **kështu që, që, sa, saqë**. P.sh.:

Ata njerëz kanë bërë diçka, **që janë mbledhur ashtu grumbull.**

Shirat binin pa pushim, **kështu që edhe vërshimet ishin të mundshme.**

### Rendi i pjesëve

Pjesa e nënrenditur qëllimore qëndron gjithmonë pas kryesores dhe ndahet gjithnjë me presje nga pjesa kryesore.

## MBANI MEND

- Pjesa e nënrenditur shkakore kryen në fjalinë e përbërë një funksion të ngjashëm me atë të rrethanorit të shkakut në fjalinë e thjeshtë.

- Pjesa e nënrenditur rrjedhimore tregon rrjedhimin e veprimit të shprehur në pjesën kryesore.

## Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur mënyrore

Analizoni fjalitë e mëposhtme. Ç'funksion kryen pjesa e nënrenditur?

**Ashtu si erdhën**, ashtu u zhdukën.

Zemra i rrihte **sikur kërkonte të rrihte nga gjoksi**.

**Si bëfsh**, gjetsh.

Ta duash dhe ta nderosh, **ashtu si të ka hije**.

### Funksioni

Pjesa e nënrenditur mënyrore kryen një funksion të ngjashëm me atë të rrethanorit të mënyrës në fjalinë e thjeshtë:

Nxënësi i mirë vepron, **ashtu siç e këshillon mësuesi**.

### Ndërtimi

Pjesa e nënrenditur mënyrore lidhen me kryesoren me anë të lidhëzave nënrenditëse mënyrore: **si, siç, ashtu si, ashtu siç, sikur** etj., dhe u përgjigjet pyetjeve: **si?, qysh?, në ç'mënyrë?**

### Rendi i pjesëve

Zakonisht pjesa e nënrenditur mënyrore qëndron pas pjesës kryesore, por ajo mund të dalë edhe përpara dhe ndonjëherë të futet edhe në mes të saj. P.sh.:

Hëna, si të rridhte një prua i argjendtë, e mbushi fushën me dritë.

Shihni dhe analizoni shembujt e mësipërm.

### Përdorimi i presjes

Në të tria pozicionet e mundshme, pjesa e nënrenditur mënyrore zakonisht ndahet me presje. Vetëm kur vjen pas pjesës kryesore, nuk ndahet me presje.

Zemra i rrihte, sikur **kërkonte te dilte nga gjoksi**.

Shpjegoni përdorimin e presjes në fjalitë e mësipërme.

## Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur krahasore

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni pjesët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'funktion kryejnë ato?.

**Sa i donte lulet Beni,** aq i donte edhe Genci.

**Sa e egër bëhej lufta e armiqve kundër tij,** aq më e vendosur bëhej lufta e tij kundër armiqve.

**Sa i gjallë ishte djali,** aq e turpshme ishte vajza.

**Sa më thellë që futeshin,** aq më tepër i merrej fryma.

### Funksioni

Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur krahasore shërben për të krahasuar një veprim a një dukuri me një tjetër. Krahasimi mund të tregojë barazi ose pabarazi.

### Ndërtimi

Kur krahasimi tregon barazi, pjesa e nënrenditur krahasore lidhet me kryesoren me lidhëzat nënrenditëse **sa** dhe **aq sa**, të cilave në pjesën kryesore u përgjigjen ndajfolja aq:

Aq sa i donte Beni lulet, aq i donte edhe Genci..

Kur barazimi tregon pabarazi, pjesa nënrenditur krahasore lidhet me kryesoren me anë të lidhëzave **se, sesa, nga, nga sa** etj., të cilave në pjesën kryesore u përgjigjet një përemër ose një ndajfolje në shkallën krahasore.

S'ka gjë më të mirë, sesa të merremi vesh me të mirë.

Beni i donte lulet më shumë, nga që i donte Genci.

### Rendi i pjesëve

Pjesa e nënrenditur krahasore e barazisë (që fillon **me sa, aq sa**) qëndron pas kryesores.

Pjesa e nënrenditur krahasore e pabarazisë (që fillon **me se, sesa, nga, nga sa**) qëndron pas kryesores.

**Për këtë shihni shembujt e sjellë më lart.**

### Përdorimi i presjes

Pjesa e nënrenditur krahasore e barazisë (**sa, aq sa,**) ndahet gjithmonë me presje nga kryesorja, si dhe pjesa e nënrenditur e pabarazisë që lidhet me lidhëzat(**se, sesa, nga, nga sa**):

**Sa më thellë që futeshin,** aq më tepër i merrej fryma.

Kur lidhet drejtpërdrejt me mbiemrin ose ndajfoljen në shkallën krahasore

që lidhet me pjesën kryesore, nuk ndahet me presje:  
Djalit iu duk ndryshe, nga ç'e kishte njohur përpara.

### **MBANI MEND**

**Pjesa e nënrenditur mënyrore** kryen në fjalinë e përbërë një funksion të ngjashëm me atë të rrethanorit të mënyrës në fjalinë e thjeshtë.

**Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur krahasore** shërben për të krahasuar një veprim a një dukuri me një tjetër, duke treguar barazi ose pabarazi.

### **Ushtrime**

Analizoni fjalitë e mëposhtme. Dalloni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur dhe tregoni llojin e kësaj të fundit.

Provoja të tregohesha tjetër nga ç'isha me të vërtetë.

Jeta këtej e kishte bërë të sajën më shpejt, se ç'do ta bënte në fshat.

Tingujt e kitarës përziheshin me të klarinetës dhe të fizarmonikës, ashtu si përziheshin meloditë e kaltra të detit me meloditë e bardha të alpeve.

Siç kujdesemi për veten, të kujdesemi për shokun.

Shkruani nga dy fjali të përbëra me pjesë të nënrenditur mënyrore dhe krahasore.

## **Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur qëllimore**

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni pjesët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'funksion kryejnë ato?

Babai punon shumë **që fëmijët të jenë të lumtur.**

**Që të mos i shprishnim qetësinë plakut** edhe anekdotat i tregonin me zë të ulët.

Erdha **me qëllim që t'i them të tëra në sy.**

Nxënësit duhet të mësojnë, **që të fitojnë dituri.**

Në fjalitë e mësipërme pjesët e shkruara me shkronja të zeza janë pjesë të nënrenditura qëllimore.

### **Funksioni**

Pjesa e nënrenditur qëllimore kryen një **funksion të ngjashëm** me atë **të rrethanorit të qëllimit** në fjalinë e thjeshtë: tregon qëllimin për të cilin kryhet veprimi i shprehur i pjesës kryesore dhe u përgjigjet

pyetjeve: **përse?**, **me ç'qëllim?**.

### **Ndërtimi**

Pjesa e nënrenditur qëllimore bashkohet me pjesën kryesore me lidhëzat qëllimore: **që, me qëllim që, në mënyrë që**. P.sh.: Fliste me zë të ulët **që të mos i pengonte të tjerët**.

Shpesh pjesa e nënrenditur qëllimore bashkohet me kryesoren edhe pa lidhëz, përkatësisht vetëm me foljen **në mënyrën lidhore**. P.sh.: Mërgimtarët çdo vit **vijnë ta vizitojnë vendlindjen dhe të çmallen me të afërmit**.

### **Rendi i pjesëve**

Pjesa e nënrenditur qëllimore mund të zërë të tria pozicionet në fjalinë e përbërë, por më shpesh qëndron pas pjesës kryesore.

Petriti shkoi **që ta thërrasë Agimin**.

Ai, **që të mos vonohej**, u ngrit shumë herët.

### **Përdorimi i presjes**

Pjesa e nënrenditur qëllimore zakonisht ndahet me presje në të gjitha pozicionet. Nuk vihet presje vetëm kur ajo vjen pas kryesores dhe lidhet drejtpërdrejt me foljen e pjesës kryesore, p.sh.: Duhet të guxosh **që të mos kesh frikë**.

**Analizoni edhe një herë fjalitë e mësipërme dhe vërtetoni se në ç'rast përdoret presja.**

## **Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur kushtore**

Analizoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni pjesët e nënrenditura.

**Në qoftë** se ke mësuar, do ta kalosh klasën.

**Po të mos jesh mirë**, po rri me ty.

**Sikur të më ketë besuar**, do ta kemi më lehtë.

Më falni, po fëmijës, **po s'qau**, nuk i japin të pijë.

Ajo s'do të kishte ardhur në spital, **po të mos më kishte ndodhur aksidenti**.

### **Funksioni**

Pjesa e nënrenditur kushtore është ajo pjesë që tregon kushtin, nga

përmbushja e të cilit varet realizimi ose mosrealizimi i asaj që thuhet në pjesën kryesore.

### **Ndërtimi**

Pjesa e nënrenditur kushtore bashkohet me pjesën kryesore në dy mënyra:

- me lidhëza nënrenditëse kushtore: **në, në qoftë se, nëse, po, po qe se, sikur, kur** etj. P.sh.: **Nëse** vjen edhe ti, do të shkojmë në dasmë.

- pa lidhëz në mënyrën lidhore: S'fluturonte zogu, **të mos kishte** krahë.

### **Rendi i pjesëve**

Pjesa e nënrenditur kushtore më shpesh qëndron para pjesës kryesore, por mund të vijë edhe pas ose të futet në mes të saj.

### **Përdorimi i presjes**

Në cilindo vend qoftë, pjesa e nënrenditur kushtore ndahet gjithmonë me presje (kur është në mes të kryesores, vihet midis dy presjesh, shih shembujt e mësipërm).

### **Ushtrim**

1. **Shkruani tri fjali me pjesë të nënrenditur kushtore duke përdorur lidhëzat: nëse, në qoftë se, po qe se.**

## **Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur lejore**

Analizoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni ç'funksion kryejnë pjesët e nënrenditura.

**Megjithëse rruga ishte e largët dhe e vështirë,** asnjë nga shokët tanë nuk u tremb.

**Kushdo që të ishte,** fjalët e nënës do ta preknin thellë.

**Sado i zoti që të jesh,** do të kesh nevojë për ndihmën e shokëve.

### **Funksioni**

Pjesa e nënrenditur lejore tregon një veprim i cili pritej ta pengonte kryerjen e veprimit të shprehur në pjesën kryesore, por nuk arrin ta pengojë dhe lejon që të kryhet, p.sh.:

Edhe pse vdiq shumë i ri, Migjeni na la një vepër të rëndësishme.

### **Ndërtimi**



Pjesa e nënrenditur lejore bashkohet me kryesoren me anë të lidhëzave nënrenditëse: **megjithëse, megjithëqë, ndonëse, sado që, sido që, edhe sikur, edhe pse** etj, si dhe me përemrat: **kushdo, cilido, çfarëdo** etj.

### **Rendi i pjesëve**

Pjesa e nënrenditur lejore qëndron zakonisht para kryesores, por ajo mund të vijë edhe pas kryesores ose të futet në mes të saj, p.sh.:

Gënjeshtari, **sado mjeshteri të ketë**, mbetet gënjeshtar.

### **Përdorimi i presjes**

Në cilindo vend që të ndodhet pjesa e nënrenditur lejore ndahet gjithmonë me presje.

Kur është në mes të kryesores, vihet midis dy presjesh.

**Shpjegoni përdorimin e presjes në shembujt e mësipërm.**

## **MBANI MEND**

**Pjesa e nënrenditur qëllimore** kryen në fjalinë e përbërë një funksion të ngjashëm me atë të rrethanorit të qëllimit në fjalinë e thjeshtë.

**Pjesa e nënrenditur kushtore** tregon kushtin që duhet plotësuar që të realizohet dukuria ose veprimi i shprehur në pjesën kryesore.

**Pjesa e nënrenditur lejore** tregon një dukuri ose veprim që duhej ta pengonte kryerjen e dukurisë ose veprimit të shprehur në pjesën kryesore, por që nuk arrin ta pengojë.

## **Ushtrime**

### **1. Dalloni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur.**

Ata ndenjen tërë natën, kështu që nuk fjetën asnjë orë.

Ishte situata e tillë që askush se kursente veten.

Dhoma ishte mbushur plot, aq sa të zihet fryma.

Ndonëse e kishte shkuar tërë jetën në beteja, Skënderbeu ishte plagosur vetëm një herë në shpatull.

### **2. Dalloni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur dhe thoni ç'lloj është kjo e fundit.**

Kjo veper, ndonëse është shkruar 450 vjet më parë, nuk e ka humbur aspak rëndësinë e saj.

Gënjeshtër, sado ta fshehësh, do të dalë në dritë.

I pihej vazhdimisht ujë, megjithëse i kishte lagur buzët kushedi sa herë nëpër burime.

Edhe pse kanë kaluar kaq vjet, akoma nuk e kam harruar.

